

PËRMBAJTJA

VENDIME ME OBJEKT – MARRËVESHJE TË NDALUARA

Nr. 585, Datë 24.01.2019	1
“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”	
Nr. 586, Datë 28.01.2019	7
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”	
Nr. 587, Datë 28.01.2019	9
“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”	
Nr. 592, Datë 31.01.2019	11
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”	
Nr. 599, Datë 15.03.2019	19
“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve”	
Nr. 605, Datë 21.03.2019	21
“Mbi mospranimin e kërkesës së AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve””	
Nr. 612, Datë 19.04.2019	23
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit””	
Nr. 623, Datë 23.05.2019	25
“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”	
Nr. 637, Datë 09.07.2019	31
“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme”	
Nr. 642, Datë 25.07.2019	37
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo””	

Nr. 643, Datë 25.07.2019..... 39

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””

Nr. 655, Datë 01.11.2019..... 45

“Për disa ndryshime në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

Nr. 583, Datë 17.01.2019..... 47

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon””

Nr. 588, Datë 28.01.2019..... 49

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”

Nr. 593, Datë 07.02.2019..... 51

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër” SHA”

Nr. 597, Datë 19.02.2019..... 55

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”

Nr. 600, Datë 15.03.2019..... 57

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Poliçan” SHA”

Nr. 602, Datë 21.03.2019..... 61

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Delvinë” SHA”

Nr. 603, Datë 21.03.2019..... 65

“Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd”

Nr. 604, Datë 21.03.2019..... 69

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””

Nr. 607, Datë 01.04.2019	71
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”	
Nr. 608, Datë 10.04.2019	77
“Mbi detyrimin për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”	
Nr. 609, Datë 10.04.2019	81
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”	
Nr. 611, Datë 10.04.2019	83
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar””	
Nr. 617, Datë 09.05.2019	85
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike””	
Nr. 618, Datë 09.05.2019	87
“Për disa ndryshime në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””	
Nr. 620, Datë 13.05.2019	89
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””	
Nr. 627, Datë 13.06.2019	91
“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”	
Nr. 628, Datë 13.06.2019	93
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetës Kanalizime Tropojë” SHA”	
Nr. 629, Datë 20.06.2019	97
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetës Kanalizime Lushnje” SHA”	
Nr. 630, Datë 20.06.2019	101
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA”	

Nr. 632, Datë 20.06.2019	105
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit””	
Nr. 639, Datë 18.07.2019	107
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës””	
Nr. 640, Datë 25.07.2019	109
“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA”	
Nr. 641, Datë 25.07.2019	113
“Mbi zbatimin periodik të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”	
Nr. 644, Datë 31.07.2019	115
“Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”	
Nr. 645, Datë 31.07.2019	121
“Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit nr. 562, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”	
Nr. 649, Datë 03.10.2019	125
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”	
Nr. 650, Datë 03.10.2019	129
“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA”	
Nr. 652, Datë 10.10.2019	133
“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”	
Nr. 656, Datë 21.11.2019	141
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Krujë” SHA”	
Nr. 657, Datë 21.11.2019	145
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Vlorë” SHA”	

Nr. 658, Datë 21.11.2019	149
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Himarë” SHA”	
Nr. 662, Datë 21.11.2019	153
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””	
Nr. 667, Datë 24.12.2019	155
“Për mbylljen procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënia e disa rekomandimeve”	
Nr. 669, Datë 24.12.2019	163
“Për vijimin e hetimit të hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar””	
Nr. 672, Datë 24.12.2019	165
“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””	

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

Nr. 580, Datë 17.01.2019	167
“Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”	
Nr. 581, Datë 17.01.2019	175
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.”	
Nr. 582, Datë 17.01.2019	177
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK”	
Nr. 590, Datë 31.01.2019	179
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.”	
Nr. 591, Datë 31.01.2019	181
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”	

Nr. 595, Datë 19.02.2019	185
“Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK”	
Nr. 596, Datë 19.02.2019	189
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A”	
Nr. 598, Datë 15.03.2019	191
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH”	
Nr. 601, Datë 21.03.2019	193
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA”	
Nr. 606, Datë 01.04.2019	195
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë”	
Nr. 610, Datë 10.04.2019	197
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”	
Nr. 614, Datë 02.05.2019	201
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd”	
Nr. 615, Datë 02.05.2019	203
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft”	
Nr. 616, Datë 02.05.2019	205
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.”	
Nr. 619, Datë 09.05.2019	209
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.”	

Nr. 621, Datë 13.05.2019	211
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.”	
Nr. 622, Datë 13.05.2019	213
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.”	
Nr. 624, Datë 31.05.2019	217
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”	
Nr. 625, Datë 31.05.2019	219
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH”	
Nr. 631, Datë 20.06.2019	223
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC”	
Nr. 648, Datë 19.09.2019	227
“Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitimin e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”	
Nr. 653, Datë 17.10.2019	233
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj”	
Nr. 654, Datë 23.10.2019	237
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt”	
Nr. 663, Datë 03.12.2019	241
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.”	
Nr. 664, Datë 03.12.2019	243
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG”	
Nr. 671, Datë 24.12.2019	247
“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Gruppo Editoriale S.p.A.”	

VENDIME TË TJERA

Nr. 589, Datë 31.01.2019	249
“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”	
Nr. 594, Datë 07.02.2019	251
“Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”	
Nr. 613, Datë 19.04.2019	255
“Mospranimi i kërkesës së Bankës së Shqipërisë në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”	
Nr. 634, Datë 04.07.2019	257
“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”	
Nr. 635, Datë 04.07.2019	265
“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”	
Nr. 638, Datë 18.07.2019	275
“Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike”	
Nr. 646, Datë 09.08.2019	279
“Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm””	
Nr. 647, Datë 09.08.2019	283
“Për miratim paraprak me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të transferimit të kontratës së koncesionit të shoqërisë DiaVita SHPK “Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan”	
Nr. 651, Datë 10.10.2019	285
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë” SHA”	
Nr. 659, Datë 21.11.2019	289
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje miratimin e një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik””	

Nr. 660, Datë 21.11.2019	295
“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, në procedurat gjyqësore”	
Nr. 661, Datë 21.11.2019	299
“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare””	
Nr. 666, Datë 23.12.2019	303
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Vorë” SHA”	
Nr. 668, Datë 24.12.2019	307
“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme”	
Nr. 670, Datë 24.12.2019	315
“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me shqyrtimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”	

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE - 2019

Nr. 633, Datë 26.06.2019	321
“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar””	

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË ICN (RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS)

Nr. 636, Datë 04.07.2019	323
“Mbi miratimin e “Kornizës së Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (<i>Competition Agency Procedures - CAP</i>) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)””	

AKTE TË TJERA TË MIRATUARA NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”, I NDRYSHUAR

Nr. 584, Datë 17.01.2019	325
“Mbi miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””	
Nr. 665, Datë 16.12.2019	327
“Mbi miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës””	

VENDIME ME OBJEKT – MARRËVESHJE TË NDALUARA

VENDIM

Nr. 585, Datë 24.01.2019

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbylljen e procedurës e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e detyrimeve dhe rekomandimeve.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja d, neni 43, pika 5, neni 70, pika 3 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

Gjatë muajit maj 2018, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paraqiti pranë Autoritetit të Konkurrencës disa konstatime në lidhje me tregun e sigurimit të jetës dhe pronës nga Raiffeisen Bank SHA dhe Banka Kombëtare Tregtare SHA. Gjithashtu, shoqëria e sigurimit të jetës SICRED SHA paraqiti pretendimin se BKT SHA “refuzon të transmetojë tek klientët e tyre edhe produktin e sigurimit të jetës për hua të shoqërisë Siced SHA” duke mos i dhënë mundësi shoqërisë për të qenë konkurrues në produktet e sigurimit të jetës për huatë.

Në zbatim të nenit 28 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Sekretariati realizoi vlerësimin e ankesës dhe monitorimin e tregut të sigurimeve me ndërmjetësimin e bankave mbi të cilën Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 526, datë 14.06. 2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë” dhe Vendimin nr. 544, datë 20.09.2018 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 526 datë 14.06.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë dhe paraqitjen e raportit në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 22 nëntor 2018.

Në bazë të nenit 36 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 385, datë 14.06.2018 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit paraprak procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë bankave të nivelit të dytë që ushtronë aktivitetin e ndërmjetësimit në sigurime.

II. Analiza e konkurrencës

Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë: tregu përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit u përcaktua tregu i shërbimit të brokerimit për sigurimin e jetës dhe për sigurimin e pronës nga zjarri dhe dëmtimet, me ndërmjetësimin e bankave të nivelit të dytë.

Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të nenit 204, pika 5 e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë. Sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe treguesve të publikuar prej saj, bankat e pajisura me licensë janë:

1. Banka Raiffeisen, licencuar në tetor 2016 për sigurim jete dhe jo jete,
2. Banka Kombëtare Tregtare, licencuar në dhjetor 2016 për sigurim jete,
3. Banka Alpha, licencuar në dhjetor 2016 për sigurim jete dhe jo jete
4. Banka Credins, licencuar në janar 2018 si broker për sigurim jo jete dhe agjent i Sicred për sigurimin e jetës.

Tregu i ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, funksionon në zbatim të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

Bankat të licencuara si ndërmjetës në sigurime, në zbatim të nenit 206 “Përgjegjësitë e brokerit/shoqërisë së brokerimit në sigurime”, kanë detyrimin të kryejnë shërbime brokerimi në emër të të siguruarve, për nënshkrimin e kontratave të sigurimit në përputhje me kërkesat e të siguruarit për sa i përket mbulimit në sigurime; kryejnë analizë rreziku të përshtatshme dhe përcaktojnë parimet bazë të mbulimit të kërkuar; japin shpjegim me shkrim dhe arsyetojnë propozimet e bëra, informojnë të siguarin për nivelin e komisioneve të përcaktuara për nënshkrimin e një kontrate sigurimi etj.

Referuar të dhënave të depozituara gjatë procedurës hetimore, XX% e primeve të nënshkruara gjatë vitit 2017, janë ndërmjetësuar nga bankat e licencuara, ku Raiffeisen Bank zotëron XX% të vlerës totale të primeve. Gjatë 5 muajve të parë të vitit 2018, treguesit janë në rritje ku pjesa e tregut e ndërmjetësuar nga bankat shkon në XX% dhe Raiffeisen Bank zotëron XX% të tij. Pjesa tjetër e tregut (XX%) është ofruar nga ndërmjetës të tjerë, agjente dhe brokera jashtë sistemit bankar.

Mbështetur në pjesët e tregut që ndërmarrjet nën hetim zotërojnë në tregun përkatës, si dhe referuar praktikave ndërkombëtare mbi pjesën e tregut të ndërmarrjeve me pozitë dominuese, vlerësojmë se asnjë nga ndërmarrjet nën hetim nuk zotëron pozitë dominuese në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg

Duke qenë se asnjë prej ndërmarrjeve nën hetim nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës, atëherë sjellja e tyre do të vlerësohet në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003. Vlerësimi i sjelljes së bankave u

përqendrua në kushtet e parashikuara në marrëveshjet e nënshkuara mes bankave dhe shoqërive të sigurimit, mënyrën e llogaritjes së primit të sigurimit dhe përfitimet e ndërmarrjeve nën hetim nga shërbimi i ofruar.

1. Raiffeisen Bank ushtron aktivitetin e ndërmjetësimit me licencën Nr.17, date 31.10.2016, miratuar me Vendimin Nr.178, datë 31.10.2016 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe ka nënshkruar marrëveshje të sigurimit të pronës nga zjarri dhe dëmtimet me tre shoqëri të sigurimit të jo jetës, Sigal Uniqa GA, Intersig VIG dhe Alb-siguracion.

Marrëveshjet përcaktojnë produktet e ofruara, komisionet e brokerimit si dhe koeficientët të llogaritjes së vlerës së primit. Sipas deklarimeve të marra gjatë procedurave të inspektimit, zgjedhja e tre shoqërive është miratuar nga bordi drejtues i bankës pas një procedurë rankimi të shoqërive të sigurimit të jo jetës.

Komisionet e brokerimit për ndërmjetësimin në shitjen e policave të sigurimit të pronës variojnë nga XX% deri në XX% të primit të arkëtuar sipas marrëveshjeve që kanë këto shoqëri siguri me bankën.

Llogaritja e primit të sigurimit të pronës është i ndryshueshëm në varësi të llojit dhe vlerës së pronës, vlerës së mbetur të kredisë dhe kohëzgjatjes së sigurimit.

Për sigurimin e jetës së debitorit, Raiffeisen Bank ka patur të nënshkruar gjatë vitit 2017 vetëm një marrëveshje me shoqërinë Sigal Life UGA dhe gjatë vitit 2018 ka nënshkruar marrëveshje edhe me dy shoqëritë e tjera në treg Sicred dhe Insig Jete.

Marrëveshja me shoqërinë Sigal Life parashikon paketa të diferencuar sipas tipit të kredisë konsumatore për të cilat përcaktohen komisione brokerimi të ndryshme. Nga vlerësimi i komisioneve konstatohet se për kreditë pa kolateral, komisioni i brokerimit varion nga XX% - XX% i cili është ndjeshëm më i lartë se komisioni i brokerimit për mikrokreditë (XX%).

Llogaritja e primit të sigurimit të jetës realizohet mbi bazën e një koeficienti i cili është në varësi të gjinisë dhe të moshës. Koeficientet e aplikuar nga Sigal Uniqa Group Austria janë më të ulta se e dy shoqërive të tjera të sigurimit të jetës gjë e cila sjell një çmim me të ulët të primit të sigurimit.

2. BKT ushtron aktivitetin e brokerimit në sigurime dhe është pajisur me licencën Nr.18, datë 27.12.2016, miratuar me Vendimin Nr.206, datë 27.12.2016 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për produktin e Sigurimit të Jetës së Debitorit.

Banka ka nënshkruar marrëveshje më të gjitha shoqëritë e sigurimit të jetës por mbi XX% e primeve të nënshkuara janë realizuar nëpërmjet shoqërisë Sigal Life UGA. Gjatë muajve të parë të vitit 2018, konstatohet një rritje e ndjeshme e numrit të policave të ofruara nga Insig Jete.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit janë të pandryshueshme për të tre kompanitë e sigurimeve dhe komisionet e brokerimit janë të njëjta, në vlerën XX%.

Nga krahasimi i koeficienteve nuk vihet re se shoqëritë e sigurimit të ofrojnë koeficiente të njëjta dhe Sigal Life paraqet koeficientet më të ulët të llogaritjes së primit të sigurimit të jetës. Ky koeficient rritet me rritjen e moshës së debitorit.

Në produktin jo-jetë, Banka Kombëtare Tregtare realizon vetëm shërbimin e ndërmjetësimit në sigurime për të cila arkëton komisionet XX% për shërbimet në sigurime me Sigma InterAlbanian VIG, XX% për tInsig dhe për Eurosig Sha është XX%. Vlera më e madhe e primeve të arkëtuara për produktin jo-jetë është siguruar nga Sigma InterAlbanian Vig nga e cila ka arkëtuar një komision të vogël, për shoqëritë e tjera nuk ka komisione të arkëtuara.

3. Banka Credins është pajisur me licencën Nr. 23 datë 31.01.2018 për veprimtari brokerimi në sigurime për klasat e jojetës dhe licencën Nr. 1139 datë 07.05.2018 për veprimtari agjenti në sigurime në klasat

e jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sicred” SHA, të cilën e ka marrë në maj të vitit 2018.

Banka ka ndërmjetësuar gjatë vitit 2017 dhe 5 mujorit të parë 2018 sigurimin e jetës vetëm nga shoqëria Sicred dhe komisioni i brokerimit për këtë shërbim është i diferencuar sipas volumit të primeve të përcaktuar në kontratë i cili varion nga XX%-XX%. Lidhja aksionare mes bankës dhe shoqërisë së sigurimit Sicred SHA ka influencuar në qëndrimin e bankës si ndërmjetës në sigurime duke i orientuar klientët drejt kësaj shoqërie sigurimi.

Gjatë vitit 2017-2018, banka ka zbatuar 8 akt-marrëveshje për sigurimin e kolateralit, të cilat kanë për objekt sigurimin e objekteve, sendeve të lëna peng, apo të çdo pasurie tjetër që barrësohet nga i Siguruari me përfitues Bankën si garanci për kreditë e dhëna nga kjo e fundit. Llojet e sigurimit për objektin e siguruar janë sigurimi nga zjarri, tërmeti dhe rreziqet shtesë.

Tarifat e primit do të aplikohen mbi vlerën e objektit që do të sigurohet, ose mbi vlerën e kredisë në bazë të kërkesës së bërë nga banka, dhe variojnë sipas llojit të pasurisë.

Nga të dhënat e administruara konstatohet se mbi XX% e primeve të nënshkruara janë realizuar nga shoqëria e sigurimit Ansig, përqindje kjo e cila ka ardhur në rritje gjatë 5 mujorit parë të vitit 2018 dhe koeficientet e aplikuar nga kjo shoqëri janë më të larta se koeficientet e aplikuar nga pjesa më e madhe e shoqërive të sigurimit të jo jetës në treg e cila ndikon në vlerën e primit.

Nga vlerësimi i sjelljes së Bankës Credins për shërbimin e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës, konstatohet kufizim i ofruesve të këtij shërbimi, koeficiente paksa më të lartë të llogaritjes së primit të sigurimit dhe komisione të brokerimi më të ultat në treg.

4. Alpha Bank është pajisur me licencën Nr. 210, datë 27.12.2016 për veprimtarinë broker në sigurime për produktin jetë dhe jojetë duke nënshkruar marrëveshje me shoqëritë Sigal dhe Intersig për produktin e sigurimit të pronës nga zjarri dhe dëmtimet dhe palët parashikojnë të njëjta kushte e metode të llogaritjes së vlerës së kolateralit, si dhe komisioni i brokerimit për ndërmjetësimin në shitjen e policave të sigurimit të pronës është i njëjtë në masën XX% të primit të arkëtuar, për të dyja shoqëritë e sigurimit.

Vlera më e madhe e primeve të nënshkruara është siguruar nga shoqëria Sigal me rreth XX%, tregues ky në ulje në 5 mujorin të parë të vitit 2018.

Përsa i takon produktit të sigurimit të jetës, banka ka marrëveshje me shoqëritë Sigal Life dhe Insig Jete dhe marrëveshjet janë amenduar në vitin 2018 dhe kanë qenë për të njëjtin objekt, ndryshim i përqindjes së komisioneve të brokerimit.

Nga të dhënat mbi vlerën e primeve, konstatohet se gjatë vitit 2017 të gjitha primit e nënshkruara janë realizuar me shoqërinë Sigal Life dhe gjatë 5 muajve të parë 2018 një ky shërbim ka filluar të merret edhe nga shoqëria Insig Jete.

Komisionet e brokerimit janë shumë të lartë duke i krahasuar edhe me komisionet që aplikohen për bankat e tjera. Komisioni i brokerimit që përfiton banka nga të dyja shoqëritë është e njëjtë, në masën XX% të primeve të arketuara.

Në përfundim të procedurës hetimore u konkludua se :

- Raiffeisen Bank dhe Banka Alpha nuk kanë lidhur marrëveshje me të gjitha shoqëritë e sigurimit për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit në sigurimin e pronës nga zjarri dhe dëmtimet dhe sigurimin e jetës së debitorit duke kufizuar mundësinë e zgjedhjes nga konsumatori.

- Banka Credins ka të kufizuar ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit të sigurimit të jetës për shoqëritë e tjera të sigurimit të jetës në treg (Insig Jete dhe Sigal Life) për shkak të licencës së agentit. Lidhja aksionare mes bankës dhe shoqërisë së sigurimit Sicred SHA ka influencuar në qëndrimin e bankës si ndërmjetës në sigurime duke i orientuar klientët drejt kësaj shoqërie sigurimi. Banka Credins, pavarësisht se ka marrëveshje më të gjitha shoqëritë e sigurimit të jo jetës, të gjitha primet e ndërmjetësuar prej saj janë të siguruar pranë shoqërisë Ansig SHA.

- Banka Kombëtare Tregtare realizon ndërmjetësimin për produktin e sigurimit nga zjarri dhe dëmtimet e pronës duke mos qenë e licensuar për këtë veprimtari.

- Llogaritja e vlerës së primit realizohet mbi bazën e një koeficienti, i cili ndryshon shumë pak nga njëra shoqëri në tjetrën. Shoqëritë e sigurimit nuk kanë një metodë të llogaritjes së primit të sigurimit në përputhje me nenit 87 dhe 88 të Ligjit Nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

- Koeficientet e brokerimit variojnë nga 20% - 62.5% e primeve të nënshkruara dhe nëse i krahasojmë me komisionet e brokerimit të evidentuara në procedurat e mëparshme në tregun e sigurimeve për produktet e TPL apo kartonit jeshil (të cilat variojnë nga 5%-10%), këto komisione janë shumë të larta.

- Mungesa e një metodologjie të llogaritjes së primit të sigurimit (çmimit të polices) e bën të pajustificueshme ekonomikisht aplikimin e komisioneve të tilla, ndërkohe që risku i sigurimit mbartet totalisht nga shoqëritë e sigurimit.

Nga sa më sipër, nuk u gjetën elementë të një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të ligjit 9121/2003, mes bankave në lidhje me shërbimin e ndërmjetësimit në sigurime.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 8, nenit 9, nenin 24, shkronja d, nenin 43, pika 5 dhe nenit 70, pika 3 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë.
2. Detyrimin për bankat e nivelit të dytë si më poshtë:
 - a) Raiffesien Bank - duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për shoqëritë e sigurimit të jo jetës, pa kufizuar mundësinë e zgjedhjes se klientëve.
 - b) Alpha Bank - duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo jetës, pa kufizuar mundësinë e zgjedhjes se klientëve.
 - c) Bankës Kombëtare Tregtare - duhet të aplikojë pranë AMF për licencimin si ndërmjetës në sigurimin e jo jetës, për produktin e sigurimit të pronës nga zjarri dhe dëmet e natyrës.
 - d) Banka Credins - duhet të aplikojë për licensimin si broker për shërbimin e ndërmjetësimit në sigurimin e jetës dhe të orientojë klientët drejt të gjitha shoqërive të sigurimit të jetës dhe jo jetës.
3. Ti rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:
 - a) Të marrë masa që bankat e nivelit të dytë, të cilat ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit në sigurimeve për klientët e tyre, të pajisen me licencat përkatëse të ndërmjetësimit në sigurime.

b) Të përcaktojë metodologjinë për përlllogaritjen e primit të sigurimit të pronës dhe jetës nga shoqëritë e sigurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit orientimin e primeve të sigurimit drejt kostos.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare brenda 6 muajve nga marrja e këtij vendimi duhet të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në pikën 1 dhe 2 të vendimit.
5. Tregu i ndërmjetësimin në sigurime nga bankat e nivelit të dytë do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e vendimit.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 586, Datë 28.01.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike.

Baza ligjore: Neni 4, neni 24, shkronja (d) dhe nenin 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Nga media e shkruar dhe ajo vizive, në datë 25 janar 2019 jemi informuar lidhur me një Vendim të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, Vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për këtë shërbim.
2. Misioni i Urdhrit të Stomatologëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga keq ushtrimi i këtij profesioni.
3. Urdhri i Stomatologut funksionon dhe rregullohet nga Ligji nr. 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
4. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jo buxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmës stomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.
5. Sipas Vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: Terapinë, Ortopedinë, Kirurgjinë dhe Ortodoncinë.
6. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar, vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës të çdo projekt-akti normativ;
7. Në bazë të nenit 4 të Ligjit 9121/2003 janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg. Vendimi i mësipërm i Urdhrit të Stomatologut, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, neni 24, shkronja (d) dhe nenin 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 587, Datë 28.01.2019

“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 4 , neni 24, shkronja (d), neni 44 dhe neni 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Nga media e shkruar dhe ajo vizive, në datë 25 janar 2019 jemi informuar lidhur me një Vendim të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, Vendimi nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për këtë shërbim.
2. Misioni i Urdhrit të Stomatologeve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit të stomatologut dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga keq ushtrimi i këtij profesioni.
3. Urdhri i Stomatologut funksionon dhe rregullohet nga Ligji nr. 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
4. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jo buxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmës stomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.
5. Sipas vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: Terapinë, Ortopedinë, Kirurgjinë dhe Ortoncinë.
6. Në bazë të nenit 4 të Ligjit 9121/2003 janë të ndaluara të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg. Vendimi i mësipërm i Urdhrit të Stomatologut, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121/2003;
7. Si përfundim, bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9121/2003, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence, pasi Vendimi i Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik”, sjell një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) , nenin 44 dhe nenin 69 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë si vijon:
 - a) Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të Vendimit të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut, Vendimit nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysHEME për shërbimin stomatologjik”, pasi bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
 - b) Depozitimin e të gjithë praktikës së ndjekur deri në marrjen e këtij vendimi, për të kryer vlerësimin ligjor të tij, bazuar në nenin 4 dhe 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
2. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore;
3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr. 9121/2003;
4. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi , bazuar në nenin78 “Sanksione Individuale”, parashikohet vendosja e gjobave individuale në masën deri 5 milionë lekë për individët që me dashje ose nga pakujdesia kryejnë ose bashkëpunojnë në veprimet e sanksionuara në nenet 73 pika 1 dhe 74 pika 1 e Ligjit 9121/2003.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 592, Datë 31.01.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo”.

Baza ligjore: Neni 4, Neni 8, Neni 9, neni 24, shkronja d, Neni 26 dhe Neni 43, pika 1, i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportin e hetimit paraprak,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 516 datë 22.05.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në Sektorin Bankar”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të paraprak në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa San Paolo, e cila do të përfshijë të gjitha produktet dhe shërbimet që ofrojnë këto banka për të vlerësuar nëse ka sjellje antikonkurrese në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit 9121/2003.
2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 336, datë 22.05.2018 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme, duke marrë shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga të gjitha bankat që ushtrojnë aktivitet në treg.

II. Analiza e konkurrencës

II.1. Tregu përkatës

4. Në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”. Përkufizimi i tregut përkatës

përfshin dy dimensione:

a) Tregun e produkteve

b) Tregun gjeografik

5. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut, shkallën e përqendrimit me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

6. Për të vlerësuar tregun përkatës të produktit është analizuar zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, barrierat në hyrje/zgjerimit, konkurrenca potenciale.

7. Tregjet përkatëse të produktit do të përfshijnë: Llogaritë rrjedhëse; Depozita me/pa afat; Kredi konsumatore; Kredi Kufi (OVD); Kredi hipotekore; Transferta Bankare të ofruara nga bankat e nivelit të dytë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

8. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse bankat e nivelit të dytë janë prezente në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si treg gjeografik përcaktohet tregu i Republikës së Shqipërisë.

II.2 Barrierat e hyrjes dhe zgjerimit

9. Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për licencimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja për të ushtruar veprimtari bankare dhe veprimtari të tjera financiare, në përputhje me ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

10. Licenca që i jepet një banke apo dege të një banke të huaj, është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme. Pjesë përbërëse e licencës është edhe aneksi i veprimtarive bankare dhe veprimtarive financiare, për të cilat banka dhe dega e bankës së huaj licencohet.

11. Kushtet, kërkesat, afatet, dokumentacioni dhe procedurat për licencimin e bankës dhe degës së bankës së huaj për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, përcaktohen në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (nenet 17, 18) dhe Rregulloren "Për Licencimin dhe Ushtrimin e Veprimtarisë së Bankave dhe Degëve të Bankave të Huaja në Republikën e Shqipërisë", (nenet 6 dhe 7) miratuar me Vendimin Nr. 14, datë 11.03.2009 të BSH.

II.3 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

12. Bankat ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve dhe shërbimeve bankare. Edhe pse shumica e këtyre produkteve hyjnë në grupin e shërbimeve klasike bankare, vitet e fundit bankat kanë filluar zgjerimin gamës së shërbimeve të tyre me disa risi për tregun. Produktet dhe shërbimet bankare janë grupuar në: Llogari rrjedhëse; Depozita me/pa afat; Kredi konsumatore; Kredi Kufi; Kredi hipotekore; Transferta Bankare.

13. Depozitat janë produkte nëpërmjet të cilave bankat sigurojnë likuiditetet monetare kurse klienti depoziton mjetet e tij të lira kundrejt përfitimit të interesave. Portofoli i depozitës për periudhën hetimore është shoqëruar me trend rritës, nga ku konstatohet se portofoli i depozitave gjatë vitit 2016 ka qenë rreth XX miliard lekë më i lartë se viti 2015, trend ky në rritje edhe gjatë vitit 2017.

14. Sipas strukturës së tregut, vihet re se bankat objekt hetimi janë bankat me vlerën më të lartë të portofolit të

depozitave. Treguesi i Hershman Herfindalit tregon për një treg mesatarisht të përqëndruar ku vlera e pjesës së tregut për tre dhe katër bankat më të mëdha (CR3 dhe CR4) janë të pandryshueshme pas vitit 2016. Katër bankat më të mëdha, BKT, Raiffeisen Bank, Banka Credins dhe Banka Intesa SanPaolo kanë ndryshime të pjesëve të tregut në vlera relativisht të vogla duke ruajtur renditjen në treg dhe qendrueshmërinë e pjesëve të tregut.

15. Depozitat me afat zënë rreth XX% të volumit, e ndjekur nga llogaria rrjedhëse me rreth XX% dhe depozitat pa afat me X%. Kjo strukturë e produkteve është pothuajse e pandryshueshme për gjithë periudhën hetimore.
16. Nga analiza e portofolit të depozitave, konstatohet ngurtësim të pjesës së tregut që zotëron secila bankë në portofolin e depozitave, ngurtësim të pjesës së tregut që zotërojnë 4 bankat më të mëdha në vlerat e portofolit (CR4), ngurtësim të pjesës së portofolit që zotëron secili produkt në portofolin e depozitës gjatë periudhës hetimore. Në tërësi vlera dhe struktura e portofolit të depozitës është e ngurtë, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1 gërma (c) të Ligjit Nr. 9121/2003 mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.
17. Llogaria rrjedhëse është një formë e depozitës bankare nëpërmjet të cilës banka lejon të depozitohen apo të tërhiqen para nga mbajtësi i llogarisë. Llogaria rrjedhëse është një produkt i domosdoshëm për përfitimin e pjesës më të madhe të shërbimeve bankare, si derdhja dhe tërheqja e pagës, lëvrimi i kredive, transaksionet me kartat, pagesat utilitare, transfertat monetare etj.
18. Treguesit e përqendrimit për llogaritë rrjedhëse, i japin tregut karakteristikat e një tregu të përqëndruar ku treguesi HHI varion nga XXXX deri në XXXX në periudhën 2016 – maj 2018. Në strukturën e tregut të llogarive rrjedhëse konstatohet se Banka Raiffeisen zotëron një pjesë të konsiderueshme të tregut me XX-XX%, e ndjekur nga 3 bankat e tjera objekt hetimi. Edhe në këtë produkt konstatohet ruajtje e pjesëve të tregut të bankave objekt hetimi dhe ruajtje e vlerës në lekë të portofolit të llogarisë rrjedhëse.
19. Në përfundim të vlerësimit të tregut të llogarisë rrjedhëse konstatuam se ky produkt zë rreth XX% të tregut të depozitave ku treguesit e përqendrimit tregojnë për një treg të përqëndruar ku indeksi i përqendrimit HHI ka variuar nga XXXX në XXXX dhe vazhdon të jetë i lartë. Bankat objekt hetimi zotërojnë XX-XX% të tregut të llogarisë rrjedhëse ku pjesën më të madhe e zotëron Raiffeisen Bank, e ndjekur nga Banka Kombetare Tregtare dhe Intesa SanPaolo Bank. Komisionet që aplikojnë katër bankat për llogaritë rrjedhëse janë pothuajse të njëjta, kurse normat e interesit janë shumë të ulta ose nuk aplikohen për këtë produkt, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.
20. Depozitat pa Afat, apo të njohura ndryshe si llogari kursimi, është një lloj depozite e cila e ndihmon klientin në depozitim në çdo kohë të likuiditeteve të lira dhe tërheqjen në cdo kohë, duke përfituar interesa nëse banka aplikon të tilla. Në përfundim të analizës së tregut të depozitave pa afat u konstatua së tregu është mesatarisht i përqëndruar dhe normat e interesit të aplikuar nga ndërmarrjet nën hetim janë në nivele shumë të ulta, ndërkohë që ka banka të cilat nuk aplikojnë fare interesa për depozitat pa afat, (ka banka me te vogla që kanë norma interesi disa herë më të larta se bankat nën hetim), gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.
21. Depozita me Afat është një marrëveshje që lidhet ndërmjet bankës dhe klientit për një shumë dhe afat të përcaktuar. Strukturat e tregut sipas bankave dhe treguesit e përqendrimit të tregut, tregojnë se tregu i depozitave me afat ka karakteristikat e një tregu mesatarisht të përqëndruar ku indeksi HHI është rreth vlerave XXX-XXX, tregues në rritje krahasuar me vitet 2014-2015. Bankat objekt hetimi janë edhe bankat më të mëdha në këtë produkt. Pjesa e tregut e këtyre bankave është pothuajse konstante e cila reflektohet edhe me indeksin CR3 dhe CR4. Portofoli i depozitave me afat gjatë periudhës hetimore ka pësuar tkurje duke u zvogëluar në 2017 me X% krahasuar më vitin 2016. Ulja e portofolit të depozitave me afat për

Bankën Raiffeisen, është ndikuar kryesisht nga tkurrja e depozitës në euro dhe nga norma e interesit e cila është më e ulta e sistemit. Nga krahasimi i normave të interesit mes bankave është vënë re aplikim i interesa shumë të ulta dhe pothuajse të njëjta mes tyre. Mënyra e aplikimit të interesave të bankave dhe normat e interesit që aplikojnë bankat si për individë edhe për biznesin në pjesën më të madhe të bankave janë të njëjta për cdo monedhë, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

22. Kredidhënia, procesi i dhënies hua të fondeve, zë rreth XX-XX% të gjithë totalit të depozitave të sistemit bankar. Vlera e portofolit të kredisë nga viti 2016-2018 është shoqëruar me një tkurrje prej X% në vitin 2017 dhe rritje prej X% në vitin 2018 (nga XXX miliard lekë në 2016, në XXX miliard lekë në 2017 dhe XXX miliard lekë në 2018). Në total tregu i kredisë paraqet tregues të moderuar të përqendrimit, ku tregu vazhdon të zotëroret nga 4 bankat më të mëdha objekt hetimi BR, BKT, BC dhe ISPB.
23. Në tregun e kredisë (total) vihet re një qëndrueshmëri e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve nën hetim dhe pjesën më të madhe të tregut e zë BKT me rreth XX% të tregut, BR dhe BC zënë nga XX% të tregut, ndërsa ISPB me rreth X% të tregut. Pjesën më të madhe të kredisë e zë kredia e biznesit mbi XX% të portofolit total të kredisë me një prirje në rritje për vitin e fundit.
24. Overdrafti ndër vite zë afërsisht XX% të portofolit të kredisë. Kredia hipotekore dhe ajo konsumatore zënë përkatësisht XX% dhe XX% të portofolit të kredisë me një qëndrueshmëri në këto vite. Tregu i kredisë Overdraft është tregu me indeksin më të lartë të përqendrimit HHI mbi XXXX. Ky treg zotërohet mbi XX% nga 4 bankat objekt hetimi. BR është banka me pjesë më të madhe në treg, me XX% në 2016 dhe XX% për vitin 2017. BKT zë afërsisht XX% pjesë tregu me qëndrueshmëri për të treja vitet. Ndërsa ISPB po njësoj si BKT ka një qëndrueshmëri të pjesës që zë në treg me rreth XX% të tregut.
25. Komisionet e Overdraftit për biznesin gjatë periudhës hetimore si në monedhën lek ashtu dhe në euro për 4 bankat objekt hetimi nuk kanë ndryshuar ndjeshëm që nga viti 2016. Vihet re se BR ka komisionin më të lartë në lidhje me vonesat në masën XX%. Për komisionet e Overdraftit për individ vihet re se ka patur ndryshime të komisioneve por në nivele shumë të ulta (me presje dhjetore) për bankën BR, ndërsa komisionet më të larta në lidhje me penalitetin për pagesat i kryeson BKT me XX% në monedhën lek. Në monedhën euro komisionet thuajse nuk kanë ndryshuar, bankat BKT, ISPB dhe BR kanë komisionet më të larta për penalitetet.
26. Tregu i Kredisë Konsumatore është një treg me indekse të larta të përqendrimit HHI, ku 4 bankat objekt hetimi zënë mbi XX% të tregut. Në tregun e kredisë konsumatore vihet re një shpërndarje thuajse e barabartë e pjesëve të tregut mes BR (XX%), BKT(XX%), BC (XX%) dhe BA (X%) me një qëndrueshmëri për të tre vitet, ndërsa ISPB zë një pjesë shumë të vogël në këtë treg. Përsa i përket komisioneve për kredinë konsumatore si në monedhën vendase dhe në euro vihet re se nuk ka ndryshime ndër vite. BR dhe BKT aplikojnë komisionet me të larta në lidhje me penalitetin për shlyerje të vonuar të këstit përkatësisht me XX% dhe XX%.
27. Në tregun e Kredisë hipotekore vihet re një qëndrueshmëri e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve nën hetim dhe pjesën më të madhë të tregut e zë BKT me rreth XX% të tregut. BR dhe BC zënë përkatësisht rreth XX% dhe XX% të tregut, ndërsa pjesën më të ulët të tregut nga bankat objekt hetimi e zë ISPB me rreth X% të tregut. Ndër vite vihet re se nuk ka ndryshime thelbësore në masën e komisionit të aplikuar në vite dhe mbeten të larta. Lidhur me aplikimin e këtyre komisioneve kryesojnë BR dhe BKT me komisionet ndëshkuese ndaj penaliteteteve, për monedhën në lek të dyja bankat aplikojnë XX%, ndërsa në euro ndërsa BR aplikon të njëjtin komision XX%, BKT aplikon XX%.
28. Tregu i Kredisë së biznesit është mesatarisht i përqendruar përsa i përket indeksit HHI. BKT zë pjesën më të madhe të tregut me rreth XX%, duke e ruajtur këtë pjesë gjatë viteve 2016 dhe 2017. Tre bankat e tjera

kanë qëndrueshmëri në pjesët e tregut për periudhën nën hetim. Për kredinë e biznesit e cila konsiderohet si kredia me më shumë risk nga ana e bankave, komisionet pararaqiten në një situatë ndryshe nga kreditë e tjera për bankat e tjera jo objekt hetimi të cilat kanë nivele të larta për komisionet në lidhje me vonesat e pagesave. Për bankat objekt hetimit sërisht BR aplikon të njëjtat komisione edhe si në kreditë e tjera, ndërsa vihen re komisionet tepër të ulta të BKT dhe BC krahasuar me komisionet e tyre në llojet e tjera të kredive.

29. Interesi nga kreditë përbën burimin kryesor të të ardhurave që sigurojnë bankat. Llogaritja e interesit realizohet në norma fikse për gjithë periudhën e kredimarrjes ose me normë të ndryshueshme ku variabël i ndryshimit është norma Euribor ose Tribor sipas monedhës në të cilën jepen kreditë.
30. Në lidhje me tregun e Overdraftit bankat me normën më të lartë të interesit janë Intesa Sapaolo ku NEI paraqitet në vlerën XX% në lekë dhe XX% në Euro. Dy bankat më të mëdha në treg, Raiffeisen Bank dhe BKT kanë norma pothuajse të njëjta si në monedhen lek ashtu dhe atë europiane.
31. Kredia konsumatore paraqitet në dy forma, kredi personale me kolateral për të cilën kredimarrësi duhet të ofrojë për bankën një pronë të paluajtshme si garaci hipotekore ose pa kolateral; dhe kredi personale pa kolateral. Normat NEI të kredisë pa kolateral janë me të larta se kredia me kolateral. Bankat aplikojnë norma të ndryshme të cilat në disa banka ndryshojnë në varësi të kohëzgjatjes së periudhës së kredisë. Katër bankat objekt hetimi konstatohen të kenë norma të ndryshme ku më të lartën e paraqet Banka Intesa SanPaolo dhe më të ultën Raiffesen Bank.
32. Kredia për biznesit ofrohet e detajuar sipas madhësisë së biznesit, në të vogël të mesëm dhe të madh/korporatat.
33. NEI të biznesit të vogël në disa banka janë ndjeshëm më të larta se normat e interesit për biznesin e mesëm dhe korporatat. Duke qenë një kredi pa kolateral, overdrafti konsiderohet si kredi me nivel të lartë të riskut të kthimit nga biznesi i vogël duke i ofruar në nivel të lartë të NEI-it. Për bankat objekt hetimi, Raiffeisen Bank konstatohet të ketë një nivel të lartë të NEI-t dhe një diferencë të ndjeshme mes biznesit të vogël dhe atij të mesëm dhe të madh.
34. Kredia për inventar dhe kapital qarkullues është një kredi e cila ofrohet nga bankat për bizneset për një periudhë që shkon deri në 5 vjet e cila u jep mundësi bizneseve për zgjidhjen e nevojave për likuiditet.
35. NEI për kredinë afatgjatë është në tregues më të ulët se dy llojet e mëparshme të kredisë, sikurse dhe diferencat mes tipologjisë së biznesit janë më të ulta. Normat e interesit mes Raiffesien Bank dhe BKT janë pothuajse të njëjta me diferenca shumë të vogla për të tre llojet e biznesit si në monedhën vendase edhe në atë të huaj. Aplikimi nga Raiffeisen Bank i normave më të larta për Biznesin e vogël krahasuar më dy format e tjera të biznesit, mund të shërbejë si një barrierë për ofrimin e këtij produkti për këtë tipologji klienti dhe për më tepër mund të përbejë kosto të mëdha financiare për nxitjen e biznesit të vogël më rritjen e aktivitetit ekonomik.
36. “Spread-i”, diferenca midis interesit të kredive me interesin e depozitave që përbën edhe faktorin kryesor të fitimit të bankave paraqitet: normat e interesit të kredive për individët janë mesatarisht mbi X% (për kredinë hipotekore mbi X%, kredinë konsumatore mbi X% dhe Overdraft mbi X%), normat e interesit të depozitave për klientët individ variojnë nga X-X% duke rezultuar në interesa të kredive shumë herë më të larta se interesat e depozitave; normat e kredive për biznesin janë mesatarisht mbi X%, ndërkohë që normat e interesit të depozitave për biznesin po ashtu variojnë nga X-X%, duke rezultuar që interesi i kredive të jetë shumë herë më i lartë se interesi i depozitave. Kjo sjellje e ndërmarrjeve nën hetim, duke aplikuar norma shumë më të larta të interesave për kreditë në krahasim me normat e interesave për depozitat, mund të përbejë një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) të Ligjit Nr. 9121/2003.
37. Përsa i përket tregut të transfertave bankare, në përjashtim të BKT, vihet re që bankat nën hetim kanë

tendencën të përdorin tarifata maksimale për transfertat dalëse brenda vendit, duke u bazuar në vendimin nr.12 datë 23.02.2011 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloret “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS” dhe “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël AECH””. Duke krahasuar të dyja periudhat hetimore, për transfertat dalëse në monedhë të huaj me dy ditë datëvalutë, për kategorinë individ që janë klientë të bankës në tregun bankar, vërehet se bankat e nivelit të dytë, të cilat janë nën hetim, kanë ruajtur po të njëjtat vlera komisionesh si për tarifata minimale dhe për tarifata maksimale.

38. Sigurimi i stabilitetit të përgjithshëm të industrisë bankare është një objektivi kyç nga ana e rregullatorit, por nga ana tjetër qëllimi i politikës së konkurrencës është të mbrojtë konkurrencën dhe të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë të zhvillimit të konkurrencës në interes të konsumatorëve përfundimtarë.
39. Bankat nën hetim BKT, BR, ISPB dhe BC (CR4) për vitin 2017 përfaqësojnë: XX% të portofolit të depozitave dhe XX% të pjesës së fitimit neto.
40. Bankat nën hetim kanë aplikuar norma të larta fitimi (pas taksave) për vitet 2016 – 2017 përkatësisht: BKT (XX% dhe XX% me rritje X%); BR (XX% në vitin 2017); dhe ISPB (XX% në vitin 2016 dhe XX% në vitin 2017).
41. Përfitueshmëria e bankës matet edhe nëpërmjet raportit të kthimit mbi aktivet gjithsej ROA (Return on Assets) dhe/ose raportit të kthimit mbi kapitalin e vet ROE. Bankat me nivelin më të lartë të ROA për vitin 2017 janë: BKT me X%; BR me X%; ISPB me X% të cilat janë më shumë se niveli mesatar. ROE mesatare për vitin 2017 është X%. Bankat (nën hetim) me nivelin më të lartë të ROE për vitin 2017 janë: BR me XX%; BKT me XX%; ISPB me XX% dhe BC me X%. Nga vlerësimi i diferencës ROA dhe ROE rezultoi që bankat nën hetim po rrisin shkallën e përdorimit të depozitave për të gjeneruar fitim.
42. Të ardhurat kryesore realizohen nga interesat që përfaqësojnë në totalin e të ardhurave mbi XX% në grupin e bankave nën hetim. Marzhi nga interesat është i lartë dhe përfaqëson XX-XX% (të ardhura nga interesat-shpenzime nga interesat). Edhe pse të ardhurat nga interesat kanë rënë, rënia në ritme më të larta të shpenzimeve për interesa ka bërë që rezultati neto i tyre të jetë i lartë dhe të rritet në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016. Norma e ulët për interesat e depozitave dhe norma efektive e interesave për kreditë e lartë, (diferenca) ka dhënë efekte që bankat gjatë kësaj periudhe të arrijnë fitime të larta.
43. Për sa më sipër, nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nën hetim, konstatohet qëndrueshmëria e pjesëve të tregut lidhur me depozitat dhe kreditë, shkallë e lartë përqendrimi në segmente të produkteve, norma shumë të ulta dhe të ngurtësuar të interesave të depozitave, norma të larta të interesit të kredive, spread disa herë më i lartë krahasuar me normën e interesit të depozitave, komisione dhe penalitete bankare të larta për ndërrimin e bankës (switching cost), komisione të larta për transfertat bankare në monedhë të huaj dhe norma të larta fitimi. Kjo sjellje e ndërmarrjeve nën hetim mund sjellë kufizim të konkurrencës në tregjet përkatëse në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24 (gërma d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar në tregjet e: depozitave, kredive dhe transfertave bankare, ndaj ndërmarrjeve: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins dhe Banka Intesa San Paolo.
2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2016 deri në 31.12.2018.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga

hapja e hetimit të thelluar.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 599, Datë 15.03.2019

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) dhe neni 41, 69 dhe 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologut ka marrë Vendimin nr. 12, datë 14.12.2018 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme për shërbimin stomatologjik” sipas të cilit, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për këtë shërbim.
2. Nëpërmjet këtij vendimi, është vendosur miratimi i një liste çmimesh dysheme për një kategori të caktuar shërbimesh dentare për: Terapinë, Ortopedinë, Kirurgjinë dhe Ortodoncinë.
3. Urdhri i Stomatologut funksionon dhe rregullohet nga Ligji nr. 127/2014 “Për urdhrin e stomatologut në Republikën e Shqipërisë”.
4. Urdhri i Stomatologut në Republikën e Shqipërisë është ent publik, jo buxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesionistëve, stomatologë dhe ndihmës stomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.
5. Komisioni i Konkurrencës ka marrë vendimin nr. 586, datë 28.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
6. Komisioni i Konkurrencës ka marrë vendimin nr. 587, Datë 28.01.2019 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike”, duke vendosur disa detyrime për Urdhrin e Stomatologut.
7. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar, vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës të çdo projekt-akti normativ;

8. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkëpunon me Urdhrit të Stomatologut për hartimin e dokumenteve të rëndësishme në fushën e shëndetësisë.
9. Bazuar në Ligjin nr. 9928, datë 09.06.2008 “Për shërbimin stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, institucioni përgjegjës për shërbimin stomatologjik është Ministria e Shëndetësisë, e cila përcakton mënyrën e funksionimit dhe organizimit të shërbimit, si dhe përcakton rregullat e ushtrimit të veprimtarisë së personelit të shërbimit shëndetësor stomatologjik.
10. Në datë 15 janar 2019, Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Stomatologut ka marrë Vendimin nr. 15, datë 07.02.2019 “Për anulimin (shfuqizimin) e vendimit të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë të datës 14.12.2018, nr. prot. 12 “Për miratimin e listës së çmimeve dysheme në shërbimin stomatologjik””, duke shfuqizuar vendimin e marrë në dhjetor 2018.
11. Për sa më sipër, konstatohet se Vendimi nr. 12 i mësipërm është shfuqizuar dhe nuk është zbatuar asnjëherë nga ofruesit e shërbimeve stomatologjike në Shqipëri.
12. Autoriteti i Konkurrencës synon eliminimin e praktikave të cilat mund të bien ndesh me parimet dhe rregullat e konkurrencës në treg, duke dhënë sipas rastit edhe rekomandime institucioneve përgjegjëse.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 24, shkronja (d) (f), nenin 41, 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003),

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurave të hetimit paraprak në tregun e shërbimeve stomatologjike.
2. Ti rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që:
 - (a) Në respektim të nenit 69 dhe 70 të ligjit, të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ i cili mund të sjellë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; që synon vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; apo projekt akte normative të cilat imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes;
 - (b) Të kërkojë paraprakisht mendimin e Autoritetit të Konkurrencës në rastet kur parashikohen të përcaktohen metodologji të përcaktimit të tarifave apo rishikime të tarifave në shërbimin stomatologjik;
 - (c) Tarifat që i ofrohen konsumatorëve në shërbimin stomatologjik, duhet të jenë të orientuara drejt kostos.
3. Ti rekomandojë Urdhrit të Stomatologut që:
 - (a) Në rastet e marrjes së vendimeve nga organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut, në lidhje me aspekte të ndryshme të cilat prekin konkurrencën në treg, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, të respektohen dispozitat e Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’ i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 605, Datë 21.03.2019

“Mbi mospranimin e kërkesës së AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i kërkesës së AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi kërkesën e AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585 datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”,

VËREN SE:

AMF, nëpërmjet shkresës nr. 447/1 prot, datë 22.02.2019 kërkon rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”, lidhur me:

- a) pikën 2/c të vendimit sipas së cilës i rekomandohet Bankës Kombëtare Tregtare të aplikojë pranë AMF për licencimin si ndërmjetës në sigurimin e Jo-Jetës, për produktin e sigurimit të pronës nga zjarri dhe dëmet e natyrës.

AMF shprehet se me vendimin e Bordit të AMF nr. 206, datë 27.12.2016 “Për miratimin e licencës për ushtrimin veprimtarie brokerimi në sigurime të shoqërisë “Banka Kombëtare Tregtare””, kjo e fundit është licencuar për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime për klasat e Jetës dhe Jo-Jetës për një periudhë pa afat.

Nga verifikimet u konstatua se BKT është e licencuar për të dy produktet (Jetë dhe Jo-Jetë) por nuk e ka ushtruar të drejtën e ndërmjetësimit në sigurimin e produkteve të Jo-Jetës.

- b) për pikën 3, b), sipas të cilit i rekomandohet AMF-së që të përcaktojë metodologjinë sigurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kërkojë nga shoqëritë e sigurimit orientimin e primeve për përlllogaritjen e primit të sigurimit të pronës dhe jetës nga shoqëritë e të sigurimit drejt kostos.

AMF, i referohet parimeve aktuariale ndërkombëtare për llogaritjen e primit të riskut, por nuk i referohet asnjë akti nënligjor të AMF-së për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së primit të sigurimit.

Llogaritja e primit të sigurimit duhet të jenë pjesë e një metodologjie të miratuar nga AMF dhe sipas nenit 87, pika 3 të ligjit 52/2014 “Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet, me kërkesë të këtij të fundit, bazat teknike dhe vlerësimet aktuariale të përdorura për llogaritjen e primeve të sigurimit dhe për produktet e sigurimit të jo jetës, të shoqëruara me opinionin e aktuarit të autorizuar të shoqërisë”, AMF duhet të ketë informacion mbi mënyrën e llogaritjes së primit të sigurimit nga shoqëritë e sigurimit.

AMF ka detyrimin të orientojë të gjithë aktorët që operojnë në tregun e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës, të përlllogaritin në mënyrë individuale primet për çdo shoqëri sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar nga AMF në mënyrë që tarifat e aplikuar të jenë të ndryshme për çdo shoqëri dhe të jenë të orientuara drejt kostos.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së AMF për rishikimin e Vendimit nr. 585 datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve” dhe lënien në fuqi të rekomandimeve të dhëna sipas pikës 3 të këtij Vendimi.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 612, Datë 19.04.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit të miellit,

VËREN SE:

1. Me anë të vendimit nr. 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” është vendosur hapja e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 30.09.2018, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe/ose 9 të ligjit nr. 9121/2003, si dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, gjatë periudhës së hetimit paraprak është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe në mënyrë të përsëritur nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Informacioni i administruar, deri në shtator të vitit 2018 nuk është i mjaftueshëm për konkludimin e procedurave hetimore.
3. Me qëllim vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, lind nevoja për hetime të mëtejshme, prova dhe të dhëna shtesë nga ndërmarrjet prodhuese dhe importuese si dhe e zgjatjes së periudhës hetimore për administrimin e të dhënave për periudhën shtator 2018-mars 2019 për importin e grurit dhe të miellit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” bëhen këto ndryshime:
 - a. Objekti i hetimit të ndryshohet si vijon: “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të grurit dhe të miellit”;
 - b. afati në pikën “II” të shtyhet deri në 1 prill 2019 si dhe
 - c. afati i përcaktuar në pikën “III”, shtyhet me 3 (tre) muaj.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 623, Datë 23.05.2019

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e monitorimit të zbatimit të Vendimit Nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil.

Baza ligjore: Neni 4 pika 1, neni 5, neni 6, neni 24, neni 26, neni 28, dhe neni 45 pika 1 dhe 2, nenet 48-52, neni 70 i ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e monitorimit mbi zbatimin e Vendimit Nr. 499, datë 15.02.2018 të Komisionit të Konkurrencës për kartonin jeshil,

VËREN SE:

1. Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, Sekretariati ka realizuar monitorimin e këtij tregu, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.
2. Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet vendimit të mësipërm, ka vendosur:
 - a. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil;
 - b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
 - i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;
 - ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregton dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.
 - c. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

3. Gjatë monitorimit të zbatimit të VKK Nr. 499, datë 15.02.2018 në lidhje me këto rekomandime, Autoriteti Konkurrencës:
- Me shkresën Nr. 358 Prot., datë 01.06.2018 dhe Nr. 358/1 Prot., datë 17.07.2018 ka kërkuar informacion nga Byroja shqiptare e Sigurimit (BSHS), lidhur me zbatimin e VKK Nr. 499, datë 15.02.2018, si dhe kopje të policës së sigurimit të tregtuar për produktin karton jeshil, për secilën nga palët pjesë në marrëveshje për periudhën pas Vendimit të Komisionit të Konkurrencës.
 - Me shkresën Nr. 663 Prot., datë 19.11.2018 ju është drejtuar të gjitha ndërmarrjeve pjesë të marrëveshjes për zbatimin individual të VKK Nr. 499, datë 15.02.2018 lidhur me zbatimin e marrëveshjes së përjashtuar nga ndalimi si dhe zbatimin e pikës 2.ii të vendimit të VKK Nr. 499, datë 15.02.2018.
 - Si dhe është monitoruar faqja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

I. Zbatimi i rekomandimeve

4. Byroja Shqiptare e Sigurimit në përgjigje të kërkesës për informacion, shprehet se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 499 datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” në të gjitha pikat e vendosura për BSHS, duke mos kufizuar lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij dhe gjithashtu të disponueshëm në të gjitha pikat kufitare, ku dalin mjetet motorrike jashtë territorit të Shqipërisë. BSHS bashkëngjit edhe specimen të policave të kartonit jeshil për secilën palë në marrëveshje, ku është bërë i mundur dhe implementimi i barkod, në përputhje me këtë vendim.
5. Ndërmarrjet shprehen se kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 499, datë 15.02.2018, lidhur me: tregtimin e produktit kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe policat e sigurimit të cilat përmbajnë logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës, dhe konkretisht:
- Kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 499 datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” në të gjitha pikat e vendosura pa kufizuar lirinë tregtare dhe konsumatore, duke mos kufizuar të drejtën e konsumatorëve dhe klientëve për të zgjedhur produktin dhe duke ofruar shitjen e këtij produkti në të gjitha pikat e shitjes të shoqërisë në degë, ndërmjetës dhe pika të kalimit kufitar ku shoqëritë kanë pika shitje;
 - Tregtojnë produktin karton jeshil nëpërmjet pikave të shitjes dhe ndërmjetësve të licensuar nga AMF në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe policat e sigurimit përmban logon e ndërmarrjes që e tregon dhe barkodin përkatës;
6. Nga monitorimi i faqes së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe të dhënat e dërguara nga kompanitë e sigurimeve për produktin karton jeshil për të njëjtën periudhë para Vendimit të Komisionit dhe pas Vendimit të Komisionit (Janar-Dhjetor 2017, 2018) rezultoi se:
- Primet e shkruara bruto për produktin karton jeshil për periudhën pas vendimit të Komisionit janë rritur me XX%. Disa nga ndërmarrjet kanë rritur volumin (Intersig XX%, Albsig XX%, Insig XX% dhe Ansig XX%) dhe disa nga ndërmarrjet kanë ulur volumin e primeve (Sigma XX% dhe Eurosig XX%);
 - Ndërmarrjet me pjesë më të madhe tregu kanë ulur lehtësisht pjesën e tregut si: Sigal Uniqa Group Austria me XX%; Eurosig me XX%; Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group me XX%. Ndërmarrjet me pjesë më të vogël tregu kanë rritur lehtësisht pjesën e tregut si: Intersig Vienna Insurance Group me XX%; Albsig me XX%; Insig me XX% dhe Ansig me XX%.

- Dëmet e shkruara bruto për produktin karton jeshil kanë rënë XX% më pak se në periudhën e mëparshme. Ndërmarrjet që kanë rritur volumin e dëmeve pas Vendimit krahasuar me periudhën para Vendimit janë: Albsig me XX%; Atlantik me XX%; Ansig me XX%. Ndërmarrjet që kanë ulur volumin e shitjeve pas Vendimit krahasuar me periudhën para Vendimit janë: Sigal Uniqa Group Austria me XX%; Eurosig me XX%; Sigma Interalbani Vienna Insurance Group me XX%; Intersig Vienna Insurance Group me XX% dhe Insig me XX%;
 - Ndërmarrjet që kanë rritur pjesën e tregut për nga shlyerja e dëmeve janë: Sigal Uniqa Group Austria me XX%; Eurosig me XX%; Sigma Interalbani Vienna Insurance Group me XX%; Albsig me XX%; Insig me XX%; Ansig me XX% dhe Atlantik me XX%. Ndërmarrja Intersig Vienna Insurance Group ka ulur shlyerjen e dëmeve duke ulur dhe pjesën e tregut me XX%.
7. AMF, me shkresën Nr.1416/1 Prot., datë 27.04.2018, protokolluar me tonën Nr. 269, datë 27.04.2018 “Mbi një ankesë depozituar në Autoritet”, e vë në dijeni AK mbi një ankesë të bërë nga qytetari AM në lidhje me kartonin jeshil, ku sipas ankesës qytetari shprehet: “...ishte e pamundur të bleja sigurimin me shoqërinë që unë kërkoja sepse ishte e paracaktuar”, bashkangjitur edhe ankesën.
8. AMF, përsëri me shkresën Nr. 1725 Prot., datë 14.05.2018, protokolluar me tonën Nr. 269/1 prot., datë 15.05.2018 i drejtohet AK për sa vijon: “AMF duke vlerësuar bashkëpunimin midis institucioneve tona, në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit të vitit 2006, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve përkatëse mbikëqyrëse, ju informojmë se, pas një ankese të ardhur me e-mail datë 30.04.2018, AMF në datë 03.05.2018 kreu inspektim në pikat e shitjes së policave të sigurimit të shoqërive, pranë pikës së kalimit kufitar Hani Hotit.
- Nisur nga gjetjet e këtij inspektimi nga ku kanë dalë problematikat mbi funksionimin e tregut të sigurimeve AMF do të vlerësojë çdo hetim apo veprim të AK si institucion përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe që kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve që veprojnë në treg që lidhen me tregun e sigurimeve.*
- Nëse ju gjykoni, ne jemi të gatshëm për inspektime të përbashkëta për verifikimin e sistemit të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm nga shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit e tyre.”*
9. Në përgjigje të shkresës me Nr. 1725 Prot., datë 14.05.2018 të AMF, më shkresën me Nr.269/3 Prot., datë 21.05.2018 të Autoritetit të Konkurrencës, i është kërkuar AMF që ajo në lidhje: “... me inspektimet e realizuara në pikat e shitjes së policës së sigurimit të shoqërive, pranë pikës së kalimit të Hanit të Hotit, të cilat në gjykimin tuaj shfaqin shenja të kufizimit, shtembërimit apo pengimit në këtë treg, të parashtrihen pranë Autoritetit”.
- Pas kësaj shkrese dërguar në AMF nga ana e AK, nuk është depozituar as edhe një informacion në lidhje me shkresën Nr. 269/3 Prot., datë 21.05.2018 të AK.
10. Në korrespondencën e tij me AMF, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, është theksuar dhe evidentuar, se në zbatim të nenit 70 të ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ai bashkëpunon me çdo organ të administratës publike, dhe ent rregullator për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, dhe nga ana tjetër çdo entitet publik është i detyruar në mënyrë individuale të zbatoj dispozitat e këtij ligji, për të siguruar edhe ai një konkurrencë të lirë dhe efektive, në fushën e rregullimit të tij.
11. Si një institucion publik i pavaruar, AK ka detyrimin ligjor, që në çdo rast kur ai shikon shenja që pengojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në treg, të filloj procedurat e tij hetimore, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat e ligjit Nr. 9121/2003, përkatësisht nenet 41-47.

12. Veprimtaria e AK, është e pavaruar nga ajo e çdo institucioni, apo enti tjetër rregullator. AK nuk ka detyrim ligjor që të bashkërendojë veprimet me një institucion, apo ent rregullator për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij të vendosur nga ligji, pasi AK vepron në çdo rast kur pengohet, kufizohet apo shtembërohet konkurrenca në çdo treg. Ligji i ka dhënë diskrecionin AK, që të mbrojë dhe të rregullojë konkurrencën në të gjitha tregjet/sectorët, pavarësisht nëse fusha/sectori ka rregullatorin përkatës.
13. Për këtë arsye pretendimi i ngritur nga AMF për bashkërendim veprimesh, për inspektime të përbashkëta dhe verifikimin e sistemit të shitjes së policave të sigurimit të detyrueshëm nuk qëndron pasi është detyrim ligjor i AMF sipas nenit 138 dhe nenit 139 të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
14. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me shkresën Nr. 1537 prot., datë 08.05.2019, protokolluar me tonën Nr. 305 Prot., datë 09.05.2019 i drejtohet Autoritetit të Konkurrencës si më poshtë vijon:
- *“Duke vlerësuar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka kërkuar gjithmonë bashkërendim të veprimeve si dhe organizimin e takimeve konsultative për të mbështetur Autoritetin e Konkurrencës për një hetim të plotë dhe shterues të tregut të sigurimeve, për mbrojtjen e konkurrencës së lirë, efektive në treg, në funksion të mbrojtjes konsumatore dhe të një tregu konkurrues.*
 - *Lidhur me raportin vjetor të vitit 2018, të publikuar nga Autoriteti i Konkurrencës, dëshirojnë të sjellin në vëmendje se: Në pjesën e dytë të raportit që lidhet me tregjet e monitoruara, “Tregu i sigurimeve për produktin karton jeshil”, citoni se për realizimin e monitorimit AK ka bashkëpunuar me AMF-në.*
 - *Për vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018, “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, nuk e keni gjykuar të nevojshëm këtë bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe nuk e keni kërkuar një gjë të tillë.*
 - *Për këtë arsye, Autoriteti do të vlerësonte ndryshimin e këtij konstatimi në raportin vjetor”.*
15. Nga vlerësimi i pretendimeve të ngritura nga AMF si dhe duke qene në procedurë monitorimi të zbatimit të VKK Nr. 499 datë 15.02.2018 sqarojmë si më poshtë vijon:
- Vendimi Nr. 499 datë 15.2.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, i Komisionit të Konkurrencës, është marrë në koherencë të vlerësimit ligjor që i është bërë marrëveshjes së propozuar nga BSHS, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm ligjor që është depozituar prej saj, ku midis të tjerave: *“Lidhur me marrëveshjen e propozuar për përjashtim nga ndalimi, Byroja Shqiptare e Sigurimeve i është drejtuar AMF e cila në përgjigje të kërkesave të AK me shkresën e saj Nr. 85/1 prot. datë 11.01.2018 ndër të tjera shprehet se Përjashtimi i marrëveshjes është tagër i Autoritetit të Konkurrencës...”*
16. Pretendimi i AMF në lidhje me *“Vendimin e Autoritetit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018, “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil”, nuk e keni gjykuar të nevojshëm këtë bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe nuk e keni kërkuar një gjë të tillë”* është i papabazuar në ligj dhe në prova.
17. Në zbatim të Ligjit Nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar në mënyrë explicite në dispozitat e tij, parashikohet roli dhe pozicioni i AMF në raport me BSHS:
- Neni 42, Byroja Shqiptare e Sigurimit, pika 8: Mbikëqyrja e byrosë kryhet nga AMF, i cili përcakton me rregullore të veçantë rregullat dhe standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes.

- Neni 43, Organet drejtuese të byrosë:

- pika 2, Drejtori ekzekutiv i byrosë emërohet nga asambleja e përgjithshme, me miratimin paraprak të AMF;

- pika 3, Kompetencat, detyrat e organeve drejtuese të byrosë dhe forma e organizimit të saj përcaktohen në statutin e byrosë, i cili propozohet nga asambleja e përgjithshme dhe miratohet nga AMF.

Për sa më sipër, AMF është organi kompetent që mbikëqyr veprimtarinë e BSHS, për pasojë procedura e ndjekur nga BSHS për përjashtimin nga marrëveshja pranë AK, është bërë në dijeni dhe në bashkëpunim me AMF.

18. Nga monitorimi i zbatimit të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.2.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” rezulton se janë respektuar kushtet dhe detyrimet e vendosura për shoqëritë e sigurimit pjesë e kësaj marrëveshje. AMF si rregullator i tregut të sigurimeve, në çdo mënyrë, dhe në çdo kohë të procedurës është vënë në dijeni për këtë marrëveshje të njoftuar në AK, si dhe i është kërkuar në vazhdimësi parashtrimi i shqetësimeve për konkurrencën në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, nenit 26, nenit 28 dhe nenit 45 pika 1 dhe 2, nenit 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. Monitorimin në vazhdimësi të tregut të sigurimeve për shitjen dhe administrimit të kartonit jeshil, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil” deri në përfundim të marrëveshjes së përjashtuar me kushte dhe detyrime të vendosura deri më 15.02.2020.
 - II. Detyrimin e AMF për të parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo rast që pengon, kufizon, apo shtrembëron konkurrencën, në lidhje me tregun e shitjes së policës - kartoni jeshil.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 637, Datë 09.07.2019

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e raportit të monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme.

Baza ligjore: Neni 24, neni 28 dhe neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e monitorimit për zbatimin e vendimit nr. 561, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës për produktin TPL e brendshme,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme” vendosi:
 - a. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për produktin TPL e brendshme.
 - b. T’i rekomandojë AMF-së që brenda afatit 90 ditor:
 - i. Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e MTPL;
 - ii. Të verifikojnë nëse tregtimi i TPL në sistemet e tyre të shitjeve është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg;
 - iii. Të marrë masat për ndalimin e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - iv. Të marrë masat për të lejuar shfaqjen në sistemet e tregtimit që përdoren nga agjentët vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
 - v. Të ndalojë agjentët të tregtojnë për llogari të kompanive të tjera të sigurimit për të cilat nuk janë të licencuar;

- vi. Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrense;
- vii. Të parashtrijë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurrense nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
- c. Për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si dhe për të shmangur çdo sjellje të mundshme antikonkurrense, ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, brenda afatit 90 ditor:
 - i. Të ndalojnë tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - ii. Sistemet që përdorin kompanitë e sigurimit dhe agjentët/punonjësit e tyre për tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm të lejojnë shfaqjen vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron;
 - iii. Agjentët/punonjësit e kompanive të sigurimit të tregtojnë vetëm për llogari të kompanisë së sigurimit për të cilën është licencuar;
 - iv. Në sistemet e tregtimit të policave të sigurimit të detyrueshëm të shmangen ndërhyrjet që nuk janë në përputhje me aktet nënligjore dhe rregullat e vendosura nga AMF, me qëllim shmangien e një koordinimi të mundshëm të sjelljes midis ndërmarrjeve konkurrense.
- d. Ndërmarrja “Star Broker” SHA të ushtrojë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, në mbrojtje të interesave të konsumatorit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe duke zbatuar rregullat e miratuara nga AMF.
- e. Monitorimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta nga Autoriteti i Konkurrencës për një periudhë 6 (gjashtë) mujore.

I. Zbatimi i rekomandimeve nga AMF

2. Autoriteti i Konkurrencës ka kryer monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”.
3. AK, për realizimin e këtij monitorimi ka kryer korrespondencën me AMF si më poshtë vijon:
 - Me shkresën Nr. 363/9 prot., datë 18.10.2018, AMF i është njoftuar VKK Nr. 561, datë 15.10.2018;
 - AMF, me shkresën e saj Nr. 3602/2 prot., datë 14.11.2018 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018” na ka informuar për zbatimin e këtij vendimi;
 - AK, me shkresën Nr. 363/12 prot., datë 06.05.2019 “Kërkesë për informacion” ka kërkuar zbatimin e VKK Nr. 561, datë 15.10.2018;
 - AMF, me shkresën e saj Nr. 3602/4 prot., datë 06.05.2019 dhe shkresën e Nr. 3602/5 prot., datë 08.05.2019 na informon në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës si më poshtë vijon:

i. Pika “a” e VKK Nr. 561, datë 15.10.2018: Të miratojë primin e riskut për çdo kompani sigurimi mbështetur në raportin e përgatitur nga aktuari i kompanisë, duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e TPL.

AMF, me Vendimet Nr. 54, datë 27.03.2019 “Albsig”; Nr. 55, datë 27.03.2019 “Ansig”; Nr. 56, datë 27.03.2019 “Atlantik”; Nr. 57, datë 27.03.2019 “Eurosig”; Nr. 58, datë 27.03.2019 “Insig”; Nr. 59, datë 27.03.2019 “Intersig VIG”; Nr. 60, datë 27.03.2019 “Sigal Uniqa Group Austria”; Nr. 61, datë 27.03.2019 “Sigma Interlbanian Vienna Insurance Group”, “Për miratimin e tabelës së primit për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete”, ka miratuar tabelat e primit të rrezikut për secilën shoqëri për produktin TPL.

Me Vendimin Nr. 62, datë 27.03.2019 “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e nivelit të provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete”, për kontratat TPL të sigurimit; për kontratat kufitare të sigurimit; dhe për kontratat kartoni jeshil.

Për sa më sipër, pika “a” e dispozitivit të VKK Nr. 561, datë 15.10.2018 është zbatuar nga AMF duke miratuar prime rreziku individuale për çdo shoqëri.

ii. Pika “b”, “c”, “e”, “f” e VKK Nr. 561, datë 15.10.2018: Të verifikojë nëse tregtimi i TPL në sistemet e shitjeve të shoqërive të sigurimit është në përputhje me rregullat e sjelljes së tregut të miratuara nga AMF, me qëllim shmangien e pasojave të padëshiruara për konkurrencën në treg.

AMF, me shkresën Nr. 3602/4, datë 06.05.2019 “Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të AK”, na informon se do të vazhdojë të kryejë inspektimet pranë shoqërive në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, të ndryshuar.

AMF, në shkresën Nr. 3602/4, datë 06.05.2019 “Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të AK”, i referohet gjithashtu edhe shkresës Nr. 2375/2 prot., datë 31.08.2018 të sjellë pranë AK, me lëndë: “Dërgohet informacion...”, ku bashkangjitur është Informacion “Për verifikimin e sistemit të shitjeve në tregun e sigurimeve”.

Nga vlerësimi ligjor bërë shkresës me Nr. 2375/2 prot., datë 31.08.2018, rezulton se materiali “Informacion për Verifikimin e Sistemit” i realizuar përpara datës së miratimit të VKK Nr. 561, datë 15.10.2018, ka qenë në funksion të zbatimit të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF për vitin 2017”. Për pasojë, të gjitha gjetjet dhe propozimet kanë qenë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, pranë Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni i cili vlerëson veprimtarinë vjetore të AMF.

Për sa më sipër vlerësojmë, se referenca nga ana e AMF tek shkresa me Nr. 2375/2 prot., datë 31.08.2018, të cilën ajo e evidenton në shkresën Nr. 3602/4, datë 06.05.2019 “Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të AK”, nuk ka lidhje me zbatimin e Vendimit të VKK Nr. 561, datë 15.10.2018, konkretisht me pikave “b”, “c”, “e”, “f” të dispozitivit të tij. Vendim, i cili nga pikëpamja kohore, ka hyrë në fuqi më datë 15.10.2018.

Për sa më sipër, rekomandimet e dhëna për pikat “b”, “c”, “e”, “f” të dispozitivit të Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018, nuk janë realizuar nga AMF.

iii. Pika “d” e VKK Nr. 561, datë 15.10.2018: Të marrë masa për të lejuar shfaqjen në sistemin e tregtimit që përdoren nga agjentët, vetëm të kompanisë së sigurimit për llogari të të cilit vepron.

AMF, me shkresën Nr. 3602/4, datë 09.05.2019, na informon se *ky rekomandim do të zbatohet gjatë inspektimeve ku do të përfshihen dhe pikat “c”, “e” dhe “f”.*

- iv. *Pika “g” e VKK Nr. 561, datë 15.10.2018: Të parashtrijë përpara Autoritetit të Konkurrencës duke kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore për çdo rast për të cilin konstaton sjellje antikonkurruese nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.*

AMF raporton se: *në vijim të rregullores së ndryshuar, por edhe në kuadër të rekomandimeve ka realizuar gjatë muajve dhjetor 2018 – janar 2019 një seri inspektimesh të kombinuara në pikat e shitjeve të agjentëve për të verifikuar: dokumentacionin e nevojshëm të përdorur prej tyre, sistemet e teknologjisë së informacionit që përdorin për të lëshuar një policë të sigurimit të detyrueshëm motorik, inspektim tematik tek shoqëritë e brokerimit.*

Nisur nga sensibiliteti publik dhe shqetësimet e shfaqura herë pas here dhe konstatimet që kanë dalë nga puna e përditshme, kanë dërguar disa shkresa përkatësisht: Nr. 1416/1, datë 27.04.2018 “Mbi një ankesë të depozituar në AMF”, Nr. 1725 prot., datë 14.05.2018 dhe Nr. 1725/2 prot., datë 22.05.2018 “Mbi inspektimin të ndërmjetësit në sigurime”, në pikën kufitare të Hanit të Hotit, si dhe Nr. 1789 prot., datë 18.05.2018 dhe Nr. 2143 prot., datë 18.06.2018 “Mbi inspektimin tek ndërmjetësit në sigurime” Bankat – Broker.

Për sa më sipër, nga vlerësimi i gjithë dokumentacionit të depozituar rast pas rasti në vitin 2018, AMF në asnjë rast nuk ka depozituar asnjë informacion i cili mund të shfaqë shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në lidhje me tregtimin e produktit TPL nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve, subjekte veprimtaria e të cilave rregullohet nga ana e saj.

AMF, me shkresën Nr. 3602/4, datë 06.05.2019 “Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të AK” për Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018, u referohet shkresave të saj me:

- I. Nr. 1416/1, datë 27.04.2018 “Mbi një ankesë të depozituar në AMF”, bashkangjitur ankesa e qytetarit AM; Nr. 1725 prot., datë 14.05.2018 “Mbi inspektimin tek ndërmjetësit në sigurime”, dhe Nr. 1725/2 prot., datë 22.05.2018 “Përgjigje shkresës Tuaj, Nr. 269/3, datë 22.05.2018.

“Në lidhje me këto 3 (tre) shkresa, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në vendimin Nr.499, datë 15.02.2018 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit, për kartonin jeshil”, përkatësisht pika 5 e dispozitivit të tij, e ka vendosur këtë përjashtim në procesin e monitorimit. Në vazhdimësi, Komisioni i Konkurrencës, është shprehur mbi zbatimin e kushteve dhe detyrimeve me Vendimin Nr.623, datë 23.05.2019 “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit Nr. 499, datë 15.02.2018, të KK për kartonin jeshil”.

- II. Nr. 1789 prot., datë 18.05.2018 “ Mbi inspektimin për ndërmjetësit në sigurime”; Nr. 2143 prot., datë 18.06.2018 “Mbi inspektimin tek ndërmjetësit në sigurime” Bankat – Broker.

Në lidhje me këto 2 (dy) shkresa , Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin Nr. 585, datë 24.01.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ndërmjetësimin në sigurime, nga bankat e nivelit të dytë, vendosjen e disa detyrimeve dhe rekomandimeve”.

- III. Në lidhje me TPL, të cilës i referohet gjithashtu shkresa Nr. 1725/2, datë 22.05.2018, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”, ashtu siç është cituar edhe më sipër në këtë vendim.

Shkresat e paraqitura nga ana e AMF, ashtu siç citohet edhe në to, kanë të bëjnë me shkelje të ligjit nr.52/2014 “Për sigurimin dhe risigurimin”, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat janë objekt shqyrtimi dhe vendimmarrje nga autoriteti përkatës rregullator – AMF.

Neni 70 i ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar kërkon nga çdo organ i administratës publike dhe ent rregullator detyrimin për bashkëpunim me AK për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Veprimtaria e AK është e pavarur nga ajo e çdo institucioni, apo enti tjetër rregullator. AK nuk ka detyrim ligjor që të bashkërendojë veprimet me një institucion, apo ent rregullator për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij të vendosur nga ligji, pasi AK vepron në çdo rast kur shikon shenja që pengojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në treg, duke filluar procedurat e tij hetimore, të parashikuara shprehimisht nga nenet 41-47.

Ligji i ka dhënë diskrecionin AK, që të mbrojë dhe të rregullojë konkurrencën në të gjitha tregjet/sectorët, pavarësisht nëse fusha/sectori ka rregullatorin përkatës.

Rekomandimet e dhëna në pikën II, gërmat: “b”, “c”, “d”, “e”, “f” “g” të dispozitivit të Vendimit Nr. 561, datë 15.10.2018, nuk janë realizuar nga AMF.

II. Zbatimi i rekomandimeve nga Shoqëritë e Sigurimit

1. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 222, datë 25.03.2019, ka kërkuar informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për zbatimin e rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018 “Për disa rekomandime dhe mbylljen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme”.
2. AK, në përgjigje të shkresës Nr. 222, datë 25.03.2019, ka administruar shkresat nga ndërmarrjet: shkresa Nr. 844/1, datë 01.04.2019 e ndërmarrjes “Insig”; shkresa Nr. 2481, datë 01.04.2019 e ndërmarrjes “Eurosig”; shkresa Nr. 1257, datë 02.04.2019 e ndërmarrjes “Sigal”; shkresa Nr. 266/1, datë 02.04.2019 e ndërmarrjes “Atlantik”; shkresa Nr. 622, datë 04.04.2019 e ndërmarrjes “Intersig”; shkresa Nr. 680, datë 04.04.2019 e ndërmarrjes “Sigma”; shkresa Nr. 514/1, datë 05.04.2019 e ndërmarrjes “Albsig”; shkresa Nr. 520, datë 05.04.2019 të shoqërisë “Ansig”.
3. Nga vlerësimi i informacionit rezultoi se: ndërmarrjet e sigurimeve kanë informuar autoritetin se kanë zbatuar rekomandimet e dhëna sipas pikës 3 “a”, “b”, “c”, “d” të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018.
4. Për sa më sipër, duke qenë se AMF, si organi rregullator i tregut të sigurimeve nuk ka përmbushur rekomandimet e dhëna në VKK nr.561, datë 15.10.2018, pika 2, gërmat: b”, “c”, “d”, “e”, “f” “g” të dispozitivit të tij, rekomandime të cilat u drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe ndërmarrjeve që operojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin TPL e brendshme, përkatësisht pika 3 e këtij vendimi, gërmat: a”, b”, c’, d”, konsiderohen si të pa përmbushura.

III. Zbatimi i rekomandimeve nga ndërmarrja “Star Broker” SHA

5. Zbatimi i pikës 4 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018 janë kompetencë e AMF në bazë të ligjit Nr. 52/2014, neni 193 pika 2 “AMF licencon dhe mbikëqyr veprimtarinë e ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime. Dispozitat e këtij ligji për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit zbatohen rast pas rasti edhe për mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”.

6. Duke patur parasysh se që nga muaji mars 2019 AMF ka miratuar primet e rrezikut të ndryshme për çdo shoqëri, nga ana e AK do të vazhdojë të mbajë nën monitorim aktivitetin e ndërmarrjes “Star Broker” SHA, i cili duke qenë se është ndërmjetës në tregtimin e produktit TPL, nuk e ka zbatuar pikën 4 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 561, datë 15.10.2018, për shkak se edhe shoqëritë e sigurimit që lidhin kontrata ndërmjetësimi me të nuk kanë zbatuar rekomandimet e dhëna.
7. Autoriteti i Konkurrencës ka evidentuar, se në zbatim të nenit 70 të ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ai bashkëpunon me çdo organ të administratës publike, dhe ent rregullator për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, dhe nga ana tjetër çdo entitet publik është i detyruar në mënyrë individuale të zbatojë dispozitat e këtij ligji, për të siguruar edhe ai një konkurrencë të lirë dhe efektive, në fushën e rregullimit të tij. Përsa më sipër zbatimi i ligjit Nr. 52/2014 ka për qëllim mirëfunksionimin e tregut të sigurimeve dhe AMF është autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjen e këtij tregu. Rekomandimet e dhëna nga KK, me Vendimin Nr. 561, datë 15.10.2018, janë në funksion të përmirësimit të konkurrencës në tregun e sigurimeve dhe mbetet detyrë e AMF zbatimi i tyre me qëllim rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, nenit 26, nenit 28 dhe nenit 45 pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë AMF zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 561, datë 15.10.2018, brenda një periudhë 6 mujore. Të raportojë pranë AK për përmbushjen e rekomandimeve.
 - II. Monitorimin e sjelljes së shoqërive të sigurimit në tregun e TPL, pas përcaktimit të primeve të rrezikut nga AMF të ndryshme për çdo shoqëri sigurimi, duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019.
 - III. Monitorimin e sjelljes së shoqërive të brokerimit dhe shoqërisë “Star Broker” të licencuar nga AMF si ndërmjetës në sigurime duke raportuar pranë AK shitjet mujore për çdo shoqëri për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga muaji mars 2019.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 642, Datë 25.07.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 592, datë 31.01.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar.

Për realizimin e procedurave hetimore, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga bankat e nivelit të dytë për vlerësimin e konkurrencës në tregun e shërbimeve në sektorin bankar, përcaktimin e strukturave të tregut dhe kryerjen e analizave ekonometrike.

Informacioni i dërguar nga bankat e nivelit të dytë nuk ka ardhur sipas formatit të kërkuar dhe i mungojnë elementët shpjegues të kërkuar. Koha e mbetur në dispozicion nga momenti i depozitimit të informacionit është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 592, datë 31.01.2018.

Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 592, datë 31.01.2019 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo””, pika “3”, të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i Hetimit të Thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 tetor 2019”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 643, Datë 25.07.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit të grurit dhe miellit”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit të grurit dhe miellit,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Nisur nga një ankesë, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, vendosi të realizojë një monitorim në tregun e importit të grurit dhe miellit, për të vlerësuar dhe analizuar kushtet e zhvillimit të konkurrencës në tregjet përkatëse, efektet që mund të sjellë ndonjë nga veçoritë e tregut të grurit, miellit dhe bukës, si dhe për të parë nëse ka elemente që kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën në këtë treg.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të monitorimit, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja d dhe neni 42, pika 1, të ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit” vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 30.09.2018, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003.
3. Në zbatim të vendimit nr. 551, datë 04.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.563, datë 08.10.2018 "Autorizim inspektorësh", gjatë periudhës së hetimit paraprak u realizua kryerja e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, gjatë periudhës së hetimit paraprak është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit.

5. Informacioni i administruar, deri në shtator të vitit 2018 nuk ishte i mjaftueshëm për konkludimin e procedurave hetimore. Për këtë arsye, me qëllim vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, lind nevoja për hetime të mëtejshme, për periudhën shtator 2018-mars 2019 për importin e grurit dhe të miellit.
6. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës çmoi se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive dhe me vendimin nr. 612, datë 19.04.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 551, datë 04.10.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”, vendosi ndryshimin e objektit të hetimit si dhe zgjatjen e afatit të hetimit deri në datë 1 prill 2019.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 76, datë 07/04/2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” tregu përkatës përfshin tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik.
8. Bazuar në VKK nr. 551, datë 04.10.2018 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit importit dhe përpunimit të grurit dhe miellit”, tregu përkatës i produktit përfshin:
 - Tregun e importit të grurit,
 - Tregun e prodhimit/përpunimit të miellit
 - Tregu i importit të miellit
9. Analiza e këtyre tregjeve bëhet e domosdoshme pasi, ndërmarrjet më të mëdha në tregun e prodhimit të miellit janë importuesit më të mëdhenj të grurit dhe çdo shtrembërim i konkurrencës në tregun e importit të grurit, jep efekte të drejtpërdrejta në tregun e prodhimit të miellit dhe transmetohet tek prodhuesit e bukës, deri tek konsumatori përfundimtar.
10. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, ***treg gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë, pra tregu i brendshëm.***

II.2 Struktura e tregut

11. Referuar të dhënave të administruara gjatë periudhës hetimore konstatohet se sasia totale e prodhuar dhe importuar e grurit për vitin 2017, nga ku vërehet se rreth 52% është sasi e prodhuar në vend dhe 48% është sasi e importuar. Ndërsa për vitin 2018, sasia e prodhuar në vend është pak më e ulët pra rreth 45 % krahasuar me sasinë e importuar e cila zë rreth 55% të konsumit të brendshëm. Vendet importuese të grurit mbeten Rusi dhe Serbia, me rreth 90% të sasisë totale të importuar.
12. Tregu i importit të grurit është në kufirin e sipërm të një shkalle të moderuar përqendrimi, duke qenë se treguesi HHI është në vlerat 1640, pasi janë rreth 4 ndërmarrje të cilat zotërojnë pjesën kryesore të importit dhe një numër të konsiderueshëm importuesish me pjesë shumë të vogla tregu, nën 1 %.
13. Sasia totale e miellit të prodhuar është 495 mijë ton për vitin 2017, ndërsa për vitin 2018 është rreth 497 mijë ton.
14. Tregu i importit të miellit është në kufirin më të ulët të përqendrimit, ku HHI paraqitet në vlerën e 1147 për vitin 2017 dhe për vitin 2018 me një rënie të konsiderueshme, duke arritur në vlerën prej 567. Edhe

përsa i takon treguesve në lidhje me peshën e ndërmarrjeve më të mëdha importuese në treg, treguesi është rreth 20-35%, për vitin 2018.

15. Nëntregu i importit të miellit rifuxho (ose me ambalazh mbi 25 kg) (përfashtuar miellin për përdorim vetjak) paraqitet me një nivel të lartë përqendrimi për të gjithë periudhën nën hetim ku treguesi HHI paraqitet në nivelin 4500 deri në 6000.

II.3 Vlerësimi i konkurrencës

II.3.1 Pjesët e tregut

16. Nga analiza e pjesëve të tregut, vërehet se ndërmarrjet AGROBLEND, MIELL TIRANA, BLOJA dhe ATLAS zotërojnë pjesën më të madhe të sasisë së importuar të grurit për të gjithë periudhën nën hetim duke e ruajtur këtë pjesë tregu për të gjithë periudhën. Pjesa e kombinuar e tregut të importit të grurit të këtyre ndërmarrjeve arrin në rreth 70%.
17. Qëndrueshmëria e pjesës së tregut të ndërmarrjeve në tregun e importit të grurit si dhe fuqia e këtyre tre ndërmarrjeve, referuar treguesit CR3, sjell dyshime për ndonjë kufizim të mundshëm të konkurrencës në tregun e importit të grurit.
18. Këto ndërmarrje kanë krijuar një qëndrueshmëri të pozicionit të tyre në treg që vjen si rezultat i shfrytëzimit të linjave të prodhimit të miellit, duke ruajtur këtë pjesë për të gjithë periudhën nën hetim, duke na paraqitur një treg mesatarisht të përqendruar përsa i takon peshës që këto ndërmarrje zënë në tregun e importit të grurit duke u bërë kështu një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e ofertës së grurit dhe miellit në tregun e brendshëm.
19. Siç u konstatua edhe në ndarjen e tregut sipas importit të grurit, ashtu dhe në tregun e prodhimit (përpunimit) të miellit në fabrikat vendase, ndërmarrjet Agroblend, Miell Tirana, Bloja dhe Atlas kanë peshën më të madhe në treg në prodhimin e miellit. Linja e prodhimit iu jep mundësinë këtyre ndërmarrjeve të ruajnë këtë pozicion për një periudhë të gjatë.

II.3.2 Barrierat në hyrje

20. Midis importuesve të grurit dhe prodhuesve të miellit ka integrim vertikal dhe ky integrim ju jep atyre fuqinë ekonomike financiare, rrit pengesat në hyrje të ndërmarrjeve të reja si dhe mundësinë e një bashkërendimi të veprimeve ruajtur të njëjtën strukturë tregu.
21. Ndërmarrjet kryesore të integruara vertikalisht kanë pjesën më të madhe të tregut përsa i takon sasisë së grurit të importuar dhe sasisë së miellit të prodhuar duke krijuar mundësinë e koordinimit të sjelljeve të këtyre ndërmarrjeve si rezultat i integritimit vertikal.
22. Meqenëse 4 nga ndërmarrjet zotërojnë pjesë të konsiderueshme të tregut, si dhe duke qenë se burimi i furnizimit të produktit grurë është rreth 97 % nga Rusia dhe Serbia, pra burim i njëjtë furnizimi referuar origjinës, mund të themi se ndërmarrjet importuese të grurit kanë një pozicion të fortë në tregun e rrjedhës së sipërme. Referuar kësaj analize mundësia e koordinimit të sjelljes mes këtyre ndërmarrjeve është më e madhe dhe efektet e bashkëpunimit të tyre mund të ndihen në tregun e rrjedhës së poshtme.

II.3.3 Analiza e çmimit

23. Nga analizimi i të dhënave të administruara, çmimi CIF i importit të grurit paraqet një luhatje të konsiderueshme, çmimi mesatar mujor i miellit të prodhuar, i cili është nënprodukt i grurit, nuk paraqet një ndryshim. Çmimi mesatar i shitjes së miellit nga ndërmarrjet e blojës nuk ndjek luhatjet e çmimit të grurit dhe trendi i ndryshimit të tij është i njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.

24. Pavarësisht nga ndryshimet e dukshme të çmimit të grurit, trendi i çmimit të shitjes së produktit miell për ndërmarrjet Agroblend, Miell Tirana, Bloja dhe Atlas është paralelisht i njëjtë, duke mos reaguuar në asnjë rast të ndryshimit të çmimit CIF.

II.3.4 Importi i miellit

25. Tregu i importit të miellit përbehet nga një numër i madh ndërmarrjesh, ku pjesa më e madhe e tyre zotëron më pak 1% të pjesës së tregut. Gjithashtu konstatohet se struktura e tregut nuk është e qëndrueshme, pasi vërehen ndryshime të dukshme të pjesëve të tregut të ndërmarrjeve për vitet 2017-2018. Sasia e miellit të importuar ka pësuar një rënie të dukshme me rreth 50% duke treguar një strukturë aspak të qëndrueshme.

26. Ky treg paraqitet problematik duke qenë se ky produkt futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar dhe rrjedhimisht edhe cilësinë. Për këtë arsye mund të themi se çmimi i ulët i importit favorizon ndërmarrjet në treg, duke i vendosur ndërmarrjet prodhuese në kushte të pafavorshme të konkurrencës.

27. Nën tregu i importit të miellit rifuxho (ose me ambalazh mbi 25 kg) (përfshijë miellin për përdorim vetjak) paraqitet me një nivel të lartë përqendrimi për të gjithë periudhën në hetim ku treguesi HHI paraqitet në nivelin 4500 deri në 6000.

28. Gjithashtu edhe përsa i takon treguesve lidhur me peshën që ka në treg ndërmarrjet me fuqi tregu më të madhe vërehet se CR2 ose pesha e 2 ndërmarrjeve me pjesë më të lartë tregu është rreth 95 % për vitin 2017 dhe rreth 75% për periudhën janar – shtator 2018. Por që ndikimi në treg i këtyre ndërmarrjeve nuk është i konsiderueshëm, duke mos pasur fuqi apo peshë për të ndikuar në ofertën e miellit.

II.3.5 Problematika në treg

29. Importi i miellit nga vendet si Serbia, Kosova dhe Mali i Zi, zënë një pjesë të konsiderueshme të sasisë së miellit rifuxho (ose me ambalazh mbi 25 kg) për periudhën hetimore. Ky produkt futet në tregun vendas si miell gruri pa përcaktuar destinacionin e tij përfundimtar dhe çmimi i ulët i importit favorizon ndërmarrjet në treg, duke rritur pjesën e tregut si dhe duke e mbajtur atë për një kohë të gjatë.

30. AKU, në rolin e mbikëqyrësit të cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore, nuk përcakton nivelin të proteinës (% proteinike) në “Raportet e Provës” për produktin miell, duke sjell për pasojë mos identifikimin e llojit të produktit apo nivelit të cilësisë së tij. Ky fakt iu jep mundësinë importuesve të miellit të operojnë në treg me çmime më të ulta, për produkte cilësisht të ndryshme.

31. DPD nuk e ka të parashikuar në “Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave 2018” ndarjen e produktit miell gruri sipas karakteristikave dhe cilësisë së produktit dhe destinacionit përfundimtar të produktit (konkretisht miellit) siç dhe rekomandohet në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 207, datë 31.03.2015. Ky element regjistrimi i produktit pengon identifikimin e llojit të produktit (miell) sipas cilësisë dhe destinacionit përfundimtar të përdorimit.

32. Si përfundim, vlerësohet se ndërmarrjet importuese të grurit dhe prodhuesve të miellit janë të integruara vertikalisht dhe pjesa e kombinuar e tregut të 4 ndërmarrjeve është rreth 70% ; qëndrueshmëria e pjesëve të tregut gjatë periudhës hetimore mundëson ndërmarrjet për t’u bërë faktor përcaktues i ofertës së grurit dhe miellit, duke përjashtuar ndërmarrjet e tjera jo të integruara; sjellja e ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes së produktit miell nuk paraqet trendin e çmimit CIF si dhe trendi i ndryshimit të këtij çmimi paraqitet i njëjtë për të gjitha ndërmarrjet.

Referuar analizës së tregut të importit dhe prodhimit të grurit dhe miellit rezulton se mund të ketë elementë të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës apo sjellje të bashkërenduar nga ndërmarrjet që zënë peshën

kryesore në treg “AGROBLEND” dhe “MIELL TIRANA”, “BLOJA” dhe “ATLAS” referuar nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe prodhimit të grurit dhe miellit, konkretisht ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”;
2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.06.2019.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë 6 muaj nga dalja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 655, Datë 01.11.2019

“Për disa ndryshime në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Neni 112 i Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””,

VËREN SE:

1. Me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”, të ndryshuar, Komisionit të Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 30.09.2018.
2. Në përfundim të hetimit rezultoi se, në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, mund të ketë elementë të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës apo sjellje të bashkërenduar nga ndërmarrjet që zënë peshën kryesore në treg “AGROBLEND” dhe “MIELL TIRANA”, “BLOJA” dhe “ATLAS”.
3. Bazuar sa me sipër, me vendimin nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”, Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit të thelluar ndaj këtyre ndërmarrjeve në tregun përkatës. Hetimi i thelluar përfshin periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.06.2019.
4. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003 me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, është kërkuar informacion nga ndërmarrjet nën hetim.

5. Nga administrimi i informacionit u konstatua se në ndërmarrjen nën hetim Atlas SHA, e cila ka ushtruar veprimtarinë ekonomike në tregun e përpunimit dhe tregtimit të miellit, ka ndodhur transferimi i biznesit (veprimtarisë ekonomike) të përpunimit dhe tregtimit të miellit tek ndërmarrja Atlas Mills SHPK, konkretisht me vendim e datës 03.09.2018 të Asamblesë së Përgjithshëm të shoqërisë Atlas SHA. Atlas Mills SHPK është krijuar si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me ortak të vetëm Dimitrios Thomoglou, aksioner i vetëm edhe i ndërmarrjes Atlas SHA.
6. Në datë 28 Shtator 2018, zotëruesit e shoqërive Atlas Mills SHPK dhe Besniku SHPK, kanë lidhur marrëveshjen “Kontratë Shitje Kuotash”, ku Z. Dimitrios Thomoglou (shitësi), në cilësinë e pronarit të “kuotës” së kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK i shet shoqërisë Besniku SHPK (blerësi) kuotën e vetme të kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK.
7. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”, ka vendosur të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100 % të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.
8. Sa më sipër, ndërmarrja Atlas Mills SHPK nga data 28.09.2018 ka kaluar në pronësi të shoqërisë Besniku SHPK, gjë e cila nënkupton faktin që ndërmarrja Atlas SHA nga ky moment nuk operon më në tregun e prodhimit (përpunimit) dhe tregtimit të miellit.
9. Si përfundim rezulton se, gjatë periudhës nën hetim 01.01.2017 deri në 30.06.2019, në tregun objekt hetimi operojnë të dyja ndërmarrjet Atlas SHA me aksionar z. Dimitrios Thomoglou dhe Atlas Mills SHPK me ortak të vetëm shoqërinë Besniku SHPK, duke bërë të nevojshme përfshirjen e të dyja këtyre ndërmarrjeve nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a. Objekti i hetimit të ndryshohet si vijon: “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agro Blend” SHPK, “Miell Tirana” SHA, “Bloja” SHA, “Atlas SHA” dhe “Atlas Mills” SHPK”;
 - b. Pika 1 e dispozitivit të ndryshohet si vijon: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agro Blend” SHPK, “Miell Tirana” SHA, “Bloja” SHA, “Atlas SHA” dhe “Atlas Mills” SHPK”;
 - c. Në pikën 2 të dispozitivit periudha kohore: “nga 01.01.2018” bëhet “nga 01.01.2017”.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

VENDIM

Nr. 583, Datë 17.01.2019

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit, për periudhën kohore për vitet 2015-2018, dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), si dhe është kërkuar informacion në mënyrë shkresore nga FSHF-ja dhe Klubet e Futbollit.
3. Lidhur me kërkesën për informacion dërguar FSHF-së, fillimisht të dhënat e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk ishin të plota dhe për këtë arsye me shkresën Nr. 631/4 Prot., datë 14.11.2018, i është kërkuar FSHF-së plotësimi i informacionit brenda datës 21.12.2018. FSHF-ja me shkresën Nr. 631/11 Prot., datë 28.12.2018, shprehet se do të dorëzojë informacionin e kërkuar brenda datës 15.01.2019, pasi kjo shkresë ka mbërritur në zyrat e saj në datën 28.12.2018. Nga FSHF informacioni është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 16.01.2019, me shkresën Nr. 1486/1 Prot., datë 15.01.2019.
4. Koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së FSHF-së, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018.

5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon Federata Shqiptare e Futbollit, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, pika “2”, të ndryshohet si vijon:

“2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 25 Prill 2019.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 588, Datë 28.01.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9 dhe neni 42 pika 1, i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003) dhe Rregulloren “Për organizimin dhe Funksonimin e Veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) ka paraqitur një kërkesë me objekt “Njoftim për një sjellje të mundshme anti-konkurrese dhe kërkesë për hetim”.
2. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) i drejtohet Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me një ankesë të një operatori, GEN-I Tirana SHPK (Furnizues dhe Tregtues i Energjisë Elektrike) depozituar pranë ECS në lidhje me disa shqetësime në tregun e energjisë elektrike:
 - Pretendohet se është shpërndarë informacion konfidencial në përfitim të “pjesëmarrësve të privilegjuar të tregut”, lidhur me ofertat e dorëzuara nga pjesëmarrësit e tjerë, duke u mundësuar atyre të paraqesin ofertat e tyre me diferencë shumë të vogël lidhur me ofertat më konkurruese, duke siguruar kështu rezultatin e dëshiruar të tenderit si dhe nëpërmjet sinjaleve të pasakta, të rreme dhe çorientuese lidhur me prodhimin e tij në treg duke i dhënë informacion të brendshëm “pjesëmarrësve të privilegjuar të tregut” dhe;
 - Dy marrëveshjeve kuadër të lidhura ndërmjet KESH dhe kontraktorëve respektiv (kontrata “depozitimi” dhe kontrata “devijimi”).
3. Në vijim të shqyrtimit të kërkesës së Sekretariatit të Energjisë, konstatojmë se KESH i realizon procedurat në përputhje me rregullore të posaçme të miratuara nga ERE dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
4. Nga të dhënat e administruara nga faqja zyrtare e ERE, rezulton se pavarësisht se janë 110 operatorë të licencuar në treg për tregëtimin e energjisë elektrike, në procedurat e tenderimit të zhvilluara për periudhën janar 2017 deri në gusht 2018 kanë marrë pjesë një numër i kufizuar operatorësh, vetëm 9 operatorë.

5. Në lidhje me marrëveshjet kuadër të lidhura nga KESH, është konstatuar se në Ligjin 43/2015 ‘Për sektorin e Energjisë Elektrike’, i ndryshuar, parashikohen transaksione të tilla si blerja, shitja dhe shkëmbimi. Në lidhje me shkëmbimin e energjisë elektrike, respektohen procedurat sipas rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike.
6. Në lidhje me marrëveshjet Kuadër të “depozitimit” apo të “devijimit”, për të cilat referohet kërkesa e Sekretariatit të Energjisë, ERE në vitin 2016 ka marrë Vendimin nr. 131, datë 15.08.2016 “Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH SHA “Ftesë për ofertë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, sipas të cilit ERE, si institucioni rregullator në sektorin e energjisë ka vendosur që KESH duhet të ndërpresë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin dhe përfundimin e kësaj procedure.
7. Si përfundim konstatohet se nga kërkesa e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe nga ankesa e depozituar pranë institucionit tonë për dijeni, nga një operator i licencuar për tregtimin e energjisë elektrike, potencialisht mund të evidentohen elementë të cilat mund të përbejnë shkelje të dispozitave në fushën e konkurrencës.
8. Në procedurat e realizuara për depozitimin dhe devijimin e energjisë elektrike, mund të ketë elementë të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të Ligjit 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9 dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Rregulloren “Për organizimin dhe Funksonimin e Veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
 2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 593, Datë 07.02.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 699 Prot., datë 17.12.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 59, datë 20.07.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt - vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas organizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt - vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale në vitet në vazhdim, duke patur orientimin drejt kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
 - Tarifat aktuale që aplikon ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SHA për ujin e pijshëm për konsum publik janë miratuar me Vendimin Nr. 12 datë 30.03.2017 të KKRR-së. Sipas ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SHA, niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale, investimet e realizuara është relativisht i ulët.
3. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Gjirokastërës (43 lek/m³) dhe për zonën rurale (Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie) (25 lek/m³), të cilat janë të miratuara nga ERRU.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA propozon rritje të tarifave për zonën urbane, për konsumatorin familjar me 3 lek/m³, duke pësuar një rritje afro 7% dhe për konsumatorët publik dhe privat me 8 lek/m³, ndërsa për zonën rurale (Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie) nuk propozohet ndryshim i nivelit të tarifës.
5. Nga analiza e bërë, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2018, 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara.
6. Nga analiza ekonomiko financiare rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA edhe pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes në masën 108 % dhe ato totale 92.4%.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot totale të operimit dhe mirëmbajtjes, si edhe kostot totale në 2% krahasuar me vitin 2017, vit gjatë të cilit ajo ka mbuluar kostot edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit, duke mos marrë parasysh propozimin e ndërmarrjes për kosto më të larta.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA ka ende nevojë, për subvencione për mbulimin e kostove totale, si dhe ka nevojë për investime emergjente dhe afat mesme, pasi rrjeti është i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.
9. Tarifat nuk duhet të tejkalojnë kostot e tyre, duke shmangur fitimin monopol të ndërmarrjes dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2018, 2019 mbetet thuajse në të njëjtat nivele me ato të vitit 2017 me një rritje prej 2%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetllës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
11. Nga vlerësimi i Konkurrencës për “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA” rezulton se Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Gjrokastër SHA ka pozite dominuese dhe si e tillë ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos.
12. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Gjrokastër SHA nuk ka realizuar një ndarje veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura.
13. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale se bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, date 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
14. Konstatohet se informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve vendimin e tij ku të përfshijë të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK me anë të Vendimit Nr. 492, date 28.12.2017 të Komisionit të Konkurrencës.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 597, Datë 19.02.2019

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore, për periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 30 shtator 2018 dhe raporti i hetimit të përgjithshëm të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion në mënyrë shkresore nga: Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake, Spitalet Private si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

Për vlerësimin e konkurrencës në treg (vlerësimin e strukturave të tregut, kryerjen e analizës së sjelljes, kryerjen e analizave statistikore-ekonomike për të gjithë shërbimet shëndetësore), do të ishte i nevojshëm administrimi i informacionit për të gjithë vitin 2018 (1 janar - 31 dhjetor 2018).

Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë për të gjithë periudhën kohore 2018, me qëllim analizimin e konkurrencës në tregun spitalor, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, pika “II”, të ndryshohet si vijon:

“2. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 31 dhjetor 2018.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 600, Datë 15.03.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Poliçan” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Poliçan” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, gërma d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Poliçan SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 722 Prot., datë 28.12.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 59, datë 20.07.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt - vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas organizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt - vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale në vitet në vazhdim, duke patur orientimin drejt kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
 - Tarifat aktuale që aplikon ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA për ujin e pijshëm për konsum publik janë miratuar me Vendimin nr. 27 datë 18.06.2010 të ERRU-së. Sipas ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Poliçan SHA, niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale, investimet e realizuara është relativisht i ulët.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Poliçanit (37 lek/m³) dhe për zonën e riorganizuar Vërtop dhe Tërpan (44 lek/m³), të cilat janë të miratuara nga ERRU.

4. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA propozon rritje të tarifave për zonën urbane, për konsumatorin familjar me 13 lek/m³ (zona e Policanit), duke pësuar një rritje afro 35%, ndërsa për Tërpan dhe Vërtoq tarifa rritet me 6 lek/m³, duke pësuar një rritje prej 13.6% të tarifës. Për konsumatorët jo familjar (buxhetor, privat) tarifa pësuar një rritje 45 lekë ose 56%, ndërsa për konsumatorët buxhetor tarifa rritet 30 lekë për konsumatorët privat ose 31.5% e tarifës aktuale.
5. Nga analiza e bërë, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara.
6. Nga analiza ekonomiko financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA edhe pas riorganizimit nuk arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi janë në masën 46% dhe në vitin 2019 objektivi është të arrij 99.3%.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot totale të operimit dhe mirëmbajtjes, si edhe kostot totale në 46.8% më shumë, krahasuar me vitin 2017, duke marrë parasysh propozimin e ndërmarrjes për kosto më të larta.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA ka nevojë, për subvencione për mbulimin e kostove totale, si dhe ka nevojë për investime emergjente dhe afatmesme, pasi rrjeti është i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.
9. Tarifatat nuk duhet të tejkalojnë kostot e tyre, duke shmangur fitimin monopol të ndërmarrjes dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2019 rritet në nivele rreth 46.8% më të lartë se në vitin 2017, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetllës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
11. Nga vlerësimi i Konkurrencës për “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA” rezulton se; Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Poličan SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë ka detyrimin e orientimin të cmimeve drejt kostos.

Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Poličan SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.

ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

12. Konstatohet se informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, gërma d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Poliçan SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjiellës Kanalizime Poliçan SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar a) shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi, të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK, për ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 602, Datë 21.03.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Delvinë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Delvinë” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, gërma d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar)..

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Delvinë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 296/5 Prot., datë 22.01.2018, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 60, datë 06.09.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA, e cila ka propozuar me anë të projektvendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projektvendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale në vitet në vazhdim, duke patur orientimin drejt kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
 - Tarifat aktuale që aplikon ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA për ujin e pijshëm për konsum publik janë miratuar me Vendimin nr. 12 datë 29.05.2008 të KKRR-së. Sipas ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Delvinë SHA, niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale, gjendjen e amortizuar të sistemit që është relativisht e ulët.
3. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Delvinës (48 lek/m³) dhe për zonën rurale (Vergo, Vanë, Letferhor, Kakodhiq) (0 lek/m³), të cilat kanë qenë të miratuara nga ERRU.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA propozon rritje të tarifave dhe unifikimin e tyre, për konsumatorin familjar me 10 lek/m³, duke pësuar një rritje afro 20.8% dhe për konsumatorët publik dhe privat me 20 lek/m³, ndërsa për zonën rurale (Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie) propozohet vendosje e tarifës së ndryshuar, e cila për të tre konsumatorët është një tarifë e re.
5. Nga analiza e bërë, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2018, 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara.
6. Nga analiza ekonomiko financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA edhe pas riorganizimit nuk arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ato parashikohet të jenë në masën 82 % gjatë 2019, ndërsa mbulimi i kostove totale parashikohet 71%.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot totale të operimit dhe mirëmbajtjes, si edhe kostot totale në 12% krahasuar me vitin 2017, vit gjatë të cilit ajo ka mbuluar rreth 59% të kostos totale edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA ka ende nevojë, për subvencione për mbulimin e kostove totale, si dhe ka nevojë për investime emergjente dhe afat mesme, pasi rrjeti është i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.
9. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos së tyre, duke shmangur fitimin monopol të ndërmarrjes dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2018, 2019 mbetet thuajse në nivele të ulta krahasuar me ato të vitit 2017 me një rritje prej 12%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjetllës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
11. Nga vlerësimi i Konkurrencës për “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA” rezulton se; Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Delvinë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.

ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale sëbashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).
12. Konstatohet se informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, gërma d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkoj nga Ujësjetllës Kanalizime Delvinë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar a) shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të publikojë dhe bëjë transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi, të gjithë informacionin mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave, duke marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë nga AK, për ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura, sipas metodologjisë së miratuar nga ERRU.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 603, Datë 21.03.2019

“Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Zbatimi i masës së përkohshme dhënë me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”.

Baza ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e masës së përkohshme dhënë me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018, ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, vendosi:
 - i. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, si vijon:
 - a- *Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD detyrohet që të respektojë të gjitha kontratat e lidhura me ndërmarrjen Tosk dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë aktivitetet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
 - ii. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore;

- iii. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr. 9121/2003;
 - iv. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr. 9121/2003.
3. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, i është njoftuar ndërmarrjes “Bankers Petroleum Albania” LTD, nëpërmjet shkresës sonë nr. 607/12 prot, datë 20.12.2018.
 4. Ndërmarrja Tosk Energji, në vijim të VKK nr. 578, ka kërkuar nga ndërmarrja Bankers furnizimin me sasinë e mjaftueshme për funksionimin e Rafinerisë së Ballshit me të paktën XXX MT në muaj dhe me kushtet e kontratës ekzistuese, të vetmen kontratë të lidhur atë të maj-dhjetor 2018.
 5. Gjatë inspektimit të kryer në ndërmarrjen Bankers më datë 30.01.2019 dhe me anë të shkresës nr. 11/2, datë 06.02.2019, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, Bankers shprehet se ka respektuar me përpikmëri VKK nr. 578, sipas të cilit Bankers ka detyrimin të shesë tek ndërmarrjet vendase sasinë e naftës në bazë të kontratave që Bankers ka lidhur me këto ndërmarrje. Sa i përket ndërmarrjes Tosk shoqëria Bankers ka respektuar kontratën duke furnizuar Tosk-un me XXX MT naftë bruto/muaj, sipas dispozitave të kontratës. Gjithashtu për vitin 2019 Bankers ka lidhur kontratat e reja me palët që operojnë në tregun përkatës.
 6. Për tregtimin e naftës bruto të prodhuar, ndërmarrja Bankers gjatë vitit 2018 ka lidhur kontrata furnizimi me operatorët që kryejnë përpunimin e saj, vendas dhe të huaj, si vijon:
 - Me XXX për periudhën maj - dhjetor 2018, ku parashikohet një sasi prej XXX MT/muaj +/- 10% në muaj me një çmim prej XXX % të Brent-it.
 - Me XXX për periudhën prill - dhjetor 2018. Në këtë kontratë nuk parashikohet sasia e furnizimit, ndërsa çmimi i shitjes është prej XXX% të Brent-it.
 - Me XXX, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018, ku parashikohet një sasi minimale prej XXX metrik ton +/- 10%, dhe një sasi maksimale prej XXX metrik ton +/- 10%, me një çmim, i cili varion sipas cilësisë së produktit nga XXX% deri në XXX% të Brent-it.
 7. Për vitin 2019 Bankers ka lidhur kontrata furnizimi me operatorët që kryejnë përpunimin e saj, vendas dhe të huaj, si vijon:
 - Me XXX për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2019, me një sasi mujore të naftës bruto minimumi XXX MT +/- 10% dhe maksimumi XXX MT +/- 10%, me një çmim prej XXX % të Brent-it.
 - Kontratën me XXX, për periudhën janar - dhjetor 2019, dhe sipas sasive si vijon: - Për muajin janar XXX metrik ton +/- 10%; Për muajin shkurt XXX metrik ton +/- 10%; Për muajt mars-dhjetor sipas marrëveshjes midis palëve, dhe me një çmim prej XXX% të Brent-it.
 - Me XXX, për periudhën 1 janar 2019 - 31 dhjetor 2021, ku parashikohet një sasi minimale prej XXX metrik ton +/- 10%, dhe një sasi maksimale prej XXX metrik ton +/- 10%, me një çmim për vitin 2019 i cili varion sipas cilësisë së produktit nga XXX% deri në XXX% të Brent-it.
 8. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 për masën e përkohshme dikton respektimin e marrëdhënieve kontraktore midis Bankers Petroleum Albania LTD me ndërmarrjen Tosk, si

dhe të gjitha ndërmarrjeve të tjera, të cilat kanë lidhur këto kontrata dhe që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Palët e çdo kontrate, duhet të përmbushin të drejtat dhe detyrimet respektive, që rrjedhin prej tyre.

9. Ndërmarrja Bankers, gjatë periudhës objekt hetimi, ka lidhur kontratat e mësipërme, si dhe është angazhuar në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin prej tyre, kundrejt ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto sipas VKK nr. 578, duke lidhur dhe kontratat e reja për vitin në vazhdim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD si dhe të gjithë ndërmarrjet e tjera, midis të cilave edhe ndërmarrja Tosk, që ushtrojnë aktivitet në tregun e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të naftës në territorin e Republikës së Shqipërisë, te respektojnë kushtet e kontratave të lidhura për periudhën janar – dhjetor 2019.
 2. Masa e përkohshme, marrë me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 kundrejt ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd, përfundon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 604, Datë 21.03.2019

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.

Baza ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd dhe ndërmarrjes ankuese Tosk Energji SHA, si dhe është kërkuar informacion nga këto ndërmarrje, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), DPD dhe “Albpetrol” SHA. Nga informacioni i depozituar rezulton se mungojnë dokumente të rëndësishme për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes nën hetim, gjatë procedurës së hetimit paraprak.
3. Bazuar sa më sipër si dhe për shkak të kohës së shkurtër të mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjes nën hetim Bankers, e cila operon në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ne vend, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit paraprak me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, afati i përcaktuar në pikën “III”, shtyhet me 2 (dy) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 607, Datë 01.04.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9 dhe neni 43 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), ka monitoruar sektorin e sportit, si treg që kryen veprimtari ekonomike lidhur me praktikën e trajtuara nga Komisioni Europian dhe të Autoriteteve të Konkurrencës në BE, nga ku rezultoi se: në Bashkimin Europian ekziston një praktikë e gjerë mbi ndërhyrjen e konkurrencës për të rregulluar tregun në sektorin e sportit të futbollit, pasi konsiderohen subjekte që i nënshtrohen Ligjit të Konkurrencës si subjekte që zhvillojnë aktivitet ekonomik.
2. Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me Vendimin Nr. 564, datë 25.10.2018 vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, për periudhën kohore 2015-2018.
3. Në bazë të nenit 35 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe në zbatim të Vendimit Nr. 564, datë 25.10.2018 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 631, datë 07.11.2018 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë Federatës Shqiptare të Futbollit, duke marrë shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve.
4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Klubeve të Futbollit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre, dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
6. Produktet që duhet të përfshihen në tregun përkatës dhe kufijtë gjeografikë të atij tregu, përcaktohen në varësi të hapësirës në të cilën klientët mund të zgjedhin shumë lehtë midis produkteve të zëvendësueshme.
7. Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës janë: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës, konkurrenca potenciale dhe barrierat e hyrjes në treg.

II.1.1 Tregu përkatës i produktit

8. Në rastin tonë nuk kemi ndërmarrje të tjera që plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si konkurrentë ekzistues pasi është e vetme FSHF. Në tregjet e shërbimeve si e drejta e transmetimit audiovizive është dhënë ekskluzivisht dhe konsumatorët nuk mund të këmbëjnë produktet me ato të tregut përkatës, në përgjigje të ndryshimeve të çmimeve.
9. Bazuar në sa më sipër, treg përkatës i produktit është i gjithë aktiviteti ekonomik i FSHF me produktet/shërbimet që kryen si: shitja e të drejtës së transmetimit të eventeve sportive në të cilën përfshihen ndeshjet e kategorisë superiore, kategorisë së parë, kupa e Shqipërisë, si dhe ndeshjet e ekipeve kombëtare, shitja e biletave, etj.

II.1.2 Tregu përkatës gjeografik

10. Tregu përkatës gjeografik përcaktohet si: një treg përkatës gjeografik ku përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene dhe që mund të dallohen nga zona fqinjë sepse kushtet e konkurrencës janë vlerësuar të ndryshme në këto zona. Kështu edhe pse shet në Kosovë FSHF kjo zonë dallohet nga parapëlqimet e konsumatorëve, rëndësia e preferencave, informacioni mbi variacionet e çmimeve dhe të shitjeve sipas zonës, sa ju kushton klientëve për të kërkuar produktet që furnizohen nga zona të tjera gjeografike, diferencat e çmimeve në nivel kombëtar, si dhe nëse klientët e palëve çvendosin porosinë e tyre drejt ndërmarrjeve të vendosura diku tjetër në një periudhë afatshkurtër dhe me një kosto të pakonsiderueshme.
11. Si përfundim, tregu përkatës gjeografik është i gjithë territori i Shqipërisë duke qenë se ky produkt tregtohet në të gjithë territorin me të njëjtat kushte.

II.2 Vlerësimi i pozitës dominuese

12. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit Nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
13. Sipas Ligjit Nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese.
14. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve; fuqia kundërvepruese e blerësve/

konsumatorëve; zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve; lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera; karakteristika të tjera të tregut përkatës.

15. Në bazë të Ligjit 79/2017 “Për Sportin” FSHF është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare, në sportin e futbollit. Konform këtij Ligji, FSHF si organizatore e veprimtarive sportive është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbolistike brenda dhe jashtë vendit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik.
16. Në bazë të nenit 36 Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” tek veprimtaria ekonomike e organizatës jofitimprurëse, cilësohet se për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës jofitimprurëse, të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së organizatës. Nëse organizata jofitimprurëse, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.
17. Sipas nenit 55 të Statutit të Federatës Shqiptare të futbollit, FSHF dhe anëtarët e saj janë pronarë origjinalë të të gjitha të drejtave që dalin nga garat dhe ngjarje të tjera që vijnë nga juridiksioni respektiv i tyre. Këto të drejta përfshijnë, midis të tjerash, çdo lloj të drejte financiare, audiovizuale dhe regjistrimin në radio, të drejtat e riprodhimit dhe transmetimit, të drejtat e multimedias, të drejtat e marketingut dhe reklamave etj.
18. Detyrat e federatave janë përcaktuar në nenin 18, pika 2, të Ligjit Nr. 79/2017 “Për Sportin” ku asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.
19. Federatës Shqiptare të Futbollit i jepet një status monopol ligjor jo vetëm për organizimin dhe administrimin e aktivitetit të futbollit, por edhe për aktivitetet ekonomike të përfshira si shitja nga një njësi e vetme që zotëron të drejtat ekskluzive. Kjo ndërmarrje në kuptim të nenit 8, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", ka një pozitë dominuese ku zotëron 100%.

II.3 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes

20. Komisioni Europian për konkurrencën ndër 13 sektorët më të rëndësishëm, trajton edhe Sektorin e Sportit pasi ka një rëndësi të madhe dhe ndikim të konsiderueshëm ekonomik në çdo vend edhe në BE, për pjesën që përfaqëson në GDP, për punësimin, për biznesin që bën për të drejtat e transmetimit, veçanërisht për TV, duke u bërë shumë fitimprurëse.
21. Shumica e rasteve sportive janë trajtuar sipas rregullave të antitrustit të BE-së, të cilat ndalojnë marrëveshjet dhe praktikat anti-konkurrese, si dhe abuzimin e pozitës dominuese. Këto raste kanë të bëjnë me aktivitetet e gjenerimit të të ardhurave të lidhura me sportin, të tilla si të drejtat e mediave dhe shitjet e biletave dhe aspektet rregullatore / organizative të sportit.
22. Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që përderisa veprimtaria e kryer është një veprimtari ekonomike, e cila është e pamohueshme për sportet, ajo bie nën rregullat e Traktatit (TFEU), prandaj dispozitat e konkurrencës duhen aplikuar.
23. Në praktikat e vendeve të BE, Komisioni dhe Gjykatat Komunitare kanë vendosur që aktivitetet ekonomike në kontekstin e sportit të përfshihen në fushën e së drejtës së KE-së, duke përfshirë nenet 101 dhe 102 të TFEU. Kjo është konfirmuar dhe në rastin Meca Medina nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë (Rasti C-519/04 P David Meca-Medina dhe Igor Majcen kundër Komisionit).

24. Rasti i shitjes së përbashkët i të drejtës audiovizive të Ligës Gjermane është trajtuar së pavarësisht nga forma e tyre ligjore, klubet/federatat duket se janë ndërmarrje në kuptimin e Ligjit të Konkurrencës për shkak se ata angazhohen në një sërë aktiviteteve ekonomike duke shitur bileta për ndeshjet, duke transferuar lojtarë, duke shitur mallra, reklamimet, sponsorizimet, dhe shitjen e të drejtave audiovizive. Nga ana e saj, Shoqata duket që është një ndërmarrje dhe për aq sa është ekonomikisht aktive, konsiderohet një ndërmarrje.
25. Metodologjia që është përdorur për vlerësimin e aktivitetit të FSHF në kuadër të Ligjit për Konkurrencën, gjatë hetimit janë: 1. *Materialet e OECD*, Competition and Sports 1996, “Policy Round Tables” “Competition Issues Related to Sports 1996”; Competition and Sports 2010, OECD - “Policy Round Tables” “Competition Issues Related to Sports”; Competition Issues in Television and Broadcasting 2013, OECD – “Policy Round Tables”; 2. *Vendime të Komisionit Europian* Case C-519/04, David Meca-Medina and Igor Majcen v. Commission, REG 2006 s. I-6991; Case COMP/C-2/37.214 - Joint selling of the media rights to the German Bundesliga; COMP/M. 2876 Newscorp/Telepiù, of April 2, 2003.
26. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga FSHF dhe klubet e futbollit. FSHF, në përgjigje të kërkesave për informacion, nuk ju është përgjigjur të gjitha kërkesave të Sekretariatit. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 583, datë 17.01.2019, ka vendosur për një ndryshim në Vendimin Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, me qëllim sigurimin e një informacioni të plotë dhe të detajuar, për realizimin e një vendimmarrje objektive nga KK.
27. Bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), për veprimtarinë ekonomike të Organizatës Jofitimprurëse thuhet që për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike. Organizata jofitimprurëse mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e organizatës jofitimprurëse.
28. Detyrat e federatave janë përcaktuar në nenin 18, pika 2, të Ligjit Nr. 79/2017 “Për Sportin” ku asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të federatës, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj.
29. FSHF kryen aktivitet ekonomik dhe gjeneron të ardhura lidhur me: shitjen e të drejtave të transmetimit televiziv; shitjen e biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama; etj., të cilat sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe sipas praktikës së BE-së dhe vendeve anëtare të saj, përfshihet në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të Ligjit Nr. 9121/2003.
30. Duke qenë se sipas Ligjit 79/2017, FSHF është entitet i vetëm, hyrja është me pengesa të larta në tregjet përkatëse.
31. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, fuqisë së tregut, shkallës të përqendrimit, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, por dhe nga praktikat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, FSHF në tregjet përkatëse ka pozitë dominuese.
32. Federata Shqiptare e Futbollit, si pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarive sportive të organizuara prej saj, në bazë të nenit 35 të Ligjit 97/2017 “Për Sportin” ka shitur të drejtën televizive për “Kategoria Superiore”, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë 3 vjeçare për periudhën 2015-2018 dhe një periudhë 4 vjeçare për periudhën 2018-2022.

33. Digitalb ka fituar të drejtën ekskluzive, të plotë për ofrimin e të drejtës së transmetimit të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” në platformën Digitalb, në satelit dhe/ose dixhitale tokësore, PPV, Pay Tv, Kabllore, IPTV, OTT, me ose pa pagesë, mobile, internet.
34. Digitalb ka fituar të drejtën e transmetimit të ndeshjeve zyrtare të “Kategoria Superiore” dhe “Kupa e Shqipërisë” për sezonet/periudhën 15.08.2015-15.05.2018 dhe ka kryer pagesën totale prej [.....] euro për sezonet: Sezoni 2015/16 – [.....] euro; Sezoni 2016/17 – [.....] euro; Sezoni 2017/18 – [.....] euro, *me një pagesë të rritur nga viti në vit me të njëjtin marzh.*
35. “DIGITALB”, ka paraqitur vlerën ekonomike me totalin [.....] euro për 4 sezonet”: Sezoni 2018/19 Ekskluzive Paketa A [.....] euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B [.....]; Sezoni 2019/20 Ekskluzive Paketa A [.....] euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B [.....] euro; Sezoni 2020/21 Ekskluzive Paketa A [.....] euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B [.....] euro me tvsh; Sezoni 2021/22 Ekskluzive Paketa A [.....] euro me tvsh + Ekskluzive Paketa B [.....] euro me tvsh, *duke rritur per 2 vitet e fundit me [.....] euro/vit.*
36. Kontrata e licensimit e dhënë për 3 dhe 4 vjet (të njëjtit operator) bie në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare. Komisioni Europian, ka përcaktuar disa mjete kundër tejkalimit të të drejtave të kontratave ekskluzive në dy mënyra: të drejtat ekskluzive duhet të reduktohen në fushëveprim dhe kohëzgjatja e ekskluzivitetit.
37. Në praktikën Liga e Kampionëve të UEFA-s dhe në rastet e DFB-së është parë se Komisioni ka pranuar kontrata me kohëzgjatje prej 3 vitesh në një kontekst ku të drejtat janë ndarë dhe u janë shitur operatorëve të ndryshëm.
38. *Ekskluziviteti i një kohëzgjatjeje më të gjatë dhe për një gamë më të gjerë të të drejtave mund të kufizojë konkurrencën duke përjashtuar operatorët e tjerë në tregun e rrjedhës së poshtme, aq më tepër kur kemi të bëjmë me operator me pozitë fdominuese në të dy tregjet. Dhënia e tepërt e ekskluzivitetit në aspektin e fushëveprimit dhe kohëzgjatjes të të drejtës së transmetimit tek një blerës i vetëm ka të ngjarë të çojë në kufizim të tregut.*
39. Të drejtat e transmetimit të përcaktuara në kontratën e licensimit, i janë licensuar Digitalb mbi baza ekskluzive çka nënkupton që sipas termave të kësaj kontrate, Licensuesi nuk do t’i japë këto të drejta të tilla ndonjë pale të tretë dhe nuk do t’i ushtrojë as vetë këto të drejta, deri në përfundimin e kësaj kontrate në asnje format të njohur transmetimi.
40. Federata zotëron të drejtat televizive të të gjitha ndeshjeve të kombëtares shqiptare. Përgjatë vitit, Federata dhe klubet pjesëmarrëse kanë rënë formalisht dakort që të centralizohet shitja e të drejtave televizive të Ligës shqiptare të futbollit dhe gjithashtu kanë rënë dakort që të jenë pjesë e një skeme e të ardhurave të gjeneruara.
41. “Shitja e përbashkët” pa praninë e klubeve pjesëmarrëse në aktivitet parandalon secilin nga klubet të ketë të drejtën e vendimarrjes në shitjen e të drejtës audiovizive dhe si rezultat dhe në të ardhurat që përfitohen nga kjo kontratë.
42. Zbatimi i Ligjit për Konkurrencën për të drejtën audiovizive lidhet kryesisht me “shitjen kolektive/përbashkët” të së drejtës së transmetimit dhe të mbulimit të eventeve sportive. “Shitja kolektive” pa praninë e palës së tretë kufizon konkurrencën në dy mënyra kryesore: Dhënia e një fuqie të tregut të Federatës për të përcaktuar çmimin e të drejtave audiovizuale, që çon në çmime të fryra si në rrjedhën e sipërme për transmetuesit, ashtu edhe në rrjedhjen e poshtme për konsumatorët; Forcimi i pozitës së tregut të transmetuesve më të rëndësishëm (në tregun e rrjedhës së poshtme rastin tonë Digitalb), pasi që ata

mund të jenë operatorët e vetëm në gjendje të ofrojnë të gjitha të drejtat në një paketë, aq më tepër kur operatori ka pozitë dominuese.

43. “Shitja e përbashkët” pa praninë e klubeve pjesëmarrëse në aktivitet parandalon secilin nga klubet të ketë të drejtën e vendimarrjes në shitjen e të drejtës audiovizive dhe si rezultat dhe në të ardhurat që përfitohen nga kjo kontratë.
44. Komisioni European ka theksuar se shitja e paketave të ndara të të drejtës audiovizive rrit mundësinë për më shumë transmetues duke përfshirë kompanitë e vogla dhe të mesme për të fituar të drejtën e transmetimeve dhe si rrjedhojë dhe konsumatorët.
45. Ndarja e të drejtave ekskluzive në paketa (të mundshme ekskluzive) të kombinuara, do të jetë një përparësi për konsumatorët në terma afatgjatë, sepse do të përmirësojë kushtet e konkurrencës midis operatorëve televizive në lidhje me çmimin dhe cilësinë. Shitja e paketave të kombinuara në tregun e rrjedhës së poshtme vështirëson transparencën lidhur me çmimin dhe koston e produkteve në veçanti.
46. Për vlerësimin e sjelljes në lidhje me çmimin e biletave, në mungesë të informacionit të një modeli të koston të detajuar të shërbimeve, është përdor alternativa krahasuese si një nga metodat kryesore të hetimit atë të krahasimit me vende të tjera të rajonit (Benchmarking). Çmimet e biletave të miratuara nga FSHF janë më të larta se Maqedonia, Kosova, dhe Serbia, si vende me nivel të Produktit të Brendshëm Bruto (GDP) dhe të ardhura për frymë të krahasueshme me Shqipërinë (p.sh Maqedonia).
47. Për sa më sipër, nga analiza e sjelljes së FSHF në tregjet përkatëse konstatohet: Shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë 4 vjet, me tendencë rritje të çmimit të paketës A, duke përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, duke u bërë përjashtuese për operatorët e tjerë, çmime të shitjes së biletave të larta krahasuar me rajonin, të cila mund të kufizojnë konkurrencën në kuptim të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9, nenin 24 (gërma d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit.
 2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2018.
 3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 muaj nga hapja e hetimit të thelluar.
 4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 608, Datë 10.04.2019

“Mbi detyrimin për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Raportimi periodik i “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve”

Baza ligjore: Neni 8, neni 24, shkronja (d), neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi raportimin periodik të “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 567, datë 07.11.2018, ka vendosur disa detyrimeve për ndërmarrjen EMS APO, monitorimin e sjelljes së kësaj ndërmarrjeje për një periudhë 1 (një) vjeçare, si dhe detyrimin e saj për të raportuar çdo 3 (tre) muaj pranë Autoritetit të Konkurrencës të dhëna lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi dhe marrëdhëniet me palët e treta.
2. Ndërmarrja EMS APO, në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018, si dhe në përgjigje të shkresës nr. 84 prot, datë 30.01.2019 të Autoritetit, nëpërmjet shkresës së saj nr. 44 prot, datë 14.02.2019 (protokolluar pranë AK me nr. 84/1 prot, datë 15.02.2019), ka raportuar pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.
3. Referuar vendimit të Komisionit nr. 567, datë 07.11.2018, ndërmarrjet stivadore të licencuara për të operuar në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit në portin e Durrësit, ASC SHPK, Liburnet 1 SHPK dhe Egnatia 1 SHPK, kanë paraqitur kërkesë pranë Autoritetit (protokolluar pranë AK me nr. 202 prot, datë 13.03.2019), nëpërmjet së cilës pretendojnë se ndërmarrja EMS APO nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në pikën III të Vendimit brenda afatit 90-ditor, duke kërkuar zbatimin e pikës IV të VKK nr. 567/2018.
4. Sa më sipër EMS APO, në respektim të pikës V të vendimit 567/2018, ka raportuar për 3 mujorin e parë pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna sipas këtij vendimi, nga ku rezulton se:

5. Lidhur me rekomandimet e dhëna sipas pikës III/a/b/c/d/e, EMS APO deklaroi se:
- EMS APO nuk ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me ndonjë ndërmarrje nga data e vendimit deri më sot;
 - EMS APO nuk ka vendosur kushte apo detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë;
 - Përpunimi i anijeve në terminalin lindor për periudhën nga data e vendimit deri në datën e kësaj shkrese është kryer sipas parimit “kush hyn i pari, shërbehet i pari”;
 - Kushtet e vendosura nga EMS APO për të njëjtat veprime tregtare me përdoruesit e portit që kanë kryer shërbime pranë terminalit lindor të portit të Durrësit janë të barabarta për të gjithë përdoruesit e portit;
 - EMS APO ofron shërbime me të njëjtat kushte teknike dhe financiare.
6. Raportimet e bëra nga EMS APO si më sipër, nuk mjaftojnë për të vlerësuar nëse rekomandimet e dhëna janë zbatuar ose jo nga kjo ndërmarrje. Për të mundësuar këtë vlerësim nevojiten prova dhe fakte konkrete, të cilat të dokumentojnë veprimet e kryera nga EMS APO si më sipër.
7. Lidhur me rekomandimin e dhënë sipas pikës III/f, të VKK 567/2018, EMS APO ka depozituar draftin e kontratës standarte që mund të përdoret sipas nevojave të kësaj ndërmarrjeje, nga vlerësimi i së cilës, rezultoi se:
- Shoqëria EMS Shipping & Trading GmbH në bazë të Kontratës së Koncesionit për dhënien me koncesion menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të Terminalit Lindor të Portit të Durrësit, nënshkruar në datë 6 maj 2013, me Ministrin e linjës (MIE), më qëllim realizimin e kësaj kontrate, ka krijuar shoqërinë shqiptare “EMS APO” SHPK, të cilës i transferon të gjithë koncesionin.
 - Në zbatim të Kontratës Koncesionare, neni 10.1 “Nënkontraktimi”, Koncesionari mund të nënkontrakttojë një ose disa prej detyrimeve të tij, por gjithsesi jo më shumë se 20% të tyre në total, pas lidhjes së një kontrate të shkruar për këtë qëllim dhe pas miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktor. Në çdo rast Koncesionari do të jetë plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës dhe performancën e detyrave, si dhe obligimeve të tij.
 - Draft kontrata e paraqitur nga EMS APO ka për objekt kryerjen nga Stivadori të shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në terminalin lindor në portin e Durrësit dhe aktivitetet e lidhura me to, sipas kërkesës së Koncesionarit, si dhe në nivelet e produktivitetit të specifikuar në çdo kontratë të veçantë të lidhur për çdo anije.
 - Sipas këtij drafti, stivadori/nënkontraktori duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në formën e garancisë bankare në shumën XXX Euro, për të siguruar Koncesionarin për përmbushjen korrekte të detyrimeve të stivadorit, ndërkohë që sipas kontratave të lidhura me stivadorët në vitet 2013 dhe 2014, shuma e kërkuar për Sigurimin e Kontratës ishte XXX Euro.
 - Stivadori lejohet të operojë vetëm me mjetet në pronësi të tij të miratuara paraprakisht nga Koncesionari, duke ju privuar mundësinë e marrjes me qira të këtyre mjeteve.
 - Për kryerjen e shërbimeve të ngarkim shkarkimit të mallrave në terminalin lindor të portit të Durrësit, stivadori do të faturtojë dhe mbledhë shpërblimin e tij ekskluzivisht nga Koncesionari, i cili i mbledh ato nga përdoruesit përkatës të terminalit.
 - Pjesa e fitimit në përqindje mbi tarifën përkatëse, konkretisht prej XXX% për mallrat rifuxhio dhe XXX% për mallrat gjenerale, sipas draft kontratës, rezultojnë shumë më të ulëta se ato të parashikuara

në kontratat e para të lidhura nga EMS APO me ndërmarrjet stivadore ASC dhe Liburneti 1, ku për stivadorin parashikohet një përqindje prej XXX% dhe XXX% e tarifave përkatëse të publikuara nga APD.

- Stivadori duhet të mbulojë një siguracion prej XXX Euro kundrejt riskut të dëmtimit apo humbjes për mjetet e veta, njerëzve, mjeteve, anijeve, pronës (infrastrukturës dhe superstrukturës), mjedisit dhe mallrave në Terminalin Lindor. Gjithashtu stivadori ka detyrimin për prerjen e një police sigurimi të përgjithshme që të mbulojë të gjitha detyrimet e tij, të gjitha mjetet dhe pajisjet në pronësinë e tij, si dhe duhet të sigurojë dhe mbajë të vlefshme një sigurim të detyrueshëm profesional.
8. Lidhur me këto detyrime që i vendosen ndërmarrjeve stivadore, sipas Kontratës Konçesionare (neni 10.1, pika 5) i vetmi përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për të gjitha dëmet, mospërbushjet dhe veprimet a mosveprimet jo në përputhje me këtë Kontratë apo të mangëta të nënkontraktorëve të tij, është Konçesionari EMS APO.
 9. Konçesionari është përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për të gjitha dëmet që mund të shkaktohen gjatë zbatimit të kontratës konçesionare, por nëse dëmi shkaktohet nga stivadorët e nënkontraktuar, lind detyrimi edhe për nënkontraktorin që të mbulojnë dëmin e shkaktuar për fajë të tij, pasi ai është përgjegjës për dëmet e shkaktuara prej tij gjatë përmbushjes së detyrave të tij. Për këtë qëllim mund të kërkohet lënia e garancive për konçesionarin, por gjithmonë me vlera të arsyeshme, sipas rregullave të tregut, dhe me pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.
 10. Duke qenë se draft kontrata përmban detyrime të vendosura në mënyrë të njëanshme, për vlefshmërinë dhe lidhjen e saj me kushte të drejta tregtimi, kërkohet vullneti i të dyja palëve dhe dakordësia midis tyre për të gjitha kushtet thelbësore të kontratës, pëlqimi i shoqërive stivadore të cilat marrin përsipër detyrimet sipas kontratës, si dhe shkaku i ligjshëm nga burojnë këto detyrime. Për më tepër për transferimin e këtyre detyrimeve kërkohet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor (MIE) me të cilin është lidhur kontrata e konçesionit.
 11. Këto kushte e detyrime të parashikuara për tu vendosur në kontratë duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë parasysh gjendjen financiare të stivadorëve të cilët për shumë kohë nuk operojnë në terminalin lindor të Portit të Durrësit, pavarësisht kontratës licencë që kanë me APD-në.
 12. Konçesionari EMS APO në çdo rast nënkontraktimi të shoqërive të ngarkim shkarkimit për të operuar në terminal, në zbatim të kontratës konçesionare, duhet të aplikojë kushte të njëjta bashkëpunimi për nënkontraktorët, si dhe të vendosura në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24, shkronja (d) dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të mos pranojë draft kontratën për kryerjen e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit në terminalin lindor në portin e Durrësit, të paraqitur nga EMS APO.
2. Konçesionari EMS APO në çdo rast nënkontraktimi të shoqërive të ngarkim shkarkimit për të operuar në terminal, në zbatim të kontratës konçesionare, duhet të aplikojë kushte të njëjta bashkëpunimi për nënkontraktorët, si dhe të vendosura në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
3. EMS APO për hartimin e draft kontratës, në respektim edhe të pikës I/b të VKK 567/2018, të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si Autoriteti Kontraktor, me qëllim nxjerrjen e një drafti të përbashkët.

4. EMS APO, në çdo raportim pranë AK-së, të paraqesë dokumente, prova, fakte për të vërtetuar deklaratimet e bëra prej saj lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna sipas pikës III të VKK 567/2018.
5. Ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në pikën (III) të VKK 567/2018, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, të ligjit nr. 9121/2003.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 609, Datë 10.04.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: Neni 4, pika 1, neni 9, neni 24 shkronja (d) dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e ankesave të paraqitura lidhur me caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”,

VËREN SE:

Gjatë dy viteve të fundit, pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë paraqitur disa ankesa dhe kërkesa të cilat konsistojnë në sjelljen e operatorëve të shërbimit taksi në qytetin e Tiranës, lidhur me caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi në qytetin e Tiranës.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i këtyre ankesave ka rezultuar se:

Sindikata Shqiptare e Taksive, Shoqata “Taksitë e Klasit të Parë”, si dhe disa subjekte që operojnë në shërbimin taksi, pretendojnë se subjekti “XXX” ushtron aktivitetin e tij në shërbimin taksi (4+1 vende) duke përdorur instrumente matëse (taksimetër) të verifikuar në kundërshtim me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.3, datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.14, datë 28.02.2013.

Lidhur me këtë sjellje të subjektit “XXX”, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka konstatuar se ky subjekt, për periudhën 01.11.2017 deri më 01.11.2018, ka zbatuar tarifën prej XXX lekë për 1.5 km e para, ndërkohë që operatorët e tjerë në treg kanë zbatuar tarifën tavan (maksimale) prej 250 lekë për 1.5 km e para.

“XXX”, i është drejtuar Bashkisë Tiranë për kalibrimin e taksimetrit nën nivelin tavan të miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 30.03.2009, të ndryshuar. Bashkia Tiranë nisur nga kjo kërkesë, ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për kolaudimin e taksimetrit për mjetet e kompanisë “XXX” me “tarifë fillestare” për ditët e zakonshme të javës, me tarifë XXX lekë më të ulët nga tarifa tavan e miratuar për 1.5 km e parë; dhe “tarifë fillestare” për ditët e pushimit dhe festave zyrtare dhe për udhëtimet natën, me tarifë XXX lekë më të ulët nga tarifa tavan e miratuar për 1.5 km e parë.

Sipas pretendimeve të “XXX”, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ka refuzuar kërkesën e tij për kalibrimin e taksimetrave për flotën e makinave të saj në vlerën XXX lekë për tarifën fillestare, me arsyetimin se vendosja e një tarife fillestare më pak se 250 lekë është në shkelje të ligjeve në fuqi dhe dëmton konkurrencën me operatorët e tjerë të shërbimit taksi në Tiranë.

Në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, dhe udhëzimit të përbashkët të MPPTT (sot MIE) dhe MF, nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi”, Këshilli Bashkiak i Tiranës me vendimin nr. 3, datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës”, të ndryshuar, ka miratuar çmimet dhe tarifatat maksimale (tavan) të shërbimit taksi (4+1 vende dhe 8+1 vende), poshtë të cilave subjektet taksi do të operojnë.

Referuar sa më sipër, ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi brenda territorit të Bashkisë Tiranë duhet të aplikojnë tarifa jo më ta larta se niveli tavan i përcaktuar në VKM nr. 3, datë 30.03.2009, të ndryshuar, dhe në bazë të Udhëzimit nr. 1726/3/2008, taksistët janë të lirë që të kalibrojnë taksimetrat e tyre me tarifa poshtë vlerës maksimale duke zgjedhur tarifa më të ulëta, si dhe t’u japin klientëve mundësinë e negociimit për uljen e këtyre pagesave.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesave dhe kërkesave të paraqitura, si dhe informacionit të depozituar lidhur me to, rezulton se, pavarësisht se taksistët janë të lirë që të kalibrojnë taksimetrat e tyre me tarifa poshtë vlerës maksimale (tavan) të miratuar, duke zgjedhur tarifa më të ulëta, pothuajse të gjitha ndërmarrjet që operojnë në tregun e transportit të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, zbatojnë tarifën fillestare tavan prej 250 lekë për 1.5 km e para.

Për sa më sipër, nisur nga problematikat e ngritura në mënyrë të vazhdueshme në tregun e shërbimit taksi, sjellja e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, mund të shfaqë, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1, nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në 31.03.2019.
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 611, Datë 10.04.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar me vendimin nr. 597, datë 19.02.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, vendosi fillimin e procedurave hetimore në Shërbimin Spitalor i cili përfshin shërbimin publik dhe shërbimin privat.
2. Për realizimin e procedurave hetimore dhe vlerësimin e konkurrencës në treg (përcaktimin e strukturave të tregut, kryerjen e analizës së sjelljes, kryerjen e analizave statistikore-ekonomike për të gjithë shërbimet shëndetësore), bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacione në mënyrë shpresore nga: Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake, Spitalet Private si dhe institucionet; Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.
3. Informacioni i depozituar deri tani është i paplotë dhe koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar, të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 30 qershor 2019”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 617, Datë 09.05.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”.

Baza ligjore: Neni 8 dhe 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike,

VËREN SE:

1. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) ka paraqitur një njoftim më datë 19.10.2018, protokolluar pranë AK me nr. 601 prot., me objekt “Njoftim për një sjellje të mundshme anti-konkurrese dhe kërkesë për hetim në lidhje me dy procedura tenderuese që KESH ka zhvilluar në lidhje me Kontratat e “Depozitimit” dhe Kontratat e “Devijimit” (“Notification of potential anti-competitive conduct and request for investigation”).
2. Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Gjatë procedurës hetimore u konstatua se ERE, nisur nga ankesa e shoqërisë GEN I Tirana SHPK, si enti mbikëqyrës dhe rregullues i sektorit të energjisë elektrike, ka realizuar një monitorim për procedurat e shitblerjes së energjisë elektrike nga KESH për vitin 2017 dhe periudhën janar-mars 2018, draft raporti i këtij monitorimi është paraqitur pranë AK me shkresën nr. 601/4, datë 22.11.2018.
4. Referuar nenit 13 të Rregullores për “Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike” miratuar me vendim të Bordit të ERE nr.1, datë 10.01.2011, ERE monitoron të gjitha procedurat e shitjes së energjisë elektrike.
5. Nga seanca dëgjimore e realizuar më datë 02.05.2019 pranë Autoritetit të Konkurrencës, nga përfaqësuesit e ERE u deklarua se janë realizuar draft/raportet e monitorimit lidhur me procedurat e shitblerjes së energjisë elektrike dhe kontratën e depozitimit ndërmjet KESH dhe EFT si dhe kontratën e devijimit ndërmjet KESH dhe GSA, por bordi i ERE nuk është shprehur akoma me një vendimmarrje lidhur me

këto draft/raporte. Në vijim të seancës dëgjimore, u kërkua nga ERE, të paraqesë pranë AK:

- Vendimmarrjen e Bordit të ERE mbi “Monitorimin e kryer pranë shoqërisë KESH lidhur me ankesën e shoqërisë Gen I Tirana SHPK mbi zbatimin e procedurave të shit-blerjes së energjisë elektrike për vitin 2017 dhe 2018” si dhe Raportin përkatës;
 - Vendimmarrjen e Bordit të ERE mbi “Monitorimin e kryer pranë shoqërisë KESH lidhur me “Kontratën e devijimit” ndërmjet KESH dhe GSA dhe “Kontratën e depozitimit” ndërmjet KESH dhe EFT si dhe Raportin përkatës;
 - Raportet analitike argumentues mbi shitjet e kryera nga KESH për vitet 2016-2017-2018, të cilat janë raportuar pranë ERE si detyrim referuar nenit 13, pika 2, të “Rregullave dhe procedurave të shitjes së energjisë energjike” miratuar nga ERE me vendimin nr. 1, datë 10.01.2011.
 - Qëndrimin e ERE në lidhje me afektimin e veprimtarisë së OST, nga kontrata e devijimit të KESH me GSA me afat deri në 2025, dhe çfarë ka ndryshuar nga momenti i marrjes së përgjegjësisë së KESH për ofrimin e balancimit.
6. Për sa më sipër, duke qenë se ERE është organi i cili për periudhën hetimore realizonte monitorimin e të gjitha procedurave si dhe kontratave të lidhura nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në sektorin e energjisë elektrike, vendimmarrja e saj lidhur me të dyja pikat e ankesës së paraqitur nga Sekretariatit të Energjisë është vendimtare për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes KESH SHA lidhur me procedurat e tregtimit të energjisë elektrike si dhe kontratat e depozitimit dhe devijimit.
7. Komisioni i Konkurrencës çmon se me administrimi i raporteve të monitorimit të procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike të ndërmarrjes KESH SHA, dhe monitorimit të kontratave të depozitimit dhe devijimit dhe vendimmarrja e ERE mbi këto raporte është e domosdoshme për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 588, datë 28.01.2019 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike” të ndryshohet:
 - a. afati i përcaktuar në pikën “II”, shtyhet me 5 (pesë) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 618, Datë 09.05.2019

“Për disa ndryshime në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.

Baza ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Rregullorja “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, të ndryshuar me Vendimin nr. 604, datë 21.03.2019 të Komisionit të Konkurrencës, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 nëntor 2018.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania Ltd dhe ndërmarrjes ankuese Tosk Energji SHA, si dhe është kërkuar informacion nga këto ndërmarrje, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, DPD dhe Albpetrol SHA. Nga informacioni i depozituar rezulton se mungojnë të dhëna mbi sasitë reale të furnizuara nga Bankers për shoqëritë që operojnë në tregun e përpunimit të naftës bruto, vendase dhe të huaja.
3. Përsa më sipër si dhe në respektim të Vendimit Nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”, pika 1 e dispozitivit, vlerësojmë të nevojshme kryerja e hetimeve shtesë për periudhën 1 janar-30 prill 2019 me qëllim kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjes nën hetim. Për realizimin e kësaj analize duhet bërë zgjatja e periudhës nën hetim, si dhe afatit të hetimit paraprak.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika II bëhet si vijon:

“II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 30 prill 2019”

b) Pika III bëhet si vijon:

“III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 3 Tetor 2019”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 620, Datë 13.05.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e Arsimit të Lartë, për periudhën kohore nga 1 janari 2017 deri në përfundim të procedurave hetimore. Raporti i hetimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit të përgjithshëm është kërkuar informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë; Universitetet publike dhe private. Nga informacioni i depozituar rezulton se mungojnë informacionet e kërkuara nga disa Universitete publike dhe private, informacione këto të nevojshme për kryerjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë.
3. Bazuar sa më sipër si dhe për shkak të kohës së shkurtër të mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin e Arsimit të Lartë, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin nën hetim, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, afati i përcaktuar në pikën “3”, shtyhet me 5 (pesë) muaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 627, Datë 13.06.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

Baza ligjore: Nenet 24 shkronja (d), 26 dhe 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Brunës SHPK ndaj Terminalit të Konteinerëve Durrës SHA (DCT)”,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar ankesa e ndërmarrjes Brunës SHPK drejtuar Koncesionarit të Terminalit të Konteinerëve Durrës “Durrës Container Terminal” SHA (DCT SHA) lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari DCT SHA.

Nga vlerësimi ligjor dhe administrimi i provave të sjella nga ankimuesi Brunës SHPK, si dhe nga takimi në APD, rezulton se: Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit "Për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të terminalit të konteinerëve në portin e Durrësit", miratuar me VKM Nr. 532, datë 13.7.2011, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja DCT SHA, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjitha infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal.

Nëpërmjet kësaj kontrate Koncesionarit i jepet e drejta ekskluzive për aktivitet terminal konteinerësh në Gjirin e Durrësit për një kohëzgjatje prej 35 vitesh. Për pasojë Koncesionari DCT SHA ka ekskluzivitet në ofrimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit të anijeve të konteinerëve dhe aktiviteteve të lidhura me to në terminalin e konteinerëve Durrës, duke u vlerësuar si ndërmarrje me pozitë dominuese (monopol) në këtë treg.

Kjo ndërmarrje me pozita monopol në tregun përkatës, i ka faturuar ndërmarrjes Brunës një tarifë ekstra për shërbimin zbrazje konteineri, tarifë e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së. Për këtë tarifë Ankimuesi nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar apo komunikim paraprak.

Sipas kontratës, pika 2.5.1/(i) e Kontratës Koncesionare, DCT SHA merr përsipër që të mos aplikojë, zbatojë, vjelë, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo pagesa të tjera të ndryshme të cilat

përcaktohen në mënyrë ekskluzive nga Autoriteti Portual. Në rastin konkret DCT SHA ka aplikuar një tarifë shtesë në mënyrë të padrejtë, e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së. DCT SHA ka detyrimin që të mos aplikojë tarifa të pamiratuara paraprakisht nga APD dhe Ministrinë përkatëse.

Kjo sjellje e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese, (monopol) që zotëron ky koncesionar, në ofrimin e shërbimeve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, germa a), të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në 31.05.2019.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 628, Datë 13.06.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tropojë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tropojë” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Tropojë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 320 Prot., datë 17.05.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 6 Prot., datë 01.02.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Tropojë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Tropojë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave jo në mënyrë graduale në vitet në vazhdim prej 15 vitesh.
 - UK Tropojë SHA duhet të aplikojë tarifat e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr.29, datë 13.10.2004 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Tropojë SHA”, por aktualisht referuar Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. Ekstra Prot., datë 29.12.2013, për kategorinë e konsumatorëve familjarë për zonën urbane (qytetin Bajram Curri) aplikon tarifën volumetrike të ndryshuar (29.2 lek/m³). Sipas ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Tropojë SHA, niveli i tarifave në fuqi në raport me koston totale, gjendjen e amortizuar të sistemit është relativisht i ulët.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Tropojës (29.2 lek/m³) dhe për zonën rurale (15.8 lek/m³), të

cilat kanë qenë të miratuara me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. Ekstra Prot., datë 29.12.2013 dhe janë më të larta nga ato që kanë qënë miratuar nga ERRU me Vendimin Nr.29, datë 13.10.2004.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA propozon rritje të tarifave dhe unifikimin e tyre, për konsumatorin familjar në zonat urbane me 11.8 lek/m³, duke pësuar një rritje afro 37% dhe për konsumatorët publik rritet me 30 lek/m³ ose 60% më shumë, për konsumatorët privat rritet me 13.3 lekë/m³ ose 20% më shumë, ndërsa për zonën rurale propozohet vendosje e tarifës prej 14.2 lekë/m³ më shumë, pra duke pësuar një rritje 89.87%. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, për të tre konsumatorët është një tarifë e re, fikse 13 lekë/m³ për konsumatorin familjarë, 22 lekë/m³ për konsumatorin publik dhe privat.
5. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2018, 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, uljen e humbjeve teknike dhe administrative.
6. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA edhe pas riorganizimit nuk arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 98 % gjatë 2019, ndërsa mbulimi i kostove totale parashikohet 76%.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes me 15%, si edhe kostot totale me 16% krahasuar me vitin 2018, vit gjatë të cilit ajo ka mbuluar rreth 60% të kostos totale edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA ka ende nevojë për subvencione për mbulimin e kostove totale, si dhe ka nevojë për investime emergjente, pasi rrjeti është i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.
9. Tarifat nuk duhet të tejkalojë kostot, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Tropojë SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove për vitin 2018, 2019 mbetet thuajse në nivele të ulëta krahasuar me ato të vitit 2017 me një rritje prej 15%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjiellës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase e fitimprurëse, dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
11. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Tropojë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Tropojë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.

ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

12. Konstatohet se informacioni mbi aplikimin për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me

Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja (d), dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Tropolje SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjiellës Kanalizime Tropolje SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar a) shërbimi i furnizimit me ujë dhe b) shërbimi i largimit të ujërave të ndotura, duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 629, Datë 20.06.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Lushnje” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Lushnje” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 321 Prot., datë 17.05.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 63 Prot., datë 06.09.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Lushnje SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
 - UK Lushnje SHA duhet të aplikojë tarifën e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr.17, datë 05.05.2017 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Lushnje Qytet SHA dhe sipas Vendimit Nr.3 datë 17.01.2006 për U Lushnje Fshat”. Sipas ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Lushnje SHA, niveli i tarifave në fuqi është i diferencuar dhe për të mundësuar unifikimin e tyre ka aplikuar për ndryshimin e tyre.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,* aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Lushnjes (58 lek/m³) dhe për zonën rurale (60 lek/m³), të cilat kanë qenë të miratuara me Vendimit Nr.17, datë 05.05.2017 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Lushnje Qytet SHA dhe sipas Vendimit Nr.3 datë 17.01.2006 për U Lushnje Fshat.

4. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA propozon rritje të tarifave për të mundësuar unifikimin e tyre, për konsumatorin familjar në zonat urbane me 65 lek/m³, duke pësuar një rritje 7 lek/m³ dhe për konsumatorët publik në qytet dhe 5 lek/m³ për konsumatorët në zonën rurale, për konsumatorët privat rritet me 17 lekë/m³ në qytet dhe 47 lekë/m³ në zonën rurale, ndërsa për të gjithë zonën pas riorganizimit propozohet vendosje e tarifës fikse 150 lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, pra një rritje 100%, tarifa fikse 200 lek/muaj/lidhje për konsumatorin publik dhe privat, me rritje 100% në zonën rurale. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, për të tre konsumatorët është një tarifë e re, fikse 17 lekë/m³ për konsumatorin familjarë, 22 lekë/m³ për konsumatorin publik dhe 25 lek lek/ m³ për konsumatorin privat.
5. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin për rritje të qëndrueshmërisë financiare.
6. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 104 % gjatë 2019, por mbulimi i kostove totale të operimit dhe mirëmbajtjes parashikohen 68%.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes me 9%, si edhe kostot totale me 9% krahasuar me vitin 2018, vit gjatë të cilit ajo ka mbuluar rreth 59% të kostos totale edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA ka ende nevojë për subvencione për mbulimin e kostove totale, si dhe ka nevojë për investime për të përmirësuar shërbimin dhe për të patur qëndrueshmëri financiare.
9. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Lushnje SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2019 mbetet thuajse në nivele relativisht të ulëta krahasuar me ato të vitit 2018 me një rritje prej 9%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rjetit të ujësjetllës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
11. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të cmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Lushnje SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.

ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

12. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me

Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 630, Datë 20.06.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, gërma d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 342 Prot., datë 28.05.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr.20, datë 19.04.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për largimin e ujërave të ndotura në njësinë administrative Koplik, pas kalimit të sistemit të kanalizimeve pranë UK Malësia e Madhe SHA, bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Malësisë së Madhe nr. 149, datë 25.07.2018.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Malësi e Madhe SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, miratimin e tarifave në zbatim të kriterëve referuese, kostove të pranueshme, të justifikuara si dhe të përballueshmërisë së konsumatorëve.
 - UK Malësi e Madhe SHA duhet të aplikojë tarifën e miratuar nga ERRU, pasi nuk ka një nivel aktual të tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.
3. *Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja nuk ka aplikuar tarifa të miratuar nga ERRU, për Njësinë administrative Koplik. Tarifa e parashikuar për miratim për konsumatorët familjar është 12 lek/ m³.

4. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA kërkon miratimin e tarifave për ofrimin e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për të tre kategoritë e konsumatorëve, propozohet vendosja e tarifës 12 lek/m³ për konsumatorët publik dhe tarifa 15 lek/m³ për konsumatorët privat dhe publik. Kjo tarifë volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, për të tre konsumatorët është një tarifë e re, por krahasuar me tarifën e këtij shërbimi në zonat në afërsi të saj konsiderohet një tarifë më e ulët.
5. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar pjesërisht kostot e mirëmbajtjes dhe operimit.
6. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim- mirëmbajtjes në masën 90 % gjatë 2018, por në analizën ekonomiko - financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA për vitin 2019 duhet të krijojë inventarin e aseteve për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura si dhe atë të furnizimit me ujë; të hartojë një plan në drejtim të zgjerimit të këtij shërbimi, për investimet në sistemin e largimit të ujërave të ndotura dhe për riparimet apo zëvendësimet me kosto të lartë të rrjetit ekzistues, të mbajë të ndara kostot për të dy shërbimet që ofron: shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të largimit të ujërave të ndotura me qëllim që shërbimet të orientohen drejt kostos reale të tyre; duhet të rrisë kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes me 4.5% gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018.
8. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Malësi e Madhe SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
9. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të tarifave drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Malësi e Madhe SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pishëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.
10. ERRU në analizën ekonomiko - financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).
11. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për miratimin e tarifave nuk është bërë transparent në faqen e ERRU-së, pra nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, gërma d) dhe f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

I. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve.
2. ERRU të kërkojë nga Ujësjetllës Kanalizime Malësi e Madhe, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 632, Datë 20.06.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”.

Baza ligjore: Neni 24 gërma, (d) dhe neni 43 pika 3 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

Në pikën “2” të dispozitivit të Vendimit Nr. 607, datë 01.04.2019 të Komisionit të Konkurrencës duhet të bëhet ndryshimi për zgjatjen e afatit si vijon: *Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.*

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma (d) dhe nenin 43 pika 3 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”, pika “2” të ndryshohet si vijon:

“2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 639, Datë 18.07.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 609, datë 10.04.2019 vendosi “Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, për periudhën kohore nga 1 Janari 2018 deri në 31.03.2019, dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektive pranë Sindikatës Shqiptare së Taksive dhe Shoqatës së Taksive, si dhe është kërkuar informacion në mënyrë shkresore nga Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
3. Lidhur me kërkesën për informacion dërguar Bashkisë së Tiranës me shkresën Nr. 223/6 Prot., datë 07.05.2019, Bashkia e Tiranës i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës me shkresën Nr. 20907/1 Prot., datë 18.06.2019, protokolluar pranë AK me Nr. 223/7 Prot., datë 21.06.2019, jashtë afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative (15 ditë) dhe duke proceduar për marrjen e informacionit dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit.
4. Në vijim të procedurave, në datën 02.07.2019 AK i ka dërguar shkresën Nr. 418 Prot., “Kërkesë për Informacion” Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Informacioni i pritshëm nga shkresat do të ndihmonte Grupin e Punës në vlerësimin e strukturës së tregut dhe operimin e ndërmarrjeve në këtë treg.
5. Koha e mbetur në dispozicion, dhe mungesa e informacionit të kërkuar është e pamjaftueshme për

përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019.

6. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 609, datë 10.04.2019 “Hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:

“2. Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 14 Tetor 2019.”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 640, Datë 25.07.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë “Illyrian Guard” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) , neni 29/1 dhe nenin 69 dhe 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar ankesa me Nr.354 Prot., datë 03.06.2019, ku shoqata “Union Security Albania” ka paraqitur pretendimet e saj në lidhje me një subjekt juridik të ri të krijuar me VKM Nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SHA dhe për përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”.
2. Me anë të kësaj VKM, është krijuar shoqëria tregtare “Illyrian Guard” SHA me kapital 100% shtetëror zotëruar nga Ministria e Brendshme. Kjo është shoqëri aksionare, e cila do të ofrojë shërbime me pagesë kundrejt subjekteve të treta, publike ose private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj.
3. Në pikën 10 të kësaj VKM, parashikohet se të gjitha institucionet dhe subjektet publike të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen, me kërkesë kësaj shoqërie për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike. Nëse kjo shoqëri, sipas pikës 11 të VKM, merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar, institucionet dhe subjektet publike, mund ta sigurojnë këtë shërbim në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Në nenin 7 të kësaj VKM, është parashikuar edhe mënyra e përlllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, tarifa të cilat përcaktohen me Udhëzim të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.
5. Tregu i ofrimit të shërbimeve të rojeve fizike ka qenë objekt hetimi në disa raste nga Autoriteti i Konkurrencës, ku ka pasur një sërë ankesash lidhur me këtë treg. Komisioni i Konkurrencës, me disa

vendime ka konstatuar problematika, ka vendosur penalitete për disa subjekte që ofrojnë këtë shërbim në treg dhe ka nxjerrë edhe rekomandimet përkatëse lidhur me këtë treg:

- VENDIM Nr. 240 , datë 26.07.2012 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Nazëri – 2000” Sh.p.k, dhe “Dea Security” Sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike;
 - VENDIM Nr. 283 , datë 08.05.2013 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”;
 - VENDIM Nr. 287 , datë 04.06.2013 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës”
 - VENDIM nr.317 , datë 23/05/2014 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Dibrës”
 - VENDIM nr. 407 , datë 8.03.2016 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”
6. Në datën 4 Korrik 2019, janë zhvilluar seanca dëgjimore me ankuesin, me përfaqësues të shoqërisë “Illyrian Guard” SHA dhe me përfaqësues të Agjencisë së Prokurimeve Publike.
 7. Lidhur me shkelje të dispozitave të ndryshme ligjore të ligjeve specifike, Autoriteti i Konkurrencës është informuar nga përfaqësuesit e “Union Security Albania” se ka filluar proces gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në lidhje me këto pretendime.
 8. Përfaqësues të shoqërisë “Illyrian Guard” SHA, paraqitën faktin se kjo shoqëri është relativisht e re, e sapo krijuar. Vizioni i kësaj kompanie është ruajtja e sigurisë fizike me metoda SMART dhe ku do synohet menaxhim nga salla, me pak burime njerëzore dhe pa kosto. Nuk ka filluar akoma aktiviteti dhe nuk janë lidhur akoma kontratat e para.
 9. Nga Agjencia e Prokurimit Publik na u bë me dije se jo çdo lloj shërbimi mund të prokurohet. Ka lloje shërbimesh që mund të sigurohen vetë nga institucionet publike sipas nocionit të “*in house procurement*”, ku vetë institucioni i plotëson nevojat e veta me burimet e veta.
 10. Konstatohet se me VKM Nr. 117, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SHA dhe për përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”, është krijuar një shoqëri e re, me kapital shtetëror e cila do të ofrojë midis të tjerave dhe shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike. Parë në këndvështrimin e konkurrencës shtimi i numrit të ofruesve të shërbimeve në treg favorizon konkurrencën e lirë dhe efektive duke sjellë mundësi zgjedhjeje.
 11. Në respektim të dispozitave të Ligjit 9121/2003 shoqërisë “Illyrian Guard” SHA, të cilës i është dhënë e drejta për të ofruar shërbimin e ruajtjes dhe sigurimit të objekteve shtetërore siç përcaktohet në pikën 10 të VKM, duhet të silllet në një mënyrë të veçantë, duke respektuar parimet e konkurrencës dhe në veçanti parashikimet e nenit 9 të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 24, shkronja (d) (f), nenin 29/1, nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë shoqërisë "Illyrian Guard" SHA, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet e konkurrencës dhe dispozitat ligjore që burojnë nga Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar dhe sidomos respektimin e nenit 9 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 641, Datë 25.07.2019

“Mbi zbatimin periodik të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Raportimi periodik i “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me to, për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit dhe dhënien e disa rekomandimeve””.

Baza ligjore: Neni 8, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 567, datë 07.11.2018 nga ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK, për tremujorin e dytë të raportimit,

VËREN SE:

1. Në zbatim të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nr. 567/2018 (pika III), si dhe nr. 608/2019 (pika 4), ndërmarrja EMS APO nëpërmjet shkresës së saj nr. 93/1 prot, datë 17.05.2019 dhe nr. 93/2 prot, datë 12.06.2019, ka raportuar pranë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për periudhën 15 shkurt-15 maj 2019.
2. Nga raportimi i bërë si më sipër rezulton se shërbimet e ngarkim-shkarkimit të anijeve në terminalin Lindor janë kryer nga vetë ndërmarrja EMS APO sipas objektivit të kontratës koncesionare, duke mos hyr në marrëdhënie kontraktore me shoqëritë stivadore.
3. EMS ka paraqitur kontratat model që lidhen me përdoruesit e terminalit për shkarkimin ose ngarkimin e anijeve. Këto kontrata Tip përdoren nga EMS me çdo përdorues porti në çdo rast kur kërkohet përpunimi i anijeve për kryerjen e procesit të ngarkimit apo shkarkimit. Ato përmbajnë të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve me qëllim realizimin e procesit të përpunimit të anijes. Kushtet e vendosura në këto kontrata janë të njëjta për të gjithë përdoruesit e portit dhe të lidhura me objektin e këtyre kontratave.
4. EMS APO ka paraqitur evidencën e tremujorit të fundit të përpunimit të anijeve dhe Akt-Rakordimet e mbajtura me Njësinë e Monitorimit pranë APD-së. Konkretisht: EMS ka paraqitur Proces-verbalet mbi rakordimin e anijeve të përpunuara në Terminalin Lindor gjatë muajit Shkurt, Mars dhe Prill si dhe akt-rakordimet përkatëse, nga ku rezulton se: përpunimi i anijeve është bërë sipas datës së mbërritjes së anijes duke respektuar parimin “kush hyn i pari, shërbehet i pari”. Gjithashtu kjo rezulton edhe nga “Raporti mbi

performancën e anijes” për periudhën 15 shkurt-15 maj, depozituar nga EMS APO.

5. EMS APO ka paraqitur draft-marrëveshjen për shërbimet stivadore në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, të rishikuar në kuadër të vendimin të Komisionit të Konkurrencës nr. 608, datë 10.04.2019, nga ku rezulton se kryesisht janë reflektuar konstatimet e bëra nga Komisioni i Konkurrencës. Mbetet e pandryshuar Shtojca C “Shpërblimi për Stivadorin”, ku pjesa e fitimit të stivadorit, shprehur në përqindje mbi tarifën përkatëse, vazhdon të rezultojë shumë më e ulët se ajo e parashikuar në kontratat e para të lidhura nga EMS APO me ndërmarrjet stivadore.
6. Referuar sa më sipër dhe në respektim të Kontratës Konçesionare sipas së cilës Koncesionari EMS APO nuk mund të transferojë detyrimet e tij pa miratimin paraprak nga Autoriteti Kontraktor (MIE) me të cilin është lidhur kontrata e koncesionit, vlerësojmë të rëndësishëm bashkëpunimin midis tyre për nxjerrjen e një drafti të përbashkët, ku të reflektohen interesat e të gjitha palëve të interesuara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 24, shkronja (d) dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndërmarrja “EMS-Albanian Port Operator” SHPK në respektim të VKK nr. 567/2018, pika I/b), si dhe VKK nr. 608/2019, pika 3, ta përcjellë draft kontratën e rishikuar për shërbimet stivadore pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim bashkëpunimin për nxjerrjen e një drafti të përbashkët, ku të reflektohen interesat e të gjitha palëve të interesuara.
 2. Të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me draft - kontratën e përbashkët nga ana e EMS-së.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 644, Datë 31.07.2019

“Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”.

Baza ligjore: Neni 8 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 45 dhe neni 69 dhe 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS) ka paraqitur Shkresën më datë 19.10.2018, protokolluar pranë AK me nr. 601 prot., me objekt “Njoftim për një sjellje të mundshme anti-konkurrese dhe kërkesë për hetim” (“*Notification of potential anti-competitive conduct and request for investigation*”), në lidhje me dy procedura tenderuese që KESH ka zhvilluar referuar: “Kontratës së depozitimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë EFT AG dhe “Kontratës së devijimit” lidhur midis KESH SHA dhe shoqërisë GSA SHPK.
2. Në vijim të procedurave, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës organizoi në datë 8 Nëntor 2018, një takim me ekspertët e Sekretariatit të Energjisë, të cilët parashtruar kërkesën e tyre për hapjen e një hetimi nga ana e AK, për shkelje të rregullave të konkurrencës të parashikuar nga ligji nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenet e Traktatit “Mbi funksionimin e Komunitetit të Energjisë” (“*Treaty Establishing Energy Community*”), Sekretariati i Energjisë ka të drejtë të informojë autoritetet kombëtare, në lidhje me çështje për të cilat ai gjykon se janë shkelur rregullat përkatëse, dhe në rastin konkret, në zbatim të neneve 18(1) (a) dhe 18 (1) (b) të Traktatit, ai i është drejtuar Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, për sjellje antikonkurrese dhe abuzim me pozitën dominuese, në lidhje me procedurat tenderuese të realizuara nga KESH për: kontratën e depozitimit dhe kontratën e devijimit.
4. Gjatë ndjekjes së procedurave hetimore është kontaktuar edhe nëpërmjet e-mailit me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës ku kemi kërkuar të na vënë në dispozicion informacione apo fakte dhe prova që mund

të kenë lidhur me rastin si dhe çdo informacion shtesë lidhur më kërkesën që na kanë drejtuar për fillimin e procedurave hetimore.

5. Nga ana e Sekretariatit na është vënë në dispozicion një nga marrëveshjet kuadër, me e-mail e datës 12.11.2018 me objekt “*Cooperation on energy case*”. Të njëjtën marrëveshje e depozitoi pranë institucionit tonë me shkresën nr.601/3 prot, datë 19.11.2018 edhe KESH SHA.
6. Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 588, datë 28.01. 2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin nr. 617, datë 09.05.2019 (ku është vendosur zgjatja e hetimit) ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
7. Më datë 21.03.2019 është realizuar një seancë dëgjimore me përfaqësues të KESH SHA, pas ftesës së dërguar nga Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 24/4 prot., datë 26.02.2019. Pas realizimit të kësaj seance, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 24/8 prot, datë 25.04.2019 kërkoi nga KESH informacione shtesë të cilat u administruan me shkresën nr. 24/12, datë 22.05.2019.
8. Më datë 02.05.2019 nga ana e AK, është realizuar edhe seanca dëgjimore me përfaqësuesit e ERE, ku nga ana e tyre u deklarua se janë realizuar draft/raportet e monitorimit lidhur me procedurat e shit-blerjes së energjisë elektrike për kontratën e depozitimit ndërmjet KESH SHA dhe EFT AG si dhe kontratën e devijimit ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK.
9. Gjatë kësaj procedure, u kërkua informacion nga ERE me shkresën nr. 286/1, datë 06.05.2019 dhe OST me shkresën nr. 24/13, datë 28.05.2019, informacion i cili u administrua pranë Autoritetit të Konkurrencës.

II. Analiza e marrëveshjeve kuadër/kontratave të depozitimit dhe devijimit të KESH SHA

II.1. Kontrata e Depozitimit midis KESH SHA dhe EFT AG

10. Në vitin 2016¹ KESH ka nënshkruar kontratën e depozitimit me shoqërinë “EFT AG” me afat deri në 31 dhjetor 2019, ku kanë marrë pjesë 5 shoqëritë “GSA” SHPK, “GEN I Tirana” SHPK, “EFT AG”, “AXPO Trading AG” dhe “ALPIQ Energy SE (Ceki).
11. Kontrata e depozitimit ka për objekt depozitimin e energjisë së tepërt që do të prodhohet nga Depozituesi në kushtet e prurjeve të mëdha dhe kthimin e saj, po në formë energjie nga Partneri për një periudhë tjetër të vitit ku nuk krijohen kosto shtesë për depozituesin, me afat deri më 31 dhjetor 2019.
12. Në lidhje me “kontratën e depozitimit”, ERE në vitin 2016 ka marrë Vendimin nr. 131, datë 15.08.2016 “Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH SHA “Ftesë për ofertë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, sipas të cilit ERE, si institucioni rregullator në sektorin e energjisë ka vendosur që KESH SHA duhet të ndërpresë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin dhe përfundimin e kësaj procedure, sepse KESH SHA nuk ka zbatuar dispozitat e ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i cili parashikon shprehimisht si transaksione të energjisë elektrike vetëm blerjen, shitjen dhe shkëmbimin. Në këtë mënyrë KESH nuk ka respektuar parashikimet e rregullave dhe procedurave të shkëmbimit të energjisë elektrike miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 100, datë 27.12.2016.
13. Referuar vendimit të mësipërm KESH SHA është shprehur se ky produkt i ofruar nga ana e tij nuk është subjekt i rregullimit nga “Rregullat e shitjes, blerjes dhe shkëmbimit të energjisë” e miratuar nga ERE.

¹ Të njëjtën praktikë KESH ka ndjekur edhe në vitin 2011

14. Gjithashtu, ERE me Vendimin nr. 148, datë 30.09.2016 “ Mbi kërkesën e shoqërisë KESH SHA për rishikimin e vendimit nr. 131 datë 15.08.2016 të bordit të ERE “Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH SHA - “Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, ka konstatuar se: KESH SHA ka finalizuar procedurën e ndjekur me kontratën nr.6549, datë 27.07.2016 dhe në zbatim të vendimit të ERE nr.131, datë 15.08.2016 ka pezulluar veprimet e mëtejshme për zbatimin e kësaj kontrate.
15. Në përfundim ERE i ka kërkuar KESH SHA, që në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, për qëllime të interesit publik, garantimit të furnizimit me energji elektrike si dhe shfrytëzimin eficient të energjisë elektrike, në konsultim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, të adresojë menaxhimin e energjisë elektrike mbështetur në legjislacionin përkatës pas përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik, të parashikuar në ligj.
16. Pavarësisht konstatimit të ERE - ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH SHA nëpërmjet “Ftese për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike”, nga informacioni i depozituar nga ana e KESH SHA pranë AK, me shkresën nr.601/3, datë 19.11.2018, lidhur me zbatimin e “Kontratës së depozitimit” për periudhën nga momenti i hyrjes në fuqi deri në momentin e raportimit, kjo kontratë është miratuar me vendimin nr. 9, datë 28.07.2016 nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë KESH SHA.

II.2. Kontrata e Devijimit midis KESH SHA dhe GSA SHPK

17. Në vitin 2009 shoqëria GSA SHPK i është drejtuar shoqërisë KESH me shkresën nr.4143, datë 02.09.2009 “Kërkesë për marrëdhënie kontraktuale ndërmjet KESH dhe GSA” për furnizim me energji shtesë/devijime për destinacion konsumatorë të kualifikuar.
18. Pas vlerësimit që i është bërë kërkesës së mësipërme ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK është nënshkruar kontrata me nr.01-09, datë 11 shtator 2009 “Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve” me kohëzgjatje: 7 shtator 2009 – 31 dhjetor 2015.
19. Në vijim të zbatimit të kontratës së mësipërme ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK është nënshkruar kontrata me nr. 1, datë 11.03.2013 “Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve” me afat vlefshmërie nga 11 mars 2013 – 31 dhjetor 2025, duke shfuqizuar në këtë mënyrë kontratën nr.01-09, datë 11 shtator 2009.
20. Sipas kontratës “Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve” palët bien dakord që:
- KESH SHA të furnizojë me energji elektrike GSA SHPK kur, për çfarëdo arsye do të ketë një ndërprerje në furnizim me energji të Konsumatorit të Kualifikuar nga GSA SHPK dhe/ose kur GSA SHPK nuk mund të sigurojë shërbime interkonjeksioni dhe transmetimi nga OST.
 - KESH SHA do të bashkëpunojë me GSA SHPK për energjinë që KESH SHA mund të furnizojë/absorbojë për/prej GSA SHPK (energji e devijimeve) kur për çfarëdo arsye – do të ketë devijime ndërmjet Programit të Importit dhe Programit të Furnizimit, për qëllimin e furnizimit me energji të Konsumatorit të Kualifikuar.
21. Bazuar në ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 20 germa “h”, Enti Rregullator i Energjisë ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, si dhe të kontratave bilaterale, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këtu përfshihen edhe shërbimet e balancimit, kontratat e të cilave duhet të miratohen nga ERE, si dhe nuk duhet të kenë një afat më të gjatë se 12 muaj.

III. Kuadri i ri rregullator dhe vendimmarrja e ERE

22. Nga data 1 janar 2018, me miratimin e “Rregullave e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendim të bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017, të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë palë përgjegjëse për balancimin e energjisë elektrike.
23. Nisur nga ky detyrim i ri për ndërmarrjen KESH SHA, kjo e fundit në seancën dëgjimore të datës 21.03.2019, shprehet se duke filluar nga data 1 janar 2018 ka vendosur ta konsiderojë të pazbatueshme në praktikë “kontratën e devijimit” për faktin se KESH SHA tashmë është palë përgjegjëse për balancimin e energjisë elektrike dhe për pasojë mund ti shkaktohen kosto shtesë që mund të lindin nga marrëdhënia kontraktore me GSA SHPK, në lidhje me këtë kontratë. KESH nuk shprehet shprehimisht për zgjidhjen e saj, e cila është lidhur deri më 31.12. 2025, dhe si kontratë krijon të drejta dhe detyrime për palët e saj.
24. ERE me shkresën nr. 343/1 prot., datë 19.06.2019, (protokolluar me tonën nr. 394 prot, datë 20.06.2019) njofton vendimin nr. 93, datë 03.06.2019 “Mbi rezultatet e monitorimit të kryer pranë shoqërisë KESH SHA lidhur me ankesën e shoqërisë GEN-I TIRANA SHPK mbi zbatimin e procedurave të shit-blerjes së energjisë elektrike për vitin 2017 dhe periudhën janar-mars 2018 si dhe monitorimit lidhur me zbatimin e kontratave të depozitimit dhe shkëmbimit nga KESH SHA për vitet 2017 dhe 2018”, me anë të të cilit ka vendosur që:
- KESH SHA të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së lidhur më dt. 11.03.2013 ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK “Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve” me afat vlefshmërie deri 31.12.2025 si dhe ti bëjë me dije ERE-s vendimin e marrë;
 - KESH SHA të marrë masa për kthimin e sasisë prej 3 865 MWh nga EFT AG sipas kushteve të kontratës me nr. 6549, datë 27.07.2016 “Për depozitimin e energjisë, ndërmjet KESH SHA dhe EFT AG” ka hyre në fuqi pas miratimit në parim të saj nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të KESH me vendimin nr. Nr. 09, datë 28.07.2016 “Mbi kontratën e depozitimit të energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha lidhur mes KESH SHA dhe EFT AG”;
 - KESH SHA të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës mes shoqërisë KESH SHA dhe shoqërisë EFT AG me nr. 6549, datë 27.07.2016 “Për depozitimin e energjisë, ndërmjet KESH SHA dhe EFT AG” ka hyre në fuqi pas miratimit në parim të saj nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të KESH me vendimin nr. Nr. 09, datë 28.07.2016 “Mbi kontratën e depozitimit të energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha lidhur mes KESH dhe EFT AG”;
 - T’i rekomandojë KESH SHA që të kërkojë e propozojë në organet drejtuese të shoqërisë rishikimin rregullores për procedurat e shitblerjes së energjisë, duke i përshtatur ato me kërkesat e tregut dhe parashikimet e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.103/2016, e cila parashikon ndërtimin e një platformë IT online, përfshire publikimin të të dhënave të blerësit dhe shitësit në funksion të blerjes/shitjes së energjisë elektrike;
 - Të vijojnë monitorimet e nisura, në transaksionet e Energjisë elektrike dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e lejuara ligjore me qëllim zbardhjen e rrethanave që çuan në fillimin e monitorimeve me qëllim trajtimin e ankesës së GEN- I Tirana SHPK, duke shqyrtuar transaksionet e kryera nga të gjithë pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike.

IV. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes KESH

25. KESH SHA ka në funksionim 79% të kapaciteteve prodhuese në vend dhe furnizon rreth 70% të kërkesës për energji elektrike të klientëve tariforë, siguron energjinë e nevojshme për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit, si dhe nëpërmjet energjisë balancuese e shërbimeve ndihmëse garanton sigurinë e sistemit energjetik shqiptar, duke zotëruar një pozitë dominuese në këtë treg bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
26. Në lidhje me “Kontratën e depozitimit”, ndërmjet KESH SHA dhe EFT AG, nga informacioni i depozituar nga ana e KESH SHA pranë AK, rezulton se kjo kontratë është zbatuar për vitet 2016, 2017 dhe 2018 me një kohëzgjatje 3 vjeçare duke përjashtuar në këtë mënyrë operatorë të tjerë të interesuar në tregun e depozitimit.
27. Duke qenë se KESH SHA zotëron pozitë dominuese në prodhimin e energjisë në vend, afati 3 vjeçar për lidhjen e kontratës dhe dhënies së një të drejte të tillë të veçantë (depozitimi), të paparashikuar në ligj dhe në licencën përkatëse, një operatori ekonomik, përbën kufizim të konkurrencës dhe në zbatim të nenit 9, pika 2, germa ç) të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, sjellja e KESH SHA përbën abuzim me pozitën dominuese në tregun e depozitimit.
28. Për “Kontratën e devijimit”, objekt hetimi, rezulton se ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK është nënshkruar kontrata me nr.01-09, datë 11 shtator 2009 “Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve”, me afat vlefshmërie deri në vitin 2015.
29. Kontrata me të njëjtin objekt me nr. 1, datë 11.03.2013 me afat vlefshmërie nga 11 mars 2013 – 31 dhjetor 2025, e cila ka shfuqizuar në këtë mënyrë kontratën e mëparshme, ku përveç përditësimit të bazës ligjore, përmban të njëjtat të drejta dhe detyrime për palët si kontrata e mëparshme.
30. Kontrata e devijimit ndërmjet KESH SHA dhe GSA SHPK është nënshkruar nga KESH SHA pa realizuar asnjë procedurë konkurrimi duke sjellë si pasojë nënshkrimin e një kontrate shumë afatgjatë e cila kufizon konkurrencën duke mos lejuar pjesëmarrje të gjerë të operatorëve që operojnë në tregun e devijimit (furnizimit).
31. Duke qenë se ndërmarrja KESH SHA zotëron pozitë dominuese në prodhimin e energjisë në vend, lidhja e kontratave me afat 15 vjeçar përbën kufizim të konkurrencës, duke përjashtuar mundësinë që shoqëri të tjera të mund të konkurrojnë për ofrimin e këtij shërbimi. Kjo sjellje e ndërmarrjes KESH SHA përbën abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa ç) në tregun e devijimit të energjisë elektrike.
32. Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me shkresën nr. 24/14 Prot. datë 27.06.2019 “Mbi Hetimin paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike” ka dërguar pranë ndërmarrjes KESH SHA raportin e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, duke e ftuar KESH SHA të paraqesë angazhimet apo pretendimet mbi konkluzionet e këtij hetimi.
33. KESH SHA nuk është shprehur në lidhje me këtë hetim të kryer nga Autoriteti i Konkurrencës.
34. Në përfundim të procedurës hetimore konstatohet se ndërmarrja KESH SHA nëpërmjet lidhjes së dy kontratave afatgjata për depozitimin dhe devijimin e energjisë elektrike ka abuzuar me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa ç) e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8 dhe 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26, nenin 45 dhe nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike.
2. Konstatimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës që rrjedhin nga pozita dominuese e KESH, në drejtim të procedurave për lidhjen dhe zbatimin e :
 - a. Kontratës së devijimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA dhe GSA SHPK.
 - b. Kontratës së depozitimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA me EFT AG.
3. Dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA:
 - a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA në zbatim të Vendimin nr.93/2019 të ERE të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
 - b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Sekretariatit e Energjisë në Vjenë për ecurinë e zbatimit të vendimit nr.93/2019 të ERE.
 - c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për ecurinë e zbatimit të vendimit nr.93/2019 të ERE.
 - d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozite dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive, për ndërmarrje (kompani) ose për produkte te caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga Komisioni i Konkurrencës.
4. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhe 1 vjeçare.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 645, Datë 31.07.2019

“Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Vendimit nr. 562, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të monitorimit, në zbatim të Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në Republikën e Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 24, 28 dhe neni 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi monitorimin, për zbatimin e Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës, në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr.562, datë 25.10.2018 në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë, vendosi:

- I. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë ;
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për shkelje të konkurrencës, konkretisht të nenit 9, pika 2, gërmat (a) dhe (ç), të Ligjit Nr. 9121/2003, në masën XXXX të xhiros totale të ndërmarrjes për vitin paraardhës financiar (2017), përkatësisht në shumën XXXX Lekë;
- III. Detyrimin e ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:
 1. Të zbatojë në mënyrë të menjëhershme detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimit cilësor, të kënaqshëm, duke vënë në përdorim QKTL-të pranë QKT-ve me fluksin më të madh të klientëve;
 2. Të vendosë në funksionim 100% të kapacitetit të të gjitha QKT-ve dhe QKTL-ve.

3. Heqjen e pikës tre nga Deklarata–Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar;
4. Hartimi i një plani për rishikimin e rishpërndarjes së posteve të ofrimit të shërbimit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të shërbimit, në kuptimin që, në ato QKT, ku postet janë të papërdorura, apo në një nivel të ulët përdorimi, të mund të sillen drejt QKT-ve ku ka fluks më të lartë.
5. Të hartojë një plan masash për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet, me kushte më të mira tregtimi në përputhje me kontratën, dhe të njoftojë pranë Autoritetit të Konkurrencës;

IV. Ti rekomandohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si vijon:

1. Liberalizimin e tregut në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimit të servisit, sikurse pjesa më e madhe e vendeve të BE e ofron.
2. Për kohën e vazhdimin të këtij konkensionari, brenda një afati prej 90 ditëve:
 - a. të miratohet një rregullore për funksionimin dhe monitorimin e Konkensionarit SGS, ku të jenë përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, shërbimet që ofrohen nga ana e Tij,
 - b. miratimin e planit të investimeve vjetore, me qëllim që shërbimi të jetë cilësor dhe t'i përgjigjet trendeve të zhvillimit, për rritjen e fluksit të mjeteve çdo vit si edhe shpërndarjes së popullësisë.
3. Rishikimin e manualit teknik dhe sidomos të afatit të testimit të mjeteve për t'u pajisur me çertifikatën e kontrollit teknik.
4. Plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore duke përcaktuar qartë rolin e organeve shtetërore në lidhje me marrëdhëniet midis ndërmarrjes Koncesionare, që ka në menaxhim dhe administrim infrastrukturën e QKT-ve dhe mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis tyre nga organet rregullatorë.

V. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të kontrollit teknik për automjetet në Republikën e Shqipërisë.

I. Zbatimi i rekomandimeve nga SGS Albania SHPK

1. Autoriteti i Konkurrencës ka kryer monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me Vendimin Nr.562, datë 15.10.2018 “Për vendosje gjore dhe detyrime ndaj ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK në tregun e shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë dhe dhënien e disa rekomandimeve”.
2. Autoriteti i Konkurrencës në realizimin e këtij monitorimi ka kryer korrespondencën me SGS Albania SHPK si edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si më poshtë vijon:
 - AK me shkresën Nr. 66 Prot., datë 28.01.2019, “Kërkesë për Informacion” i ka kërkuar ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” SHPK zbatimin e këtij vendimi.
 - Ndërmarrja SGS Automotive Albania SHPK, me shkresën e saj Nr.1089 prot.,datë 14.02.2019 e protokolluar në Autoritetin e Konkurrencës me Nr. 66/1 prot., datë 15.02.2019 na ka informuar në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

Ndërmarrjes me pozitë dominuese “SGS Automotive Albania SHPK, sipas pikës III të vendimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës, i është vendosur detyrimi për të ndaluar shkeljen e konkurrencës dhe brenda 45 ditëve të marrë masat e nevojshme, si vijon:

1. Të zbatojë në mënyrë të menjëhershme detyrimin ligjor për ofrimin e shërbimit cilësor, të kënaqshëm, duke vënë në përdorim QKTL-të pranë QKT-ve me fluksin më të madh të klientëve;
2. Të vendosë në funksionim 100% të kapacitetit të të gjitha QKT-ve dhe QKTL-ve.
3. Heqjen e pikës tre nga Deklarata–Tip që nënshkruhet nga klientët para dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar;
4. Hartimi i një plani për rishikimin e rishpërndarjes së posteve të ofrimit të shërbimit, më qëllim rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të shërbimit, në kuptimin që, në ato QKT, ku postet janë të papërdorura, apo në një nivel të ulët përdorimi, të mund të sillen drejt QKT-ve ku ka fluks më të lartë.
5. Të hartojë një plan masash për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet, me kushte më të mira tregtimi në përputhje me kontratën, dhe të njoftojë pranë Autoritetit të Konkurrencës;

Nga vlerësimi ligjor bërë shkresës së depozituar nga ndërmarrja SGS, referuar pikës III të Vendimit Nr.562, datë 15.10.2018 rezulton se:

1. Nga ana e Autoritetit të Konkurrencës u realizua monitorimi i zbatimit të vendimit në datë 29.05.2019 pranë ndërmarrjes SGS Automotive Albania SHPK si edhe në datë 25.07.2019 në qendrën e kontrollit teknik Tirana 2, lidhur me monitorimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet si edhe vendosjen në funksion 100% të QKTL-ve pranë QKT-ve me fluksin më të madh, nga ku rezultoj se aktualisht janë tre QKTL, dy nga të cilat janë në qendrën Tirana 2 dhe janë në përdorim përditë, ndërsa tjera (e treta) është e gatëshme për përdorim në karrel, në këtë qëndër të kontrollit të mjeteve. Fluksi i makinave ishte i menaxhueshëm dhe i përbalueshëm nga katër linjat në dispozicion të kontrollit teknik të mjeteve. Pra rezulton se QKTL-të janë të kompletuara dhe funksionale. Aktualisht nuk ka fluks, sepse me futjen e shërbimit të prenotimit online, radhët janë reduktuar dhe linjat aktuale që funksionojnë e përballojnë fluksin në këtë qëndër.

Pra sa më sipër pika “1” e dispozitivit të Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2019 është përmbushur nga ndërmarrja SGS Albania SHPK.
2. QKT dhe QKTL-të janë në funksionim sipas monitorimit të realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës në datë 29.05.2019 dhe datë 25.07.2019 në ndërmarrjen SGS Albania SHPK.

Pra sa më sipër pika “2” e dispozitivit të Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2019 është zbatuar nga ndërmarrja SGS Albania SHPK
3. Ndërmarrja SGS Automotive Albania SHPK e ka hequr pikën 3 të Deklaratës Tip në datë 12.10.2018.

Pra sa më sipër pika “3” e dispozitivit të Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2019 është zbatuar nga ndërmarrja SGS Albania SHPK.
4. Nuk është hartuar ndonjë plan për rishikimin e rishpërndarjes së posteve(linjave teknike të kontrollit) të ofrimit të shërbimit, më qëllim rritjen e efikasitetit dhe ngritjen e nivelit të shërbimit, në kuptimin që në ato QKT ku postet (linjat teknike të kontrollit) që janë të papërdorura, apo në një nivel të ulët përdorimi, të mund të sillen drejt QKT-ve ku ka fluks më të lartë, pasi sipas pretendimeve të SGS Albania **janë çështje teknike dhe nuk mund të realizohen në këtë kohë kur po përfundon afati i kontratës.** Pra sa më sipër pika “4” e dispozitivit të Vendimit Nr. 562, datë 15.10.2019 nuk është realizuar nga ndërmarrja SGS Albania SHPK.

5. Të hartojë një plan masash për ofrimin dhe përmirësimin e shërbimit në tregun e kontrollit teknik për automjetet, me kushte më të mira tregtimi në përputhje me kontratën, dhe të njoftojë pranë Autoritetit të Konkurrencës;

Nga dy monitorimet e realizuar nga AK përkatësisht në datë 29.05.2019 dhe datë 25.07.2019 rezulton se SGS Albania SHPK nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë këtë pikë pasi ajo (SGS) ka realizuar vetëm shërbimin online. SGS Albania SHPK që nga koha e dhënies së vendimit Nr.562, datë 15.10.2018 të KK nuk ka hartuar një plan masash konkret.

Aktualisht sot, kur kontrata përfundon në datë 03.09.2019 koha e mbetur për realizimin e kësaj pikë është e pamjaftueshme, fakt i cili evidentohet dhe nga monitorimi i datës 25.07.2019.

II. Zbatimi i rekomandimeve nga MIE

Në zbatim të Vendimit Nr. 562, datë 25.10.2018, AK i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 85 prot., datë 30.01.2019, dhe shkresën e përsëritur me nr. 85/1 Prot, datë 12.03.2019 duke i kërkuar informacion lidhur me zbatimin e vendimeve brenda afatit 90 ditor nga zbardhja e vendimit.

Në vijim, për këto dy shkresa AK nuk ka marrë përgjigje nga MIE.

AK i është drejtuar sërisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 66/2 prot., datë 19.06.2019 e cila është përgjigjur me anë të shkresës nr. 6119/1 prot., datë 17.07.2019, protokolluar së brendëshmi me tonën nr. 66/3 prot., datë 18.07.2019.

Nga vlerësimi ligjor bërë shkresës së depozituar nga ndërmarrja MIE, referuar pikës IV të Vendimit Nr.562, datë 15.10.2018 rezulton se:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përgjigjen e saj datë 19.06.2019 nuk ka zbatuar rekomandimet e dhëna nga AK në vendimin e KK me Nr. 562, datë 15.10.2018, pavarësisht se Kontrata e Konkensionit datë 03.09.2009 “ Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” përfundon në 03.09.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, nenin 26, nenin 28, nenin 45 pika 1 dhe 2; nenin 69 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 69 të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” ti kërkoj MIE liberalizimin e tregut duke qënë se Kontrata e Konkensionit datë 03.09.2009 “ Për shërbimin e kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë” përfundon në 03.09.2019.
2. Të njoftoj Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për moszbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës me Nr.562, datë 15.10.2018 nga ana e MIE.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 649, Datë 03.10.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”.

Baza ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, si dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura dhe Transaksioni

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja Brunës SHPK lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari DCT SHA, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Brunës SHPK ndaj Terminalit të Konteinerëve Durrës SHA (DCT)”, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 257/8, datë 13.06.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim “Durrës Container Terminal” SHA (DCT SHA)”, e cila ushtron

veprimtarinë e saj në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja DCT SHA, Autoriteti Portual Durrës (APD) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
6. Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja DCT SHA, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali.
7. Në bazë të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 627, datë 13.06.2019, hetimi paraprak është hapur në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës.
8. Nisur nga problematikat e ngritura në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjes DCT SHA, e cila konsiston në sjelljen e kësaj ndërmarrjeje lidhur me ofrimin e shërbimit të mbushjes-zbrazjes së konteinerëve, si një shërbim i cili nuk ka një tarifë të përcaktuar dhe miratuar nga institucionet kompetente, ndryshe nga shërbimet e tjera kryesore të cilat ofrohen kundrejt tarifave të përcaktuara dhe miratuara sipas librit të tarifave të APD-së, vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes nën hetimit do të fokusohet në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ana e ndërmarrjes DCT SHA. Për këtë arsye si treg përkatës do konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.
9. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.
10. Bazuar në Masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i konteinerëve (ngarkim-shkarkimi i anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to) kryhet pranë Terminalit të Konteinerëve Durrës, ku ndërmarrja Koncesionare DCT SHA operon e vetme.
11. Referuar sa më sipër, tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit të Konteinerëve në Portin e Durrësit.
12. Si përfundim, tregu përkatës përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

13. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit, përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

14. Sipas ligjit nr. 9121, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji.
15. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
16. Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit, duke filluar nga muaji Shkurt 2013 operohet, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja DCT SHA, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal. Terminali është marrë me koncesion për 35 vjet nga ndërmarrja DCT SHA dhe për gjithë këtë periudhë kjo ndërmarrje është e vetme në këtë treg.
17. Duke marrë parasysh faktin që Koncesionari DCT SHA është posedues, operues, menaxhues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit të Konteinerëve Durrës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës; si dhe barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja DCT SHA vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimeve të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktiviteteve të lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, ku përfshihet edhe shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.

II.3 Sjellja e ndërmarrjes në treg

18. Ndërmarrja DCT SHA duke filluar nga muaji Maj 2018 ka ofruar shërbimet e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar, tarifë e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.
19. Koncesionari DCT SHA ka marrë miratimin e APD-së në 11 Maj 2018 për fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve. Sipas APD faturimi i këtij shërbimi do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendosen nga mbledhja e Këshillit Drejtues. Konkretisht ofrimi i këtij shërbimi nga DCT SHA ka filluar nga data 14.05.2018, duke aplikuar tarifat e propozuara nga vetë kjo shoqëri, konkretisht: për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet një tarifë prej XXX Euro/Box; për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet një tarifë prej XXX Euro/Box.
20. DCT SHA ka vijuar punën për përpunimin e konteinerëve duke ofruar edhe shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes, kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar dhe të pa miratuar nga instancat përkatëse, pavarësisht kërkesave të APD-së për ndërprerjen e ofrimit të këtij shërbimi, duke operuar në kundërshtim me termat e Kontratës Koncesionare si dhe me Librin e Tarifave Portuale.
21. Në vijim të shqyrtimit të propozimit për tarifat e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, Këshilli Drejtues i APD-së, me anë të vendimit nr. 21, datë 15.11.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 5, datë 02.03.2015 “Mbi përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, i ndryshuar, ka miratuar tarifat për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale konkretisht si vijon: - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet (20’) tarifa XXX Euro/Box; - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet (40’) tarifa XXX Euro/Box.
22. Sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, tarifat e miratuara sipas këtij vendimi i përcillen në formë propozimi për bashkëfirmosje Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Këto tarifa të miratuara hyjnë në fuqi sipas përcaktimit në aktin e miratimit nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht këtij miratimi paraprak të tarifës nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA nuk e ka ndryshuar sjelljen e saj duke vazhduar ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së Konteinerëve me të njëjtën tarifë të vetëpërcaktuar, e cila është me e lartë se tarifa e miratuar për këtë shërbim nga APD, konkretisht XXX% më e lartë për konteinerët 20' dhe XXX% më e lartë për konteinerët 40'.

23. Në bazë të kontratës Koncesionare DCT SHA ka ekskluzivitetin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në Gjirin e Durrësit. Ushtrimi i kësaj të drejte përfshin edhe të drejtën për të ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve si një shërbim i lidhur me shërbimet kryesore të ngarkimit shkarkimit të konteinerëve, shërbim i cili është parashikuar si zë i veçantë në Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 1568/3, datë 14.07.2015 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, të ndryshuar, konkretisht në Kapitullin 2, pika 2.12/5/Vii. Sipas këtij udhëzimi shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, si shërbimet e tjera të renditura në nën pikën 5 si më sipër, *faturohet dhe paguhet më vite*. Referuar kontratës koncesionare dhe këtij udhëzimi, shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është një shërbim ofrimi i të cilit i është dhënë ekskluzivisht koncesionarit. Por nga ana tjetër për këtë shërbim nuk rezulton asnjë tarifë e miratuar në këtë udhëzim.
24. Pavarësisht sa më sipër, në respektim të kontratës koncesionare (pika 2.5.1/(i)), DCT SHA merr përsipër që të mos aplikojë, zbatojë, vjelë, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo pagesa të tjera të ndryshme të cilat përcaktohen në mënyrë ekskluzive nga Autoriteti Portual. Në rastin konkret DCT SHA ka aplikuar një tarifë shtesë në mënyrë të padrejtë, e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.

Kjo sjellje e ndërmarrjes koncesionare DCT SHA mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese, (monopol) që zotëron ky koncesionar, në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, pika 2, germa a), të ligjit nr. 9121, datë. 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA, me NUIS: L12126504E, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.
2. Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.09.2019.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 650, Datë 03.10.2019

“Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Marrja e masave të përkohshme në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA.

Baza ligjore: Neni 8, neni 9, Neni 24, shkronja (d) dhe neni 44 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, si dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja Brunës SHPK lidhur me faturimin e padrejtë të shërbimit të zbrazjes dhe mbushjes së konteinerëve nga Koncesionari DCT SHA, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes Brunës SHPK ndaj Terminalit të Konteinerëve Durrës SHA (DCT)”, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja (d) dhe nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 627, datë 13.06.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 257/8, datë 13.06.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim “Durrës Container Terminal” SHA (DCT SHA)”, e cila ushtron

veprimtarinë e saj në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktivitet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës.

4. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja DCT SHA, Autoriteti Portual Durrës (APD) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

I. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
6. Në bazë të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 627, datë 13.06.2019, hetimi paraprak është hapur në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim të anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës.
7. Nisur nga problematikat e ngritura në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës ndaj ndërmarrjes DCT SHA, e cila konsiston në sjelljen e kësaj ndërmarrjeje lidhur me ofrimin e shërbimit të mbushjes-zbrazjes së konteinerëve, si një shërbim i cili nuk ka një tarifë të përcaktuar dhe miratuar nga institucionet kompetente, ndryshe nga shërbimet e tjera kryesore të cilat ofrohen kundrejt tarifave të përcaktuara dhe miratuara sipas librit të tarifave të APD-së, vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes nën hetimit do të fokusohet në ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ana e ndërmarrjes DCT SHA. Për këtë arsye si treg përkatës do konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.
8. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.
9. Bazuar në Masterplanin e miratuar dhe kontratën koncesionare, përpunimi i konteinerëve (ngarkim-shkarkimi i anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura me to) kryhet pranë Terminalit të Konteinerëve Durrës, ku ndërmarrja Koncesionare DCT SHA operon e vetme.
10. Referuar sa më sipër, tregu përkatës gjeografik vlerësohet zona gjeografike e Terminalit të Konteinerëve në Portin e Durrësit.
11. Si përfundim, tregu përkatës përfshin ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës nga ndërmarrja koncesionare DCT SHA.

II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

12. Terminali i Konteinerëve Durrës, në bazë të kontratës së koncesionit, duke filluar nga muaji Shkurt 2013 operohet, menaxhohet dhe administrohet nga ndërmarrja DCT SHA, e cila është poseduesja dhe administruesja e vetme e të gjithë infrastrukturës dhe faciliteteve të këtij terminali. Çdo përdorues porti për të marrë shërbimet nga ky terminal, duhet patjetër të ketë akses në infrastrukturën dhe facilitetet që ofron ky terminal. Terminali është marrë me koncesion për 35 vjet nga ndërmarrja DCT SHA dhe për gjithë këtë periudhë kjo ndërmarrje është e vetme në këtë treg.
13. Duke marrë parasysh faktin që Koncesionari DCT SHA është posedues, operues, menaxhues dhe administrues i vetëm i infrastrukturës dhe faciliteteve të Terminalit të Konteinerëve Durrës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës; si dhe barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121/2003, ndërmarrja DCT SHA vlerësohet

me pozitë dominuese në tregun e ofrimit të shërbimeve të ngarkim-shkarkimit të anijeve konteinerike dhe aktiviteteve të lidhura me to në Terminalin e Konteinerëve Durrës, ku përfshihet edhe shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve.

II.3 Sjellja e ndërmarrjes në treg

14. Ndërmarrja DCT SHA duke filluar nga muaji Maj 2018 ka ofruar shërbimet e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar, tarifë e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.
15. Koncesionari DCT SHA ka marrë miratimin e APD-së në 11 Maj 2018 për fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve. Sipas APD faturimi i këtij shërbimi do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendosen nga mbledhja e Këshillit Drejtues. Konkretisht ofrimi i këtij shërbimi nga DCT SHA ka filluar nga data 14.05.2018, duke aplikuar tarifat e propozuara nga vetë kjo shoqëri, konkretisht: për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet një tarifë prej XXX Euro/Box; për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet një tarifë prej XXX Euro/Box.
16. DCT SHA ka vijuar punën për përpunimin e konteinerëve duke ofruar edhe shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes, kundrejt një tarife të vetëpërcaktuar dhe të pa miratuar nga instancat përkatëse, pavarësisht kërkesave të APD-së për ndërprerjen e ofrimit të këtij shërbimi, duke operuar në kundërshtim me termat e Kontratës Koncesionare si dhe me Librin e Tarifave Portuale.
17. Në vijim të shqyrtimit të propozimit për tarifat e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, Këshilli Drejtues i APD-së, me anë të vendimit nr. 21, datë 15.11.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 5, datë 02.03.2015 “Mbi përcaktimin dhe miratimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, i ndryshuar, ka miratuar tarifat për mbushje/zbrazje konteineri gjenerale konkretisht si vijon: - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 20 feet (20’) tarifa XXX Euro/Box; - Mbushje/zbrazje konteineri gjenerale 40 feet (40’) tarifa XXX Euro/Box.
18. Sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, tarifat e miratuara sipas këtij vendimi i përcillen në formë propozimi për bashkëfirmosje Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Këto tarifa të miratuara hyjnë në fuqi sipas përcaktimit në aktin e miratimit nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Pavarësisht këtij miratimi paraprak të tarifës nga APD që nga muaji nëntor 2018, DCT SHA nuk e ka ndryshuar sjelljen e saj duke vazhduar ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së Konteinerëve me të njëjtën tarifë të vetëpërcaktuar, e cila është me e lartë se tarifa e miratuar për këtë shërbim nga APD, konkretisht XXX% më e lartë për konteinerët 20’ dhe XXX% më e lartë për konteinerët 40’.
19. Në bazë të kontratës Koncesionare DCT SHA ka ekskluzivitetin e shërbimeve të përpunimit të konteinerëve në Gjirin e Durrësit. Ushtrimi i kësaj të drejte përfshin edhe të drejtën për të ofruar shërbimin e mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve si një shërbim i lidhur me shërbimet kryesore të ngarkim shkarkimit të konteinerëve, shërbim i cili është parashikuar si zë i veçantë në Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MFE nr. 1568/3, datë 14.07.2015 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, të ndryshuar, konkretisht në Kapitullin 2, pika 2.12/5/Vii. Sipas këtij udhëzimi shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, si shërbimet e tjera të renditura në nënpikën 5 si më sipër, *faturohet dhe paguhet më vite*. Referuar kontratës koncesionare dhe këtij udhëzimi, shërbimi i mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve është një shërbim ofrimi i të cilit i është dhënë ekskluzivisht koncesionarit. Por nga ana tjetër për këtë shërbim nuk rezulton asnjë tarifë e miratuar në këtë udhëzim.
20. Pavarësisht sa më sipër, në respektim të kontratës koncesionare (pika 2.5.1/(i)), DCT SHA merr përsipër që të mos aplikojë, zbatojë, vjelë, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo pagesa

të tjera të ndryshme të cilat përcaktohen në mënyrë ekskluzive nga Autoriteti Portual. Në rastin konkret DCT SHA ka aplikuar një tarifë shtesë në mënyrë të padrejtë, e cila nuk është e miratuar dhe nuk është prezent në librin e tarifave të publikuara në faqen zyrtare të APD-së.

21. Kjo sjellje e ndërmarrjes DCT mund të përbëjë abuzim me pozitën e saj dominuese në treg kundrejt përdoruesve të terminalit, duke u imponuar atyre çmime të padrejta tregtimi, duke i detyruar ata të paguajnë një çmim më të shtrenjtë për shërbimin e përfituar nga kjo ndërmarrje.

Si përfundim, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjes DCT SHA në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 8, nenin 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 44 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA, në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës, si vijon:
 - a. Ndërmarrja “Durrës Container Terminal” SHA duhet të ndalojë aplikimin e tarifave të padrejta për ofrimin e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës.
 - II. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
 - III. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja “Durrës Container Terminal” SHA ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.
 - IV. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës vendos gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa ndërmarrja “Durrës Container Terminal” SHA të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma b) të ligjit nr. 9121/2003.
 - V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 652, Datë 10.10.2019

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e “Raportit mbi hetimin paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”.

Baza ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi hetimin paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, si dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Bazuar në ankesat e paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja Tosk Energji SHA (Tosk) dhe Al.Global Oil SHA kundrejt ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd (Bankers), lidhur me abuzimin me pozitën dominuese të kësaj të fundit, filluan procedurat për vlerësimin e ankesës në respektim të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi ankesat ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd, në mbështetje të nenit 42, pika 1, nenit 9 dhe nenit 24, (shkronja d), të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 575, datë 03.12.2018 “Për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, vendosi: hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Bankers në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
3. Duke qenë se në ankesat e depozituara nga ndërmarrjet është kërkuar dhe marrja e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Bankers, Autoriteti i Konkurrencës më datë 11.12.2018 realizoi një seancë dëgjimore me ndërmarrjen Bankers dhe Tosk, të cilat paraqitën pretendimet e tyre përpara Komisionit të Konkurrencës.
4. Bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 578, datë 20.12.2018 vendosi marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, vendim i cili i është njoftuar ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, nëpërmjet shkresës nr. 607/12 prot, datë 20.12.2018.

5. Lidhur me zbatimin e vendimit të mësipërm nga ana e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me anë të Vendimit nr. 603, datë 21.03.2019 “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 578, datë 20.12.2018 “Për marrjen e masave të përkohshme në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD”.
6. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të Vendimit nr. 575, datë 03.12.2018 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 11/1, datë 15.01.2019 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit paraprak proceduan me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjes nën hetim Bankers Petroleum Albania LTD, e cila ushtron veprimtarinë e saj në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, si dhe ndërmarrjes Tosk Energji SHA.
7. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacion me nga: ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD, ndërmarrja Tosk Energji SHA, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), DPD, DPT dhe Albpetrol SHA.

I. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

8. Në zbatim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
9. Aktiviteti i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në vendin tonë, gjatë periudhës nën hetim, është kryer nga tetë ndërmarrje. Pavarësisht se sipas të dhënave vetëm njëra prej ndërmarrjeve (Bankers Petroleum) rezulton të ketë pjesën më të madhe të prodhimit të naftës, ekzistojnë edhe disa ndërmarrje të tjera që e realizojnë këtë aktivitet, pavarësisht se në një masë shumë të vogël. Sasia e naftës së prodhuar varet nga rezervat natyre të vendburimeve përkatëse të naftës nga ku rezulton se vendburimi që zotëron ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd ka rezervat më të mëdha të naftës në vendin tonë.
10. Për sa më sipër, në rastin tonë, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
11. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në vendin tonë e ushtrjnë aktivitetin e prodhimit të naftës në vendburimet e naftës, të cilat gjenden apo janë të shpërndara në të gjithë territorin e vendit. Prandaj, *tregu përkatës gjeografik në rastin tonë përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.*
12. Sa më sipër, treg përkatës është tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II.2 Marrëveshja hidrokarbure

13. Albpetrol SHA ka lidhur Marrëveshje Hidrokarbure për vendburimin e Patos-Marinzës me ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD (ish Saxon International Energy Ltd), marrëveshje kjo e miratuar me VKM nr. 477, datë 16.07.2004 “Për Miratimin e Marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e Patos-Marinzës”, të ndryshuar.
14. Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje Hidrokarbure Kontraktori Bankers i bashkohet Albpetrolit për kryerjen e operacioneve hidrokarbure duke u bërë palë gjithashtu dhe në Licencë Marrëveshjen e datës 7 qershor 2004, dhënë Albpetrolit nga Ministria dhe AKBN (ish AKH).

15. Kontraktori ka të drejtën ekskluzive të zhvillojë operacione hidrokarbure dhe të prodhojë naftë në zonën e kontratës, zonë kjo e përshkruar në Marrëveshjen Hidrokarbure dhe në Licencë Marrëveshje.
16. Sipas nenit 13 të Licencë Marrëveshjes si dhe nenit 14.3 dhe 21 të Marrëveshjes Hidrokarbure, Kontraktori Bankers në mënyrë që të garantojë shërbimet e kërkuara për Operacionet Hidrokarbure mund të punësojë nën-kontraktorë, por si vetë Kontraktori dhe nën-kontraktorët e tij do t'i japin prioritet mallrave dhe materialeve të prodhuara në Shqipëri nëse këto mallra dhe materiale ofrohen sipas kushteve favorizuese të barabarta në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponueshmërinë, dhe në sasi të kërkuara. Kontraktori do t'i japë prioritet shërbimeve të kryera nga nën-kontraktorë shqiptarë, nëse shërbime të tilla janë ofruar në kushte njëjloj të favorshme në lidhje me cilësinë, çmimin dhe disponueshmërinë që ato ofrohen nga nën-kontraktorët e huaj. Gjithashtu Kontraktori Bankers do të bëjë tendera konkurrues për ndonjë shërbim të kryer nëse shërbime të tilla priten të kalojnë dy milion \$US. Në këto raste Albpetroli mund të ndjekë hapjen e ofertave për të gjithë tenderat e tillë.
17. Në çdo rast të kryerjes së shërbimeve lidhur me operacionet hidrokarbure nga nën-kontraktorë të punësuar, çdo përgjegjësi dhe detyrim mbi kryerjen e tyre është e Kontraktorit Bankers. Gjithashtu Kontraktori informon Albpetrolin me të gjitha aktivitetet që do të kryhen sipas Marrëveshjes dhe do të lejojë përfaqësuesit e tij të inspektojnë operacionet hidrokarbure.
18. Bazuar në nenin 2, pika 2.3/(d) të Marrëveshjes Hidrokarbure, në përputhje dhe me nenin 3.2/(d) të Licencë Marrëveshjes, palët kanë të drejte ekskluzive: ta përdorin për llogari të vet, ta shesin, shkëmbejnë, eksportojnë, ta nxjerrin ose posedojnë naftën e prodhuar nga zona e kontratës dhe të marrin fitim dhe të drejtën e pronësisë ndaj kësaj naftë të prodhuar. Gjithashtu sipas pikës 2.10 të Marrëveshjes Hidrokarbure, kontraktori ka të drejtën të marri në natyrë, disponojë dhe eksportojë lirshëm pjesën e tij të naftës nga Zona e Projektit në përputhje me klauzolat e kësaj marrëveshjeje.
19. Një pjesë e të drejtave dhe detyrimeve të Kontraktorit, palë në Marrëveshjen Hidrokarbure, janë të parashikuara në ligjin nr. 7746, date 28.07.1993 "Për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", i ndryshuar, ku detyrimi themelor i Kontraktorit është zhvillimi i vendburimit dhe maksimizimi i prodhimit të hidrokarbureve duke respektuar në të njëjtën kohë legjislacionin shqiptar, por edhe praktikën më të mira që pranohen përgjithësisht në industrinë ndërkombëtare të naftës.
20. Në bazë të nenit 3 "Pronësia mbi hidrokarburet", të ligjit nr. 7746/1993 "Për hidrokarburet.." të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar.
21. Në vijim, sipas nenit 5, pika 3/c, të ligjit për hidrokarburet, një marrëveshje hidrokarbure "I garanton Kontraktorit të drejtën të shesë apo të tregtojë për eksport apo ndonjë gjë tjetër Hidrokarburet për të cilat ai ka marrë pronësinë sipas Marrëveshjes së Hidrokarbureve, përveç rasteve kur i nënshtrohet të drejtës së porosisë në kushte emergjence si dhe çdo detyrimi që përmban Marrëveshja e Hidrokarbureve për të furnizuar ose për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal".
22. Sipas kësaj dispozite, e drejta e kontraktorit Bankers, si palë në një marrëveshje hidrokarbure, për të tregtuar lirshëm naftën bruto në pronësi të tij, kufizohet përveçse në kushte emergjence edhe në rastet kur marrëveshja hidrokarbure përmban detyrimin e kontraktorit për të furnizuar ose për të kontribuar në furnizimin e tregut lokal.
23. Sa më sipër, ligji për hidrokarburet i jep të drejtën marrëveshjes hidrokarbure për të vendosur kufizime në formën e detyrimeve ndaj kontraktorit, me qëllim dhënien prioritet ndërmarrjeve vendase të përpunimit të

naftës bruto, në kushtet kur depozitimet e hidrokarbureve janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe këto burime duhet të përdoren në përfitim të popullit shqiptar.

24. Gjithashtu referuar nenit 3 të ligjit të hidrokarbureve, nenin 13 të Licencë Marrëveshjes, neneve 14.3 dhe 21 të Marrëveshjes Hidrokarbure, si dhe qëndrimin të mbajtur nga AKBN (Shkresa e AKBN nr. 4266 prot., datë 17.05.2017, drejtuar ndërmarrjes Bankers) rezulton se, në respektim të ligjit, Licencë Marrëveshjes dhe Marrëveshjes Hidrokarbure duhet t'i jepet prioritet shërbimeve të kryera nga nënkontraktorët shqiptarë, duke konsideruar që depozitimet e hidrokarbureve janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe këto burime duhet të përdoren në përfitim të popullit shqiptar.

II.3 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), për sjellje të mundshme antikonkurruese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të ligjit, përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
26. Sipas ligjit nr. 9121, nuk është e ndaluar pozita dominuese nga një ose disa ndërmarrje në treg, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjeve një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të këtij ligji.
27. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve të blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes; karakteristika të tjera të tregut përkatës.
28. Sipas sasisë totale të naftës bruto të prodhuar në Shqipëri, për vitin 2016 ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD zë rreth XXX të tregut përkatës, ndërsa në vitet 2017 dhe 2018 ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD zë përkatësisht XXX dhe XXX të tregut, ndërsa për periudhën Janar-Prill 2019 zë XXX të tregut përkatës duke qenë kështu prodhuesi më i madh i naftës bruto në vend për të tre vitet dhe duke paraqitur një qëndrueshmëri të pjesëve të tregut në vite. Pra vëmë re se pjesa e tregut të ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD ka patur një rënie të vogël nga viti 2016 duke ruajtur pjesën e tregut për vitet 2017 dhe 2018. Ndërsa volumi i prodhimit ka pësuar rënie nga viti 2016 në vitin 2018. Gjithashtu, rezulton se vetëm ndërmarrja Bankers Petroleum kryen operacione të eksportit të naftës bruto.
29. Gjatë periudhës nën hetim në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto kanë operuar kryesisht shtatë kompani, të cilat kanë nënshkruar Marrëveshje Hidrokarbure me Albpetrol SHA për prodhimin dhe zhvillimin e vendburimeve ekzistuese të naftës dhe gazit. Marrëveshjet Hidrokarbure jepen për një periudhë që nuk i kalon 25 vjet. Duke qenë se burimet natyrore të hidrokarbureve janë të kufizuara në numër dhe marrëveshjet për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburim janë me afate shumëvjeçare (deri në 25 vjet), mund të themi që barrierat për hyrjen e konkurrentëve në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto janë barrierat natyrore më tepër sesa ligjore. Gjithashtu, hyrja në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj kërkon investime të mëdha, investime të cilat përbëjnë barrierat të larta ekonomike për hyrjen në tregun përkatës.
30. Aktiviteti i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në vendin tonë pavarësisht se kryhet nga tetë ndërmarrje (duke përfshirë edhe Albpetrol), vetëm njëra prej tyre, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD rezulton të ketë pjesën më të madhe të prodhimit të naftës (rreth XXX), ndërsa ndërmarrjet e tjera kanë

një pjesë shumë të vogël, prandaj konkurrenca në këtë treg është në nivele të ulëta. Sasia e naftës së prodhuar varet nga rezervat natyre në vendburimet përkatëse të naftës nga ku rezulton se vendburimi që zotëron ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka rezervat më të mëdha të naftës në vendin tonë.

31. Konsumatorët e naftës bruto (rafineritë që bëjnë përpunimin e naftës) nuk zotërojnë fuqi kundërvepruese për t'u marrë në konsideratë, pasi edhe pse ata mund të kalojnë drejt furnizuesve të tjerë (prodhuesit e tjerë) ata nuk mund të plotësojnë të gjithë nevojat e tyre për shkak të pjesës së vogël të naftës bruto që prodhuesit e tjerë mund t'u ofrojnë. Prandaj burimi kryesor me naftë bruto për rafineritë e përpunimit të naftës është nafta e prodhuar nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD.
32. Duke marrë parasysh pjesët e tregut përkatës të ndërmarrjeve, barrierat për hyrjen në treg (ligjore dhe ekonomike), konkurrencën potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe qendrueshmërinë e pjesëve të tregut në vite, bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9121/2003, ndërmarrja Bankers Petroleum Albania LTD ka pozitë dominuese në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto në Republikën e Shqipërisë.

II.4 Sjellja e ndërmarrjes në treg

33. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit vërehet se ndërmarrja Bankers eksporton pjesën më të madhe të prodhimit dhe konkretisht XXX të prodhimit gjatë vitit 2016, XXX të prodhimit gjatë vitit 2017, XXX të prodhimit gjatë vitit 2018 dhe XXX të prodhimit gjatë periudhës Janar-Prill 2019. Për tre vitet e fundit, nga viti 2016 – 2018 dhe periudhën Janar-Prill 2019, ndërmarrja Bankers Petroleum eksporton nga XXX - XXX të prodhimit të saj të naftës bruto.
34. Sipas Programeve të Punës dhe Buxhetit të Bankers-it për vitet 2016-2019, programe këto të aprovuara nga Albpetrol dhe AKBN, mbi kontratat e lidhura midis Bankers dhe ndërmarrjeve përpunuese të naftës bruto, përse i përket përqindjes së shitjeve të parashikuara në tregun vendas rezulton se pjesa më e madhe e shitjeve, sipas kontratave të lidhura është për eksport, duke mos iu përmbajtur parashikimeve të Programeve të Punës dhe Buxhetit.
35. Çmimi i shitjes së naftës bruto nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd ka ardhur në rritje nga viti 2016 në vitin 2018. Çmimi i shitjes së naftës bruto brenda vendit nga kjo ndërmarrje rezulton të jetë më i ulët se çmimi i eksportit të naftës bruto për vitet 2017, 2018 dhe periudhën Janar-Prill 2019. Ndërkohë që sipas informacionit të depozituar në Autoritet nga ndërmarrja Bankers, kjo e fundit pretendon se aplikon çmime të njëjta për shitjen e naftës bruto brenda vendit dhe për eksport.
36. Në Republikën e Shqipërisë, ushtrojnë aktivitetet të përpunimit të naftës bruto katër rafineri nga të cilat rafineria më e madhe është Rafineria e Ballshit (Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh), e cila operohet nga ndërmarrja Tosk Energji. Kapaciteti përpunues i Rafinerisë së Ballshit është XXX Ton Naftë Bruto në vit. Bazuar në kushtet aktuale të rafinerisë ajo është e gatshme që të përpunojë rreth XXX Ton Naftë Bruto në ditë ose rreth XXX Ton Naftë Bruto në Muaj. Në rafinerinë e Ballshit janë të punësuar XXX punëmarrës.
37. Rafineria e dytë më e madhe në vend është rafineria e Fierit (Uzina e Përpunimit të Naftës në Fier) që operohet nga ndërmarrja Al.Global Oil SHA. Kapaciteti maksimal përpunues mujor i saj është XXX MT/muaj dhe minimumi i punimit të fabrikës është XXX MT/muaj. Në rafinerinë e Fierit janë punësuar mbi XXX punonjës.
38. Ndërmarrja Bankers ka lidhur me ndërmarrjen Tosk kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.05.2018 për furnizime për periudhën maj - dhjetor 2018 ku parashikohet një sasi prej XXX MT/muaj +/- XXX në muaj me një çmim prej XXX të Brent-it. Nga vlerësimi i informacionit të siguruar rezulton se ndërmarrja Tosk është furnizuar me sasi më të vogla se sasi të parashikuara në kontratën e lidhur me Bankers. Kjo mënyrë

furnizimi ka sjellë fikjen XXX herë të rafinerisë së ndërmarrjes Tosk gjatë vitit 2018, në një kohë shumë të shkurtër, ku shkak kryesor i fikjes ka qenë mosfurnizimi me lëndë të parë, naftë bruto.

39. Në kontratatën e furnizimit me naftë bruto lidhur nga ndërmarrja Bankers me Tosk Energji, për vitin 2019, parashikohet një sasi më e vogël se kontrata e vitit 2018. Konkretisht për muajin Janar: XXX metrik ton +/- XXX; për muajin Shkurt: XXX metrik ton +/- XXX; për muajt Mars-Dhjetor: sipas marrëveshjes midis palëve, dhe me një çmim prej XXX të Brent-it, ndërkohë që kontrata e vitit 2018 parashikonte një sasi prej XXX metrik ton +/- XXX në muaj me një çmim prej XXX të Brent-it. Këto janë sasi të pamjaftueshme për funksionimin normal të Rafinerisë, ndërkohë që Tosk ka kërkuar një furnizimin me sasinë e nevojshme prej XXX MT/muaj me një çmim prej XXX të Brent-it dhe me të njëjtat kushte si të kontratës së mëparshme.
40. Sipas kontratës së vitit 2019 lidhur ndërmjet Bankers dhe Tosk Energji, për muajin Mars-Dhjetor sasia e furnizimit do të përcaktohet sipas marrëveshjes midis palëve, duke e lënë atë të papërcaktuar. Bazuar në nenin 773 të Kodit Civil, paragrafi i parë: *“Kur nuk është përcaktuar sasia e furnizimit nënkuptohet se marrëveshja është për sasinë që përkon me nevojat normale të palës që furnizohet deri në kohën e përfundimit të kontratës”*. Kjo nënkupton faktin që sipas marrëveshjes së lidhur, Bankers duhet të furnizojë Tosk me një sasi naftë bruto e cila do të përmbushë nevojat normale të Rafinerisë së Ballshit.
41. Referuar informacionit të depozituar nga Tosk, për shkak të mos furnizimit me naftë bruto Rafineria e Ballshit është fikur XXX herë gjatë katër mujorit të parë të vitit 2019.
42. Nafta bruto është lëndë e parë pa të cilën procesi i rafinerisë nuk mund të kryhet. Për rrjedhojë mos furnizimi me sasinë e nevojshme me naftë bruto dhe shpërndarje/alokim të furnizimit në shkelje të nevojës për furnizim të ndërmarrjes Tosk, fut në kolaps funksionimin e rafinerisë së Ballshit, e cila ka nevojë për furnizim ditor prej XXX ton në ditë. Sasia e furnizuar aktualisht nga Bankers, rezulton të jetë totalisht e pamjaftueshme për të mundësuar ndezjen e rafinerisë së Ballshit, kjo e fundit operon vetëm në kushtet e një furnizimi linear dhe periodik gjatë një muaji. Mos furnizimi në sasinë e nevojshme, me lëndën e parë (si input thelbësor) nga ana e Bankers, e cila ka pozitë dominuese në prodhimin e naftës bruto, shkakton kolaps në proceset e tjera të përpunimit dhe shitjes nga ana e Tosk duke sjellë në mënyrë të përshkallëzuar, daljen jashtë tregut të kësaj ndërmarrjeje.
43. Ndërmarrja Bankers ka lidhur me ndërmarrjen Al.Global Oil SHA kontratën e shitjes së naftës bruto datë 01.04.2018 për furnizime për periudhën prill - dhjetor 2018. Kjo kontratë nuk parashikon sasinë e furnizimit, ndërsa çmimi i shitjes është i njëjtë me atë të Tosk, prej XXX të Brent-it. Kapaciteti maksimal përpunues mujor i Rafinerisë është XXX Mt/muaj dhe minimumi i punimit të fabrikës është XXX MT/muaj, ndërkohë që ndërmarrja Bankers e furnizon me vetëm XXX Mt/vit.
44. Për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2019 Bankers ka lidhur kontratë me Al.Global Oil SHA, me një sasi mujore të naftës bruto minimumi XXX MT +/- XXX dhe maksimumi XXX MT +/- XXX, me një çmim prej XXX të Brent-it, ndërkohë që minimumi i punimit të fabrikës është XXX MT/muaj dhe kapaciteti përpunues është XXX Mt/muaj.
45. Për sa i përket marrëveshjes së lidhur për vitin 2018 midis Al.Global.Oil dhe Bankers, e cila ka sasi të pacaktuar furnizimi me naftë bruto, bazuar në nenin 773 të Kodit Civil, paragrafi i parë, Bankers-it i lind detyrimi të furnizojë Al.Global.Oil me një sasi naftë bruto e cila do të përmbushë nevojat normale të Rafinerisë së Fierit, gjë e cila sipas Al.Global.Oil nuk është përmbushur.
46. Lidhur me problematikën e mësipërme të rafinerive vendase, UPN Fier dhe KPTHN Ballsh, AKBN me shkresën Nr. 4266 Prot., datë 17.05.2017, drejtuar ndërmarrjes Bankers, është shprehur se: *“Në mënyrë që këto rafineri të funksionojnë me një kapacitet të plotë, nevojitet një furnizim prej më shumë se XXX MT në muaj. AKBN konstaton se aktualisht Bankers Petroleum ka dedikuar vetëm (XXX-XXX) të prodhimit*

të saj mujor, ndërsa pjesa më e madhe e prodhimit eksportohet jashtë territorit të Shqipërisë. Eksportimi i pjesës më të madhe të naftës së prodhuar nga kompania Bankers ka vendosur në një situatë të vështirë operacionale e financiare rafineritë vendase....”.

47. Nëpërmjet kërkesave të përsëritura për informacion ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD i është kërkuar paraqitja e të gjitha kontratave të lidhura me kontraktorët/nënkontraktorët vendas dhe të huaj, për shërbimet që ju ofrohen, si dhe analiza e kostos sipas elementeve që përcaktojnë çmimin e shitjes së naftës bruto. Në vijim të kësaj kërkesë Bankers ka kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar nga AK, kërkesë e cila u mor në konsideratë nga Autoriteti, duke iu caktuar një afat i dytë.
48. Në vijim Bankers, ka kërkuar sqarime lidhur me kërkesën e AK-së sa i përket kontratave të lidhura me kontraktorët/nënkontraktorët vendas dhe të huaj, duke u shprehur se kjo kërkesë nuk është specifikuar qartë në mënyrë që shoqëria Bankers të vlerësojë se cili informacion është i nevojshëm dhe cili jo, duke kërkuar që të specifikohet natyra/lloji i kontratave të shërbimit që kërkohet të vihen në dispozicion të AK-së. Për sa i përket kërkesës për analizën e kostos sipas elementeve që përcaktojnë çmimin e shitjes së naftës bruto, Bankers shprehet se kjo analizë nuk do i shërbejë kuptimit të përcaktimit të çmimit të shitjes së naftës bruto, pasi përlllogaritja e çmimit nuk bazohet në një metodë tipike kosto plus marzh fitimi, por vetëm nga kushtet e tregut.
49. Lidhur me këtë kërkesë të Bankers vlerësojmë se në funksion të hetimit, i cili ka për objekt tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto nga ndërmarrja Bankers Petroleum Albania Ltd, është e domosdoshme paraqitja e kontratave/nënkontratave të shërbimit me objekt kryerjen e operacioneve hidrokarbure, ku përfshihet ndër të tjera edhe prodhimi i naftës bruto si treg produkti nën hetim, si dhe analiza e kostos së produktit naftë bruto.

Referuar sa më sipër sjellja e ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd mund të përbëjë një abuzim me pozitën dominuese që zotëron kjo ndërmarrje, në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jemi para shkeljes së nenit 9, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, nenin 26 dhe nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Hapjen e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto.
2. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 31 tetor 2019.
3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 656, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Krujë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Krujë ” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Krujë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 372 prot., datë 02.10.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr.72 prot.,datë 01.10.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Krujë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Krujë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
3. ERRU thekson që ndërmarrja “UK Krujë” SHA aplikon tarifa të miratuara dhe të pamiratuara nga ERRU të diferencuara, për të gjithë zonën e shërbimit dhe kërkon ndryshimin e tarifave për të gjithë zonën pas riorganizimit bazuar në:
 - Vendimit nr. 13 datë 30.05.2007,
 - Vendimin nr.15 datë 23.04.2004 me vlefshmëri deri në datë 30.04.2005 të UK Fushë Krujë SHA.
 - Tarifimi për Njësinë Administrative Bubq, një pjesë e Njësisë Administrative Nikël dhe Njësinë Administrative Kodër Thumanë janë shërbyer në furnizimin me ujë nga UK Durrës SHA.

4. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja ka aplikuar tarifën e vitit 2004, vitit 2007, pra një tarifë prej 28 lek/m³ edhe 33 lek/m³ në varësi të zonave respektive. Tarifa e propozuar, për zonën e riorganizuar është 35 lek/ m³. Kjo tarifë e propozuar pëson një rritje nga 6% deri në 25% më shumë se tarifa aktuale e miratuar nga ERRU. Kjo vlerë është propozuar nga ERRU të jetë 35 lek/ m³ për të gjithë zonën e shërbimit të furnizimit me ujë.
5. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Krujë SHA, propozon rritje të tarifave që për konsumatorin familjar në të gjitha zonën do të jetë në vlerën 35 lek/m³, pra duke pësuar një rritje që varion nga 2 lek/m³ deri në 7 lek/m³; tarifa për konsumatorët publik pëson një rritje nga 20 lek/m³ deri në 40lekë/m³ për të gjithë zonën pas riorganizimit, ndërsa për konsumatorët privatë rritja është 40 lekë/m³. Propozohet ndryshim i tarifës fikse duke pësuar një rritje nga 0lek/muaj/lidhje deri në 50lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, një rritje nga 0 lekë /muaj/ lidhje deri në 100 lek/ muaj/ lidhje të tarifës aktuale, rritet tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, propozohet një rritje me 0lek/ m³ deri në 4lekë/m³ për konsumatorin familjarë, 0 lekë/m³ deri në 2lekë/m³ për konsumatorin publik dhe për konsumatorin privat nuk ndryshon tarifa volumetrike e KUN².
6. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva vështirësisht të arritshme për vitin 2019, të cilat synojnë përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, arritjen e objektivave real në drejtim të reduktimit të kostos së mirëmbajtjes dhe operimit, menaxhimin e uljes së humbjeve teknike dhe administrative, si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, transparencën në përfitimin dhe shlyerjen e investimeve deri të tanishme, rritjen e efikasitetit në faturime nëpërmjet task forcës.
7. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Krujë SHA pas riorganizimit nuk arrin të mbulojë kostot e operimit mirëmbajtjes pasi ajo është 58.5% dhe parashikohet të jetë në masën 76.6 % në vitin 2019. UK Krujë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që janë nën nivelin 100% të mbulimit të kostos së operimit dhe mirëmbajtjes.
8. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Krujë SHA paraqet nivel administrimi jo të mirë për vitin 2019, por do të përmirësojë nivelin e lartë të humbjeve që shkaktohen për shkak të numërit të lartë të lidhjeve nga 66% në 62% nëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza për reduktimin e humbjeve. Ndërmarrja UK Krujë SHA duhet të mbajë në kontabilitet të ndara sipas llojit të shërbimit të ofruar kostot përkatëse, me qëllim që edhe tarifën të orientohen drejt kostove.
9. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Krujë SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duhet të angazhohet seriozisht në fushata ndërgjegjësimi, për të bindur banorët që përfitojnë ilegalisht shërbimin e furnizimit me ujë, për t'u paraqitur në zyrat e UK Krujë SHA, për t'u bërë klient të ligjshëm pasi çdo shërbim duhet paguar; duke angazhuar stafin për eliminimin e lidhjeve të paligjësme, vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasinë e ujit që nuk maten, mbi sasinë e autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë zërat e tij. Gjithashtu, të gjitha pikat e prodhimit edhe pikat kryesore të rrjetit duhet të pajisen me matës të mëdhenj me qëllim zbatimin e një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë dhe çdo muaj.
10. Tarifën duhet të jenë të orientuara drejt kostos, me synimin e arritjes së fitimeve të arsyeshme të ndërmarrjes UK Krujë SHA, e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

² Aktualisht këto tarifa aplikohen vetëm për zonën e qytetit, për klientët që përfitojnë nga shërbimi i kanalizimeve.

11. Duke qenë se ndërmarrja nuk ka instaluar matësa në prodhim, në pikat kryesore të rrjetit, niveli i humbjeve administrative dhe real është shumë i lartë, rekomandohet të analizojë historikun e debisë, hedhja në databazë, në librin e llogarive të gjitha investimet e përfituara në vite si asete të ndërmarrjes si edhe të analizoj detyrimin që rezulton nga mos pagimi i faturave të shërbimeve ndaj UK Krujë SHA. UK Krujë SHA duhet të hartojë një plan të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura. Gjithashtu, duhet të menaxhojë saktë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj furnitorëve me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatë vonesat duke përfituar edhe nga subvencionet e alokuara nga Qeveria. Të gjitha investimet duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
12. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Krujë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Krujë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Krujë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura gjithashtu dhe kostot për shërbimin e ofruar me ngritje mekanike apo me rënie të lirë.
13. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).
14. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, gjithashtu është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit.

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Krujë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjiellës Kanalizime Krujë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos përfshirë dhe kontabilizimin e investimeve të financuara. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 657, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Vlorë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Vlorë ” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Vlorë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 361 Prot., datë 26.09.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr.73 prot.,datë 01.10.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vlorë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
3. ERRU thekson që shoqëria “UK Vlorë” SHA aplikon tarifa të miratuara nga ERRU të diferencuara, për të gjithë zonën e shërbimit dhe kërkon ndryshimin, por jo unifikimin e tarifave për të gjithë zonën pas riorganizimit bazuar në :
 - Vendimi nr. 11 datë 15.03.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ndërmarrjen UK Vlorë SHA”.
 - Vendimi nr. 46 datë 26.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ndërmarrjen U Orikum SHA”.

- Vendimi nr. 52 datë 10.12.2010 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ndërmarrjen U Novoselë SHA”. NJA Shushicë dhe NJA Qendër Vlorë aplikon tarifa të miratuara nga ish këshillat e komunave, pasi nuk u ofrohej shërbim nga asnjë ndërmarrje UK.
- 4. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja ka aplikuar tarifën e vitit 2011 (25 lek/m³ si edhe 33 lek/m³). Tarifa e propozuar për zonën e riorganizuar është 50 lek/m³ duke pësuar një rritje nga 36% deri në 80% më shumë se tarifa aktuale e miratuar nga ERRU. Kjo vlerë është propozuar nga ERRU të jetë 45 lek/m³ për të gjithë zonën e shërbimit të furnizimit me ujë.
- 5. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, propozon rritje të tarifave për të mundësuar ndryshimin e tyre të ligjësuar, për konsumatorin familjar në të gjitha zonat në vlerën 45 lek/m³, duke pësuar një rritje që varion nga 12 lek/m³ deri në 20 lek/m³ për konsumatorët familjarë; tarifa për konsumatorët publik pëson një rritje nga 30 lek/m³ deri në 50lekë/m³ për të gjithë zonën pas riorganizimit, ndërsa për konsumatorët privatë rritja varion nga 20 lekë/m³ deri në 30 lekë/m³. Propozohet ndryshim i tarifës fikse duke pësuar një rritje nga 20lekë/muaj/lidhje deri në 100lekë/muaj/lidhje për konsumatorin familjar, një rritje nga 50 lekë /muaj deri në 150 lek/ muaj/ lidhje të tarifës aktuale, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat rritet. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, propozohet një rritje me 4 lek/ m³ deri në 15lekë/m³ për konsumatorin familjarë, 12 lekë/m³ deri në 25lekë/m³ për konsumatorin publik dhe për konsumatorin privat.
- 6. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 dhe vitin 2020 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, transparencën në përfitimin e investimeve, rritjen e efikasitetit në faturime dhe menaxhimin e humbjeve teknike.
- 7. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezultojnë se ndërmarrja Ujësjetllës KanalizimeVlorë SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 107 % gjatë 2019. UK Vlorë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që tentojnë të mbulojnë mbi nivelin 100% kostot e operim & mirëmbajtjes.
- 8. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA për vitin 2019 do të përmirësojë nivelin e lartë të humbjeve nga 77.1 % në75.9 % njëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza për reduktimin e humbjeve të cilat ndikojnë në përmirësimin e performancës financiare. Ndërmarrja UK Vlorë SHA duhet të mbajë në kontabilitet të ndara sipas llojit të shërbimit të ofruar kostot përkatëse, me qëllim që edhe tarifën të orientohen drejt kostove.
- 9. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasinë e ujit që nuk maten, mbi sasinë e autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë zërat e tij. Gjithashtu, të gjitha pikat e prodhimit edhe pikat kryesore të rrjetit duhet të pajisen me matësa të mëdhenj me qëllim zbatimin e një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë dhe çdo muaj.
- 10. Tarifën duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Vlorë SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.

11. Duke qenë se ndërmarrja nuk ka instaluar matësa në prodhim, në pikat kryesore të rrjetit, niveli i humbjeve administrative dhe real është shumë i lartë, rekomandohet të analizojë historikun e debisë nga mos pagimi i faturave të shërbimeve UK, si edhe të hartojë një plan të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura. Gjithashtu, duhet të menaxhojë saktë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj furnitorëve me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatë vonesat duke përfituar edhe nga subvencionet e alokuara nga Qeveria. Të gjitha investimet duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
12. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Vlorë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura gjithashtu dhe kostot për shërbimin e ofruar me ngritje mekanike apo me rënie të lirë.
13. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
14. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, gjithashtu është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit.

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 658, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Himarë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Himarë” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjellës Kanalizime Himarë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 364 Prot., datë 27.09.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr.76 prot., datë 06.11.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Himarë, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Himarë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
 - ERRU thekson që shoqëria “UK Himarë” SHA aplikon për herë të parë “Për miratimin e nivelit tarifor të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura”. Tarifatat që aplikohen aktualisht nuk janë të miratuara nga ERRU, por janë të miratuara me Vendimin nr.144 datë 23.02.20148 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Himarë.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,* aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja ka aplikuar tarifatat e vitit 2017 (40 lek/m³ si edhe 50 lek/m³). Tarifa e propozuar për zonën e riorganizuar është e njëjtë me tarifën e aplikuar, por të pamiratuara nga ERRU në vitin 2018 (60 lek/m³), dukshëm një rritje prej 50% për zonat e shërbimit për furnizimin me rënie të lirë dhe 10% për zonat e shërbimit për furnizim me ngritje

mekanike. Kujtojmë që shoqëria aplikon për herë të parë për miratimin e nivelit tarifor të shërbimit të UK nga ERRU.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Himarë SHA, propozon rritje të tarifave për të mundësuar unifikimin e tyre të ligjësuar, për konsumatorin familjar në të gjitha zonat në vlerën 60 lek/m³, duke pësuar një rritje që varion nga 10 lek/m³ deri në 20 lek/m³ për konsumatorët familjarë; tarifa për konsumatorët publik pëson një rritje prej 50 lekë/m³ deri në 60 lekë/m³ për të gjithë zonën pas riorganizimit, ndërsa për konsumatorët privatë rritja varion nga 20 lekë/m³ deri në 30 lekë/m³. Propozohet ndryshim i tarifës fikse duke pësuar një rritje me 100lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar me një rritje 100% të tarifës aktuale, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat rritet me 200 lekë/m³ dhe 100 lekë/m³ respektivisht. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, propozohet një rritje me 10 lekë/m³ për konsumatorin familjarë, 20 lekë/m³ deri në 30 lekë/m³ për konsumatorin publik dhe një ulje prej 10 lekë/m³ për konsumatorin privat.
5. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 dhe vitin 2020 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e mundësisë për shlyerjen e investimeve të deritanishme.
6. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Himarë SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 109 % gjatë 2019. UK Himarë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që tentojnë të mbulojnë mbi nivelin 100% kostot e operim & mirëmbajtjes.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Himarë SHA për vitin 2019 do të përmirësojë nivelin e lartë të humbjeve nga 74 % në 67 % nëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza për reduktimin e humbjeve të cilat ndikojnë në përmirësimin e performancës financiare. Ndërmarrja UK Himarë SHA duhet të mbajë në kontabilitet të ndara sipas llojit të shërbimit të ofruar kostot përkatëse, me qëllim që edhe tarifatat të orientohen drejt kostove.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Himarë SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasitë e ujit që nuk maten, mbi sasitë e autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë zërat e tij. Gjithashtu, të gjitha pikat e prodhimit edhe pikat kryesore të rrjetit duhet të pajisen me matësa të mëdhenj me qëllim zbatimin e një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë dhe çdo muaj.
9. Tarifatat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Himarë SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se ndërmarrjes nuk i është marrë në konsideratë viti 2017 për shkak se në "Pasqyrat Financiare 2017" nuk janë zbatuar Standardet Kombëtarë të Kontabilitetit (SKK), rekomandohet të analizojë historikun e debisë nga mos pagimi i faturave të shërbimeve UK, si edhe të hartojë një plan të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura. Gjithashtu, duhet të menaxhojë saktë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj furnitorëve me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatë vonesat duke përfutur edhe nga subvencionet e alokuara nga Qeveria. Të gjitha investimet duhet të jenë sa më transparente, të

përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.

11. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Himarë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Himarë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Himarë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura gjithashtu dhe kostot për shërbimin e ofruar me ngritje mekanike apo me rënie të lirë.
12. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
13. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, gjithashtu është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e unifikuar që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Himarë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kërkojë nga Ujësjetllës Kanalizime Himarë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 662, Datë 21.11.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me vendimin nr. 620, datë 13.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë” ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e Arsimit të Lartë, për periudhën kohore nga 1 janari 2017 deri në përfundim të procedurave hetimore. Raporti i hetimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit ka lindur nevoja për informacione mbi burimet e të ardhurave të IAL-ve; rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave; cila është pjesa e buxhetit për mësimin, kërkimin, zhvillimin e personelit, pagat; metodologjinë e llogaritjes së kostos studimeve, tarifës së studimit; kostos së programit të studimit; politikën dhe procedurën e dhënies së bursave; politikën e pagave të IAL-ve dhe strukturën e të punësuarve; etj, informacione këto të nevojshme për kryerjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë.
3. Bazuar sa më sipër, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në Sektorin e Arsimit të Lartë, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin nën hetim, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, afati i përcaktuar në pikën “3”, shtyhet me 2 (dy) muaj.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 667, Datë 24.12.2019

“Për mbylljen procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënia e disa rekomandimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënia e disa rekomandimeve.

Baza ligjore: Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 43, pika (5) dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Gjatë dy viteve të fundit, pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë paraqitur disa ankesa për sjelljen e operatorëve të shërbimit taksi në qytetin e Tiranës lidhur me caktimin e çmimeve dhe tarifave.
2. Sindikata Shqiptare e Taksive; Shoqata “Taksitë e klasit të parë”; shoqëria “Merr Taxi”, operatori V. Bushi si dhe disa subjekte që operojnë në shërbimin taksi kanë paraqitur disa ankesa dhe kërkesa të cilat konsistojnë në sjelljen e operatorëve të shërbimit taksi në qytetin e Tiranës, lidhur me caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi në qytetin e Tiranës. Ata pretendojnë se subjekti “Green Taxi” ushtron aktivitetin e tij në shërbimin taksi (4+1 vende) duke përdorur instrumente matëse (taksimetër) të verifikuar në kundërshtim me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 28.02.2013. Lidhur me këtë sjellje të subjektit “Green Taxi”, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka konstatuar se ky subjekt, për periudhën 01.11.2017 deri më 01.11.2018, ka zbatuar tarifën prej 200 lekë për 1.5 km e para, ndërkohë që operatorët e tjerë në treg kanë zbatuar tarifën tavan (maksimale) prej 250 lekë për 1.5 km e para.
3. “Green Taxi”, i është drejtuar Bashkisë Tiranë për kalibrimin e taksimetrit nën nivelin e tarifave të miratuara me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 30.03.2009, të ndryshuar. Bashkia Tiranë nisur nga kjo kërkesë, ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për kolaudimin e taksimetrit për mjetet e kompanisë “Green Taxi” me “tarifë fillestare” për ditët e zakonshme të javës, me tarifë 50 lekë më të ulët nga tarifa tavan e miratuar për 1.5 km e parë; dhe “tarifë fillestare” për ditët e pushimit dhe festave zyrtare dhe për udhëtimet natën, me tarifë 50 lekë më të ulët nga tarifa tavan e miratuar për 1.5 km e parë.

4. Sipas pretendimeve të “Green Taxi”, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) ka refuzuar kërkesën e tij për kalibrimin e taksimetrave për flotën e makinave të saj në vlerën 200 lekë për tarifën fillestare, me arsyetimin se vendosja e një tarife fillestare më pak se 250 lekë është në shkelje të ligjeve në fuqi dhe dëmton konkurrencën me operatorët e tjerë të shërbimit taksi në Tiranë.
5. Në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, dhe udhëzimit të përbashkët të MPPTT (sot MIE) dhe MF, nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi”, Këshilli Bashkiak i Tiranës me vendimin nr. 3, datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës”, i ndryshuar, ka miratuar çmimet dhe tarifatat maksimale (tavan) të shërbimit taksi (4+1 vende dhe 8+1 vende), poshtë të cilave subjektet taksi do të operojnë.
6. Referuar sa më sipër, ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi brenda territorit të Bashkisë Tiranë duhet të aplikojnë tarifa jo më ta larta se niveli i përcaktuar në VKB nr. 3, datë 30.03.2009, të ndryshuar, dhe në bazë të Udhëzimit nr. 1726/3, datë 21.04.2008, taksistët janë të lirë që të kalibrojnë taksimetrat e tyre me tarifa poshtë vlerës maksimale duke zgjedhur tarifa më të ulëta, si dhe t’u japin klientëve mundësinë e negocimit për uljen e këtyre pagesave.
7. Nga vlerësimi i ankesave, Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 4, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 690, datë 10.04.2019 vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, për periudhën kohore 1 Janar 2018 - 31 Mars 2019.
8. Në bazë të nenit 22 të Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 223/5, datë 07.05.09, u ngrit grupi i punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
9. Grupi i punës në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar u pajis me Autorizimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 223/4 prot., datë 17.04.2019 “Autorizim Inspektorësh”.
10. Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës.
11. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit” (DPKM) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.
12. Nga administrimi i të dhënave rezultoi se koha e mbetur në dispozicion nga mungesa e informacionit të kërkuar është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 609, datë 10.04.2019.
13. Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2016 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me anë të Vendimit nr. 639, datë 08.07.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 609, datë 10.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës”, vendosi për të shtyrë afatin e përgatitjes dhe dorëzimit të raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 14 Tetor 2019.

II. Analiza e Konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

14. Në bazë të nenit 3, pika 7 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përbëhet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
15. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensionet:
- Tregu përkatës i produktit
 - Tregu përkatës gjeografik
16. Transporti rrugor i udhëtarëve në qytetin e Tiranës ofrohet nga individ - persona fizik, dhe subjekte juridike të cilët përshkruajnë intenerare të ndryshme, në kohë të ndryshme brenda qytetit të Tiranës. Shërbimi taksi është shërbim publik që siguron një transport të menjëhershëm e të drejtpërdrejtë të udhëtarëve dhe bagazheve të tyre. Rregullat dhe kushtet e veçanta për taksitë, si dhe zbatimi i tarifave dhe të çmimeve, përcaktohet në nenin 36 të udhëzimit nr. 1726/3, datë 21.4.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi”.
17. Tregu përkatës i produktit përfshin tregun e shërbimit të transportit me taksi (4+1) vende në qytetin e Tiranës.
18. Tregu përkatës gjeografik përfshin qytetin e Tiranës, në të cilin ushtrohet aktiviteti i shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1) nga individ/persona fizik dhe subjekte juridike, për linja të përshkuara brenda qytetit të Tiranës.

II.2 Subjektet fizike dhe juridike në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1)

19. Bazuar në Vendimin nr. 609, datë 10.04.2019 të Komisionit të Konkurrencës, “Për Hapjen e Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1) në qytetin e Tiranës, ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, si dhe organizatat apo shoqatat ku ata janë anëtarë ose aderojnë, në zbatim të neneve 35, 36 dhe 38 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ndërmarrjet nën hetim të cilat operojnë në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1) në qytetin e Tiranës janë pasqyruar në Tabelën e Aneksit të këtij raporti. Aktualisht shërbejnë 90 subjekte fizike dhe 12 subjekte juridike të licensuara nga 2017 deri në Mars 2019 pranë Bashkisë Tiranë. Konkretisht të specifikuar sipas ndarjes në vite janë:
- Gjatë vitit 2017 janë licensuar 27 taksi individ; dhe 4 person juridik me 45 makina në pronësi të tyre.
 - Gjatë vitit 2018 janë licensuar 49 taksi individ; dhe 6 persona juridik me 38 makina në pronësi të tyre.
 - Gjatë vitit 2019 janë licensuar 14 taksi individ; dhe 2 person juridik me 36 makina në pronësi të tyre.
 - Gjithsej nga 2017 deri në 2019 janë licensuar 90 taksi për individ me NIPT-et përkatëse dhe 12 subjekte juridike me 119 taksi.
20. Në tregun e taksive në qytetin e Tiranës, ushtrojnë aktivitetin 891 subjekte fizike dhe juridike të licensuar, nga të cilat disa janë të regjistruara në DPT dhe realizojnë një xhiro vjetore të matshme, ndërsa të tjerë nuk janë të regjistruar, për këtë arsye përcaktimi i pozitës dominuese të ndërmarrjeve në këtë treg, në pjesët

përkatëse të tyre, është i pamundur.

21. Për sa më sipër në kuptim të nenit 8 të Ligjit nr. 9121/2003, nuk vlerësohet me pozitë dominuese asnjë ndërmarrje që operon në tregun e shërbimi të transportit të udhëtarëve me taksi (4+1) në qytetin e Tiranës.

II.3 Kuadri ligjor i transportit rrugor

22. Sipas VKB nr. 2, datë 30.03.2009 “Miratimi i rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës”, Taksi është mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me vende të ulura jo më pak se 4 dhe jo më shumë se 8, përveç atij të drejtuesit të automjetit, që ka jo më pak se katër dyer për autoveturat dhe jo më pak se tre dyer funksionale për mikrobuzët dhe është i pajisur me taksimetër.

23. Transporti rrugor në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (ligji nr. 8308/1998), i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

24. Transporti i udhëtarëve me taksi përcaktohet në Kreun II.4 të Ligjit nr. 8308/1998 dhe në bazë të nenit 35 të tij, Këshilli Bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet dhe licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

25. Licenca për shërbimin taksi jepet me afat 5 vjet, me të drejtë rinovimi automatikisht, kur subjekti ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

26. Lidhur me tarifën sipas nenit 36 të ligjit nr. 8308/1998 është përcaktuar se “Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave. Niveli dysHEME i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse).

27. Në Udhëzimin e Ministrisë nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi”, pika (V), parashikohen rekomandime mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave nga këshilli bashkiak.

28. Në pikën (V.5), rekomandohet që tarifën e pagesës të përfaqësojnë një vlerë maksimale dhe nuk duhet të vendosen tarifa pagese fikse ose minimale. Për këtë, taksistët janë të lirë që të kalibrojnë taksimetrat e tyre me tarifa poshtë vlerës maksimale duke zgjedhur tarifa më të ulëta, si dhe t’u japin klientëve mundësinë e negociimit për uljen e këtyre pagesave.

29. Referuar kreut V, pikës 3, këshilli bashkiak merr vendimin në caktimin e vlerave dhe tarifave, që përfshin vlerën e tarifës fillestare, në përputhje me formulën e pranuar nga të dyja palët, bashkia dhe përfaqësuesit e shërbimit taksi. Vlerat e tarifave rishikohen në mënyrë të rregullt çdo vit.

30. Sipas kreut V, pika 6 këtij udhëzimi është përcaktuar se Bashkia, pas vendimit të marrë nga këshilli bashkiak në lidhje me caktimin e vlerave të tarifave, njofton DPKM, Inspektoratin e Kontrollit Rrugor në Rrugë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policinë rrugore, Policinë tatimore, si edhe njofton komunitetin e tij me anë të mediave me shkrim dhe asaj elektronike lokale të paktën dy javë para vendimit.

31. Kreu V, pika 7, Bashki të ndryshme mund të kenë nivel të ndryshëm çmimesh, të cilat varen nga një numër faktorësh lokalë, si: pranimi i diskutimeve të çmimit nga taksistët, niveli i jetesës së përdoruesve të taksisë, si edhe koston e shërbimit të taksive”.

32. Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.03.2009 “Miratimi i rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar, numri i licencave për automjetet e shërbimit taksi 4+1 për qytetin e Tiranës është i pakufizuar.
33. Referuar nenit 21, të Udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar:
- Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse.
 - Këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit taksi brenda juridiksionit të vet.
 - Licenca për këtë veprimtari lëshohet për persona fizikë dhe juridikë. Transporti i udhëtarëve me taksi sigurohet nëpërmjet:
 - a. shërbimit taksist - pronar, kur subjekti zotëron si pronë një autoveturë taksi;
 - b. shërbimit ndërmarrje (kompani) – taksish, kur subjekti zotëron si pronë ose të huazuar më shumë se një autoveturë taksi. Në këtë rast subjekti është person juridik.
 - Subjekti paraqet:
 - a. Dokumentin për verifikimin dhe plumbosjen e taksimetrit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK).
34. Bazuar në Udhëzimin nr. 12, datë 19.07.2007, për “Përcaktimin e numrit të auto veturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licensave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrin të shërbimit taksi”, i ndryshuar, Zyrat e transportit në bashki dërgojnë, pranë degëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në rrethe, listën me emrat e subjekteve transportuese në shërbimin taksi, të përzgjedhur për t'u licencuar, për vendosjen, kolaudimin dhe pumbosjen e taksimetrit të shoqëruar me numrin e serisë për çdo subjekt.
35. Me VKB nr. 3 datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak ka miratuar caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës ku tarifa fillestare për 1.5 km e para është 250 lekë.
36. VKB nr. 74, datë 7.10.2016 “Për disa ndryshime në vendimin e këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.03.2009 “Mbi Miratimin e rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar, sipas pikës (XVI) neni 39 është ndryshuar duke përcaktuar se;
- Transporti i udhëtarëve në shërbimin taksi 4+1 dhe 8+1 vende, lejohet vetëm me mjete të destinuara për transport udhëtarësh. Subjektet që i nënshtrohen licensimit, mjete duhet të plotësojnë një nga kriteret e mëposhtme:
 - Për çdo aplikim të ri, mjete duhet të jetë i prodhuar (i) jo më shumë se dy vite nga viti i aplikimit për licensë për personin/at fizik dhe (ii) në të njëjtin vit me vitin e aplikimit për licensim për shoqërinë/të tregtare, si dhe specifikat teknike të mjetit/ve duhet të plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:
 - a) Të jetë “Euro 6” ose e një standardi më të ri (nëse vendoset një i tillë)
 - b) Të jetë “Elektrike”
 - c) Të jetë “Hibrid”
 - Në rastet e rilicensimit mjete nuk mund të jetë më i vjetër se 15 vite nga viti i aplikimit për rilicensim.
37. Modeli 105 i Licensës së Taksistit, përmban dispozitat e përgjithshme, nga ku citohet: në pikën 4 të saj:

niveli dysHEME i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus; në pikën 6 të saj: Në vendqëndrimet e taksive të caktuara nga bashkitë merren udhëtarë vetëm nga taksitë që janë nën juridiksionin e tyre.

II.4 Analiza e sjelljes së subjekteve në tregun përkatës

38. Bashkia, pas vendimit të marrë nga këshilli bashkiak në lidhje me caktimin e vlerave të tarifave, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Kalibrimit dhe Metrologjisë, Inspektoratin e Kontrollit në Rrugë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policinë Rrugore, Policinë Tatimore, si dhe njofton komunitetin e tij me anë të mediave me shkrim dhe asaj elektronike lokale të paktën dy javë para vendimit.
39. Këshilli bashkiak i Bashkisë Tiranë përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet dhe nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit & Ministrisë së Financave.
40. Zyrat e transportit në bashki dërgojnë, pranë degëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në rrethe, listën me emrat e subjekteve transportuese në shërbimin taksi, të përzgjedhur për t'u licencuar, për vendosjen, kolaudimin dhe pumbosjen e taksimetrit të shoqëruar me numrin e serisë për çdo subjekt, si edhe përcaktojnë vendndodhjen e tyre.
41. Bashkia Tiranë, pas vendimit të marrë nga Këshilli Bashkiak, është organi i vetëm që licenson subjektet në tregun taksi (4+1) në qytetin e Tiranës dhe përcakton vlerat e tarifave bazuar në VKB dhe Udhëzimet e Ministrive (për t'u zbatuar nga DPKM për kalibrimin e taksimetrave) kjo sjellje e saj ndikon në kushtet e konkurrencës në treg.
42. Bashkia Tiranë nuk ka bërë transparente në faqen e saj zyrtare (online) listën e mjeteve të licensuara si edhe tarifatat përkatëse të kërkuara për kalibrim nga subjekte të ndryshme.
43. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesave dhe kërkesave të paraqitura, si dhe informacionit të depozituar lidhur me to, rezulton se, pavarësisht se taksistët janë të lirë që të kalibrojnë taksimetrat e tyre me tarifa poshtë vlerës maksimale të miratuar, duke zgjedhur tarifa më të ulta, pothuajse të gjitha ndërmarrjet që operojnë në tregun e transportit të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës, zbatojnë tarifën fillestare prej 250 lekë për 1.5 km e para, përveç ndërmarrjes “Green Taxi” shpk e cila zbaton tarifën 200 lekë për 1.5 km e para.
44. Kërkesa e ndërmarrjes “Green Taxi” shpk për uljen e tarifave kundrejt çmimeve të caktuara në VKB nr. 3, datë 30.03.2009, i ndryshuar dhe realizimi i kolaudimit të taksimetrit me këtë vlerë të kërkuar kjo ndërmarrje dhe vepruar nga DPKM, i ka vendosur në kushte të pa barabarta ofruesit e shërbimit të transportit taksi.
45. Kriteret e vendosura nga Bashkia Tiranë në VKB nr. 2, datë 30.03.2009, i ndryshuar, mund të kufizojnë hyrësit e rinj në treg dhe mund të mbartin një kosto të lartë të hyrësve në treg. Caktimi i nivelit të tarifave dhe çmimeve duhet të bazohet në standartet e jetës që kanë sot banorët e qytetit të Tiranës.
46. Nga hetimi është konstatuar se ka disa subjekte që nuk janë të licensuara nga Bashkia Tiranë, realizojnë aktivitetin duke ndikuar në tregun e taksive, gjithashtu ka taksi të cilat janë në listën e verifikuar të kalibrimit dhe plumbosjes së taksimetrit nga DPKM, por nuk janë të regjistruar në DPT. Bashkia Tiranë dhe DPKM, në lidhje me kolaudimi e tarifës fillestare për 1.5 km e para, nuk i kanë dhënë mundësi të barabartë ndërmarrjeve konkurruese tregun e shërbimit taksi (4+1) të rishikojnë tarifatat fillestare. Kalibrimi i taksimetrave me një tarifë të ndryshme nga ajo e miratuar me VKB nr. 3, datë 30.03.2009, i ndryshuar, i

ka vendosur operatorët taksi në kushte të padrejta dhe të ndryshme të tregtimit.

47. Ky treg nuk është i rregulluar, Udhëzimet dhe VKB në fuqi bien në kundërshtim me njëra tjetrën lidhur me caktimin e vlerave të tarifave, nëse ajo është tavan apo dysheme. Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 1726/3, datë 21.04.2008, i ndryshuar përcakton tarifën fillestare dysheme jo më të vogël se dyfishi i tarifës së transportit publik, d.m.th. jo më të vogël se 320 lekë, ndërsa VKB nr. 3, datë 30.03.2009, i ndryshuar, përcakton tarifë fillestare 250 lekë/1.5km e para, dhe nuk e përcakton nëse është tavan apo dysheme. Referuar Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 1726/3, datë 21.04.2008 dhe Formatit të Licensave të taksistëve, rezulton se në pjesën e mbrapme të formatit ka dispozita të përgjithshme, ku vlera fillestare është përcaktuar si vlerë jo më të vogël se dyfishi i tarifës së transportit publik.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 8, nenin 9 dhe nenin 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në Tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës;
2. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave:
 - a. Të rishikojë dhe përditësojë Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave), nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi” dhe unifikimin e të gjitha akteve që dalin në zbatim të këtij udhëzimi.
3. T’i rekomandojë Bashkisë Tiranë:
 - a. Respektimin e hierarkisë së akteve normative, pas rishikimit dhe përditësimit të udhëzimit nga MIE dhe MF, duke qenë se Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.
 - b. të kryejë verifikimin e subjekteve transportuese të licensuar në shërbimin taksi, duke bërë transparente në faqen zyrtare listën e të licensuarve dhe të regjistruarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
4. T’i rekomandojë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) të kryejë plumbosjen e taksimetrit sipas tarifës së përcaktuar nga Vendimi i Këshillit Bashkiak për të gjithë ndërmarrjet e licensuara që operojnë në tregun e taksive të shoqëruar me numrin e serisë për çdo të licensuar dhe verifikimin e tyre periodik (brenda vitit).
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 669, Datë 24.12.2019

**“Për vijimin e hetimit të hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018
“Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për vazhdimin e procedurës së hetimit të përgjithshëm në shërbimin spitalor, hapur me Vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar, të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vijimin e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”, vendosi fillimin e procedurës së vlerësimit të konkurrencës në shërbimin spitalor i cili përfshin shërbimin spitalor publik dhe shërbimin privat.

Për vlerësimin e konkurrencës në treg (përcaktimin e strukturave të tregut, kryerjen e analizës së sjelljes, kryerjen e analizave statistikore-ekonomike për të gjithë shërbimet shëndetësore), bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacione në mënyrë shkresore nga: Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake, Spitalet Private si dhe institucionet; Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor, përgjigjet e të cilave kanë qenë pjesërisht të plota

Komisioni e Konkurrencës, në mbledhjen e datës 17 tetor 2019, shqyrtoi raportin e realizuar mbi vlerësimin e konkurrencës në shërbimin spitalor nga ku u konkludua se vlerësimi i tregut kërkon analiza shtesë.

Për të realizuar një vlerësim më të thelluar të tregut të shërbimeve spitalore, kërkohet administrim i të dhënave shtesë nga ofruesit e shërbimit dhe shtrirja e analizës për një periudhë më afatgjatë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d dhe nenit 41, pika 1 e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Vijimin e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor hapur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar
2. Hetimi do të përfshijë periudhën kohore shtesë nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019.
3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 672, Datë 24.12.2019

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”.

Baza ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 41 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar me vendimin nr. 620, datë 13.05.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë” ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e Arsimit të Lartë, për periudhën kohore nga 1 janari 2017 deri në përfundim të procedurave hetimore. Raporti i hetimit të përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit, në përgjigje të shkresës sonë nr. 647 prot., datë 21.11.2019 “Kërkesë për informacion” drejtuar Institucioneve të Arsimit të Lartë në vend, pjesa më e madhe e Institucioneve të Arsimit të Lartë kanë kërkuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të informacionit të kërkuar për shkak të situatës së krijuar në vend pas tërmetit të 26.11.2019. Sa më sipër, me shkresën nr. 647 prot., datë 21.11.2019, IAL-ve që kishin kërkuar shtyrje afati dhe atyre që nuk kishin sjellë akoma informacion, iu vu në dispozicion një afat tjetër për dorëzimin e informacionit të kërkuar, përkatësisht data 18.12.2019. Deri më tani rezulton se nga 39 IAL publike dhe private, vetëm 17 prej tyre kanë sjellë informacionin e kërkuar.
3. Bazuar sa më sipër, në kushtet e mungesës së informacionit për pjesën më të madhe të IAL-ve publike dhe private me qëllim vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin e Arsimit të Lartë, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të përgjithshëm me qëllim kryerjen e një analize të plotë të konkurrencës në sektorin nën hetim, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 573, datë 26.11.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, afati i përcaktuar në pikën “3”, shtyhet me 6 (gjashtë) muaj.
 2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT – PËRQENDRIME

VENDIM

Nr. 580, Datë 17.01.2019

“Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi rastin e përfimit të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD SKOPJE,

VËREN SE:

I. Procedura dhe përqendrimi

Përfaqësuesi ligjor i palës blerëse ka njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës transaksionin në lidhje me shitblerjen e 98.83% të kuotave të Tirana Bank, nga Piraeus Bank S.A te Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje.

Palët në transaksion janë:

Blerësi 1: Balfin SHPK, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rrugën “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa nr.12, kati 11, Zyra nr.1206, Njësia bashkiake nr.2, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nuis; K72223031K. Sipas të dhënave të QKB, shoqëria është themeluar në vitin 2007 me objekt të veprimtarisë investime me pjesëmarrje në kuota; shërbim konsulence në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave dhe informatikës; menaxhim i qendrave tregtare, bareve dhe restoranteve; import-eksport, shitje me shumicë dhe pakicë e produkteve tekstile dhe veshjeve të të gjitha llojeve, e pajisjeve elektrike, elektronike, lëndë e parë për industrinë; tregtim i artikujve të ndryshëm; transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit etj.

Sipas të dhënave të depozituara nga shoqëria, Balfin SHPK nëpërmjet paketave kontrolluese të shoqërive në Shqipëri, zotëron përkatësisht: XX të tregut të nxjerrjes së mineralit të ferrokromit nëpërmjet shoqërisë [...]

SHPK dhe XX% të tregut të nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK; XX% të tregut të shitjes së pajisjeve elektronike nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK; XX% të tregut të shitjeve online të produkteve jo ushqimore realizuar nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK; XX% të tregut të administrimit dhe dhënies me qera të hapësirave tregtare nëpërmjet shoqërive [...] SHPK; XX% të tregut të shitjes më pakicë të artikujve ushqimore nëpërmjet shoqërisë [...]; XX% të tregut të blerjes dhe shitjes së energjisë nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK; XX % të tregut të speditimit detar nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK, si dhe disa ndërmarrje të tjera më pjesë më të vogël tregu.

Shoqëria Balfin SHPK ka shtrirë aktivitetin e saj nëpërmjet shoqërive të kontrolluara në tregun ndërkombëtar, kryesisht në Kosovë dhe Maqedoni. Shoqëria zotëron XX% të tregut të shitjes me pakicë dhe shumicë të pajisjeve elektronike dhe elektroshtëpiake, nëpërmjet shoqërisë [...] në Maqedoni; XX% të tregut të shitjes të pajisjeve elektronike dhe elektroshtëpiake, nëpërmjet shoqërisë [...] SHPK; XX% të tregut të shërbimeve të servisit të pajisjeve elektronike dhe elektroshtëpiake në Maqedoni nëpërmjet [...].

Blerësi 2: Komercijalna Banka AD Shkup, me numër regjistri tregtar 4065573, me seli në Orce Nikolov Str. No.3, 1000, Shkup, Maqedoni. Komercijalna Banka AD Shkup, Maqedoni është themeluar në vitin 1955 dhe aktivitetet financiare të kësaj banke, sipas ekstraktit të shoqërisë, përfshijnë mbledhjen e depozitave dhe burimeve të tjera të fondeve të kthyeshme; kreditimin në vend, duke përfshirë faktorizimin dhe financimin e transaksioneve tregtare; lëshimin dhe administrimin e mjeteve paguese; lëshimin e parave elektronike; leasing financiar; operacionet e shkëmbimit; operacionet e pagesave në vend dhe jashtë vendit, duke përfshirë edhe blerjen e valutës; transferimin e shpejtë të parave; lëshimin e garancive të pagesave, letrave me vlerë dhe formave të tjera të kolateralit etj.

Nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të saj, kjo bankë zotërohet nga XXX aksionarë të përbërë nga individë dhe entitetet ligjore të huaj dhe lokale. Zotëruesi mazhoritar i aksioneve me XX% është shoqëria [...], e cila operon në fushën e ndërtimeve rezidenciale dhe jo-rezidenciale. Komercijalna Banka është banka e parë në Maqedoni duke zotëruar XX% të tregut në terma të aktiveve dhe XX% të tregut të depozitave.

Shitësi: Piraeus Bank SA, shoqëri aksionare, e themeluar më 6 korrik 1916, me titull dallues “Piraeus Bank”, me numër regjistri të përgjithshëm tregtar 225501000, me seli në Amerikis Street, 10564 Athinë, Greqi. Piraeus Bank S.A është pjesë e Piraeus Bank Grup, i cili ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare tek një numër i madh klientësh në Greqi. Piraeus Bank në Greqi zë XX% të tregut bankar përsa i përket depozitave dhe kredive.

Piraeus Bank, bazuar në udhëzimet e Fondit të Stabilitetit Financiar Helen dhe politikat e brendshme të bankës, duhet të hiqte dorë nga investimet e kryera në vende të tjera, përveç Greqisë³.

Në faqen zyrtare të Piraeus Bank janë evidentuar transaksionet e ndodhura vitin e fundit (2018), pas Planit të Ristrukturimit të miratuar nga BE, lidhur me degët e kësaj banke në rajon, ku evidentohet shitja e të gjitha aksioneve që kjo bankë ka zotëruar (ka patur paketën mazhoritare në këto banka).

Rumani: Në datë 29.06 2018, Piraeus Bank lajmëron se ka përfunduar shitja e Piraeus Bank Romania Acquired tek J.C. Flowers &Co, pas marrjes së miratimit të nevojshëm nga Banka Kombëtare e Rumanisë.

³ Burimi: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-14-870_en.htm, COMMISSION DECISION of 23.07.2014 ON THE STATE AID SA.34826 (2012/C), SA.36005 (2013/NN) implemented by Greece for Piraeus Bank Group relating to the recapitalisation and restructuring of Piraeus Bank S.A.;

Bullgari: Në datë 07.11.2018, Piraeus Bank SA lajmëron se ka hyrë në negociata me synim lidhjen e marrëveshjes midis Eurobank Ergasias SA për shitjen e 99.98% që zotëron në Bullgari, Piraeus Bank Bulgaria AD (“PBB”), tek Eurobank Bulgaria AD.

Shqipëri: Në datë 07.08.2018, Piraeus Bank S.A. lajmëron se ka hyrë në bisedime për lidhjen e një marrëveshjeje me Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka, për shitjen e degës së tyre në Shqipëri, Tirana Bank. Shuma totale është €57.3 mln për pjesën prej 98.83% që Piraeus Bank zotëron tek Tirana Bank.

Shoqëria target: Tirana Bank SHA është një institucion financiar, bankar i nivelit të dytë, themeluar si shoqëri anonime dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: J661924008V, me një kapital të ndarë në 501.975 aksione me vlerë nominale prej 216.24 secili aksion. Kjo bankë është regjistruar më 03.11.1995 dhe është themeluar më 20.10.1995. Piraeus Bank S.A me seli në Greqi zotëron 496,098 aksione që përfaqësojnë rreth 98.829 % të kapitalit të emetuar të Tirana Bank, kurse Z. [...] zotëron 1.171% të kapitalit të Tirana Bank.

Objekti i aktivitetit të kësaj banke përfshin veprimtaritë bankare lidhur me pranimin e depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku, që do të përdoren për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet; emetimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike etj.

Më 3 Gusht 2018 është nëshkruar “Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve” dhe njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës është bërë më 29 Gusht 2018, duke respektuar afatin 30 ditor që përcakton ligji.

Mbështetur mbi raportin e Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 579 datë 20.12.2018 “Për fillimin e procedurës së thelluar në vlerësimin e transaksionit të ndodhur midis Piraeus Bank, si dhe Balfin SHPK e Komercijalna Banka AD Skopje”, vendosi kalimin në procedurën e thelluar të vlerësimit të transaksionit me argumentin se, pavarësisht faktit që tregu bankar në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar pa praninë e bankave me pozitë dominuese dhe Tirana Bank SHA zotëron në një pjesë të vogël në këtë treg, pritet që pas një kohe të shkurtër, Tirana Bank SHA mund të rrisë pjesën e tregut të shërbimeve, pasi të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK do ti orientojnë transaksionet dhe do të marrin shërbime nga Tirana Bank SHA. Kjo situatë mund të sjellë ndikimin e veprimtarisë së Tirana Bank SHA nga veprimtaria ekonomike e shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK, si dhe mundësinë e një sjellje jo konkurruese të Tirana Bank SHA për klientët e tjerë kredi marrës të cilët mund të operojnë në tregje të njëjta më shoqëritë e kontrolluara nga Balfin SHPK.

Për vlerësimin e transaksionit të njoftuar, gjatë muajit dhjetor 2018, Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet përdorimit të instrumentit të RFI-së (*Request for Information*), pjesë e Rrjetit të Konkurrencës për Evropën Juglindore OECD-GVH/RCC, kërkoi nga autoritetet homologe interpretimin e tyre mbi rastin në vlerësim.

Gjithashtu, nëpërmjet korrespondencës me Autoritetin Grek të Konkurrencës u kërkua informacion mbi njoftimin e këtij transaksioni dhe me përgjigjen nr. 690 prot. i AK, datë 13.12.2018, informohemi se ky rast nuk është njoftuar për të filluar procedurat e kontrollit të përqendrimeve pranë agjencisë së tyre.

Në përgjigje të shkresës së Autoritetit të Konkurrencës, nr.484/4 prot., datë 12.12.2018 “Mbi transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë Tirana Bank SHA”, Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 5958/1 prot. datë 21.12.2018, është shprehur se: “Në këtë proces, Banka e Shqipërisë vlerëson se transferimi i pronësisë së aksioneve të Bankës së Tiranës nuk do të ndryshojë pozicionin e saj në treg. Gjithashtu vlerësohet se ky transaksion nuk do të ndikojë negativisht në zbatimin e politikës monetare dhe atë të këmbimeve valutore në zbatuar nga BSH”.

Për realizimin e analizave gjatë procedurës së thelluar, nëpërmjet shkresës nr. 484/9 datë 27.12.2018 “Kërkesë për informacion”, janë kërkuar të dhëna shtesë për shoqëritë e kontrolluara nga Balfin SHPK.

Pala njoftuese ka marrë pjesë në një seancë dëgjimore, në datë 27 dhjetor 2018, ora 10.30, për t'u shprehur në lidhje me njoftimin e transaksionit të ndodhur midis Piraeus Bank SA dhe Balfin SHPK e Komercijalna Banka Ad Skopje, si dhe pyetje dhe sqarime lidhur me transaksionin, eficientat e pritshme nga ky transaksion etj.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate” miratuar më vendimin e KK nr. 132, datë 07.12.2009, Autoriteti analizon eficientat e pritshme të pretenduara nga ndërmarrja si pasojë e këtij përqendrimi. Evidentimi i efekteve pozitive të këtyre eficientave në treg dhe tek konsumatorët duhet të tejkalojnë ato efekte që mendohen se shkelin potencialisht parimet e konkurrencës. Këto eficienta duhet të përmbushin kushtet dhe barra e provës bie mbi ndërmarrjet palë në transaksion, për të provuar se këto eficienta janë plotësuar.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, transaksioni i synuar mes Bankës së Pireut dhe shoqërisë Balfin SHPK e Komercijalna Bank është një përqendrim konglomerat ku ndërmarrjet pjesëmarrëse operojnë në tregje të ndryshme dhe strukturat e tregut nuk ndikohen në mënyrë të menjëhershme nga transaksioni i ndodhur, por në periudhë afatgjatë, tregu mund të gjenerojë ndryshime të influencuar nga faktorë të jashtëm.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve bankare dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Në Republikën e Shqipërisë aktualisht ushtrojnë aktivitetin e tyre 15 banka. Sektori bankar shqiptar vazhdon të dominohet nga filialet e grupeve të huaja bankare, me origjinë kapitali nga: Bashkimi Evropian si Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania, Veneto Banka), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Hungari (OTP Bank, pas blerjes së Societe General Albania), Greqia (Banka Tirana, Banka Alpha Albania, Banka NBG Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimeve Albania), por edhe nga: Turqia (Banka Kombëtare Tregtare), Arabia Saudite (Banka e Bashkuar e Shqipërisë), Kuvajti (Banka e Kreditit e Shqipërisë)

Bankat me shumicë kapitali vendas janë: Banka Union, Banka Credins dhe Banka Amerikane e Investimeve.

Sektori Bankar, gjatë viteve 2017-2018 është prekur nga një numër i konsiderueshëm i transaksioneve të shitblerjes së kuotave, të cilat kanë konsistuar në ndryshimin e drejtpërdrejtë të kontrollit të disa prej tyre, si: transaksioni nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjes Veneto Banca S.p.A. nga Intesa Sanpaolo S.p.A.⁴; transaksioni i shitjes dhe transferimit të aksioneve të Bankës NBG Albania SHA nga Banka Kombëtare e Greqisë S.A. tek Banka Amerikane e Investimeve SHA⁵ - pas transaksionit Banka Amerikane e Investimeve përthithi Banka NBG Albania SHA, duke ulur kështu në 15 numrin e bankave pjesëmarrëse në tregun bankar në Shqipëri; transaksioni nëpërmjet shitblerjes së aksioneve prej 88.89% të Societe Generale Albania SHA nga Societe Generale tek OTP Bank Nyrt”, OTP Bank (bankë hungareze) hyn në tregun e shërbimeve bankare nëpërmjet degëve të bankës Societe General Albania SHA⁶;

⁴ Vendimin nr. 474, datë 14.09.201 i Komisionit të Konkurrencës

⁵ Vendimin nr. 501, datë 15.03.2018 i Komisionit të Konkurrencës

⁶ Vendimi nr. 571, datë 22.11.2018 i Komisionit të Konkurrencës

transaksioni mes Union Bank dhe ICB Financial Group Holdings AG për shitjen e aksioneve të Bankës Ndërkombëtare Tregtare.⁷

Referuar të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave për vitin 2017, **sipas aktiveve** në zotërim, Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë të aktiveve me XX%, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me XX % dhe Credins Bank me XX %. Banka e Tiranës zë XX% të tregut të aktiveve.

Tregu bankar shqiptar në terma të aktiveve klasifikohet si mesatarisht i përqendruar ku indeksi i Herfindahl-Hirchman (HHI) është në vlerën 1461, pa praninë e bankave me pozitë dominuese.

Në tregun e depozitave rezulton se Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me XX%, e ndjekur nga Raiffeisen Bank me XX% dhe Credins Bank me XX%. Banka e Tiranës zë XX% të tregut të depozitave.

Tregu bankar shqiptar në terma të depozitave klasifikohet si mesatarisht i përqendruar me HHI në vlerën 1545, pa praninë e bankave me pozitë dominuese.

Në tregun e kredisë, Banka Kombëtare Tregtare ka përqindjen më të lartë me XX%, e ndjekur nga Credins Bank me XX% dhe Raiffeisen Bank me XX%. Tirana Bank zë XX% të tregut të kredive.

Tregu bankar shqiptar në terma të kredive klasifikohet po përsëri si mesatarisht i përqendruar, ku HHI ka vlerën 1288, pa praninë e bankave me pozitë dominuese.

Para përqendrimit, pjesët e tregut të Tirana Bank SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive janë në vlerën XX%. Duke qenë se Balfin SHPK nuk operon në tregun e shërbimeve bankare apo në tregje të lidhura me tregun bankar dhe Komercijalna Bank AD nuk operon dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Shqipërisë, pas transaksionit, në situatën aktuale nuk rezulton të kemi ndryshim të strukturës së tregut.

Aksionari kryesor i Tirana Bank, shoqëria Balfin SHPK ka kontrollin e një numri të madh shoqërisht si brenda dhe jashtë vendit dhe aktiviteti i Tirana Bank pritet të ndikohet nga veprimtaria ekonomike e shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK, dhe performanca ekonomike dhe financiare e këtyre shoqërive do të jetë garancia e stabilitetit të Tirana Bank dhe e gjithë sistemit bankar në tërësi.

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, transaksionet konglomerate bëhen objekt analizash të thelluara në rastet kur ndërmarrja pjesëmarrëse mund të zgjerojë në mënyrë domethënëse pjesën e tregut në një të ardhme, dhe nga vlerësimi *ex-ante* i transaksionit dhe i tregjeve, blerja e aksioneve të Tirana Bank nga shoqëria Balfin SHPK mund të orientojë gjithë qarkullimin e likuiditetit dhe shërbimet bankare të shoqërive tregtare të zotëruara nga Balfin SHPK drejt Tirana Bank, e cila pritet të rrisë pjesën në tregun bankar.

Në funksion të kryerjes së kësaj analize, me shkresën nr.484/8 prot. “Kërkesë për informacion”, drejtuar shoqërisë Balfin SHPK është kërkuar informacioni mbi shoqëritë e kontrolluara prej Balfin SHPK dhe nga përpunimi i të dhënave është vlerësuar vlera e detyrimeve financiare (ekspozimi ndaj kredive) të shoqërive në bankat e nivelit të dytë, si dhe treguesit e performancës financiare të shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK.

Tabela paraqet vlerat e mbetura të kredive të marra nga shoqëritë e zotëruara prej Balfin SHPK dhe bankat përkatëse ku këto kredi janë disbursuar, deri në datë 30 Nëntor 2018.

TE DHENA KONFIDENCIALE

⁷ Vendimin nr. 576, datë 11.12.2018 i Komisionit të Konkurrencës
XV / 2019

Sipas të dhënave, portofoli i kredimarrjes së shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK është rreth XX milion Euro, ku XX% e saj është marrë nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri dhe pjesa tjetër nga banka në vende të huaja, kryesisht në Kosove, Maqedoni dhe Slloveni.

Shoqëria [...] SHPK paraqet vlerën më të lartë të kredive të marra, përkatësisht në shumën XX Euro e disbursuar pranë [...] në Shqipëri dhe [...] Bank në [...]. Pas saj vijon [...] në vlerën XXX Eur në bankat [...],[...] dhe [...].

Brenda Shqipërisë, banka në të cilën shoqëria Balfin SHPK ka vlerën e kredive më të lartë është [...] në vlerën XX Eur, ndërkohë që jashtë Shqipërisë, banka që ka lëvruar më tepër kredi është [...] në vlerën XX Eur dhe kompania me vlerën më të lartë të kredive të marra është [...].

Duke ju referuar likuiditeteve të lira të Tirana Bank, statistika të deklaruara prej saj, rezulton se totali i likuiditeteve të lira të bankës në shtator 2018 janë XX milion euro, ndërkohë që kreditë e marra nga shoqëritë e kontrolluara nga Balfin SHPK në bankat shqiptare janë rreth XX milion euro.

Nëse do të marrim në konsideratë kufizimin ligjor të parashikuar në nenin 64, pika 3 të ligjin nr. 9662/2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, për rrezikun e ekspozimit, gjykojmë se likuiditetet e lira të Tirana Bank nuk do të ndikohen nga portofoli i kredive të shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK.

Në funksion të stabilitetit ekonomik të bankës dhe ndikimit të saj nga aktiviteti i shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK, janë vlerësuar indikatorët e performancës financiare të të gjitha shoqërive nëpërmjet normës së fitimit, normës së kthimit të aktiveve ROA (Return on Assets) dhe normës së kthimit nga kapitali ROE (Return on Equity). Këta indikatorë janë tregues të eficesës ekonomike të shoqërisë në lidhje me shfrytëzimin e investimeve të kryera dhe vlerësimin e aftësisë paguese të shoqërive për shlyerjen e detyrimeve financiare.

TE DHENA KONFIDENCIALE

Shoqëria me fitimin neto më të madh dhe të ardhura nga aktiviteti më të larta është [...] SHPK, e cila zotëron tregun e përpunimit të mineralit të kromit. Kjo shoqëri, edhe pse ka ekspozimin më të larta ndaj kredisë, ka ROA dhe ROE pozitive (më shumë se XX%), e cila jep siguri për vazhdueshmërinë e aktivitetit

Normën më të lartë të fitimit, ROA dhe ROE e ka kompania [...] Shpk, shoqëri e cila operon në tregun e shërbimit të speditimit, si agjent i [...].

Kompania [...], e cila ka një ekspozimin të lartë ndaj kredisë, ka një normë fitimi pozitive (XX%) dhe ROA dhe ROE pozitive (XX% dhe XX%). Pavarësisht vlerës së lartë të kredisë, shoqëria jep garanci për aktivitetin tregtar të saj.

Shoqëria me treguesit e normave të kthimit më pak se XX% është [...] dhe [...], por nuk i vlerësojmë si shqetësues, nëse do kemi në konsideratë që shoqëria [...] është në fazën e zgjerimit të investimeve dhe aktiviteti i tyre është në tregun e qiradhënies. Treguesit e normave të fitimit, mbi XX% janë element pozitiv për performancës e shoqërive.

Referuar pasqyrave financiare të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, shoqëritë [...] Shpk, [...] Shpk, [...] SHPK dhe [...] janë paraqitur me rezultat negativ.

Nga vlerësimi i treguesve të përfitueshmërisë së shoqërive të kontrolluara nga Balfin SHPK në lidhje me treguesin e normës së fitimit, treguesin e rentabilitetit të aseteve (ROA) dhe treguesi i kthimit të investimit (ROE), konstatohet se shoqëritë e kontrolluara nga Balfin SHPK mund të ndikojnë pozitivisht në aktivitetin ekonomik të bankës, duke mundësuar që banka të jetë një konkurrent potencial në treg.

Si rezultat i transaksionit të synuar, pritet që Tirana Bank të rrisë fuqinë e saj në treg dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121 datë 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, banka ka detyrimin

ligjor të mos abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet zbatimit të kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; apo vendosjes së kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

Në referencë të nenit 131 “Marrëdhëniet e bankës ose degës së bankës së huaj me persona të lidhur me të”, të Ligjit Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, bankat ose degët e bankave të huaja nuk duhet të ushtrojnë veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të.

Në këndvështrim të nenit 13, pika 2, gërma c) të Ligjit 9121/2003, Komisioni, në vlerësimin e përqendrimeve, mban parasysh eficientat ekonomike që mund të rrjedhin nga përqendrimi dhe që kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve ose, të paktën, neutralizojnë efektet e mundshme negative që mund të sjellë përqendrimi. Në këtë kontekst, sjellja e palës blerëse pas transaksionit duhet të japë siguri mbi qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punës së stafit ekzistues të Tirana Bank SHA, sipas detyrimeve të përcaktuara në *Aneksi 4* të marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve, ku struktura organizative dhe numri i të punësuarve nuk pritet të ndryshojë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 61, pika 1 gërma d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka AD Skopje, me kushtet dhe detyrimet e mëposhtme:
 - a. Të mos zbatojë kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - b. Të mos vendosë kushte për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë;
 - c. Të mos ushtrojë veprimtari bankare ose financiare me dhe në përfitim të personave të lidhur me të;
 - d. Transaksioni të sigurojë eficientë ekonomike dhe të japë siguri mbi qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të punës së stafit ekzistues të Tirana Bank SHA .
2. T’i rekomandojë Bankës Qendrore të Shqipërisë që:
 - a. Për çështje të stabilitetit financiar, të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK, që zotërojnë pozitë dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë, duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre.
 - b. Të parashtrijë përpara Autoritetit të Konkurrencës çdo ndryshim në strukturën e shoqërive të monitoruara, ku mund të krijohet apo forcohet pozita e dominuese në treg.
3. Autorizimi i miratuar me këtë vendim do të hyjë në fuqi pas miratimit të transaksionit nga Banka Qendrore e Shqipërisë.
4. Monitorimin e sjelljes së shoqërisë Tirana Bank SHA, për një periudhë 1 vjeçare nga data e marrjes së këtij vendimi.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 581, Datë 17.01.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, ndërmjet Summer BidCo B.V. në cilësinë e blerësit dhe Adria Luxco s.a r.l. në cilësinë e shitësit, në lidhje me blerjen e aksioneve të Adria TopCo B.V..

Blerësi: Summer BidCo B.V., është një shoqëri e krijuar rishtazi, e kontrolluar nëpërmjet një zinxhiri ndërmarrjesh të tjera nga Summer Invest S.a.r.l. Kjo e fundit zotërohet nga BC European Capital X. Të gjitha këto shoqëri bëjnë pjesë në Grupin BC Partners. Objekti i shoqërisë Summer BidCo B.V. është të marrë pjesë dhe të financojë shoqëritë dhe bizneset; të bashkëpunojë, të operojë dhe menaxhojë punët dhe t’u ofrojë këshillim dhe shërbime të tjera shoqërive dhe bizneseve të tjera; të japë dhe marrë hua; t’u japë kolateral për borxhet dhe obligacionet e tjera të shoqërisë shoqërive dhe bizneseve të tjera etj.

Shitësi: Adria LuxCo S.a.r.l. është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Luksemburgut. Objekti i veprimtarisë së saj është të veprojë si një shoqëri holding dhe të koordinojë aktivitetin e çdo personi juridik me të cilin shoqëria është e interesuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, dhe për të marrë të gjitha ose pjesë të kuotave, grupe të obligacioneve, bonove dhe titujve të tjerë të lëshuar ose të garantuar nga çdo person dhe çdo aktiv tjetër i çdo lloji duke i mbajtur ato si investime, t’i shesë, shkëmbejë, të kryejë çdo tregti ose biznes ose të blejë të gjithë ose pjesë të bizneseve; të blejë, të marrë me qira, të shkëmbejë, të japë me qira çdo pasuri të vërtetë ose personale dhe çdo të drejtë ose privilegj mbi të dhe në lidhje me të etj.

Shoqëria target: **Adria TopCo B.V.** është një shoqëri holding, përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve të shoqërive të ndryshme operative në Evropën Qendrore dhe Lindore në fushën e telekomunikacionit duke ofruar shërbime kabllore ose direkt në shtëpi nëpërmjet transmetimit satelitor, akses në internet, telefoni fikse ose celulare për abonentët në rajonin e ish-Jugosllavisë. Adria TopCo zotërohet në mënyrë të tërthortë nga Grupi KKR. KKR është një firmë investimesh globale e cila zotëron gjithashtu United Group ku kjo e fundit realizon xhiro në Shqipëri nëpërmjet Direct Media SHPK.

Referuar marrëveshjes mes palëve dhe pasqyrave financiare të vitit 2017, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke u bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin si edhe duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar i njoftuar është përfitim kontrolli i Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.

Shoqëria target Adria TopCo B.V. nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Shoqëria blerëse Summer BidCo B.V. nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Adria TopCo B.V. nga Summer BidCo B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 582, Datë 17.01.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK,

VËREN SE:

I. Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes për pjesëmarrje në shoqëri, ndërmjet BConnect SHPK në cilësinë e blerësit dhe Doxa S.p.a në cilësinë e shitësit, në lidhje me blerjen 100 % të kapitalit të Grid SHPK.

Blerësi: **BConnect SHPK** është një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar. Shoqëria BConnect SHPK është e specializuar në dhënien e shërbimeve të asistencës telefonike në favor të palëve të treta, duke vendosur kontakte telefonike në vijim të thirrjeve hyrëse (inbound) dhe dalëse (outbound).

Shoqëria BConnect SHPK zotërohet tërësisht nga shoqëria e të drejtës italiane Covisian S.p.A. Aktivitetet e shoqërisë janë shërbimet e lidhura me marketingun e shoqërive si telekontakti, postimi dhe çdo shërbim i kryer me sistemet telematike (përfashtuar interneti).

Shitësi: **Doxa S.p.A.**, shoqëri e themeluar sipas ligjit italian. Kjo shoqëri ka për objekt, ekzekutimin për llogari të vet dhe për llogari të të tretëve të vrojttimeve statistikore dhe të përpunimit të informacioneve, të cilat grumbullohen me referendum, intervista dhe në mënyra të tjera, si dhe mbi të dhëna që janë aktualisht të disponueshme.

Shoqëria Doxa S.p.A, zotëron 100% kapitalin e shoqërisë Target.

Shoqëria target: Shoqëria Grid SHPK (Target), është një shoqëri e së drejtës shqiptare. Shoqëria Grid SHPK ka si objekt veprimtarie kërkime programe statistikore dhe aplikime informatike. Ajo shoqëri ofron shërbim edhe në tregun e shërbimit Call Center.

Referuar marrëveshjes mes palëve dhe pasqyrave financiare të vitit 2017, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke u bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

II. Vlerësimi i përqendrimit

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i shërbimeve call center dhe treg përkatës gjeografik u përcaktua territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga vlerësimi i strukturës së tregut rezultoi se tregu i shërbimit call center në Shqipëri është një treg mesatarisht i përqendruar ku treguesi i përqendrimit HHI është 1514 dhe në treg veprojnë një numër i madh konkurrentësh.

Konkurenti më i madh në tregun e shërbimit call center është shoqëria [...] SHPK e cila zotëron XX% të tregut. Më pas vjen shoqëria [...] SHPK me XX% të tregut dhe shoqëria [...] me XX% të tregut.

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të plotë të Grid SHPK nga BConnect SHPK dhe pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit arrin në vlerën XX %, duke mos krijuar shqetësime për konkurrencën në treg.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Grid SHPK nga BConnect SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 590, Datë 31.01.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co., LTD.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co., LTD,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, Projekti Gamma, ndërmjet shoqërisë CK Holdings Co.,LTD dhe Fiat Chrysler Automobiles N.V, Magneti Marelli S.p.A.

Blerësi: CK Holdings Co.,LTD, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Japonisë, e cila ka për objekt menaxhimin e kompanive që angazhohen duke mbajtur aksionet tyre në bizneset e prodhimit dhe shpërndarjes të ngrohjes, prodhimit dhe shitjes së komponentëve dhe furnizimeve për automobila, prodhimit dhe shitjes së pjesëve të automobilave që grumbullojnë makineritë, etj. CK Holdings është shoqëria holding e Calsonic Kansei Corporation (“Calsonic Kansei”).

CK Holdings zotërohet nga fondet e investimeve që menaxhohen nga filialet e KKR e cila është një shoqëri globale investimesh. KKR, nëpërmjet disa shoqërive të kontrolluara prej saj, ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2017. Të ardhurat janë realizuar në tregje të ndryshme nga tregu në të cilin shoqëria Targeti është aktiv.

Shitësi: Fiat Chrysler Automobiles N.V është një shoqëri publike holandeze, me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka në zotërim të gjitha aksionet e Magneti Marelli S.p.A. Shoqëria vepron si projektues, prodhues, shpërndarës dhe shitës i automjeteve, pjesëve dhe sistemeve të prodhimit.

Shoqëria target: Magneti Marelli S.p.A. është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, dhe objekti i shoqërisë është ushtrimi direkt apo indirekt nëpërmjet shoqërisë ose enteve pjesëmarrëse në aktivitete

projektuese, prodhues dhe tregtar në sektorët e industrisë mekanike, elektromekanike, elektronike, kimike, të tërheqjes dhe të shtytjes dhe në veçanti të prodhimit dhe tregtimit të komponentëve, detajeve, pjesëve të këmbimit dhe aplikimit për industrinë e automobilave, aksesoret dhe produktet për automjeteve etj.

Magneti Marelli S.p.A. nuk zotëron dege apo filial në Shqipëri por realizon shitje nëpërmjet klientëve të saj.

Referuar marrëveshjes mes palëve dhe pasqyrave financiare të vitit 2017, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke u bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, u konsiderua që tregu përkatës i produktit të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar ndodh në tregun ndërkombëtar dhe palët në transaksion nuk zotërojnë ndonjë filial apo degë në territorin e Shqipërisë. Magneti Marelli është aktiv vetëm në furnizimin me shumicë të pjesëve të këmbimit për automjetet e lehta dhe shoqëria blerëse CK Holdings CO., Ltd. nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Magneti Marelli S.p.A. nga shoqëria CK Holdings Co.,LTD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 591, Datë 31.01.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”,

VËREN SE:

Procedura dhe transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacionin përkatës në lidhje me përqendrimin e realizuar mes LG Electronics Inc. dhe Lufthansa Technik AG, nëpërmjet themelimit të një sipërmarrje të përbashkët (joint venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët.

Pala 1: LG Electronics Inc., është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Koresë, me objekt prodhimin dhe shitjen e aparaturave dhe pajisjeve elektronike, pajisjeve të komunikimit, pajisjeve elektrike, biznese të minierave, import-eksportit, faktoringut, leasing i aparaturave dhe pajisjeve elektronike dhe elektrike, shërbime të instalimit të rrjetit të internetit, të instalimit të elektricitetit, prodhimi dhe shitja e kamerave dhe pajisjeve optike etj .

LG Electronics Inc. është pjesë e grupit LG, një nga liderit botërorë të prodhimit dhe inovacionit të teknologjisë për pajisjet elektronike të konsumit. LG Electronics Inc., nuk është aktive në Shqipëri.

Pala 2: Lufthansa Technik AG është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt të shoqërisë; kryerja dhe marketingu i shërbimeve të inxhinierisë të aviacionit dhe të gjitha shërbimeve në lidhje me to, veçanërisht mirëmbajtja, riparimi dhe rregullimi i pajisjeve aeronautike si dhe shërbimet e logjistikës,

inxhinierisë, kërkimit dhe zhvillimit dhe shërbimet ndihmëse të lidhura për linjën ajrore dhe pronarëve të tjerë të avionëve.

Lufthansa Technik AG është pjesë e grupit Lufthansa, një nga shoqëritë më të mëdha të ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes, ndreqjes dhe rishikimit për avionë, makineri dhe pjesë përbërës si dhe një zhvillues dhe prodhues i sistemeve të kabinës.

Lufthansa Technik AG nuk është aktive në Shqipëri.

Sipas marrëveshjes do të krijohen Sipërmarrjet e Përbashkëta (SP):

SP-A, shoqëri e cila do të fokusohet në sistemet e menaxhimit të mjeteve fluturuese dhe të kabinave;

SP-P, shoqëri e cila do të fokusohet kryesisht në sistemet e argëtimit të pasagjerëve gjatë fluturimit dhe të sistemet e lidhura me monitor;

Ortakët themelues të SP-A dhe SP-P do të jenë Lufthansa Technik AG, i cili do të nënshkruaj dhe pas regjistrimit do të mbajë 51% të kapitalit të regjistruar të SP -A dhe SP -P; dhe LG Electronics Inc., i cili do të nënshkruaj dhe pas regjistrimit do të mbajë 49% të kapitalit të regjistruar të SP-A dhe SP-P.

SP-S, shoqëri e cila do të zotërohet bashkërisht dhe më masë të njëjtë nga SP-A dhe SP-P dhe do të jetë përgjegjëse për shitjen, marketingun dhe shërbimet e konsumatorit të nivelit të parë për produktet dhe shërbimet e SP-A SP- P.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe, duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit e praktikën e Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit mund të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një sipërmarrje të përbashkët (joint-venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc. dhe Lufthansa Technik AG.

Lufthansa Technik AG dhe LG Electronics Inc nuk janë konkurrentë në të njëjtin treg dhe nuk operojnë as në nivele të ndryshme të zinxhirit të produktit. Ky transaksion është një përqendrim konglomerat ku veprimtaritë ekonomike ose produktet e ndërmarrjeve pjesëmarrëse janë plotësuese të njëra-tjetrës.

Shoqëritë Lufthansa Technik AG dhe LG Electronics Inc nuk janë aktive në Shqipëri dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta nuk priten të kryejnë aktivitet në Shqipëri.

Nisur nga sa më sipër, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët të tre shoqërive të reja (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga LG Electronics Inc.dhe Lufthansa Technik AG”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 595, Datë 19.02.2019

“Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK nga Z. Luan Leka.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK nga Z. Luan Leka,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës” të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK nga shoqëria Investment Joti-Infosoft Group” SH.P.K, Tag Engineering SHPK dhe Z. Bledar Dhima tek blerësi Z. Luan Leka.

Blerësi: Z. Luan Leka, është shtetas shqiptar, pjesëmarrës në kapitalin e shoqërive [...] SHPK (XX % e kuotave), [...]SHPK (XX % e kuotave), [...]SHPK (XX % e kuotave), [...]Konstruktion SHPK(XX % e kuotave), [...]SHPK(XX % e kuotave), [...]SHPK (XX % e kuotave) dhe [...]SHPK(XX % e kuotave), të cilat ushtrojnë aktivitete në fusha të tilla si: prodhim, rritje, shndërrim, tregtim i produkteve të ndryshme ushqimore, menaxhim, blerje, marrje me qira, ndërtim, dhënie me qira ose menaxhim, shitjen e aktiviteteve tregtare me shumicë apo me pakicë dhe të veprave e strukturave që kanë lidhje me këto aktivitete, drejtimin e veprimtarive tregtare me pakicë në bashkëpunim edhe me shoqëritë e tjera franchising dhe furnizimin, import-eksport të mallrave të ndryshme që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar etj. Hapjen dhe drejtimin e “Agjencive Doganore” në të gjithë territorin e Shqipërisë për kryerjen e çdo praktike doganore, prodhimin, vetë në formë të asociuar, ose në ortakëri me shoqata ose shoqëri të tjera, të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen në pikat e veta të shitjes ose të shoqërive ortake ose të kontrolluara prej saj si dhe /ose për eksportim; veprimtari në fushën e ndërtimit, prodhimin dhe ambalazhim të ujit në burim apo vende të tjera, prodhimin, ambalazhimin si dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të pijeve të tjera apo të produkteve të ndryshme etj.

Shitësit:

- Investment Joti-InfoSoft Group SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit pjesëmarrje në shoqëri si dhe në borde drejtuese të shoqërive; konsulencë në menaxhim dhe administrim biznesi; menaxhim i shoqërive tregtare, veprimtari të blerjes, shitjes dhe qeradhënies, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; konsulencë financiare, kontabiliteti, auditimi si dhe tatimore; shërbime dhe zhvillime të programeve të teknologjisë informative; veprimtari dhe shërbime të ndryshme publiciteti, reklamim dhe promocion; transport mallrash për vete dhe të tretë, etj.
- Tag Engineering SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit pjesëmarrje në shoqëri të tjera si dhe në organe drejtuese të këtyre shoqërive; konsulencë në menaxhim dhe administrim biznesi, menaxhim i shoqërive tregtare; veprimtari të blerjes, shitjes dhe qiradhënies së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme; konsulencë financiare, kontabiliteti, auditimi si dhe tatimore; shërbime dhe zhvillime të programeve të teknologjisë informative, etj.
- Z. Bledar Dhima, shtetas shqiptar, zotërues i 10% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK.

Shoqëria target: InfoSoft Business Solutions SHPK. Veprimtaria e kësaj shoqërie lidhet kryesisht me projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software, shitje license software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to; dhënia me qera e software-ve; shërbime të adoptimit dhe përshtatjes së softwareve; shërbime mirëmbajtje të teknologjisë së informacionit; shërbime të konsulencës teknike në fushën e teknologjisë së informacionit; shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit; shërbime të menaxhimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; shërbime të përpunimit të të dhënave; shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave përkatëse. Qendër e formimit profesional për implementim *Microsoft Dynamics Nav*.

Shoqëria InfoSoft Business Solutions SHPK zotërohet nga shoqëria Investment Joti - Infosoft Group SHPK në masën 70%, shoqëria TAG Engineering SHPK në masën 20% dhe Z. Bledar Dhima në masën 10%.

Me nënshkrimin e dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës” mes ortakëve të shoqërisë Investment Joti-Infosoft Group” SH.P.K, Tag Engineering SHPK e Z. Bledar Dhima dhe blerësit Z. Luan Leka, pronësia e kuotave në shitje kalon tek blerësi Z. Luan Leka në përputhje me kushtet dhe detyrimet e kontratës dhe shoqëria InfoSoft Business Solutions SHPK do të zotërohet nga ortaku i vetëm, Z. Leka në masën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Vlerësimi i përqendrimit

Kontrata për shitjen e kuotës është shoqëruar me “Kontratë opsioni për shitjen e kuotës”, ku, sipas përcaktimeve në nenin 2 “Opsioni i blerjes dhe Opsioni i shitjes”, shitësi dhe blerësit pranojnë dhe bien dakord që të krijohet në favor të blerësve, një opsion (e drejtë) ekskluziv i blerjes dhe detyrimi i shitjes së Kuotave të Shitësit, përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura me të (*Opsioni Blerjes*).

Bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, një përqendrim ndodh atëherë kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm në treg si pasojë e transaksionit. Sipas “Kontratë opsioni për shitjen e kuotës”, transaksioni i përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë nga Z. Luan Leka mbi shoqërinë InfoSoft Business Solutions SHPK përmes blerjes së 100 % të kuotave të saj, rezulton vetëm në një ndryshim të përkohshëm të kontrollit duke përcaktuar se: *Opsioni i Blerjes mund të ushtrohet nga blerësi në çdo moment, brenda një afati kohor prej 5(pesë) vjetësh (Afati Opsionit)*.

Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, miratuar me Vendim të Komisionit të Konkurrencës Nr.236, datë 19.07.2012 pika 1.4 “Ndryshimi i kontrollit mbi baza të qëndrueshme”, periudha e parashikuar në marrëveshje duhet të jetë mjaftueshmërisht e gjatë për të çuar në një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të ndërmarrjes.

Për sa më sipër, transferimi i kuotave nga shoqëria InfoSoft Business Solutions SHPK tek Z. Luan Leka përmes blerjes së 100 % të kuotave, nuk rezulton në një ndryshim të kontrollit me baza të qëndrueshme për tu klasifikuar si përqendrim në bazë të nenit 10), pika 1, shkronja b) e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë njoftimin mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë InfoSoft Business Solutions SHPK nga Z. Luan Leka si përqendrim në zbatim të neneve 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Në zbatim të nenit 4, pika 5 të Rregullores “Për përcaktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë AK”, miratuar me Vendimin nr. 584 datë 24.01.2019, palët në transaksion kanë detyrimin e pagesës së tarifës për ndjekjen e procedurës në shumën 150,000 lekë.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative Tiranë brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhet pagesa.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 596, Datë 19.02.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.,

VËREN SE:

Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Pala Blerëse: Sirti S.p.A është shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit italian. Objekti i shoqërisë është projektim, zhvillim, konstruksion, furnizim, mirëmbajtje dhe çfarëdo lloj aktiviteti lidhur me produkte, impiante dhe rrjete të sistemit të telekomunikacionit; produkte, impiante dhe rrjete të sistemit të energjisë elektrike dhe nga burime të rinovueshme; produkte hardware dhe software, sisteme të integritimit, aplikacione të informacionit dhe teknologjisë së komunikimit etj. Shoqëria zotërohet nga Pillarstone SpA dhe kontrollohet në mënyrë të tërthortë nga fondi investimeve KKR & Co.L.P.

Shoqëria Sirti S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Pala Shitëse: Shtetas italianë, Z. Nino Piero Maria Marsanasco , Z. Mauro Brena , Znj. Maria Stella Brena dhe Z. Gianpietro Rognoni, të cilët do të shesin një pjesë të kuotave të zotëruara prej tyre.

Shoqëria target: Wellcomm Engineering S.p.A është shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Italian, me objekt veprimtarie: prodhues kompjuterash dhe pajisje hyrëse dhe dalëse (input dhe output), programim kompjuterik, konsulencë dhe veprimtari të ngjashme dhe instalime të tjera ndërtimi etj.

Wellcomm Engineering S.p.A kontrollon shoqërinë Sicab Telecomunicazioni, e fokusuar në zhvillimin e teknologjive të komunikimit IT, shoqërinë We Consulting (pjesë të transaksionit) specializuar në sektorin e sigurisë së të dhënave e aplikacioneve dhe shoqërinë Zerbion S.r.l (që nuk është pjesë e transaksionit).

Wellcomm Engineering ka realizuar xhiro për vitin 2017 në Shqipëri nga shitjet e kryera të aplikacioneve Cisco dhe nga shitjet e bëra nga Sicab të sistemeve të video konferencave, shitje këto të realizuara direkt nga Italia.

Shoqëria target Wellcomm Engineering S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përftim kontrolli i shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe natyrën e transaksionit, duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar është një transaksion konglomerat i cili nuk krijon mbivendosje në tregjet e prekura dhe nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 598, Datë 15.03.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin që do të rezultojë me përfitim të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Pala Blerëse: Lufthansa Industry Solutions AS GmbH (LHIND), është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt veprimtarie: Ofrim i shërbimeve të sistemit të teknologjisë së informacionit, në veçanti zhvillimi i software-ve dhe shërbime konsulence, shërbime të infrastrukturës dhe shërbime të komunikimit.

Shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Pala Shitëse: Z.Minella Gjoka, Z.Robert Felix Kubera, dhe Z.Uwe Fischer zotërues me pjesë të barabartë të kapitalit të shoqërisë ALH Group SHPK, të cilët do të shesin të gjithë pjesën e kuotave të zotëruara prej tyre.

Shoqëria target: ALH Group SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: shërbime inxhinierike dhe konsulence, zhvillim software dhe programim, blerje kompanish ose biznese në fusha të ngjashme; marrje me qera ose blerje e hapësirave për publicitet dhe kryerja dhe/ose organizimi i aktiviteteve promovionale, zhvillimi i projekteve, menaxhimi dhe realizimi i projekteve, blerje dhe çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar me ligj.

Shoqëria ALH Group SHPK nuk kryen aktivitet ekonomik por ajo është vetëm zotëruese e kuotave të shoqërisë Applications Management Development-AMD SHPK e cila mundëson shërbime inxhinierike dhe

konsulencë, zhvillim software dhe programim; marrje me qera ose blerje e hapësirave për publicitet dhe kryerja dhe/ose organizimi i aktiviteteve promocionale, zhvillimi i projekteve, menaxhimi dhe realizimi i projekteve, blerje dhe çdo lloj aktiviteti tjetër që nuk është i ndaluar me ligj.

Njoftimi i përqendrimit është depozituar brenda afatit të parashikuar në nenin 12 pika 2 e Ligjit dhe palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë ALH Group SHPK dhe përfitimi i kontrollit të tërthortë të shoqërisë së kontrolluar AMD SHPK nga shoqëria LHIND AS GmbH

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe natyrën e transaksionit, duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur. Tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

LHIND AS GmbH dhe AMD SHPK nuk janë konkurrentë në të njëjtin treg përkatës por LHIND është klienti kryesor i shoqërisë së kontrolluar AMD SHPK. Shoqëria LHIND nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Transaksioni pritet të ndikojë në uljen e kostove të furnizimit për shoqërinë LHIND AS GmbH dhe pjesa e tregut e shoqërisë AMD SHPK do të mbetet e pandryshuar edhe pas transaksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 601, Datë 21.03.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote nga shoqëria Skysea B.V. tek shoqëria Tosk Energji SHA,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Tosk Energji SHA nga shoqëria Skysea B.V.

Pala Blerëse: Skysea B.V. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt veprimtarie tregti e energjisë elektrike dhe gazit nëpërmjet tubave, etj. Skysea B.V kontrollohet plotësisht nga Gunvor Group Ltd e cila është shoqëri tregtare që operon në mbi 100 vende për tregtimin e lendeve të para.

Shoqëria blerëse Skysea BV dhe mëma e saj Gunvor Group LTD nuk janë aktive në tregun shqiptar.

Pala Shitëse: CFD Conseils Sàrl, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës, me objekt veprimtarie këshillim, asistencë, ndërmjetësim financiar dhe ofrim shërbimesh në sektorin e lëndëve të para etj.

Shoqëria target: Tosk Energji SHA, është një shoqëri e themeluar më datë 11.06.2015 sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie nxjerrje, shfrytëzim, përpunim i naftës bruto dhe nën produkteve të saj, import – eksport, etj.

Shoqëria zotërohet nga në 100% të aksioneve të saj nga shoqëria CFD Conseils Sàrl.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli mbi 50% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Tosk Energji nga shoqëria Skysea B.V. Pas kryerjes së transaksionit shoqëria Skysea BV dhe shoqëria CFD Conseils Sàrl do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Tosk Energji SHA.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburante dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave, konstatohet se shoqëria Gunvor zotëron rreth XX% të tregut të furnizimit me karburante në MLD dhe shoqëria Tosk Energji SHA XX % të tregut. Transaksioni i blerjes së 50% të kapitalit me të drejtë vote të Tosk Energji SHA nga Skysea BV nuk do të sjellë ndryshime në tregun e furnizimit me karburante për shkak të pjesës shumë të vogël të tregut që zotëron shoqëria Tosk Energji SHA.

Në tregun e shitjes me shumicë, shoqëria Gunvor SA nuk ushton aktivitetet dhe sipas të dhënave të administruara nga DPD për vitin 2017 as shoqëria Tosk Energji nuk ka regjistruar zhdoganime për karburante gjatë vitit 2017.

Duke qenë se Gunvor SA dhe Tosk Energji SHA veprojnë në segmente të ndryshme të tregtimit të karburanteve, transaksioni i synuar nuk do të ndikojë në pjesën e tregut të shoqërisë Tosk Energji SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi blerjen e 50% të aksioneve të shoqërisë Tosk Energji SHA nga shoqëria Skysea B.V.
2. Monitorimin e tregut të furnizimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për një periudhë 1 vjeçare nga dalja e këtij vendimi dhe detyrimin e shoqërisë Tosk Enejji SHA për të raportuar çdo 3 muaj treguesit ekonomik e financiarë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 606, Datë 01.04.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, gërma d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, i ndryshuar, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari “Për njoftimin e përqendrimit” dhe Udhëzimi “Për procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e “Marrëveshje Shitblerje”, ndërmjet palëve (1) BRF GMBH (shitësi), (2) BRF S.A. (garantuesi i shitësit), (3) BRF Global GMBH, (1) Tyson International Holding Co (blerësi) dhe (2) Tyson Foods, Inc (garantuesi i blerësit).

Pala Blerëse: Tyson International Holding Co. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware e kontrolluar 100% nga shoqëria mëmë Tyson Foods Inc, një shoqëri multinacionale, e fokusuar në ushqime me përqendrim të lartë proteine.

Pala Shitëse: **BRF GMBH** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e zotëruar 100% nga shoqëria mëmë BRF S.A. me objekt aktiviteti industrializim, marketing, shitje me pakicë dhe shumicë dhe shfrytëzim i ushqimit të përgjithshëm, veçanërisht produktet shtazore proteina dhe produktet ushqimore duke përdorur zinxhir të ftohtë si suport dhe shpërndarës; ofrimi i shërbimeve të ushqimit në përgjithësi.

BRF Global GMBH është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë, e cila zotërohet 100% nga kompania BRF GMBH.

Shoqëritë target: janë aktualisht pjesë e grupit BRF, me seli qendrore në Brazil dhe janë përpunuese të integruara vertikalisht të pulave, me fabrika përpunimi në Tailandë dhe në Bashkimin Europian. Këto shoqëri importojnë dhe përpunojnë mish në Bashkimin Europian.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I). tregu përkatës i produktit, dhe
 - II). tregu përkatës gjeografik.
- Tregu përkatës i produktit: Sa më sipër, si dhe referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit, duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, do të jetë tregu i furnizimit dhe tregimit të mishit për konsum njerëzor.
 - Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar e i njoftuar është përftim kontrolli nga shoqëria Tyson Foods i disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.

Shoqëritë target dhe shoqëria blerëse Tyson Foods së bashku kanë pjesë tregu më pak se 1% të tregut shqiptar duke sjellë kështu një prezencë shumë të kufizuar të palëve në Shqipëri.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit nga shoqëria Tyson Foods të disa shoqërive/filiale të BRF në Europë dhe Tailandë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 610, Datë 10.04.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD,

VËREN SE:

Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD

Pala Blerëse: Albania Telecom Invest AD, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: investime dhe aktivitete në fushën e telekomunikacioneve si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohet nga legjislacioni i Republikës së Bullgarisë.

Albania Telecom Invest AD është krijuar rishtazi për qëllimin e transaksionit të synuar dhe kontrollon bashkërisht nga Albanian Telecom Invest Limited në masën 65% të kuotës dhe RSC Investments B.V. me 35% të kuotës.

Pala Shitëse: Cosmote Mobile Telecommunications S.A, është një shoqëri anonime e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, me objekt veprimtarie: instalimin, operimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin, menaxhimin dhe zhvillimin e sistemeve të telefonisë celulare dhe në përgjithësi të sistemeve të komunikimit elektronik etj

Shoqëria Target: Telekom Albania SHA është shoqëri e organizuar sipas legjislacionit shqiptar e cila ka objekt aktiviteti industrinë e telekomunikacionit, kryesisht në sektorin e komunikimeve telefonike celulare (parapagesë/kontratë), shërbimi broadband fiks/rrjet, internet, linjat fiks/rrjet, etj

Shoqëria zotërohet në 99.757 % të aksioneve nga shoqëria Cosmote Mobile Telecommunications S.A (shitës) dhe pjesa e mbetur zotërohet nga 12 aksionerë, e ndarë në përqindje pjesëmarrje.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni i njoftuar parashikon blerjen nga shoqëria Albania Telecom Invest AD të 99.757% të aksioneve që shoqëria Cosmote Mobile Telecommunications S.A zotëron tek shoqëria Telekom Albania SHA.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Për transaksionin e njoftuar, AKEP me vendimin nr.8, datë 21.03.2019 “Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e transaksionit të prishëm për shitjen e aksioneve të sipërmarrësit Telekom Albania SH.A”, ka vendosur të japë miratimin paraprak të kryerjes së transaksionit të prishëm për shitjen e aksioneve të sipërmarrësit Telekom Albania SH.A, të zotëruara nga shoqëria Cosmote Mobile Telecommunications S.A tek shoqëria Albania Telecom Invest AD, përkatësisht sipas vendimeve të organeve drejtuese të shoqërive të mësipërme.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit u konsiderua tregu i telefonisë celulare e telefonisë fikse dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i telefonisë ka qenë në vite objekt vlerësimi dhe analize e Autoritetit të Konkurrencës, i cili në bashkëpunim me AKEP ka vlerësuar dhe ka dhënë rekomandime në lidhje me shqetësimet e tregut.

Dalja nga tregu e shoqërisë Plus Communication SHA prej datës 01.01.2018, solli ndryshime strukturor duke reduktuar në 3 numrin e operatorë në tregun e telefonisë celulare. Ky ndryshim solli për pasojë rritjen e indeksit të përqendrimit të tregut dhe shpërndarën e klientëve të Pus Communication në tre operatoret e mbetur në treg.

Pjesa e tregut e shoqërisë Telecom SHA në tregun e telefonisë celulare, për produktin “përdorues aktive të telefonisë celulare”, gjatë 9 muajve të vitit 2018, rezultoi të jetë 36% dhe blerja e kuotave të zotëruara nga Cosmote Mobile Telecommunication nga shoqëria ATI Bullgari nuk do të sjellë ndryshime në strukturat e tregut të telefonisë celulare për shkak se pala blerëse nuk operon në tregun shqiptar dhe nuk krijon mbivendosje pjesësh në tregun përkatës.

Në tregun e telefonisë fikse, operojnë rreth 90 sipërmarrës, të cilët zotërojnë rrjetet/infrastrukturën e tyre, përfshirë rrjetin e aksesit apo të lidhjes direkt me përdoruesit fundorë. Operatori me pjesën më të madhe në treg është Altelecom SHA me 69% të tregut, ndërkohë që Telecom SHA ka një pjesë të pandjeshme dhe transaksioni nuk do të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në treg të shoqërisë Telecom Albania SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD.
2. Mbajtjen në monitorim për një periudhë 1 vjeçare nga marrja e këtij vendimi, të veprimtarisë së shoqërisë Telecom Albania SHA
3. Detyrimin e shoqërisë Telecom Albania SHA, të njoftojë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës të gjitha ndryshimet e kryera në paketat standarde, oferta promovionale, tarifa standarde që do të hedhë në treg, gjatë periudhës së monitorimit.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 614, Datë 02.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me krijimin e sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacionin përkatës në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA me Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd.

Pala 1: Volkswagen Financial Luksemburg SA (VWFL), është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut dhe filial i grupit Volkswagen AG, një nga prodhuesit më të mëdhenj të makinave në botë dhe lider global në zhvillimin e automjeteve elektrike duke përfshirë edhe makinat konceptuale të avancuara.

Grupi Volkswagen është aktiv në Shqipëri nëpërmjet tre shoqërive: Porsche Leasing SHPK; Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK

Pala 2: Mobileye Vision Technologies LTD është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Izraelit dhe është aktive në zhvillimin e vizioneve kompjuterike të mësimin të drejtimit të makinës, analizimit të të dhënave, vendndodhjen në harta digjitale të automjeteve me qëllim asistencën teknike për drejtuesit.

Shoqëria është e kontrolluar tërësisht nga Intel Corporation (Intel), e cila është një shoqëri me ofertë publike në të cilën më shumë se 68% e aksioneve zotërohen nga aksionarë institucionalë.

Intel Corporation (Intel) dhe Mobileye Vision Technologies LTD nuk veprojnë në Shqipëri.

Pala 3: Champion Motors Ltd është një shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Izrealit, importues dhe distributor i drejtpërdrejtë i automjeteve të markës Volkswagen, Skoda, Audi dhe Seat në Izrael.

Champion Motors zotërohet tërësisht nga Allied Holding Ltd, e cila është shoqëri izrealite që vepron në industrinë e elektronikës, infrastrukturës dhe atë të automjeteve.

Allied Holding Ltd dhe Champion Motors nuk veprojnë në Shqipëri.

Në datën 8 prill 2019 është nënshkruar dokumenti “Marrëveshja për krijimin e sipërmarrjes së përbashkët” ndërmjet shoqërive Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd .

Palët kanë rënë dakort të themelojnë një sipërmarrje të përbashkët e cila do të inkorporohet sipas ligjeve të shtetit të Izraelit dhe do të veprojë, nëpërmjet një numri automjeteve vet lëvizëse, në shërbimin e transportit privat, të ndryshëm nga taksitë, të organizuar nëpërmjet një platforme dixhitale. Aktiviteti do të ushtrohet fillimisht brenda qytetit të Tel Aviv, Izrael.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i ofrimit të shërbimit të transportit privat nëpërmjet automjeteve vet-drejtuese dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu në të cilin ndodh transaksioni nuk është funksional në Shqipëri dhe vetëm Volkswagen AG operon në Shqipëri nëpërmjet Porsche Albania SHPK, Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Nisur nga sa më sipër, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota dhe kontroll të përbashkët nga Volkswagen Financial Luksemburg SA, Mobileye Vision Technologies Ltd dhe Champion Motors Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 615, Datë 02.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë të LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Blerësi: Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft (Volkswagen Financial Services AG), është një shoqëri aksionare e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig. Shoqëria është pjesë e Grupit Volkswagen, i cili drejtohet nga ndërmarrja mëmë fundore e grupit Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG).

Volkswagen AG, shoqëri aksionare, është regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Braunschweig-ut.

Grupi Volkswagen ka tre entitete të themeluara në Shqipëri: Porsche Leasing SHPK, Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK.

Porsche Albania SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit shitje me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerjen e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve etj. Ortak me 100% të kuotave është Porsche Holding Gesellschaft m.b.H.

Porsche Leasing SHPK, shoqëri me objekte të aktivitetit veprimtari të qirasë financiare, agent në sigurime. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

Porsche Mobility SHPK, shoqëri me objekt të aktivitetit çdo formë e aktivitetit, veprimtarisë së qirasë operacionale siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Ortakë me 100% të kuotave është Porsche Bank Aktiengesellschaft.

Shitësi: DVB Bank SE është një shoqëri e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main.

Targeti: LogPay Financial Services GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Frankfurtit am Main.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli i shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të LogPay Financial Services GmbH nga Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.

Shoqëria Target LogPay Financial Services GmbH së bashku me shoqëritë në zotërim të saj nuk operojnë në Shqipëri.

Volkswagen AG operon në Shqipëri nëpërmjet Porsche Albania SHPK, Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Mobility SHPK. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë LogPay Financial Services GmbH nga shoqëria Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 616, Datë 02.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacioni përkatës në lidhje me transaksionin që konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (joint venture Sensia) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.

Pala 1 Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e kontrolluar drejtpërdrejtë nga Rockwell Automation INC.

Pala 2 Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e kontrolluar drejtpërdrejtë nga Rockwell Automation INC.

Pala 3 Schlumberger Technology Corporation, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktiviteti kryesor i saj është ai në fushën e shërbimeve të naftës dhe është entiteti kryesor i Schlumberger që ushtron aktivitetet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pala 4 Cameron International Corporation, është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila ofron produkte të pajisjeve të rrjedhjes, sisteme dhe shërbime të industrisë së naftës dhe gazit në mbarë botën.

Pala 5 Schlumberger B.V., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar sipas legjislacionit të Hollandës. Objektivi i kësaj shoqërie është të veprojë si shoqëri e ndërmjetme holding dhe financiare dhe të ofrojë shërbime administrative dhe menaxhimi për shoqëritë e grupit, si dhe të angazhohet në kërkime shkencore dhe aktivitete inxhinierike.

Palët e mësipërme do të krijojnë një shoqëri të përbashkët, me funksione të plota (joint venture), të quajtur **Sensia**.

Sensia do të jetë një shoqëri e krijuar rishtaz sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me objekt aktiviteti në ofrimin e automatizimit të integruar digjital dhe të zgjidhjeve informative për klientët në industrinë globale të Naftës dhe Gazit Natyror.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një shoqërie të përbashkët, me funksione të plota (joint venture Sensia), nga Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation, Schlumberger B.V., Rockwell Automation Diamond Holdings dhe Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings.

Rockwell Automation Diamond Holdings dhe Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings nuk janë prezentë dhe nuk kanë realizuar të ardhura në Shqipëri.

Schlumberger Limited është prezente në Shqipëri nëpërmjet shitjes së disa produkteve dhe shërbimeve të caktuara në fushën e naftës dhe gazit si, valvulat e projektuara për projektet e tubacioneve të naftës dhe produkteve mbështetëse për aktivitetet e shpimit dhe në një masë më të vogël ka realizuar shitje përmes shërbimeve të marrjes dhe interpretimit së të dhënave gjeofizike dhe softuerëve të inxhinierisë së naftës.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe ky transaksion nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të re, të përbashkët, me funksione të plota (joint venture Sensia) nga Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 619, Datë 09.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacioni përkatës në lidhje me transaksionin që konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (joint venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

Daimler AG, është një shoqëri aksionare e regjistruar në regjistrin tregtar të Shtutgartit, themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Gjerman. Daimler së bashku me filialet e saj, është një prodhues lider global i automjeteve luksoze për pasagjerë dhe tregtie me një prani të fortë në industrinë e automjeteve elektrike.

Daimler AG realizon shitje nëpërmjet përfaqësuesit zyrtar të Mercedes Benz në Shqipëri, shoqërisë Auto Star Albania SHA.

Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd është një shoqëri aksionare e regjistruar në Republikën Popullore të Kinës. Geely është një prodhues kinez lider i makinave në fusha të ndryshme biznesi të lidhur me biznese me prani të fortë në industrinë e automjeteve elektrike.

Shoqëria (Joint Venture), e quajtur **Smart Automobile Co., Ltd** do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës Popullore të Kinës.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së automjeteve dhe pjesëve të këmbimit por duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin si edhe duke iu referuar praktikave më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës mund të lihet i hapur. Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një shoqërie të përbashkët JV me funksione të plota nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group CO., LTD.

Tregu shqiptar nuk do të preket nga transaksioni i propozuar, pasi shoqëria JV nuk ka për qëllim të kryejnë në të ardhmen e parashikueshme ndonjë aktivitet në Shqipëri, prandaj Transaksioni i propozuar nuk ka asnjë impakt për konkurrencën në tregun e brendshëm.

Pas transaksionit nuk do të ketë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmartje të re, të përbashkët, me funksione të plota (joint venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 621, Datë 13.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me nënshkrimin e dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e kuotës”, ndërmjet shoqërisë INFO-Telecom SHPK dhe shoqërisë Albanian Telecommunications Union SHPK.

Blerësi: Albanian Telecommunications Union SHPK, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar më datë 25.02.2010 me objekt aktiviteti zhvillimin dhe funksionimin e telekomunikacioneve/elektronikës në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në zhvillimin e komunikimeve elektronike nëpërmjet transmetimit të sinjaleve përmes komunikimeve elektronike, që përfshin shërbime të telekomunikacioni, televizionit kabllor dhe shërbime të tjera të lidhura me të, zhvillim i linjës tokësore Wireless, etj.

Shitësi: INFO-Telecom SHPK, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar më datë 02.12.2009, me objekt veprimtarie në fushën e komunikimeve elektronike, transmetimit të dhënave dhe internetit, rrjetit dhe shërbimeve për telefoni, shërbime të linjave me qira, shërbime Voip, IP TV etj.

Shoqëria INFO-Telecom SHPK është një nga ortakët e shoqërisë Digicom SHPK.

Shoqëria target: Digicom SHPK është një shoqëri e regjistruar në sipas legjislacionit shqiptar më datë 18.08.2014, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryeje një shoqëri me përgjegjësi të XV / 2019

kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhënash/internet; operator i rrjetit dhe shërbimeve për telefoni publike të qëndrueshme (telefoni fikse); shërbime të transmetimit të të dhënave; shërbime të linjave me qira; shërbim telefonie me kartë të parapaguar; shërbim Voip; shërbime të transmetimit të të dhënave (data), IP TV, etj.

Referuar marrëveshjes mes palëve dhe pasqyrave financiare të vitit 2017, transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar duke u bërë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, treg përkatës u konsiderua tregu i shërbimeve me pakicë të komunikimeve elektronike, konkretisht tregu me pakicë i shërbimeve të internetit, telefonisë fikse dhe IP TV, dhe tregu përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i drejtpërdrejtë i kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK .

Ky transaksion është rasti i një përqendrimi vertikal, ku ndërmarrjet pjesëmarrëse ushtrojnë veprimtari në nivele të ndryshme të zinxhirit të produktit. Pas realizimit të transaksionit pritet të ketë rritje të efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit, të mundësisë së transmetimit dhe shpërndarjes të kapaciteteve profesionale nga përdorimi i teknologjisë FTTH.

Si konkluzion ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë DigiCom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 622, Datë 13.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me blerjen e 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacioni përkatës në lidhje me blerjen e 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.

Pala Blerëse: Besniku SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 15.03.1999, me objekt të aktivitetit tregtim mallrash e produktesh bujqësore e blegtorale me shumicë dhe pakicë, import-eksport i tyre, prodhim, stampim e fabrikim i miellrave të llojeve të ndryshme, tregtim me shumicë dhe pakicë i tyre, grumbullim e përpunim bimësh bujqësore e medicinale, etj. Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm Z. Dervish Domi

Pala Shitëse: Atlas Mills SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 03.04.2018, me objekt të aktivitetit kryesisht në përpunimin, prodhimin, paketimin dhe tregtimin e miellit, operimin në biznese industriale dhe tregtare që kanë lidhje me industrinë e miellit, marketingun e grurit dhe prodhimet e tjera bujqësore, etj. Shoqëria zotërohet nga z. Dimitrios Thomoglou.

Me vendim e Asamblesë së Përgjithshëm të shoqërisë Atlas SHA, aksionaret e shoqërisë vendosën të miratonin transferimi i biznesit (veprimtarisë ekonomike) të përpunimit dhe tregtimit të miellit nga Atlas SHA tek shoqëria Atlas Mills SHPK. Shoqëria Atlas SHA është një shoqëri aksionare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në vitin 1995, me objekt përdorimin e një fabrike mielli dhe operimin në biznese industriale edhe tregtare të lidhura me industrinë e miellit, prodhimin e ushqimeve të kafshëve dhe të grurit në përgjithësi.

Në datë 28 Shtator 2018, zotëruesit e shoqërive Atlas Mills SHPK dhe Besniku SHPK, kanë lidhur marrëveshjen “Kontratë Shitje Kuotash”, ku Z. Dimitrios Thomoglou (shitësi), në cilësinë e pronarit të “kuotës” së kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK i shet shoqërisë Besniku SHPK (blerësi) kuotën e vetme të kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK kuotë e cila rezulton të jetë 100% e kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Mbështetur në veprimtarinë e palëve në transaksion si dhe referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i importit të grurit, tregu i importit të miellit dhe tregu i përpunimit dhe tregtimit të miellit dhe treg përkatës gjeografik konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i importit të grurit

Në Shqipëri, nevojat për grurë sigurohen nga tregu ndërkombëtar dhe prodhimi vendas, ku pjesën më të madhe të grurit të importuar e përbën gruri i zakonshëm i cili shërben si lëndë e parë për ndërmarrjet e prodhimit dhe tregtimit të miellit.

Tregu i importit të grurit rezulton të jetë një treg mesatarisht i përqendruar me një indeks përqendrimi në vlerën XXX. Konkurrentët kryesor në tregun e importit të grurit janë shoqëria [...] SHPK e cila zotëron XX% të tregut, shoqëria [...] me XX% të tregut dhe shoqëria [...] me XX% të tregut. Në treg operojnë edhe 52 shoqëri të tjera, ku 40 prej tyre zënë pjesë tregu më të vogël se XX%.

Besniku SHPK zë XX% të këtij tregu ndërsa Atlas SHA zë XX%. Pjesa e kombinuar e tregut e Besniku SHPK dhe Atlas SHA shkon në XX%.

Duke ju referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) për periudhën janar-shtator 2018 për importin e grurit, rezulton se shoqëria Besniku SHPK ka rritur sasinë e grurit të importuar nga XXX ton në vitin 2017 në XXX ton për periudhën janar-shtator 2018, ku tregohet qarte se shoqëria po përgatitet për hyrjen në tregun e përpunimit të grurit, ndërkohë që Atlas SHA nuk ka realizuar importe për të njëjtën periudhë të vitit 2018.

Tregu i importit të miellit

Oferta në treg për miell mbulohet nga importi i miellit si dhe prodhimi i miellit nga fabrikat përpunimit të grurit.

Duke ju referuar të dhënave të DPD, tregu i importit të miellit ka mbuluar për vitin 2017 rreth XX% të nevojave ose rreth XX mijë ton miell.

Tregu i importit të miellit rezulton të jetë një treg mesatarisht i përqendruar me një HHI XXX. Konkurrentët kryesor në tregun e importit të miellit janë shoqëria [...] e cila zotëron XX% të tregut, shoqëria [...] me XX% të tregut dhe shoqëria [...] me XX% të tregut.

Atlas SHA zë XX% të tregut. Pjesa e kombinuar e tregut e Besniku SHPK dhe Atlas SHA shkon në XX%.

Tregu i përpunimit dhe tregtimit të miellit

Tregu i prodhimit të miellit mund të konsiderohet si treg mesatarisht i përqendruar me një indeks përqendrimi në vlerën XXX. Prodhuesit kryesor janë [...] me XX% të tregut, [...] me XX% të tregut secili, dhe [...] me XX% të tregut.

Atlas Mills SHPK nuk ka ekzistuar në tregun e prodhimit të miellit për vitin 2017, por shitja e aktivitetit ekonomik nga Atlas SHA në Atlas Mills SHPK i ka ofruar Atlas Mills SHPK një pjesë prej XX% të tregut të prodhimit të miellit. Besniku SHPK nuk është prezent në këtë treg.

Pas transaksionit, pala blerëse do të marrë në shfrytëzim një fabrike të përpunimit të grurit dhe prodhimit të miellit duke hyrë në tregun e prodhimit të miellit në vend dhe për rrjedhojë edhe në tregun e importit të grurit.

Nga analiza e strukturës së tregut përkatës së produktit konkludojmë se, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime domethënëse në tregun shqiptar. Pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit nuk krijon shqetësime për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100 % të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 624, Datë 31.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Pala Blerëse: Saudi Arabian Oil Company, është një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite me Nr. regjistri kryesor 2052101150, datë 27.03.2018. Shoqëria Saudi Arabian Oil Company ushtron kryesisht të gjitha aktivitetet në lidhje me fushat e energjisë, duke përfshirë industrinë e hidrokarbureve, kimikateve, industri të tjera në lidhje me të ose plotësuese për të ose çdo aktivitet tjetër brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.⁸

Në Shqipëri shoqëria Saudi Arabian Oil Company nuk ka filial të regjistruar.

Pala Shitëse: Saudi Basic Industries Corporation, është një shoqëri aksionare publike e themeluar datë 06.09.1976 sipas legjislacionit Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe është aktive kryesisht në industrinë petrokimike, plehut, hidrokarburet, hekur, çelik, alumin, industri të tjera, projekte që përmbushin nevojat e shoqërisë, si lënda e parë, marketingu i produkteve brenda dhe jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite.⁹

⁸ Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Arabian Oil Company

⁹ Regjistër Ekstrakti i shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation

Shoqëria Saudi Basic Industries Corporation nuk ka filial në Shqipëri. Aktiviteti i saj përfshin kryesisht furnizimin nëpërmjet distributorëve të tij, të produkteve të prodhuara në Mbretërinë e Arabisë Saudite për klientë që ndodhen në Shqipëri duke shitur polietilen dhe polipropilen në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli i shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I. tregu përkatës i produktit, dhe
- II. tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit: Sa më sipër duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të Saudi Basic Industries Corporation nga Saudi Arabian Oil Company.

Saudi Arabian Oil Company nuk operon në Shqipëri.

Saudi Basic Industries Corporation nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar në Shqipëri por ajo realizon të ardhura nga shitjet e polietilen dhe polipropilen, shitje këto të cilat realizohen përmes qendrës së saj logjistike në Selanik, Greqi.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 625, Datë 31.05.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me blerjen e 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH,

VËREN SE:

Procedura dhe transaksioni

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacioni përkatës në lidhje me blerjen e 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH.

Blerësi: Mol Germany GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 10.09.1981 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: tregtinë e mallrave të të gjitha llojeve, në veçanti shpërndarja dhe tregtia e produkteve të naftës dhe produkteve petrokimike.¹⁰

Shitësi 1: A+P Vermögensverwaltungs GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 02.08.2000 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: blerja, mbajtja dhe menaxhimi i investimeve në shoqëri të tjera, si dhe menaxhimi i pasurive të veta.

Shitës 2: Z.Gerhard Schweinle është aksionar i vetëm i shoqërisë Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe shoqërisë Aurora Kunststoffe VS GmbH.

¹⁰ Ekstrakti i regjistrimit të shoqërisë Mol Germany GmbH
XV / 2019

Target 1: Aurora Kunststoffe GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 20.07.2009 sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: riciklimin dhe tregtimin e plastikës, përpunimi i të gjitha termoplastikave, prodhimi i cilësisë së lartë të materialeve të rënda, regranulave dhe të lëndës së parë, tregtia e mallrave industriale përveç mallrave që i nënshtrohen autorizimit.

Target 2: Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 19.03.2014, sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt: tregtinë e mallrave të të gjitha llojeve përveç mallrave që i nënshtrohen licensës; qiraja e automjeteve dhe pajisjeve dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e bluarjes dhe klasifikimit të plastikës.

Target 3: Aurora Kunststoffe VS GmbH, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më datë 25.04.2014, sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt: tregtinë e mallrave të të gjitha llojeve përveç mallrave që i nënshtrohen licensës; qiraja e automjeteve dhe pajisjeve dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e bluarjes dhe klasifikimit të plastikës.

Më datë 03 prill 2019, palët pjesëmarrëse në transaksion kanë lidhur marrëveshje “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve të Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH”, ku shitësit kanë rënë dakort t’ia shesin dhe transferojnë të gjitha aksionet e emetuara shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH blerësit dhe blerësi ka rënë dakort të blejë dhe të pranojë transferimin e këtyre aksioneve në dhe sipas kushteve të kësaj marrëveshje.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

- I. tregu përkatës i produktit, dhe
- II. tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit: Sa më sipër duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfshirë i kontrollit të Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga MOL Germany GmbH.

Shoqëritë Target Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nuk operojnë në Shqipëri.

MOL Germany GmbH, pjesë e Grupit MOL nuk ka prezencë fizike apo shoqëri të regjistruar në Shqipëri por ajo realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të shoqërive Aurora Kunststoffe GmbH, Aurora Kunststoffe Walldürn GmbH dhe Aurora Kunststoffe VS GmbH nga shoqëria Mol Germany GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 631, Datë 20.06.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC..

Pala blerëse: A-PQ Holdings LLC, është një shoqëri/filial i zotëruar tërësisht nga Atairos Group dhe Cambridge Information Group, me qëllim përfundimin e transaksionit të blerjes jashtë vendit.

Atairos Group është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përqendruar në mbështetjen e bizneseve drejt rritjes në një gamë më të gjerë industrish, të tilla si financa, teknologjia, media, telekomunikacioni, shërbimet e biznesit dhe argëtimit familjar.

Comcast mban një interes pa të drejtë vote tek Atairos Group nëpërmjet Comcast AG Holding LLC dhe Comcast Spectator Ventures LLC, dy entitete tërësisht në pronësi të Comcast. Ky interes përfaqëson shumicën e konsiderueshme të interesit ekonomik (përafërsisht 98%) tek Atairos Group.

Comcast operon me dy biznese parësore: Comcast Cable dhe NBCUniversal (NBCU). NBCU është një media dhe biznes argëtimi dhe ofron shërbimin brenda Shqipërisë, nëpërmjet shitjes së produkteve dhe shpërndarjen e filmave dhe përmbajtjeve televizive, shpërndarjen me shumicë të kanaleve të lajmeve të biznesit të CNBC, furnizimi me përmbajtje televizive për konsumatorët përfundimtarë, që në rastin e Shqipërisë është vetëm nëpërmjet shitjeve *de-minimis* të kanaleve që transmetojnë lajme biznesi direkt tek hotelet dhe shoqëritë e shërbimit financiar dhe licencimi i pronësisë intelektuale të prodhuesve dhe shpërndarësve të produkteve të

konsumit, duke përfshirë ato të lidhura me përmbajtjen e prodhuar nga psh: Illumination dhe Dream Works Animation.

Cambridge Information Group është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aksionare e shoqërisë target ProQuest Holdings LLC.

Pala shitëse: Goldman Sachs Inc (GS) është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila aktualisht zotëron afërsisht 38.45% të aksioneve në shoqërinë target ProQuest Holdings LLC. Goldman Sachs Inc është një shoqëri bankare e cila ofron shërbime bankare investimi, tregti dhe investimi kryesore dhe administrimi i aseteve dhe shërbimet e letrave me vlerë.

Shoqëria Target: ProQuest Holdings LLC, ku ProQuest LLC është shoqëria operuese, shoqëri e organizuar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përftim kontrolli i shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Atairos Group ofron mbështetje për biznese në fusha të tilla si financa, teknologjia, media, telekomunikacioni, shërbimet e biznesit dhe argëtimit familjar.

Cambridge Information Group (CIG) ushtron aktivitetin e saj në fushën e shërbimeve të informacionit, arsimit dhe teknologjisë.

Goldman Sachs Inc (GS) është një shoqëri bankare dhe zyrë investimi globale në letra me vlerë dhe administrim investimesh e cila ofron një larmi shërbimesh bankare, letrash me vlera si dhe shërbime investimi ndërkombëtar ndaj klientëve të shumtë, të cilët janë korporata, institucione financiare, qeveri dhe individë në pozicione të larta.

ProQuest Holding LLC ka si aktivitet mbështetjen, kërkimin dhe mësimin, botimin dhe shpërndarjen, si dhe blerjen, menaxhimin dhe zbulimin e koleksioneve të bibliotekave.

Në Shqipëri, shoqëritë Comcast Cable dhe NBC Universal (NBCU), të kontrolluar në mënyrë indirekte nga Atairos Group, ofrojnë shërbimin e shpërndarjes së transmetimeve televizive për konsumatorët përfundimtarë, shpërndarjen me shumicë të kanaleve të lajmeve të biznesit të CNBC etj.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur. Treg përkatës gjeografik u konsiderua territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërisë ProQuest Holding LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të ProQuest Holding LLC nga shoqëria A-PQ Holdings LLC.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 648, Datë 19.09.2019

“Për mos klasifikimin si përqendrim të njoftimit mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB dhe dhënien e rekomandimeve Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.09.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB.

Baza ligjore: Nenet 2, 10-12, 15, neni 24, germa d), nenet 53-64, neni 69 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB,

VËREN SE:

Procedura dhe Transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me përfitim e kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB.

Referuar dy marrëveshjeve të lidhura në datë 25 qershor 2019 “Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve”, palët në transaksion janë:

Blerësi: Diaverum International AB, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar sipas legjisllacionit të Suedisë, më datë 28.06.2011, me aktivitet pronësinë dhe administrimin e aksioneve dhe letrave me vlerë dhe aktivitete të tjera të ngjashme me to, me kapital aksionar i cili nuk do të jetë më i vogël se 50.000 sek (korona suedeze) dhe jo më shumë se 200,000 sek (korona suedeze), sipas Aktit të Themelimit.

Sipas dokumentacionit të depozituar, shoqëria është një shoqëri holding e cila nuk realizon shitje te produkteve dhe/ ose shërbimeve specifike.

Diaverum International AB nuk ushtron aktivitet në Shqipëri, nuk ka degë apo filial dhe sipas dokumenteve dhe formularëve të njoftimit të depozituar nga pala njoftuese, shoqëria nuk ka realizuar xhiro nga aktiviteti i saj si në tregun ndërkombëtar ashtu dhe në atë të brendshëm.

Shitësit: Evita SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjisllacionit të Shqipërisë me NIPT L31714005J, regjistruar datë 14.05.2013. Objekti i veprimtarisë është import-eksport dhe

tregtim me shumicë dhe pakicë i produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumenteve dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtimi me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve si dhe aksesorëve të tyre, etj. Investime, shërbime, projekte në fushën e mjekësisë dhe shëndetit. Ngritja dhe menaxhimi i klinikave private.

Evita SHPK zotëron 85% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

American Hospital SHA, është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë me NIPT K61821002C, regjistruar datë 17.02.2006. Objekti i veprimtarisë është investime dhe shërbime në fushën e mjekësisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, importimi dhe eksportimi i materialeve të ndryshëm. Industria e ndërtimit, shitblerje, dhënie ose marrje me qira. Riparim i pajisjeve dhe punëve obliguese në montim. Përgatitje projektesh. Konsulencë teknike në fushën e ndërtimit dhe fusha të tjera, projektimi i pyjeve, etj. Tregtim me shumicë të aparaturave mjekësore/pajisje, tregtim me pakicë i barnave.

American Hospital SHA zotëron 15% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

Target: DiaVita SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë, me NIPT L52305009L, e krijuar më datë 15.10.2015, me kapital themeltar 1.000.000 (një milion) Lekë. Objekt i aktivitetit të kësaj shoqërie është zbatimi i kontratës së koncesionit/PPP "Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhe, Korçë, Vlore dhe Elbasan". Kjo kontratë është nënshkruar më 10 shkurt 2016 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë DiaVita SHPK dhe është bërë efektive në qershor të vitit 2016.

Nga vlerësimi i palëve në transaksion si dhe tregun në të cilën ndodh transaksioni, vihet re se shoqëria target DiaVita SHPK, është zbatuese e kontratës së koncesionit të hemodializës, lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë "Diavita" SHPK, datë 10 shkurt 2016, shoqëria e cila synon të ndryshojë kontrollin e saj.

Në funksion të vlerësimit të transaksionit dhe në zbatim të nenit 55 të ligjit nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, me shkresën nr. 410/3, datë 30.07.2019 "Kërkesë për informacion", i është kërkuar palës njoftuese plotësimi i dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve" dhe Udhëzimin "Mbi formën e njoftimit të përqendrimit" në lidhje me: pasqyrat financiare të palëve shitëse; të dhëna të hollësishme mbi arsyet ekonomike të përqendrimit; si dhe përfitimet që do të sjellë për tregun dhe konsumatorët ky transaksion.

Dokumentacioni i depozituar nga pala njoftuese, i cili konsistonte në të dhëna mbi palën blerëse, ishte i paqartë në lidhje me referencat në emërtimet e përdorura për shoqërinë blerëse, si dhe për objektin e veprimtarisë së saj.

Me shkresën tonë nr. 410/14 prot, datë 02.09.2019 "Kërkesë për informacion", palës njoftuese iu kërkuar dokumentacion për palën blerëse në lidhje me adresën zyrtare të shoqërisë "Diaverum International AB"; pasqyrat financiare të shoqërisë "Diaverum International AB" dhe xhiroja e saj në tregun ndërkombëtar për vitin e fundit financiar; statuti i shoqërisë "Diaverum International AB", ortakët themelues të shoqërisë "Diaverum International AB" dhe struktura aktuale e ortakërisë; kuota e secilës ndërmarrje ose person në shoqërinë "Diaverum International AB" dhe mënyra e ushtrimit të të drejtës së kontrollit në këtë strukturë.

Për shoqërinë target dhe palën blerëse u kërkuar informacion mbi blerjet e realizuara prej tyre gjatë 3 viteve të fundit në tregjet e prekura të produktit si dhe kopje të analizave/ raporteve/ studimeve/ vëzhgimeve dhe çdo dokument i krahasueshëm me to, hartuar për organet drejtuese të ndërmarrjeve respektive, me qëllim vlerësimin dhe analizën e përqendrimit, i cili përfshin vlerësime në lidhje me pjesët e tregut, kushtet e

konkurrencës efektive, konkurrentët faktikë (ose potencial), arsyet e përqendrimit, etj., shoqëruar me emrat përkatës të personave që kanë përgatitur këto materiale, pozicion dhe datën e përgatitjes së tyre.

Dokumentacioni i paraqitur nga pala njoftuese, nuk i dha përgjigje pyetjeve dhe kërkesave të AK, të parashtruar në shkresën tonë nr. 410/14 prot, datë 02.09.2019 “Kërkesë për informacion” se:

1. Cilët janë ortakët themelues të ndërmarrjes “Diaverum International AB” dhe struktura aktuale e ortakërisë.
2. Cila është kuota e secilës ndërmarrje ose person në shoqërinë “Diaverum International AB” e cila është blerëse në këtë transaksion, dhe si ushtrohet e drejta e kontrollit në këtë strukturë.
3. Nuk paraqiti për palët pjesëmarrëse në transaksion – “Diavita” SHPK dhe “Diaverum International AB”, kopje të analizave/raporteve/studimeve/vëzhgimeve dhe çdo dokument i krahasueshëm me to, hartuar për organet drejtuese të ndërmarrjeve respektive, me qëllim vlerësimin dhe analizën e përqendrimit, i cili përfshin vlerësime në lidhje me pjesët e tregut, kushtet e konkurrencës efektive, konkurrentët faktikë (ose potencial), arsyet e përqendrimit, etj., shoqëruar me emrat përkatës të personave që kanë përgatitur këto materiale, pozicion dhe datën e përgatitjes së tyre.

Nga ana tjetër, Statuti i cili është dokumenti themeltar i një shoqërie tregtare, nuk është paraqitur gjatë gjithë kësaj procedure për shoqërinë Diaverum International AB, pavarësisht se paraqitja e tij përbën një kërkesë të domosdoshme në funksion të respektimit të kuadrit ligjor, për të vlerësuar një transaksion, dhe për ti dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme.

Nga ana e palës njoftuese, gjatë kësaj procedure nuk është paraqitur edhe plani i biznesit të shoqërisë blerëse Diaverum International AB, pavarësisht nga kërkesat e vazhdueshme të AK me shkresën nr. 410/3, datë 30.07.2019 “Kërkesë për informacion” dhe shkresën nr. 410/14 prot, datë 02.09.2019 “Kërkesë për informacion”, duke e bërë të pamundur që AK të vlerësojë aftësinë konkurruese të shoqërisë që do të mbajë në vazhdimësi kontratën e koncesionit, si do të zhvillohet në të ardhmen kjo kompani, çfarë përfitimesh do të rezultojnë për konsumatorin në mënyrë direkte pas realizimit të transaksionit.

Duke qenë se shoqëria target, DiaVita SHPK, është mbajtëse e një kontratë koncesioni, me shkresën Nr. 410/4, datë 30.07.2019 “Kërkohet informacion dhe dokumentacion” drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), u kërkua dokumentacioni mbi: procedurat e ndjekura nga autoriteti kontraktor në lidhje me transaksionin e njoftuar; dhënien e pëlqimit paraprak si autoritet kontraktor në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”; raportin e monitorimit të koncesionit me qëllim vlerësimin e aktivitetit të deritanishëm të kompanisë koncesionare; si dhe planin e biznesit të shoqërisë blerëse me qëllim vlerësimin e aftësisë konkurruese të shoqërisë që pritet të hyj në tregun e shërbimit të hemodializës.

Në përgjigje të kërkesës sonë, me shkresën nr. 3935/1, datë 31.07.2019 “Kthim përgjigje”, prot pranë AK me nr. 410/5, datë 31.07.019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në shkresën e saj deklaron se ka paraqitur:

1. Dhënien e pëlqimit si autoritet kontraktor për transferimin e aksioneve të shoqërisë Evita SHPK dhe Spitali Amerikan SHA tek Diaverum International AB. MSHMS nëpërmjet shkresës Nr. 127/40 Prot., datë 25.07.2019 “Kthim përgjigje”, drejtuar administratorit të DiaVita SHPK, shprehet: “dakord për vazhdimin e procedurës të ndryshimit të strukturës së ortakërisë së shoqërisë koncesionare Diavita SHPK”
2. Raportin e monitorimit të Njësisë së Zbatimit të Koncesionit për periudhën që ka operuar koncesionari Diavita SHPK.

3. Planin e biznesit të shoqërisë Diaverum International AB dhe deklaratën e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas kontratës së koncesionit si dhe Deklaratën e koncesionarit Diavita SHPK.

Dokumentacioni i mësipërm nuk i përgjigjet kërkesave të parashtruara nga Autoriteti Konkurrencës me shkresën Nr. 410/4, datë 30.07.2019 “Kërkohet informacion dhe dokumentacion”, kundrejt MSHMS, pasi ky dokumentacion nuk përmban :

1. Raportin e monitorimit të Njesisë së Zbatimit të Koncesionit për periudhën që ka operuar koncesionari Diavita SHPK.
2. Planin e biznesit të shoqërisë Diaverum International AB.

Dokumentacioni i paraqitur nga MSHMS, ishte i paqartë dhe i paplotë.

MSHMS, në zbatim të nenit 32, pika 1 të Ligjit Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht: *“Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveçse nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm”,* duhet që të shprehet në mënyrë explicite për transferimin e kontratës së koncesionit, si autoriteti kontraktor, në përputhje me kërkesat e këtij neni.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 647 datë 09.08.2019 “Për miratimin paraprak më shkrim nga MSHMS të transferimit të kontratës së koncesionit të shoqërisë DiaVita SHPK “Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan”, i kërkoi MSHMS, që në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr.125/2013” Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar të shprehet në shkrim për miratimin paraprak të transferimit të kontratës së koncesionit nga Shoqëria “DiaVita” SHPK, tek shoqëria “Diaverum International AB”, në respektim të kriterëve të përshtatshmërisë të parashikuar shprehimisht në këtë dispozitë .

Në pjesën arsyetuese të vendimit të tij, Komisioni i Konkurrencës evidentoi se transaksioni midis palëve të mësipërme, ka si palë blerëse shoqërinë “Diaverum International AB”, e cila sipas Aktit të themelimit (paraqitur pranë AK), ka si objekt të veprimtarisë së saj zotërimin dhe administrimin e aksioneve, letrave me vlerë dhe aktivitetet e lidhura me to.

Në përgjigje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, MSHMS me shkresën nr. 127/46 prot datë 22.08.2019, protokolluar në AK me nr. 410/13 datë 23.07.2019 “Kthim përgjigje”, informon Autoritetin mbi procedurën e ndjekur në lidhje me ndryshimin e strukturës aksionare të shoqërisë koncesionare duke ju referuar gjithë korrespondencës shkresore të paraqitur më parë pranë AK me shkresën nr. 3935/1, datë 31.07.2019 “Kthim përgjigje”, prot pranë AK me nr. 410/5, datë 31.07.019.

Nga MSHMS nuk u paraqit asnjë dokumentacion shtesë, në zbatim të Vendimit nr. 647 datë 09.08.2019 të Komisionit të Konkurrencës.

Dokumentacioni i paraqitur, në emrat e përdorur për palën blerëse është i paqartë, ai i referohet shoqërisë blerëse Diaverum International AB, si një shoqëri e cila ka objekt të veprimtarisë së saj shërbimin e hemodializës, kur objekti i veprimtarisë së saj, ashtu siç rezulton nga Akti themelimit është zotërimi dhe administrimi i aksioneve, letrave me vlerë dhe aktivitetet e lidhura me to.

Vlerësimi i Transaksionit

Procedura e vlerësimit të një përqendrimi sipas parashikimeve të neneve 53-64 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, realizohet në zbatim të nenit 10 dhe 12 të ligjit i cili parashikon ndryshimin e kontrollit të shoqërisë.

Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve, e lidhur në datë 25 qershor 2019 midis palës blerëse Diaverum International AB dhe 2 shitëseve: Evita SHPK, zotërues i 85% të kapitalit dhe American Hospital SHA zotërues i 15% të kapitalit do të sjellë ndryshim të kontrollit të shoqërisë Diavita SHPK ku pas transaksionit kjo e fundit do të zotërohet tërësisht nga Diaverum International AB.

Referuar dokumentacionit të depozituar, pala blerëse, Diaverum International AB është një shoqëri holding, e cila ka si aktivitet vetëm zotërim dhe administrimi i aksioneve, letrave me vlerë dhe aktivitetet e lidhura me to. Mbështetur në teorinë ekonomike, këto lloj shoqëri holding nuk prodhojnë dhe as shesin produkte dhe/ose shërbime.

Ligji nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 10, përkufizon se: “Njësi ekonomike financiare tip “holding” janë njësitë ekonomike që kanë për objekt të vetëm marrjen e pjesëve të kapitalit ose aksioneve të njërive të tjera dhe administrimin e këtyre pjesëve dhe aksioneve, për t’i shndërruar në fitim, pa u përfshirë vetë drejtpërdrejt ose tërthorazi në administrimin e këtyre njërive, por pa cenuar të drejtat e tyre si aksionarë.

Referuar nenit 15 pika 1 ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar “xhiroja totale përbëhet nga shuma e përfituar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse prej shitjes së produkteve në të gjithë veprimtarinë e zakonshme të ndërmarrjeve...”. Produkt sipas ligjit është çdo mall i shitur ose i blerë ose çdo shërbim i ofruar në treg nga ndërmarrjet.

Sipas pasqyrave financiare të shoqërisë Diaverum International AB për vitin 2018, shoqëria ka përfituar vetëm fitime/dividentë nga aksionet që zotërojnë në ndërmarrjet e grupit.

Përfaqësuesi i palës njoftuese, deklaron se “*Xhiroja e shoqërisë Diaverum International AB në 2018 ndërkombëtarësh dhe në Shqipëri ka qenë në vlerën 0, duke qenë një Shoqëri Holding*”.

Në zbatim të nenit 12, pika 1, germa a), të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, që një transaksion i njoftuar të marrë një autorizim në Autoritetin e Konkurrencës, xhiroja e palëve pjesëmarrëse në transaksion në tregun ndërkombëtar duhet të jetë me shumë se 7 miliard lekë.

Nga dokumentacioni i depozituar në datë 10.09.2019, konstatohet se pala blerëse Diaverum Internacional AB nuk ka realizuar xhiro në tregun ndërkombëtar duke mos përmbushur kriterin e xhiros së parashikuar në ligj.

Nga sa më sipër, u konstatua së transaksioni i njoftuar i ndryshimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK, nuk përmbush kriteret e parashikuar në ligj për marrjen e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në zbatim të neneve 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, të mos klasifikojë si përqendrim përfitim të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga Diaverum International AB.
 2. T’i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, transferimi i çdo të drejte ekskluzive ose te veçantë të shoqërohet nga vlerësimi i kriterit të përshtatshmërisë sipas parashikimeve ligjore.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhet pagesa.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 653, Datë 17.10.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj.

Blerësi 1: Z. Aleksandër Frangaj, individ, i cili zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 43.000,00 (dyzet e tre mijë) aksione.

Aleksandër Frangaj në të njëjtin treg, zotëron XX% të kapitalit tek shoqëria [...], regjistruar me datë 22.09.2004, me objekt aktiviteti : shitjen dhe blerjen e të drejtave televizive, filmave, programeve, cikleve, aktiviteteve të ndryshme sportive, publicitet dhe marketing në fushën e reklamave, të auditimit të spoteve publicitare, publikim, prodhim programesh të ndryshme tematike, televizive pa kufizime etj; -zotëron XX% të kapitalit tek shoqëria [...], regjistruar më datë 05.07.2000 me objekt aktiviteti : Organizim i lojrave të fatit, i lotos, konkurs i parashikimeve të sportive, llotaria e numrave dhe llotari e çastit; -zotëron XX% të kapitalit tek shoqëria [...], regjistruar më datë 15.07.2005 me objekt aktiviteti : prodhime televizive, publicitete, në fushën e prodhimit muzikë, audio-video etj; - zotëron XX% të kapitalit tek shoqëria [...], regjistruar më datë 12.02.1997 me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e mediave televizive;

Blerësi 2: Znj. Alba Gina, individ, e cila zotëron 20% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 43.000,00 (dyzet e tre mijë) aksione.

Alba Ginaj, në të njëjtin treg, zotëron XX% të kapitalit tek shoqëria [...], regjistruar më datë 12.02.1997 me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e mediave televizive.

Shitësi: Z.Redi Sata, individ, i cili zotëron 60% të kapitalit të shoqërisë ABC News SHA përkatësisht 129.000,00(njëqind e njëzet e nëntë mijë) aksione me vlerë nominale 1000(njëmijë) lekë.

Shoqëria Target: ABC News SHA, është një shoqëri anonime, e regjistruar më datë 10.05.2000, themeluar më datë 19.04.2000, e cila zhvillon aktivitetin e saj sipas licencës nr.037/TVL “Për Televizionin Privat Vendor”, i licencuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me objekt të veprimtarisë; aktivitetin radioteleviziv privat duke përfshirë prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit, të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablllove, përsëritësve, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përftim kontrolli i shoqërisë ABC News SHA nga Z.Aleksandër Frangaj dhe Znj.Alba Ginaj.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës” përfshin dy komponentë:

I. tregu përkatës i produktit, dhe

II. tregu përkatës gjeografik.

- **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet **tregu i transmetimeve audiovizive**.
- **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *tregu përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i **Republikës së Shqipërisë**.

Transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe transmetimet numerike rregullohen me Ligjin Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 22/2016 datë 10.3.2016, ndryshuar me Vendimin nr. 56 datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA, në përmbushje të kompetencave të veta, rregullon dhe mbikëqyr veprimtarinë audio dhe audiovizive në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke garantuar konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike.

Licencimi i Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) mbështetet në Ligj si dhe në Rregulloren për Kriteret dhe Procedurat për Dhënie të Licencës Kombëtare të Transmetimit Audioviziv dhe Licencës Kombëtare të Shërbimit të Programit Audioviziv.

Shërbimet audiovizive në Shqipëri për nga natyra e pronësisë janë: - Shërbime publike, transmetuesi publik, RTSH ofron shërbime radiofonike dhe televizive kombëtare dhe lokale. - Shërbime private - Shërbime jo tregtare, subjektet audio të komunitetit, deri tani janë 4 subjekte të licencuar për këtë shërbim audio jofitimprurës, dhe subjektet përsëritës.

Rreth 75% e subjekteve televizive rezultojnë të jenë në pronësi të një aksionari të vetëm, ndërsa pjesa tjetër (25%) e subjekteve përbëhet nga më shumë se një aksionar. Ndërkohë, 30% e subjekteve me përbërje mbi një aksionar zotërojnë mbi 50% të vlerës së aksioneve.

Referuar të dhënave të deklaruar nga AMA për vitin 2018 rezulton se TV Klan zotëron XX% të tregut duke u renditur si operatori i parë në treg, Top Channel zotëron XX% të tregut ndërsa Media Vizion zotëron XX% të tregut.

ABC News zotëron vetëm XX% të tregut të transmetimeve audiovizive.

Pas përqendrimit pjesa e tregut e kombinuar e TV Klan dhe ABC News do të kapë shifrën e XX% të tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ABC News SHA nga Z. Aleksandër Frangaj dhe Znj. Alba Ginaj.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 654, Datë 23.10.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Blerësi: OTP Bank Nyrt, shoqëri aksionare e krijuar sipas legjislacionit të Hungarisë. OTP Bank Nyrt është një shoqëri që ofron shërbimet e saj financiare universale nëpërmjet një sërë filialesh në Evropën Qendrore dhe Lindore. Aktivitetet e OTP Bank Nyrt janë ndërmjetësim monetar si dhe qira financiare, aktivitete të tjera të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensioneve; brokerimi i kontratave të letrave me vlerë; aktivitete të tjera ndihmëse të shërbimeve financiare, përveç fondit të sigurimeve dhe pensionit; aktiviteti i agjentëve dhe brokerave të sigurimit; aktiviteti i menaxhimit të fondeve; aktiviteti i kontabilitetit; llogari-mbajtjes dhe auditimit, konsulencës fiskale; qiradhënia dhe operimi i pasurive të paluajtshme në pronësi ose me qira.

OTP Bank Nyrt zotërohet prej (në masën më shumë se 5%) nga Hungarian Oil and Gas Company Ltd (MOL); Kafijat Ltd; OPUS Securities SA dhe Gopama Gan Vie SA;

Me vendimin nr.20, datë 13.3.2019 “Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga OTP Bank Nyrt, Hungari, të 88.89% të kapitalit aksionar të bankës Société Générale Albania SHA” të Bankës së Shqipërisë” dhe miratimit nga Banka e Shqipërisë, OTP Bank Nyrt është një bankë aktive në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SHA.

Shitësi: Soci t  Generale,  sht  n j  shoq ri anonime, e themeluar sipas legjislacionit t  Franc s, m  dat  07.10.1955, me kapital XXXX Euro.

Soci t  Generale  sht  n j  nga organizatat m  t  m dha p r ofrimin e sh rbimeve financiare n  Evrop . Aktivitetet e saj p rfshijn  sh rbime bankare p r konsumator t, kredi p r sht pi, kredi personale, depozita personale; sh rbime bankare p r korporatat dhe investime, kredi, depozita, llogari bankare p r entitete juridike; sh rbime financiare; sh rbime bankare private; menaxhimi i aseteve; sh rbime me letrat me vler  etj.

Shqip ri: Soci t  Generale nuk  sht  m  prezente dhe nuk ushtron asnj  aktivitet tregtar n  Shqip ri.

Shoq ria target: SKB Banka d.d. Ljubljana,  sht  n j  shoq ri aksionare e themeluar sipas legjislacionit t  Sllovenis , me seli n  Lubjan , Slloveni, e regjistruar m  dat  29.12.1989, me kapital themeltar XXXX Euro.

Soci t  Generale zot ron n  m nyr  direkte 97.58% t  aksioneve t  shoq ris  target SKB Banka dhe n  m nyr  indirekte, n p rmjet G n finance SASU, 2.14% t  aksioneve t  shoq ris  target.

Shoq ria SKB Banka d.d. Ljubljana, zot ron filialin e SKB Leasing d.o.o, dhe SKB Leasing Select d.o.o. n  Slloveni.

Shoq ria SKB Banka nuk  sht  prezente n  Shqip ri.

Vler simi i p rqendrimit

Transaksioni  sht  n j  p rftim kontrolli i shoq ris  SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoq ria OTP Bank Nyr. t.

Pal t n  transaksion plot sojn  kriteret e p rcaktuar n  nenin 10 dhe nenin 12 t  Ligjit Nr. 9121, dat  28.07.2003 "P r Mbrojtjen e Konkurrenc s", i ndryshuar dhe si rrjedhoj  ky transaksion  sht  objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrenc s.

Referuar nenit 3, pika 7, t  Ligjit Nr. 9121, dat  28.07.2003 "P r Mbrojtjen e Konkurrenc s", i ndryshuar, si edhe Udh zimit Nr.76, dat  07.04.2008 "P r p rcaktimin e tregut p rkat s", treg p rkat s i produktit u konsiderua tregu i sh rbimeve bankare dhe treg p rkat s gjeografik u konsiderua territori i Republik s s  Shqip ris .

Vler simi i efekteve t  n j  p rqendrimi n  konkurrenc n n  treg fillon me analiz n e struktur s s  tregut p rkat s t  produktit, analiz  kjo e fokusuar n  treguesit kryesor  t  sistemit bankar q  jan  aktivet, depozitat dhe kredit .

Tregu bankar n  Shqip ri  sht  n j  treg mesatarisht i p rqendruar pa pranin  e bankave me pozit  dominuese. Para p rqendrimit, pjes t e tregut t  OTP Bank Albania SHA sipas aseteve, depozitave dhe kredive luhaten nga XX%.

Duke qen  se shoq ria target nuk vepron apo realizon t  ardhura n  Shqip ri, transaksioni i njoftuar nuk do t  sjell  mbivendosje t  aktivitetit t  biznesit midis pal ve t  k tij p rqendrimi n  Shqip ri dhe si rrjedhoj  nuk do t  kemi ndryshim t  struktur s s  tregut.

Pjesa e tregut t  OTP Bank Albania SHA do t  mbetet n  nivelet XX % duke mos sjell  ndryshime t  struktur s s  tregut edhe pas p rqendrimit.

P R K TO ARSYE:

Komisioni i Konkurrenc s, n  baz  t  nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 t  Ligjit Nr. 9121, dat  28.07.2003 "P r Mbrojtjen e Konkurrenc s", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SKB Banka d.d. Ljubljana nga shoqëria OTP Bank Nyr.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 663, Datë 03.12.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.

Natura Cosmetics S.A. (Natura) është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Brazilian, si shoqëri aksionere me ofertë publike, me objekt aktiviteti; shitja me shumicë e produkteve kozmetike dhe produkteve të tualetit, artikujve dhe aksesorëve të veshjeve e bizhuterive, pajisjeve kompjuterike, librave, gazetave dhe botime të tjera, medikamenteve dhe ilaçeve për përdorim njerëzor, etj.

Grupi i shoqërive të Natura nuk ka asnjë prezencë të regjistruar dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Avon Products, Inc (Avon) është një shoqëri e krijuar sipas legjislacionit të SHBA-së, me seli në New York. Ajo është prodhues dhe tregtues i produkteve të bukurisë dhe produkteve të lidhura me to. Biznesi i Avon kryhet kryesisht me shitje direkt për kategorinë e produkteve të bukurisë, të modës dhe të shtëpisë.

Në Shqipëri, Avon është prezent nëpërmjet shoqërisë *Avon Cosmetics Albania SHPK*, shoqëri e cila ka për objekt aktiviteti: Import, eksporti dhe tregtim i produkteve kozmetike. Përkatësisht shoqëria do të kryejë çdo dhe të gjitha veprimtaritë e shitjes së drejtpërdrejtë të produkteve të kozmetikës, kremrave, locioneve, fragrancave, parfumeve dhe produkteve të tjera të bukurisë, artikuj argjendarie, produkte të modës, produkte konsumi dhe produkte shtëpiake të të gjitha llojeve; dhe prodhimi, reklamimi, shpërndarja dhe si importues, eksportues, tregtues dhe agjentë shitjeje të produkteve kozmetike, kremrave, locioneve, fragrancave, parfumeve dhe çdo produkti tjetër bukurie, artikuj argjendarie, produkte të modës, produkte konsumi dhe produkte shtëpiake të të gjitha llojeve si dhe produkteve të tjera bukurie në Shqipëri.

Avon Cosmetics Albania SHPK, kontrollohet nga shoqëria Avon Cosmetics Limited, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Anglisë dhe Wellsit.

Më datë 22 Maj 2019, midis palëve Natura Cosméticos S.A, Avon Products, Inc, Nectarine Merger SUB I, Inc, Nectarine Merger SUB II, Inc dhe palës Natura Holding S.A është nënshkruar “Marrëveshje dhe Plani i Bashkimit”, e cila do të finalizohet me përfundimin e kontrollit me anë të bashkimit të të gjitha aksioneve dhe kombinimin e bizneseve, operacioneve dhe bazave aksionare të Avon Product nga Natura Cosméticos S.A.

Finalizimi i marrëveshjes do të kalojë në disa transaksione paraprake si rezultat i të cilave do të ketë riorganizim të aksioneve dhe kombinim të bizneseve të shoqërive të kontrolluara nga Natura dhe Avon. Pas transaksionit, Natura Holding S.A. do të zotërojë tërësisht të gjitha aksionet e Natura dhe Avon, ku aksionarët e Natura do të zotërojnë rreth 76% të aksioneve të shoqërisë së kombinuar, ndërsa aksionarët e përbashkët të Avon do të zotërojnë rreth 24% të aksioneve.

Referuar marrëveshjes dhe xhiros së ndërmarrjeve pjesëmarrëse, transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, u konstatua se treg përkatës i produktit mund të konsiderohet tregu i produkteve të bukuri dhe produkteve të lidhura me to, por duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme tregu përkatës mund të lihet i hapur. Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni është përfundim kontrolli, i cili do të realizohet me anë të bashkimit të të gjitha aksioneve dhe rezulton në kombinimin e bizneseve, operacioneve dhe bazave aksionare të Natura Cosméticos S.A. dhe Avon Products, Inc. Natura Holding S.A. do të zotërojë tërësisht të gjitha aksionet e Natura dhe Avon, si rezultat i një ristrukturimi të shoqërisë që do të zbatohet në kontekstin e transaksionit të propozuar.

Shoqëria blerëse nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri ndërkohë që shoqëria target realizon xhiro dhe është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë Avon Cosmetics Albania SHPK. Transaksioni i synuar nuk do të sjellë mbivendosje të aktivitetit të biznesit midis palëve të këtij përqendrimi dhe si rrjedhojë nuk do të kemi ndryshim të strukturës së tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 664, Datë 03.12.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG.

Pala nr.1 Hyundai Motor Company, është një shoqëri me objekt; Prodhim/shitje me shumicë dhe pakicë, prodhim i mjeteve motorike për automjete për pasagjerë dhe tregti me shumicë e mjeteve të transportit.

Hyundai ka kontroll mbi shoqërinë Kia Motors Corporation.

Pala nr.2 Daimler AG, është një shoqëri aksionare, me objekt veprimtarie; veprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve, veçanërisht në degët si: automjetet, motorët dhe disqet teknike të të gjitha llojeve, përfshirë pjesët, asamble të dhe aksesorët e tyre, produkte të tjerë transporti, pajisje elektronike, instalime dhe sisteme, komunikimi dhe teknologjia e informacionit, shërbime dhe koncepte të lëvizshmërisë dhe transportit, shërbime bankare dhe sigurimesh, financiare dhe pagesë si dhe ndërmjetësim dhe sigurim i sigurimeve, menaxhimi dhe zhvillimi i pasurive të paluajtshme.

Pala nr.3 Ford Motor Company, është një shoqëri e regjistruar në Shtetin Delaware. Aktiviteti kryesor i shoqërisë Ford Motor Company, përfshin projektimin, prodhimin, shpërndarjen, shërbimin dhe financimin e

një linje të plotë të makinave për pasagjerë (përfshirë automjete elektrike me bateri dhe hibride) dhe automjete tregtare.

Pala nr.4 Shoqëria Dr.Ing H.c.F Porsche SHA, është një shoqëri aksionare, me objekt veperimtarie ; Prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve dhe të pjesëve dhe asamble për produkte të tilla teknike dhe të tjera, ekzekutimin e punëve zhvillimore dhe ndërtimeve, veçanërisht në fushën e ndërtimit të automjeteve dhe motorëve, konsultimin dhe zhvillimin e përpunimit të të dhënave, si dhe prodhimi dhe shpërndarja e produkteve për përpunimin e të dhënave, tregtimin e mallrave nën përdorimin e të drejtave të markës tregtare, veçanërisht ato me përbërësin “Porsche” si dhe të gjitha çështjet e tjera teknike, ekonomike dhe tregtare, përfshirë shfrytëzimin e të drejtave të pronësisë industriale.

Porsche është pjesë e grupit Volkswagen, plotësisht i kontrolluar në mënyrë indirekte të Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit VW.

VW Grup ka në zotërim 3(tre) filialet në Shqipëri: *Porsche Leasing SHPK, Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK*. Aktiviteti i Grupit VW në Shqipëri, konsiston kryesisht në shitjen e automjeteve të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare.

Pala nr. 5: Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft (BMW) është kryesisht një prodhues ndërkombëtar i automjeteve dhe motoçikletave. Përveç zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të këtyre mjeteve, BMW dhe filialet e tij ofrojnë gjithashtu shërbime financiare për klientët privatë dhe bizneset.

Shoqëria Target: Shoqëria Ionity Holding GmbH &Co.KG, është një Joint Venture e themeluar nga BMW, Daimler, Ford dhe Porsche në vitin 2017, me qëllim instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një infrastrukture karikimi me energji të lartë të aksesueshme për automjetet elektrike me bateri në të gjithë Evropën. BMW, Daimler, Ford dhe Porsche aktualisht ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi Ionity.

Më datë 06 Shtator 2019, palët kanë nënshkruar “Marrëveshje Investimi”, bashkëlidhur dhe Aneks nr.1, midis, Hyundai Motor Company (dhe shoqërisë në kontrollin e saj, Kia Motors Corporation), BMW (BMW High Power Charging Beteiligungs mbH; Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft), Ford Motor Company (dhe filialit të saj Ford of Europe GmbH), Daimler (dhe filialit të saj Vierzehnte Vermögensverwaltungsgesellschaft DVB mbH), Dr.Ing.h.c.F. Porsche AG (dhe filialit Porsche Erste Beteiligungsgesellschaft mbH; Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Audi AG) dhe Ionity Holding GmbH.

Partnerët ekzistues të JV (Ionity Management GmbH), kanë rënë dakort për rritjen e kapitalit tek Ionity Holding GmbH &Co.KG, ku shuma totale e kapitalit fiks dhe shuma totale e detyrimeve të partnerëve të JV që do të regjistrohet në regjistrin tregtar, do të rritet nga 100,000 EUR në 125,000 EUR. Shtesa në kapital do të mbulohet nga fondi i investimit që do të realizohet nga Hyundai dhe KIA dhe pjesëmarrja e partnerëve të JV në kapitalin fiks të Ionity Holding GmbH &Co.KG do të jetë; HPC (BMW) XXX Euro; DVB XXX Euro; Ford Europe XXX Euro; Porsche XXX Euro; Hyundai XXX Euro; Kia XXX Euro të cilat përfaqësojnë nga XX% secila për HPC, DVB, Ford Europe, Porsche; XX% për Hyundai dhe XX% për Kia, që përbëjnë të gjithë kapitalin fiks të Ionity Holding GmbH &Co.KG.

Referuar marrëveshjes dhe xhiros së ndërmarrjeve pjesëmarrëse, transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Vlerësimi i përqendrimit

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe duke patur parasysh objektin e veprimtarisë të shoqërisë Ionity Holding GmbH, tregu përkatës i produktit për qëllim të

përqendrimit të njoftuar mund të përcaktohet si tregu për instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave të karikimit për BEV (Bateri Elektrik Vehicle).

Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë. Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Ionity Holding GmbH & Co.KG. nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për më tepër, Shqipëria nuk ka as infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për të ofruar infrastrukturën e karimit me fuqi të lartë për automjetet elektrike me bateri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët nga shoqëria Hyundai dhe shoqëria Kia Motors Corporation, mbi shoqërinë Ionity Holding GmbH & Co.KG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 671, Datë 24.12.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve.” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfutimin e kontrollit të vetëm të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V të GEDI Grupoo Editoriale S.p.A

Pala blerëse: EXOR N.V është një shoqëri me seli ligjore në Amsterdam, Hollandë me aksione të kuotuar në Mercato Telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A.

EXOR N.V. i përket shoqërive të Grupit EXOR ("Grupi EXOR"). Aktiviteti i Grupit konsiston në investime afat-gjata me një fokus në shoqëritë aktive globale në sektorë të ndryshëm, kryesisht në Europë dhe në SHBA. EXOR nuk ka ndonjë filial të themeluar në Shqipëri dhe xhiron e realizon nëpërmjet shitjeve të mjeteve Fiat Chrysler Automobiles (FCA), pjesë e Grupi EXOR

Pala shitëse: CIR- Compagnie Industriali Riunite S.p.A me seli ligjore në Milano, me aksione të kuotuar në Mercato Telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A.

Shoqëria Target: GEDI Grupoo Editoriale S.p.A. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Italian, me aksione të kuotuar në Mercato telematico Azionario, organizuar dhe administruar nga Borsa Italiana S.p.A., segmenti STAR (segmenti për titujt me kërkesë të lartë në fushën e transparencës së informacionit, të likuiditetit dhe qeverisjes së korporatave). GEDI, drejtpërdrejt dhe nëpërmjet filialeve të saj, është aktive në sektorin e medias kryesisht në Itali, në sektorët e botimit, komunikimit dixhital, të radios dhe televizionit.

Grupi GEDI nuk ka filial të themeluar në Shqipëri. Ai realizoi një xhiro të papërfillshme në Shqipëri në 2018 nga shitja e gazetave të botuara nga GEDI tek konsumatorët (individët) që gjenden në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 02 Dhjetor 2019, është paraqitur propozimi kontraktual dhe është nënshkruar “Kontratë Shitje Aksionesh”, midis palës blerëse EXOR N.V, dhe palës shitëse CIR- Compagnie Industriale Riunite S.p.A,

Transaksioni ka të bëjë me blerjen nga EXOR N.V, nëpërmjet një shoqërie të caktuar, të veçantë dhe të zotëruar tërësisht (“Shoqëria Tenderuese”), të 43.78% të aksioneve të shoqërisë GEDI Grupoo Editoriale S.p.A., të zotëruara nga shoqëria Compagnie Industria li Riunite S.p.A., Itali (“CIR”).

Aktualisht EXOR N.V zotëron një sasi aksionesh në minorancë tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A., e barabarte me 5.99 % të zotërimit të tij aksionar si rezultat i një transaksioni të mëparshëm të kryer në vitin 2017. Pas transaksionit, duke pasur parasysh se GEDI Grupoo Editoriale S.p.A., zotëron aksione thesari të barabartë me 4.30% të kapitalit të aksioneve të emetuara, EXOR N.V do të zotërojë në total 52.01% të të drejtave votuese dhe do të jetë e aftë të ushtrojë e vetme kontrollin mbi shoqërinë GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.,

Transaksioni do të mundësojë që EXOR të zgjerojë praninë e tij në sektorin e medias dhe të botimit (kryesisht në Itali), ku aktualisht EXOR është i pranishëm, vetëm si një investitor financiar, nëpërmjet pjesës aksionare minorance (jo-kontrolluese) tek GEDI dhe tek The Economist.

Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit dhe praktikën më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit është lënë i hapur dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të tërthortë i GEDI Gruppo Editoriale S.p.A. nga EXOR N.V. i cili klasifikohet si një transaksion konglomerat ku palët pjesëmarrëse operojnë në tregje të ndryshme, Asnjë nga palët nuk zotëron degë apo filial në Shqipëri dhe përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar. Transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të kontrollit të tërthortë nga shoqëria EXOR N.V tek GEDI Grupoo Editoriale S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME TË TJERA

VENDIM

Nr. 589, Datë 31.01.2019

“Për miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës dhe Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019,

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka depozituar Draft-Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar ;

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 dhe prioritetet kryesore për vitin 2019”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 594, Datë 07.02.2019

“Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Bankën e Shqipërisë me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vlerësimi i shkresës nr. 925, datë 29.01.2019 të Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, në lidhje me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f), neni 70 i ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me shkresën nr. 925 datë 29.01.2019 “Mbi Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”, të Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, për rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, në pikën 2 të Vendimit nr. 580 datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”, vendosi t’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë që:

- Për çështje të stabilitetit financiar, të gjitha shoqëritë tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK, që zotërojnë pozitë dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë, duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre.
- Të parashtrijë përpara Autoritetit të Konkurrencës çdo ndryshim në strukturën e shoqërive të monitoruara, ku mund të krijohet apo forcohet pozita e dominuese në treg.

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet drejtorit të Departamentit të Mbikëqyrjes i është drejtuar Kryetares së Komisionit të Konkurrencës, nëpërmjet shkresës nr. 925 datë 29.01.2019 “Mbi Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”, ku shprehet në lidhje me rekomandimet e dhëna si më poshtë vijon:

- Banka e Shqipërisë në kuadër të mbikëqyrjes së veprimtarisë bankare, për rekomandimet e mësipërme, vlerëson se kryerja e veprimeve të përcaktuara në rekomandimet e AK nuk është objekt i veprimtarisë së BSH dhe banka nuk disponon instrumentet në funksion të zbatimit të rekomandimeve.

- Në lidhje me pikën a) të rekomandimit, BSH vlerëson se e ka të pamundur të identifikojë dhe vlerësojë shoqëritë tregtare me qëllim konstatimin e pozitës dominuese të tyre në treg dhe gjithashtu BSH është e paqartë për konceptin “aktivitete të lidhura më sistemin bankat”, në kushtet kur ligji për bankat përmban të tjera përcaktime.
- Në lidhje me rekomandimin b), BSH vlerëson se ajo nuk mbikëqyr dhe as monitoron shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari tregtare, pavarësisht lidhjes që ato mund të kenë më shoqëritë tregtare të licencuar për ushtrimin e veprimtarive bankare.
- Gjithashtu BSH ka bërë vlerësimin e saj në lidhje me pikën 1, germa c) të dispozitivit të Vendimit, pikë kjo e cila nuk lidhet me BSH por i është adresuar Tirana Bank SHA.

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të neneve 19, 21 dhe 24 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”, i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me cilësinë e një organi kolegjal dhe vendimmarrës, që zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në zbatim të nenit 70 të ligjit nr. 9121/2003, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive. Autoriteti i Konkurrencës, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ dhe në këto raste bën rekomandimet përkatëse. Autoriteti i Konkurrencës, për zbatimin e këtij ligji, në sektorët e rregulluar, bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatorë.

Në zbatim të rregullimeve ligjore të parashikuara shprehimisht në nenet 12, germa a) dhe 43, germa c) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, autoriteti më i lartë drejtues i Bankës së Shqipërisë është Këshilli Mbikëqyrës, i cili ka të drejtë të miratojë transaksionin e kryer dhe të vlerësojë vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, dhe jo një Departament, nga pikëpamja hierarkike institucionale.

Nga ana tjetër, transaksioni i kryer “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”, për çështje të stabilitetit financiar ku Tirana Bank SHA do të zotërohet në 88,83% të aksioneve nga Balfin SHPK, dikton nevojën e mbikëqyrjes së të gjitha shoqërive tregtare të kontrolluara nga Balfin SHPK, të cilat zotërojnë pozitë dominuese ose që do të marrin në të ardhmen këtë pozitë, në kontekstin që ato duhet të monitorohen dhe të trajtohen si aktivitete të lidhura me sistemin bankar, pavarësisht objektit të veprimtarisë së tyre, evidentuar qartë në pjesën arsyetuese të vendimit nr.580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës, dhënë me kushte dhe detyrime.

Në referencë të dispozitave ligjore, neneve 12, 42 dhe 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, vlerësojmë se Banka e Shqipërisë si rregullatori i sistemit bankar, i cili mbikëqyr veprimtarinë e bankave të nivelit të dytë, nxjerr akte ligjore dhe nënligjore për rregullimin e këtij tregu, ka të gjitha instrumentet e nevojshëm për të zbatuar dy rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr.580, datë 17.01.2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe f dhe nenit 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, zbatimin e Vendimit nr. 580 datë 17.01.2019 “Mbi përftimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”, përkatësisht në pikën 2, germa a) dhe b) e dispozitivit të këtij vendimi, të dhënë me kushte dhe detyrime.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 613, Datë 19.04.2019

“Mospranimi i kërkesës së Bankës së Shqipërisë në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së Bankës së Shqipërisë, në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f), neni 46 i ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 12, germa a) i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me shkresën nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje”, të Bankës së Shqipërisë, për rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”,

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, duke vlerësuar se Banka e Shqipërisë në zbatim të nenit 12, germa a) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është rregullatori i sistemit bankar, dhe është ekskluzivisht përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankave të nivelit të dytë, ku midis të tjerave ajo nxjerr akte ligjore dhe nënligjore për rregullimin e këtij tregu, me vendimin nr. 594, datë 07.02.2019 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna Bankës së Shqipërisë me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”, vendosi t’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës, përkatësisht për pikën 2, germa a) dhe b) të tij.

Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje”, vlerëson se çështjet e ngritura nga Autoriteti i Konkurrencës janë objekt i punës në ushtrim të funksioneve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë në lidhje me personat e lidhur në marrëdhënie të veçantë me bankën, por pavarësisht këtij fakti, ajo nuk mund të mbikëqyrë dhe të marrë masa për shoqëri tregtare që nuk ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare.

Për këto arsye, Banka e Shqipërisë sugjeroi që brenda kompetencave që njeh ligji, të rishikohet dhe tërhiqet rekomandimi i lënë për Bankën e Shqipërisë, në lidhje me mënyrën e mbikëqyrjes së marrëdhënies së Bankës Tirana me personat e lidhur.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me shkresën nr. 484/15, datë 16.04.2019 ftoi Bankën e Shqipërisë për t’u dëgjuar për sa më sipër.

Në përgjigje të ftesës, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 2087/1, datë 17.04.2019, shprehet se u qëndron vlerësimeve të saj, të bëra me shkresën nr. 925, datë 29.01.2019 dhe shkresën nr.910/2, datë 01.04.2019.

Në zbatim të nenit 46, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës ka të drejtë të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte dhe detyrime, ose të rifillojë procedurën, kur:

- a. njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
- b. palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
- c. vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, nuk gjen as edhe një shkak ligjor, që ta lejojë atë që të revokojë ose të ndryshojë vendimin e tij.

Në këtë kontekst, është e pa argumentuar dhe nuk qëndron ligjërisht, kërkesa e bërë nga Banka e Shqipërisë, që Komisioni i Konkurrencës të rishikojë dhe të tërheqë rekomandimet e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe f dhe nenit 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje” të Bankës së Shqipërisë.
2. Lënien në fuqi të rekomandimeve të dhëna sipas pikës 2, germa a) dhe b) të Vendimit nr.580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 634, Datë 04.07.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në tregun e shërbimeve celulare.

Baza ligjore: Neni 24, gërma (d), neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin Nr. 10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”. Lidhur me këtë dokument, Autoriteti i Konkurrencës dërgoi komentet e tij lidhur me pyetjet e ngritura nga AKEP-i.
2. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton neni 38 i Ligjit Nr. 9918/2008, dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003), me shkresën Nr. 1113/2 Prot., datë 25.04.2019 (protokolluar me tonën Nr. 293 Prot., datë 26.04.2019), mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për këshillim publik, lidhur me Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.
3. Sipas nenit 31 të Ligjit Nr. 9918/2008, tregjet që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë tregjet me pengesa, me natyrë juridike ose strukturore të larta dhe të qëndrueshme për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuar drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut. Sipërmarrësit, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP-i, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve.

5. Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka qenë objekt rregullimi ex-ante nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010 deri në Mars 2014, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare. Modeli BULRAIC në vitin 2010 tashmë referohet si LRIC+ ndërsa metoda e rekomanduar nga KE dhe e përdorur në shumicën e vendeve evropiane tashmë është Pure LRIC.
6. Në lidhje me masën rregulluese të rregullimit të MTR, AKEP bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018, përgatiti një version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR për këshillim publik me palët e interesuara.
7. AKEP me Vendimin Nr. 15, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”.
8. AKEP me Vendimin Nr. 70, datë 01.10.2018 vendosi miratimin e Dokumentit: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”.
9. Me Vendimet Nr. 71, 72, 73 të datës 01.10.2018 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR në nivelin e 1.22 lek/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lekë/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e koston Pure LRIC deri në 2016 dhe Korrik 2017 respektivisht.
10. Gjatë analizave të tregut të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në vitin 2018, tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare u trajtua si treg i ndarë nga ai i terminimit të thirrjeve kombëtare. Terminimi i thirrjeve ndërkombëtare ishte pjesë e dokumentit “*Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare*”.
11. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin Nr. 79, datë 01.10.2018 ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania SHA me Fuqi të Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet Nr. 80 dhe Nr. 81, datë 01.10.2018 përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Altelecom SHA dhe sipërmarrësin Telekom Albania SHA me Fuqi të Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.
12. Të tre sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom u shpallën me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, dhe u vendosën masat përkatëse rregullatore për detyrimin e mos-diskriminimit dhe detyrimin e transparencës.
13. AKEP me Vendim Nr. 89, datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit Nr. 78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “*Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar*” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të

Këshillit Drejtues Nr. 79, Nr. 80, Nr. 81 dhe Nr. 82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD Nr. 78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP. Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri me legjislacionin e Komisionit Evropian.

14. BEREC në Dhjetor 2018 ka publikuar të dhënat më të fundit për MTR-në deri më Korrik 2018, sipas të dhënave të këtij dokumenti të BEREC tarifa MTR mesatare e ponderuar në vendet e BE/BEREC rezulton 0.8541 eurocent për minutë, (1.088 lek) 12 nga 0.9079 eurocent (1.22 lek) për minutë në vitin 2017 dhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet në analizë (37 vendeve të BEREC) rezulton 0.8467 eurocent (1.078 lek) duke shënuar rënie me rreth 9% në krahasim me 0.9262 eurocent (1.245 lek) për minutë në vitin 2017.
15. Në vijim të vendimmarrjeve të AKEP në Mars 2014 e në vijim për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri bazuar në tarifën benchmark të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër (Pure BU-LRIC), AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me aplikimin e këtij modeli dhe nga vendet anëtare të BEREC dhe vlerat përkatëse mesatare, që mund të përdoren si benchmark për rregullimin e MTR-ve në Shqipëri.
16. Tarifa mesatare e 23 vendeve për vitin 2018 është 0.7907 eurocent/minutë apo 1.01 lek/minutë (kursi i këmbimit i përdorur 1 Euro=125.37 lek si edhe në raportin e BEREC). Sipas dokumentit të BEREC për MTR në Korrik 2017, nga 37 vende 24 prej tyre kanë aplikuar modelin Pure LRIC dhe mesatarja e MTR të këtyre vendeve rezulton 1.11 lek/minutë.
17. 7 vende (përfshirë Shqipërinë) rregullojnë tarifën e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifën benchmark nga vendet që kanë aplikuar modelin 'Pure-BU-LRIC'. Tarifën e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatës në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BU-LRIC në vendet e tjera Evropiane/BE.
18. Në Tetor të vitit 2018, AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR u përcaktua në nivelin e 1.22 lek/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lekë/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC deri në 2016 dhe Korrik 2017 respektivisht.
19. Nëse marrim në konsideratë tarifën e miratuara nga AKEP në Tetor të vitit 2018 dhe i krahasojmë ato me tarifën e MTR të dokumentit të BEREC në Korrik 2018, vërehet se tarifën e reja të përshkallëzuara janë në nivel më të lartë (rreth 10%) se mesatarja e tarifave të vendeve të BEREC që përdorin modelin Pure BULRIC.
20. Në periudhën 2014-2018 MTR ndërkombëtare ka ardhur në rritje. Nga të dhënat për "Të ardhura mesatare për minutë nga terminimi kombëtar dhe ndërkombëtar 2014-2018", vihet re se MTR mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) ka ardhur në rënie, e ndikuar kryesisht nga rënia e volumit të minutave të komunikimit për thirrjet ndërkombëtare.
21. Pështja e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2017 u reduktua në 52%, krahasuar me vitin 2016 ku ky tregues shënonte rreth 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pështja e thirrjeve off-net u rrit me rreth 15% në krahasim me vitin 2016 duke arritur në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014). Në ndryshim nga trendi rënës i pështjes së thirrjeve on-net deri në vitin 2017, gjatë vitit 2018 pështja e thirrjeve on-net ndaj totalit të thirrjeve dalëse arriti nivelin rreth 56%, dhe pështja e thirrjeve off-net u reduktua në rreth 41%. Gjatë viteve 2016 e në vijim ka pasur reduktim të ndjeshëm të thirrjeve

ndërkombëtare, gjë e cila ka çuar në reduktim edhe të peshës së këtyre thirrjeve duke arritur në rreth 1% gjatë vitit 2018 nga rreth 11% në vitin 2015.

22. Rritjet e ndjeshme të nivelit dhe peshës së thirrjeve off-net në totalin e thirrjeve celulare në vitet dhe reduktimet në thirrjet on-net në 2015-2018 kanë ndodhur në vijim të zbatimit të detyrimit të operatorëve celularë për mos-diskriminim në tarifatat e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, që filluan të zbatohen në Korrik 2015 (vendimet e Analizës së tregut në Nëntor 2014 dhe të ndryshuara në Mars 2015). Gjithashtu, ndikim në ndryshimin e strukturës së trafikut on-net vs off-net ka pasur edhe OTT (Whatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj.), përdorimi i të cilëve ka ardhur gjithnjë e në rritje për shkak të rritjes së përdorimit të ofrimit të internetit nga operatorët mobile.
23. Implementimi i masave rregullatore të përcaktuara nga AKEP në vendimet përcaktonin të njëjtat detyrime për të tre sipërmarrësit pasi masa ishte vendosur në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve (në të cilin janë me fuqi të ndjeshme në treg) ndërkohë që i referohet rregullimit të shërbimeve në tregjet e shërbimeve me pakicë të operatorëve të rrjeteve celulare ku sipas analizës së tregjeve me shumicë të akses-origjinimit dhe pakicës vetëm njëri nga sipërmarrësit Vodafone Albania ka fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse.
24. AKEP vlerëson se masa rregullatore on-net vs off-net duhet të mbetet në fuqi vetëm për sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të akses-origjinimit Vodafone Albania dhe të hiqet për dy sipërmarrësit e tjerë Telekom dhe Altelecom. Ky ndryshim do t'i jepte mundësinë dy operatorëve konkurrentë të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg të shtonin presionin konkurrues nëpërmjet ofrimit të më shumë minutave dhe sms-ve brenda rrjetit për abonentët e tyre dhe në këtë mënyrë të rrisnin pjesët e tregut dhe të ulnin shkallën e përqendrimit të tregut.
25. AKEP lidhur me këtë çështje në dokumentin për këshillim publik ka ngritur pyetjen: Masa rregullatore e barazimit të minutave dhe SMS-ve brenda me jashtë rrjetit (on-net off-net) duhet të vazhdojë të zbatohet ndaj të tre operatorëve apo vetëm ndaj Vodafone Albania që zotëron fuqi të ndjeshme në tregjet me shumicë të akses-origjinimit dhe tregun e pakicës?
26. Lidhur me sa më lart, Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 303, datë 16.01.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, në pikën 1.b dhe 2 të tij, i ka rekomanduar AKEP, që të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese dhe të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifatat jashtë rrjetit të operatorit me pozitë dominuese Vodafone.

Pra, referuar sa më sipër, vlerësojmë se AKEP duhet të rregullojë tarifatat on-net/off-net vetëm për sipërmarrësin e shpallur me fuqi të ndjeshme në tregun e pakicës dhe jo në tregun me shumicë të akses origjinimit.

Autoriteti i Konkurrencës është shprehur edhe me shkresën Nr. 156/1 datë 17.05.2018 drejtuar AKEP. Edhe pse struktura e thirrjeve ka ndryshuar shumë në drejtim të rritjes së peshës së thirrjeve off-net dhe është reduktuar ndjeshëm pesha e thirrjeve brenda rrjetit, AK mendon se është e domosdoshme që masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net të vazhdojë për operatorët që kanë dominancë apo FNT dhe jo për operatorët e vegjël.

27. Bazuar në arsyetimin e Analizës së vitit 2018, si dhe në impaktin e tyre në të ardhurat e sipërmarrësve dhe si rrjedhim edhe në konkurrencë, si edhe bazuar në praktikën e ndjekur nga vendet e BEREC, AKEP propozon 4 alternativa kryesore për adresimin e problematikës së MTR ndërkombëtare:
- a. Përfshirje të terminimit ndërkombëtar në të njëjtin treg përkatës si edhe thirrjet kombëtare me masa rregullatore të ndryshme;
 - b. Përfshirje të terminimit ndërkombëtar në të njëjtin treg përkatës si edhe thirrjet kombëtare me masa rregullatore të njëjta;
 - c. Përkufizimi si tregje përkatës më vete i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante;
 - d. Adresim problemesh pa FNT por me zgjidhje mosmarrëveshesh midis operatorëve vendas.
28. AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre, pra sipas pikës 1/a të nenit 57 të Ligjit Nr. 9918/2008. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP gjykon si alternativë më të mirë përdorimin e tarifave benchmark dhe praktikave më të mira në vendet e BE dhe rajonit (BEREC që përfshin vendet e BE si dhe disa vende te rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji Nr. 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2.
29. AKEP lidhur me këtë çështje ka ngritur pyetjen për këshillim publik: Cili është opinionin juaj për stadin aktual të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar sipas metodologjisë së benchmark-ut të vendeve të BE-së? A duhet t'i rishikojë drejt uljes AKEP tarifat e terminimit sipas ndryshimeve në mesataren e 23 vendeve që zbatojnë Pure LRIC apo duhet të qëndrojë në tarifat e terminimit të miratuara me datë 01.12.2018? A duhet të vazhdojë AKEP të përdorë metodën e benchmark-ut apo duhet të presë konkluzionet e Modelit të Kostove me ekspertizë ndërkombëtare për të ndërmarrë korrigjimet e nevojshme pas konkluzioneve të modelit në fillim të vitit 2020?
30. Autoriteti i Konkurrencës për sa më sipër vlerëson se AKEP për tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare të vazhdojë të përdorë metodën benchmark për rregullimin e tarifave MTR, si benchmark të përdoret vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Evropiane që kanë aplikuar modelin e kostove LRIC të pastër.
31. Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash me shumicë për operatorët për shkak të trafikut të lartë hyrës ndërkombëtar si dhe tarifës që operatorët aplikojnë për këto thirrje që arrin deri në 30 eurocent/minutë apo 40 lek/minutë që është shumë herë më e lartë (rreth 27 herë) se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare.
32. Gjatë vitit 2018, vërehet ulje e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare për të tre operatorët, megjithatë të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare vazhdojnë të zënë peshën më të madhe të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve me mbi 51%. Edhe viti 2017 ka pasur rënie të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare, kjo ka ardhur edhe si rezultat i largimit të pajtimtarëve nga përdorimi i SMS-ve dhe thirrjeve zanore ndërkombëtare duke kaluar te zëvendësuesit OTT (Whatsapp, Viber Messenger, Skype etj.), duke vënë nën presion të ardhurat e sipërmarrësve nga thirrjet ndërkombëtare. Pësia e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në të ardhurat totale nga terminimi për Telekom dhe Vodafone në 2014-2015 ka qenë rreth 84-86% ndërsa është reduktuar në 69-74% në vitin 2016. Për Albtelcom ky raport ishte 60% nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare dhe 40% nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare në vitin 2016. Të ardhurat nga terminimi i këtyre thirrjeve u reduktuan në vitin 2016 për shkak të reduktimit të ndjeshëm të trafikut hyrës ndërkombëtar.
33. Nga të dhënat për tre operatorët aktualisht aktiv në treg vihet re se:

- Peshja e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara është reduktuar ndjeshëm për shkak të rënies së trafikut hyrës ndërkombëtar por më shumë për shkak të rritjes së ndejshme të trafikut off-net.
 - Peshja e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave nga terminimi është në nivel mesatar rreth 51% në vitin 2018, rreth 52% në vitin 2017 dhe rreth 63% në vitin 2016, një rënie e ndjeshme kjo në krahasim me rreth 81% në vitin 2014 dhe rreth 82% në vitin 2015;
 - MTR ndërkombëtare gjatë vitit 2018 ka shënuar rënie në krahasim me periudhën paraardhëse duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2015, megjithatë ky tregues është shumë më i lartë se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare. Edhe treguesi mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) 2.87 lek/minutë është gati 2-fish më i lartë se MTR kombëtar (1.48 për tre operatorët në 2015-2018).
34. Argument mbështetës për arsyetimin e AKEP për përcaktimin si dy tregje të ndara për terminimin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare është edhe arsyetimi i mungesës së kompetencës ligjore për të ndikuar në politikat e rregullimit të vendeve jashtë Republikës së Shqipërisë.
35. Sipas AKEP nëse i përcakton njësoj të dy tregjet e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nëpërmjet këtij përcaktimi detyron operatorët vendas të rregullojnë edhe tarifatat e terminimit ndërkombëtar duke i ulur ato, kjo do të rezultonte vetëm në ulje të të ardhurave të terminimit ndërkombëtar për operatorët që operojnë brenda Republikës së Shqipërisë (si rrjedhim më pak të ardhura në buxhet dhe potencialisht “waterbed effect”), ndërkohë që operatorët të cilët operojnë jashtë territorit të RSH dhe që kryejnë trafik të thirrjeve me operatorët në RSH do të vazhdonin të operonin mbi bazën e kushteve rregullatore të aplikuara sipas vendit të origjinës, pra nuk do t’i ndryshonin tarifatat. Pra palë të dëmtuar do të rezultonin operatorët vendas dhe si rezultat të ardhurat në buxhetin e shtetit (pakësim) dhe konsumatorët Shqiptarë si përdorues fundor të këtyre shërbimeve.
36. AKEP lidhur me këtë çështje ka ngritur pyetjen për këshillim publik: Alternativa për rregullimin e mëtejshëm të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare apo marrëdhënieve midis operatorëve për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare:
1. Përfshirja e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare), shpalljen FNT të të tre operatorëve dhe rregullimin e tarifave në mënyrë proporcionale me balancat in-out nga terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare:
 - a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path);
 - b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mos-diskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
 2. Me përkufizim si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje ex-ante dhe FNT:
 - a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path);
 - b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mos-diskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
 3. Lënie në de-rregullim siç është aktualisht;
 4. Një version është edhe sipas vendimmarrjes së KD të datës 1 tetor 2018 me shpallje FNT të të tre operatorëve dhe vendosjen e dy masave rregullatore: detyrime për transparencë dhe mos-diskriminim.

Që nga viti 2018 të tre operatorët celularë depozitojnë rregullisht mbi baza tremujore dhe vjetore informacionin si vijon:

- a. Marrëveshjet për MTR ndërkombëtare;
- b. MTR ndërkombëtarë të aplikuara, përfshirë uljet;
- c. Trafik, MTR, të ardhura etj.;
- d. Të gjithë informacionin e mësipërm për secilin operator vendas dhe të huaj.

37. Autoriteti i Konkurrencës për sa më lart është shprehur dhe me shkresën Nr. 156/1, datë 17.05.2018 drejtuar AKEP. AK vlerëson se, AKEP duhet të adresojë në mënyrën e duhur shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto. Për këtë çështje të përdoren praktikatat më të mira të vendeve të BE që rregullimi/de-rregullimi t'i shërbejë rritjes së konkurrencës dhe uljes së tarifave

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
 1. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
 2. Vendosjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
 3. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 635, Datë 04.07.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në tregun e shërbimeve celulare.

Baza ligjore: Neni 24, gërma (d), neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me vendimin Nr. 11, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.
2. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton neni 38 i Ligjit Nr. 9918/2008, dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003), me shkresën Nr. 1113/2 Prot., datë 25.04.2019 (protokolluar me tonën Nr. 293 Prot., datë 26.04.2019), mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për këshillim publik, lidhur me “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.
3. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin Nr. 16, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”. Lidhur me këtë dokument, Autoriteti i Konkurrencës dërgoi komentet e tij lidhur me pyetjet e ngritura nga AKEP-i.
4. AKEP-i, pas marrjes së komenteve finale lidhur me dokumentin e mësipërm, me vendimin Nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare”.
5. Në vijim të analizës së miratuar me vendimin, AKEP-i me Vendimin Nr. 79 datë 01.10.2018, “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania SHA me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore”, ka përcaktuar sipërmarrësin Vodafone Albania SHA (Vodafone) me fuqi të ndjeshme në treg (FNT), përkatësisht: a) tregu me shumicë i aksesit dhe

- origjinimit; b) tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare; dhe c) tregu me pakicë i shërbimeve celulare; si dhe ka vendosur masat përkatëse rregullatore në këtë treg.
6. AKEP-i me Vendimin Nr. 82, datë 01.10.2018 ka nxjerrë për këshillim publik dokumentin për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare, i cili përmban propozimin e AKEP për metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve të përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare.
7. Komisioni i Konkurrencës bazuar në këto dokumente, me Vendimin Nr. 568, datë 15.11.2018 ka dhënë disa rekomandime për AKEP për t'i pasur në konsideratë gjatë procedurës së këshillimit publik për rregullimin e tarifave në tregun e akses – origjinimit, dhe të marrë në analizë rregullimin e tarifave të tregut me pakicë për të shmangur sjelljet antikonkurruese të ndërmarrjes me FNT nëpërmjet aplikimit të tarifave shumë të larta. Në këtë vendim i është propozuar AKEP rregullimi në tërësi i tregut ku janë konstatuar problematika si nga ana e Autoritetit të Konkurrencës ashtu dhe gjatë analizave të kryera nga AKEP, që të rregullohen jo vetëm tarifat e akses - origjinimit por edhe tarifat e shitjes me pakicë.
8. AKEP, me Vendimin Nr. 89, datë 15.11.2018 “Për shfuqizimin e vendimit Nr. 78, datë 01.10.2018 të këshillit drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, dhe shfuqizimin e vendimeve të këshillit drejtues përkatësisht Nr. 79, Nr. 80, Nr. 81 dhe Nr. 82, datë 01.10.2018”, ka vendosur:
- 1) Shfuqizimin e VKD Nr. 78, datë 01.10.2018, “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”;
 - 2) Shfuqizimin e VKD Nr. 79, datë 01.10.2018 “Për përcaktimin e sipërmarrësit “*Vodafone Albania SHA*” me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore”;
 - 3) Shfuqizimin e VKD Nr. 82, datë 01.10.2018, “Për miratimin në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në tregjet me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare”.
9. Pra, referuar vendimit të mësipërm të AKEP, e gjithë analiza e tregut të telefonisë celulare dhe vendimet e marra në vijim të saj janë shfuqizuar dhe AKEP ka kryer nga fillimi procedurën e analizës së tregut të telefonisë celulare “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare*”.
10. Sipas dokumentit të AKEP, analiza e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit (*duke përfshirë për efekt analize dhe lidhje vertikale të tregjeve përkatëse edhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare*) rishikohet sipas praktikave më të mira në funksion të përcaktimit të tregut përkatës, analizën e testit kumulativ të tre kritereve sipas parashikimeve të Rregullores Nr. 9, datë 17.7.2009 “Për analizën e tregut”, të ndryshuar, përcaktimit të një/disë sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg dhe marrjen e masave rregullatore proporcionale në funksion të sigurimit të konkurrencës efektive në tregjet përkatëse.
11. Nëse një rregullator konkludon se konkurrenca në një treg përkatës nuk është efektive për shkak të ekzistencës së një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP duhet ta shpallë sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në treg dhe të aplikojë masat rregullatore mbi sipërmarrjen/sipërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg.

12. Sipas nenit 31 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike” i (ndryshuar), tregjet që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë tregjet me pengesa, me natyrë juridike ose strukturore të larta dhe të qëndrueshme për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuar drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike. *Sipërmarrësit, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP-i, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.*
13. Në nenin 33 të Ligjit Nr. 9918/2008, përcaktohet se një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë. Pas përcaktimit nëse një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ose nëse ekziston faktikisht një konkurrencë efektive, atëherë detyrimet anulohen, mbahen, shtohen ose vendosen në përfundim të analizës së tregut.
14. Fuqia e ndjeshme në treg sipas parashikimeve të nenit 34 të Ligjit 9918/2008 është e barasvlershme me mungesën e konkurrencës efektive dhe detyrimin e AKEP për vendosjen ndaj sipërmarrësit/sve me fuqi të ndjeshme në treg të një, disa ose të gjithë detyrimeve të veçanta të nevojshme të cilësuar në nenet 39-45 dhe 56 të Ligjit.
15. Në pikën 2, të nenit 56, të Ligjit Nr. 9918/2008, përcaktohet se: “Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, për tregun përkatës për përdoruesit fundorë (tregu i pakicës) është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe nëse masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike: a) detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi: i) të mos zbatojë tarifa tepër të larta; ii) të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj; iii) të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme; iv) të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë; v) të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh; b) detyrimin për nxjerrjen e vendimit përkatës për rregullimin e tarifave, sipas nenit 57 të këtij ligji”.
16. Me Vendimin Nr. 747, datë 17.7.2009, (i ndryshuar) AKEP ka miratuar listën e tregjeve, të cilat analizohen për të përcaktuar sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe masat rregullatore. AKEP mund të përcaktojë dhe analizojë tregje të tjera që nuk janë pjesë e listës.
17. Tregu përkatës i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve nuk është pjesë e Listës së tregjeve të Rekomandimit të Komisionit Evropian, të vitit 2003, dhe në bazë të parashikimeve të Rregullores së Analizës së Tregut, AKEP në këtë dokument ka vlerësuar nëse ky treg plotëson testin e tre kritereve.
18. Tregu përkatës i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare përfshin aksesin dhe origjinimin (thirrjet zanore dalëse) në rrjetet celulare në nivelin e shumicës, aksesin nga kartat me parapagesë dhe kontratë (postpaid), aksesin për rezidentët dhe konsumatorët biznes, origjinimin e SMS-ve dhe shërbimeve të tjera data.
19. AKEP shprehet se, masat rregullatore efikase dhe propocionale ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg do të ndërmerren vetëm në tregun e rrjedhjes së sipërme (shumicës) të aksesit dhe origjinimit në funksion të nxitjes së konkurrencës së rrjeteve celulare e kryesisht hyrjes së operatorëve virtualë të telefonisë celulare (MVNO) të cilët kanë shprehur interes për marrjen e autorizimit pranë AKEP.
20. Sipas dokumentit të AKEP, masat rregullatore në tregjet me shumicë të aksesit dhe origjinimit do të adresojnë për zgjidhje problemet e konkurrencës duke nxitur hyrjen e MVNO dhe rritjen e konkurrencës

me MNO. *Ndërkohë sa i përket tregut të pakicës nëse do të ketë kufizime apo pengime të konkurrencës sipas praktikave më të mira të BE dhe BEREC ato adresohen për zgjidhje te Autoriteti i Konkurrencës sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.*

21. Në dokument kërkohet këndvështrimi në lidhje me integrimin vertikal të operatorëve të rrjeteve celulare në tregjet përkatëse të shumicës së akses-origjinimit dhe të pakicës.
22. Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet Vendimit Nr. 303, datë 16.01.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare” shprehet se: Në tregun objekt hetimi operojnë 4 kompani celulare, të cilat veprojnë njëkohësisht në të dy nivelet e tregut, si në rrjedhën e sipërme (tregu me shumicë), ashtu dhe në rrjedhën e poshtme të tij (tregu me pakicë). Pra, këto ndërmarrje janë të integruara vertikalisht dhe ofrojnë shërbime për konkurrentët e tyre në tregun e shitjes me pakicë. Në treg nuk ka operatorë të tjerë të pavarur (MVNO), që t’u ofrojnë këtë shërbim përdoruesve fundorë.
23. Është e domosdoshme që për operatorin me FNT në këtë treg, të bëhet vendosja e detyrimeve në tregjet me shumicë të akses origjinimit të njëkohshme edhe me detyrimet në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Prandaj analiza e këtij tregu dhe futja nën rregullim, të jetë në funksion të rregullimit të tregut me pakicë të shërbimeve celulare. Tregu me shumicë i akses - origjinimit nuk ka qenë pjesë e analizës së AKEP që nga viti 2010 pasi nuk është pjesë e tregjeve nën rregullim. Në kushtet e tregut shqiptar ku nuk ka operator MVNO si në tregun e terminimit dhe në tregun e shitjes me pakicë veprojnë vetëm 3 operatorë. Marrja e masave në tregjet e pakicës (rrjedhjes së poshtme) është e domosdoshme, pasi masat në tregun e rrjedhjes së sipërme (tregjet me shumicë) janë të pamjaftueshme për të adresuar për zgjidhje problematikën e konkurrencës.
24. Sipas dokumentit të AKEP, edhe Tregu me pakicë i shërbimeve celulare, nuk është pjesë e Listës së tregjeve të Rekomandimit të Komisionit Evropian, që nga viti 2003, por përfshihet në këtë analizë të tregut për shkak të karakteristikave që e lidhin në mënyrë vertikale dhe të pazgjidhshme me tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit. Edhe për këtë treg përkatës në bazë të parashikimeve të Rregullores së Analizës së Tregut, AKEP në këtë dokument do të vlerësojë nëse ky treg plotëson testin e tre kriterëve.
25. Treg përkatës me pakicë përkufizohet tregu i shërbimeve publike telefonike celulare, të cilat përfshijnë aksesin (në rrjet celular nga përdoruesit fundorë) dhe të gjitha llojet e thirrjeve dalëse, SMS-ve dhe aksesin broadband të ofruara nëpërmjet paketave me parapagim dhe me kontratë për shërbime të ofruara nga sipërmarrësit Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom në tregun gjeografik në Republikën e Shqipërisë.
26. Nga analiza që bën AKEP duke u mbështetur në udhëzuesin e Komisionit Evropian mbi Fuqinë e Ndjeshme në Treg (Maj 2018) i rezulton se tregu me pakicë celular ka probleme të konkurrencës ku Vodafone Albania ka pjesë tregu mbi 50% për shumë tregues dhe në treg vihet re aplikimi i tarifave nën-kosto të cilat ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e konkurrencës midis operatorëve, rrezikun për dalje të tjera nga tregu si pasojë e tarifimit agresiv dhe zbatimit të tarifave të pakicës nën kosto (margin squeeze), të cilat vlerësohet të kenë ndikim negativ në konkurrencën potenciale nga rrjetet virtuale MVNO dhe në përfitimet e përdoruesve të këtyre shërbimeve në periudha afatgjata.
27. Dalja nga tregu e operatorit Plus Communication e ndryshoi strukturën e tregut që nga data 1 janar 2018 nga 4 (katër) në 3 (tre) operatorë duke vijuar trendin rritës të indeksit të përqendrimit të tregut dhe për më tepër dy sipërmarrësit me pjesën më të madhe në treg kanë rritur ndjeshëm kapacitetet konkurruese nëpërmjet marrjes 50 me 50 % të të drejtave të përdorimit të frekuencave që zotëronte në përdorim duke thelluar avantazhin krahasues të hyrësve të parë në treg.

28. Përveç barrierave financiare, teknike dhe juridiko-procedurale për hyrjen në treg, dalja nga tregu e hyrësit të fundit në treg, Plus Communication, është barrierë e konsiderueshme për çdo hyrës të ri në treg. Në këto kushte, është shumë e vështirë të mendohet, që në tregun me pakicë celular, të mund të ndodhin hyrje të reja, pa ndërhyrjen rregullatore pasi për rreth 9 (nëntë) vite, Plus Communication ishte hyrja e fundit në treg dhe tashmë pas transferimit të frekuencave të dy sipërmarrësit Vodafone dhe Telekom Albania, hyrësi i fundit ka dalë nga tregu dhe struktura e tregut ka ndryshuar drejt rritjes së përqendrimit dhe dominimit të liderit të tregut/dy sipërmarrësve me pjesë më të madhe tregu.
29. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur me Vendimin Nr. 303, datë 16.01.2014 për daljen nga tregu të operatorëve të vegjël dhe për këtë arsye ka ndërmarrë hetime dhe ka konstatuar se nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes objekt hetimi rezulton se strategjia e ndjekur nga operatori me pozitë dominuese shkakton shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata ndaj konkurrentëve më të vegjël, nëpërmjet aplikimit të strategjisë diferencuese të çmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit (on-net vs off-net). Diferencimi i çmimeve brenda me jashtë rrjetit mund të përdoret si një mekanizëm i mbylljes së tregut nga operatorët e mëdhenj për operatorët e vegjël të cilët mund të rrezikojnë daljen nga tregu përkatës, dhe ky fakt përbën një shqetësim për mirë funksionimin e tregut në një periudhë afatgjatë.
30. Bazuar në gjetjet e këtij Vendimi sa më lart, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare: 1. Të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, *për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjata mbi konkurrencën, dhe në veçanti: 1. Të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese. 2. Të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifën jashtë rrjetit të operatorit Vodafone.*
31. AKEP ka vendosur që kjo masë rregullatore të jetë në fuqi për të gjithë operatorët dhe për operatorët që nuk kanë pozitë dominuese.
32. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 356, datë 31.03.2015, vendosi marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjen Vodafone në tregun e telefonisë celulare me pakicë për rivendosjen e kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg: Vodafone Albania SHA ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare: Sasia e minutave brenda rrjetit Vodafone Albania të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare.
33. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 366, datë 04.06.2015, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit” vendosi: Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 356, datë 31.03.2015 për marrjen e masave detyruese që të ndalojë të aplikojë tarifa në nivel pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, për të gjitha ofertat e hedhura në treg.
34. Autoriteti i Konkurrencës në vazhdimësi si dhe në materialet e mëparshme të Këshillimit Publik është shprehur se: është e domosdoshme që masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net të vazhdojë për operatorët që kanë dominancë apo FNT në tregun me pakicë dhe jo për operatorët e vegjël, prandaj përsëri i rekomandon AKEP heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (on-net/off-net rule) për 2 operatorët e tjerë që nuk kanë pozitë dominuese. *Kjo masë e marrë nga rregullatori nuk ka lejuar që dy operatorët e vegjël të rriten.* Pra, masat e rregullimit në tregun

me shumicë të ndërmarra nga AKEP, nuk kanë ndikuar as në tregun me shumicë dhe as në tregun e pakicës të lidhur me të për të rritur konkurrencën efektive të operatorëve të tij. Përkundrazi, së fundmi operatori Plus ka dalë nga tregu duke çuar në zvogëlimin edhe më tej të konkurrencës efektive si rezultat i masave rregullatore ndaj të gjithë operatorëve, edhe ndaj operatorëve të vegjël si Plus Communication dhe Albtelecom.

35. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur edhe me shkresën Nr. 156/1 datë 17.05.2018 drejtuar AKEP në vijim të shkresës së AKEP Nr. 2285/17, datë 27.02.2018.*Edhe pse struktura e thirrjeve ka ndryshuar shumë në drejtim të rritjes së peshës së thirrjeve off-net dhe është reduktuar ndjeshëm pesha e thirrjeve brenda rrjetit, AK mendon se është e domosdoshme që masa rregulluese e mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net të vazhdojë për operatorët që kanë dominancë apo FNT dhe jo për operatorët e vegjël.*
36. Gjithashtu, me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, në pikën 1.3.e të tij i është rekomanduar AKEP: *Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.*
37. Sipas përfundimeve të analizës së tregut celular, Vodafone është përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të akses/origjinimit dhe ndër detyrimet për FNT, AKEP ka vendosur dhe detyrime.
38. Nëse një rregullator konkludon se konkurrenca në një treg përkatës nuk është efektive për shkak të ekzistencës së një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, rregullatori duhet ta shpallë sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në treg dhe të aplikojë masat rregullatore mbi sipërmarrjen/sipërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg.
39. Bazuar në analizën e AKEP (të bërë për treguesit e tregut të shitjes me pakicë) si: vlerësimin e pjesëve të tregut, numrit të përdoruesve, të ardhurave totale, thirrjeve dalëse, përdorimit të shërbimeve broadband, treguesit e indeksit të përqendrimit, dhe treguesve të tjerë, AKEP propozon që sipas nenit 33 pika 1 të Ligjit, të përcaktojë *sipërmarrësin Vodafone Albania me fuqi të ndjeshme në tregun celular me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Bazuar në analizën për FNT në tregun e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve për shërbimet celulare, AKEP konkludon se ky treg nuk është në konkurrencë efektive.*
40. AKEP nëpërmjet këtij dokumenti ka analizuar tregjet përkatës me shumicë të akses/origjinimit në rrjetet celulare dhe tregun me pakicë të shërbimeve celulare, duke konkluduar në gjetje FNT dhe vendosje të masave rregullatore *vetëm në tregun përkatës me shumicë të akses origjinimit.*
41. AKEP do të monitorojë implementimin efektiv të masave rregullatore të vendosura në tregjet me shumicë, dhe nese aplikimi i këtyre masave nuk do të ketë efekt pozitiv në rritjen e konkurrencës në tregun me pakicë celular, AKEP do të rishikojë përfundimet e kësaj analize tregu dhe masat rregulluese, sipas procedurave të ligjit 9918 dhe rregullores së analizës së tregut.
42. Me qëllim nxitjen e konkurrencës eficiente në tregjet përkatëse të shërbimeve celulare, AKEP vendos masat rregullatore duke patur si prioritet masat rregullatore në tregjet e shumicës në mënyrë proporcionale ndaj sipërmarrësve/sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg dhe gjykon se janë të mjaftueshme sa i takojnë rregullatorit *Ndërkohë që problemet e konkurrencës në tregun e pakicës AKEP do t'i rekomandojë për ndërhyrje te Autoriteti i Konkurrencës, me synimin për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregjet përkatëse.*
43. AKEP lidhur me analizën për FNT në tregun me shumicë të akses dhe origjinimit (me të dhënat e tregut me pakicë) ku bazohet në: Përcaktimin e Fuqisë së Ndjeshme në Treg; Dinamika e pjesëve të tregut dhe

indeksi përqendrimit; Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale nga komunikimet elektronike mobile; Përdorues të shërbimeve celulare (karta sim përfshirë broadband data card); Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare; Pjesët e tregut sipas përdoruesve aktivë të shërbimeve broadband; Pjesët e tregut sipas thirrjeve dalëse; Pjesët e tregut sipas SMS-ve dalëse; Pjesët e tregut sipas trafikut të të dhënave (Gbyte); Indeksi Herfindahl-Hirschman index (HHI) sipas treguesve të mësipërm; Pengesat e hyrjes në treg; Fuqia kundërvepruese e blerësve; Fuqia ekonomike dhe ekonomitë e shkallës; etj përcakton FNT në tregun me shumicë të akses origjinimit dhe jo në tregun me pakicë.

44. Autoriteti i Konkurrencës bazuar nga kjo analizë: nisur nga pjesët e tregut, qëndrueshmërinë e pjesëve të tregut në vite, shkalla e përqendrimit në të gjithë treguesit, pengesat e hyrjes në treg; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezultojnë se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, por dhe nga praktikatat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, ndërmarrja Vodafone Albania ka pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë.
45. AKEP pret komente se a do të jenë efikase masat rregullatore propocionale ndaj sipërmarrësit me FNT në tregjet me shumicë të akses-origjinimit. Dhe në rast se përgjigja e pyetjes është jo, cilën mendoni si zgjidhjen me të përshtatshme të problemeve të konkurrencës: adresimin për zgjidhje te Autoriteti i Konkurrencës sipas nenit 8 (pozita dominuese) dhe 9 (abuzimi me pozitën dominuese) parashikuar në ligjin “Për mbrojtjen e Konkurrencës”; apo marrjen e masave rregullatore nga AKEP?
46. AK shprehet se: bazuar në nenin 31 të ligjit për komunikimet elektronike sipërmarrësit, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP-i, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij”. Rregullimi me masa ex-ante në tregjet e shumicës ka qenë i pamjaftueshëm për të adresuar zgjidhje për një konkurrencë efektive në tregjet e pakicës.
47. Marrjen e masave rregullatore nga AKEP ex-ante, sipas detyrimeve që përcakton ligji. Nëse rregullatori konkludon se konkurrenca në një treg përkatës nuk është efektive për shkak të ekzistencës së një sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg, rregullatori duhet ta shpallë sipërmarrësin me fuqi të ndjeshme në treg dhe të aplikojë masat rregullatore mbi sipërmarrjen/sipërmarrjet me fuqi të ndjeshme në treg. Vlerësojmë se detyrimet e propozuara nga AKEP për FNT në tregun me shumicë të akses dhe origjinimit të thirrjeve nuk mjaftojnë, pasi karakteristikat e tregut të pakicës së telefonisë celulare, nuk pasqyrojnë një treg konkurrues dhe prandaj shprehemi se nuk janë të mjaftueshme masat rregulluese në tregjet me shumicë akses/origjinimi). Edhe në kushtet aktuale të tregut të telefonisë celulare, të efekteve të pamjaftueshme të vendosjes së mos-diskriminimit për të gjithë operatorët, është e domosdoshme vendosja në të njëjtën kohë e detyrimeve në tregjet me shumicë të terminimit dhe të akses - origjinimit të thirrjeve, edhe e detyrimeve në tregun me pakicë, të tillë si rregullimi i tarifave me pakicë të shërbimeve celulare për operatorin me fuqi të ndjeshme në treg, pasi masat e marra nga AKEP në Tregun me shumicë nuk kanë dhënë efektet në tregun me pakicë.
48. Me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve”, në pikën 1.3.e të tij i është rekomanduar AKEP, si vijon: *“e. Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.”*
49. Në dokumentin e analizës së AKEP-it problematika e shfaqur lidhur me mungesën e konkurrencës efektive i referohet kryesisht:
- 1) On-net vs of net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve;

- 2) Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
- 3) Sjellja e operatorëve ka qenë e dyshimtë për marrëveshje të ndaluara dhe abuzim me pozitën dominuese.

50. Lidhur me problematikën e tarifave standarde Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve” i ka rekomanduar AKEP-it: *“Të kryej analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.”*

51. Meqenëse aktualisht nga AKEP-i ndërmarrja Vodafone nga analiza e tregut të pakicës, është shpallur me FNT në tregun e akses - origjinimit të shërbimeve celulare dhe nga kjo analizë janë adresuar vetëm problematika e ngjeshjes së çmimit nga aplikimi i tarifave shumë të ulëta, vlerësojmë se është e nevojshme që AKEP të marrë në analizë rregullimin e tarifave të tregut me pakicë për të shmangur sjelljet antikonkurrese të ndërmarrjes me FNT.

52. AKEP-i mund të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave “a” ose “b” të nenit 56 të Ligjit: detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi:

- të mos zbatojë tarifa tepër të larta për thirrjet standarde;
- të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj;
- të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme (paketat standarde të pakicës);
- të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë;
- të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh.

53. Gjatë procesit të këshillimit publik të dokumentit “Analizë e Tregut të Shërbimeve Celulare” miratuar me VKD NR.17, datë 22.02.2018, Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar komentet dhe qëndrimin e tij lidhur me këtë dokument, ku ndër të tjera citohet:

[.....Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar disa herë AKEP që të marrë masat për rregullimin ex-ante të tregut me pakicë të shërbimeve celulare për të shmangur daljet nga tregu të operatorëve të vegjël, pasi në këtë treg ndërmarrja Vodafone Albania ishte me pozitë dominuese dhe nga AKEP duhet të merreshin masat përkatëse rregullatore. Rregullimi ex-ante nga AKEP, i vendosur në nivel shumice nuk ka qenë i mjaftueshëm për të adresuar problemet e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë. Kriteri i barrierave të hyrjes plotësohet pasi në tregun e shërbimeve celulare ka prezencë të barrierave të hyrjes në treg. Struktura e tregut është e tillë që nuk pritet për të shkuar në drejtim të një konkurrence efektive.

Vlerësojmë se tregu me pakicë i shërbimeve celulare plotëson testin e tre kriterëve dhe është treg i justifikueshëm për ndërhyrje/analizë ex-ante nga ana e rregullatorit....]

54. AKEP me përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit dhe vendosjen e masave rregullatore për këtë sipërmarrës, pret që do t’i adresojë në mënyrën e duhur problematikën e tregut të shërbimeve mobile për tregjet përkatëse, tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit dhe tregu me pakicë.

55. Sipas praktikës së Komisionit Evropian, rregullatorët në fushën e rregullimit të komunikimeve elektronike vendosin masa rregullatore në rrjedhën e sipërme të ofrimit të shërbimit mobile, dhe vetëm në rastet kur këto masa dështojnë, atëherë shikohet mundësia për adresim të problematikave në tregun e rrjedhës së poshtme.

56. Autoriteti i Konkurrencës shprehet se: AKEP-i përcakton tregjet përkatëse dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit. Nga analiza e tregut të pakicës AKEP si rregullator tregu ka konkluduar se konkurrenca në tregun përkatës nuk është efektive për shkak të ekzistencës së një operatori me fuqi të ndjeshme në treg. Në këto kushte, AKEP duhet ta shpallë operatorin me fuqi të ndjeshme në tregun me pakicë dhe të aplikojë masat rregullatore mbi operatorin me fuqi të ndjeshme po në tregun me pakicë.
57. AK vlerëson të domosdoshme të bëhet vendosja e detyrimeve në tregjet me shumicë të akses - origjinimit njëkohësisht edhe me detyrime në tregun me pakicë. Sipas nenit 34 të ligjit “nëse AKEP përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, atëherë AKEP vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme”.
58. Autoriteti i Konkurrencës dhe në komentet e mëparshme për këshillim publik është shprehur që AKEP të marrë masat për rregullimin ex-ante të tregut me pakicë të shërbimeve celulare për të shmangur daljet nga tregu të operatorëve të vegjël, pasi në këtë treg kemi një operator me pozitë dominuese dhe nga AKEP duhet të merreshin masat përkatëse rregullatore. Rregullimi ex-ante nga AKEP, i vendosur në nivel shumice nuk ka qenë i mjaftueshëm për të adresuar problemet e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë. Në tregun me pakicë kriteri i barrierave të hyrjes plotësohet pasi në tregun e shërbimeve celulare ka prezencë të barrierave të hyrjes në treg. Struktura e tregut është e tillë që nuk pritet për të shkuar në drejtim të një konkurrence efektive dhe rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës nuk janë zbatuar për operatorin me pozitë dominuese. Për rrjedhojë, detyrimet rregullatore shtesë të vendosura ndaj operatorëve për thirrjet brenda dhe jashtë rrjetit (detyrimi i mos-diskriminimit on-net/off-net), ju është vënë edhe operatorëve të vegjël duke mos përmirësuar konkurrueshmërinë për operatorët më të vegjël. Ndaj dhe është më se e nevojshme ndërhyrja ex-ante në tregun e pakicës nga AKEP duke vendosur masa ndaj operatorit dominant për të mos çuar në daljen e operatorit të tretë dhe rritjen e fuqisë së tregut të operatorit me fuqi tregu. Në kushtet e një operatori me fuqi të ndjeshme në tregun me pakicë të telefonisë celulare bëhet e domosdoshme marrja e masave të menjëhershme për analizën e tregut të shitjes me pakicë dhe vendosja e detyrimeve rregullatore specifike për arritjen e konkurrencës efektive në këtë treg.
59. AKEP është shprehur në dokumentin e analizës së tregut me pakicë të shërbimeve celulare se ka marrë masën rregullatore të barazimit të tarifave brenda me jashtë rrjetin (on-net of-net) është marrë në tregjet me shumicë të termnimit të thirrjeve kombëtare ndërkohë që monitorimi i zbatimit të saj është bërë në tregjet me pakicë të shërbimeve celulare (minuta dhe sms) dhe vlerësohet si një masë me ndikim pozitiv për pajtimtarët por e pamjaftueshme për të zgjidhur problemet e konkurrencës që shfaqen në treg dhe rrezikojnë daljen nga tregu të operatorëve të vegjël ose hyrësve të fundit në tregun përkatës të shërbimeve celulare. Kjo e përforcon domosdoshmërinë e marrjes së masave rregullatorë ex-ante.
60. Lidhur me problematikën e tarifave standarde të konstatuara nga AKEP në këtë analizë, Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 475, datë 21.09.2017 “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve” i ka rekomanduar AKEP-it: *“Të kryej analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifatat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.”*
61. Meqenëse AKEP, aktualisht është përpara marrjes së Vendimit për miratimin e analizës së tregut “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”, vlerësojmë se është e nevojshme që AKEP për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatore, të përcaktuara nga ligji, të përcaktojë ndërmarrjen “Vodafone Albania” SHA me fuqi të ndjeshme në tregun e shitjes me pakicë, dhe të ndërmarrë masat rregulluese, për të mos lejuar praktika antikonkurrese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
1. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes "Vodafone Albania" SHA me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe vendosjen e masave rregullatore përkatëse.
 2. Sjelljen në vëmendje të zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 568, datë 15.11.2018 "Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare":
 - Të vendosë nën rregullim tarifat e shërbimeve celulare me pakicë për ndërmarrjen me FNT, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 të njëkohshme me tregun me shumicë të akses-origjinimit, për nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg, pa pritur rezultatet e rregullimit të tarifave të tregut të akses – origjinimit;
 - Rregullimi i tarifave me pakicë për operatorin me FNT duhet të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut e AKEP, si: i. on-net vs off-net në mungesë të masave të rregullimit të tarifave të shumicës për terminimin e thirrjeve; ii. Tarifat standarde jashtë ofertave janë shumë të larta;
 - Krijimin e lehtësirave për hyrjen në treg të MVNO-ve, duke vendosur detyrime të qarta për ndërmarrjen me FNT për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit.
 3. Sjelljen në vëmendje të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 475, datë 21.09.2017 "Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve", në pikën 1.3.e të tij i është rekomanduar AKEP, si vijon:
 - a. Të kryejë analiza për zhvillimin dhe orientimin drejt kostos së tarifave standarde të aplikuara për përdoruesit me parapagesë, që përdorin tarifat standarde jashtë ofertave për operatorët me fuqi të ndjeshme në këtë treg.
 4. Autoriteti i Konkurrencës i kërkon AKEP që në bazë të nenit 70 të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe nenit 38 të ligjit "Për komunikimet elektronike" të vërë në dispozicion të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese ose sjelljet e koordinuara të përshkruar në dokument. Ky informacion do të mundësonte hapjen ose jo të procedurave hetimore të parashikuara në Ligjin "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.
 5. Monitorimin e tregut të telefonisë celulare për një periudhë 6 (gjashtë) muaj nga dalja e këtij vendimi.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 638, Datë 18.07.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e disa rekomandimeve për ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) dhe nenin 69 dhe 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Dhoma e Noterëve Tiranë, i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën Nr .193 Prot të AK-së., datë 08.03.2019 “Kërkesë për ndërhyrje dhe vënie në dijeni”, në lidhje me një njoftim, sipas të cilit në zyrat dhe sportelet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), prej datës 1 Mars 2019, ofrohet shërbimi i ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike, i cili deri në këtë moment ofrohej nga zyrat e noterëve nëpër qytetet e Shqipërisë.
2. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr 193/2 Prot., datë 15.03.2019 “Kërkim informacioni” i është drejtuar DPSHTRR duke i kërkuar vënien në dispozicion të të gjithë praktikës dhe informacionit që disponohet prej tyre, bazën ligjore përkatëse mbi të cilën është vendosur ofrimi i shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike nga ky institucion si dhe metodologjinë apo përllogaritjet mbi bazën e të cilave është përcaktuar tarifa e ofrimit të këtij shërbimi.
3. DPSHTRR me shkresën Nr 193/3 Prot., i AK, datë 04.04.2019 “Kthim Përgjigje”, argumenton se ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për shtirjen dhe ofrimin e shërbimit në mbarë territorin e vendit duke pasur edhe burimet njerëzore me staf profesional të dedikuar për kryerjen e këtij shërbimi me korrektësi, siguri juridike dhe efikasitet.
4. DPSHTRR, bazuar në VKM Nr.343, datë 21.07.1999 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, ka statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim dhe me objekt të veprimtarisë shërbimin ndaj subjekteve fizik dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, si dhe çdo objekt tjetër veprimtarie të lejuar nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.
5. Synimet e kësaj nisme sipas DPSHTRR kanë qenë ulja e informalitetit, sensibilizimi dhe finalizimi në një sportel të të gjithë procedurës për ndryshimin e pronësisë së mjetit; ulja e barrës financiare

ndaj qytetarëve për marrjen e këtij shërbimi, pasi në kuadër të reformës së de-rregullimit, DPSHTRR siguron vetë nëpërmjet sistemit informatik gjithë të dhënat korrekte për dokumentacionin e mjetit, debitë ndaj tij si vërtetim për taksa, etj, konfirmime në Interpol, konfirmim nga RBS, etj.

6. Këshilli Drejtues i DPSHTRR me Vendimin Nr. 10, datë 23.05.2018 “Për Miratimin e Tarifës së Shërbimit për Ndryshimin e Pronësisë së Mjetit”, ka vendosur miratimin e tarifës së shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjetit në vlerën 1200 lekë. Ky vendim është miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 74/1, datë 01.02.2019, “Për miratimin e tarifës së shërbimit për ndryshimin e pronësisë së mjetit”.
7. Kjo tarifë është më e ulët krahasuar me tarifën që ofron shërbimi i noterisë sepse sipas DPSHTRR:
 - Të dhënat e shitësit dhe blerësit merren automatikisht nëpërmjet sistemit informatik nga regjistri i gjendjes civile;
 - Të dhënat për mjetin merren automatikisht nga sistemi informatik *edpshtrr*;
 - Koha e shkurtër e punës së punonjësit të specializuar që merret me hartimin e kontratës së ndryshimit të pronësisë së mjetit.
8. Konstatohet se ky shërbim, i cili më parë kryhej nëpërmjet zyrave noteriale, tashmë ofrohet edhe nga një burim tjetër alternativ që janë zyrat dhe sportelet e DPSHTRR. Në njoftimin dhe procedurën e ndjekur nga DPSHTRR bazuar edhe në praktikën që vete kjo drejtori na ka vënë në dispozicion me shkresën Nr 193/1 Prot të AK, datë 04.04.2019 “Kthim përgjigje” dhe shkresën Nr 193/7 Prot të AK, datë 09.05.2019 “Kthim përgjigje”, nuk i është hequr e drejta e ofrimit të këtij shërbimi edhe zyrave noteriale. Qytetari dhe subjekti janë të lirë të zgjedhin midis shërbimit që ofron DPSHTRR apo shërbimit që ofron një zyrë noteriale.
9. Komisioni i Konkurrencës ka zhvilluar seanca dëgjimore në datën 9 maj 2019 me përfaqësues të DPSHTRR, të Dhomës së Noterëve Tiranë si dhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në përfundim të seancave dëgjimore me shkresën Nr 193/3 Prot të AK., datë 12.06.2019 “Kërkim informacioni” i është kërkuar informacion shtesë DPSHTRR.
10. Nga të dhënat e administruara nga DPSHTRR me shkresën Nr 193/9 Prot të AK, datë 03.07.2019 “Kthim Përgjigje” rezultoi se duke filluar nga 1 Mars 2019 deri në 19 Qershor 2019 janë kryer në total 22 118 procedura të ndërrimit të pronësisë ku 16 583 procedura janë kryer nëpërmjet kontratave noteriale dhe 5 535 procedura janë kryer me shërbimin e ndryshimit të pronësisë nga DPSHTRR.
11. Sipas informacioneve të depozituara nga DPSHTRR, 25% e qytetarëve për periudhën kohore duke filluar nga 1 Mars 2019 deri në 19 Qershor 2019, kanë marrë shërbimin e ndërrimit të pronësisë pranë sporteleve të DPSHTRR dhe pjesa tjetër janë paraqitur me kontratë noteriale shit-blejje.
12. Profesionin e noterit në Shqipëri rregullohet, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit 110/2018 “Për Noterinë”. Në nenin 74 të Ligjit 110/2008, përcaktohet se për kryerjen e akteve dhe veprimeve noteriale, paguhet tarifa përkatëse të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, pasi të kenë marrë më parë mendimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë.
13. Për kryerjen e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike nga noterët zbatohen tarifatat e shërbimeve noteriale të përcaktuara me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 279, datë 14.06.2012 “Për Miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale” i ndryshuar, i cili ka dalë në zbatim të Ligji Nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar, i cili është shfuqizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 24, shkronja (d) (f), nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë:
 - a) Të rishikojë Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 279, datë 14.06.2012 “Për Miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, duke përcaktuar tarifa noteriale konkurruese, lidhur me ofrimin e shërbimit të ndryshimit të pronësisë së mjeteve motorike.
 - b) Tarifat për shërbimet noteriale, të jenë të orientuara drejt kostos dhe të bazuara në një metodologji të përlllogaritjes së tyre.
 - c) Të dërgojë për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës projekt aktet nënligjore të cilat kanë të bëjnë me përcaktimet e tarifave apo vendosjen e kufizimeve të ndryshme, në zbatim të nenit 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 646, Datë 09.08.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e Koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.08.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me Draft Kontratën e koncesionit me objekt “Përshërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) , neni 26, dhe neni 69 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar shkresa me nr. 467 Prot të AK., datë 29.07.2019 “Dërgohet për mendim Draft-Kontrata e koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”.
2. Kjo kontratë do të lidhet bazuar në VKM nr.365, datë 20.06.2018 “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”.
3. Kontrata parashikohet të lidhet midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërisë “Noa Control” SHPK.
4. Vlerësimi i investimeve që do të kryhen nga koncensionari janë në vlerën prej 70.000.000 lekë. Shoqëria koncensionare është e detyruar që të raportojë çdo 3 muaj me shkrim lidhur me realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë, për sasinë e verifikimeve si dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.
5. Tarifa që shoqëria koncensionare do të paguajë Autoritetit Kontraktor është 2.5% e të ardhurave të realizuara nga koncensionari.
6. Në nenin 1 “Përkufizime dhe interpretime” është parashikuar se tarifat e shërbimit do të jenë tarifat e parashikuara për tu paguar nga subjektet të cilët kryejnë veprimtarinë e shpërndarjes me pakicë të

karburantit dhe gazit të lëngshëm nëpërmjet instrumenteve matës, sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë të Financave, nr.2, datë 08.02.2013. “Për Tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtësisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, i ndryshuar.

7. Subjektet e detyruara, janë të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e shitjes me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, që janë të detyruara sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kontratës të nënshtrimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës.
8. Koncesioni ka për objekt kryerjen nga koncesionari të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e RSH.
9. Zona gjeografike e këtij koncesioni është gjithë territori i RSH dhe periudha e koncesionit është 20 vite.
10. Koncesionarit i është dhënë e drejta e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në të gjithë territorin e RSH.
11. Detyrimet e koncesionarit janë pikërisht realizimi i projektit sipas kërkesave dhe propozimit të paraqitur në ofertë; sigurimi i financimit për zbatimin e projektit dhe realizimi i shërbimit të kërkuar në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë.
12. Koncesioni konsiston në ofrimin e shërbimit të lartpërmendur nëpërmjet:
 - Verifikim fillestar;
 - Verifikim pasardhës që përfshin :
 - a. Verifikim periodik i detyrueshëm të një instrumenti matës;
 - b. Verifikim jashtë radhe me kërkesë të Subjektit të detyruar;
 - c. Verifikim pas riparimit
 - Verifikim pa tarifë jashtë frekuencave të zakonshme.
13. Në nenin 10 të draft kontratës së koncesionit përcaktohet se koncesionari ka të drejtë të përdorë dhe t’ja besojë personave të tretë në cilësinë e nën-kontraktorëve përmbushjen e një ose me shumë detyrimeve dhe shërbimeve të kontratës, për të cilat përgjegjës mbetet koncesionari.
14. Në rast ndryshimi të kontrollit, kërkohet pëlqimi paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
15. Draft kontrata parashikon ngritjen e një njësie, Njësia e Zbatimit të Projektit, e cila është strukturë që do të mbikëqyrë ecurinë e kësaj kontrate. Kjo njësi ka të drejtë që në periudha kohore prej 24 muajsh gjatë periudhës së koncesionit të verifikojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e saj. Në çdo rast, monitorimi mund të kryhet në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve nga ana e koncesionarit. Mbikëqyrja do të realizohet edhe nëpërmjet shqyrtimit të raporteve që dorëzon koncesionari.
16. Tarifat e shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati /instrumenti matës të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do të jenë sipas Udhëzimit nr. 2 , datë 08.02.2013 “Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të drejtësisë së përgjithshme të metrologjisë”, Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Financave dhe Energjetikës dhe Ministrisë të Financave. Pika 14 e draft

kontratës së koncesionit parashikon se tarifata e shërbimit nuk mund të jenë më të ulta se ato ta parashikuara në këtë udhëzim.

17. Frekuenca e verifikimit të rregullt të instrumenteve matës do të jetë jo më pak se 2 (dy) herë në vit për çdo subjekt.
18. Palët mund të bien dakord për rritjen e frekuencës së verifikimit të rregullt të instrumenteve matës për një periudhë tranzitore në rast se:
 - Gjatë kryerjes së verifikimeve në terren rezultojnë se mbi 5% e totalit të instrumenteve matës të verifikuara rezultojnë me probleme dhe/ose
 - Databaze, të dhënat dhe fletët e punës që do të dorëzohen nga Autoriteti Kontraktues përmbajnë pasaktësi ose janë të paplota.
 - Parashikohet se rritja e frekuencës mund të bëhet për të gjithë subjektet e detyruara ose për zona ose subjekte të detyruara të caktuara.
19. Konstatohet se është respektuar zbatimi i nenit 69 të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, sipas të cilit organet e administratës publike kërkojnë vlerësimin e AK për projekt aktet normative të cilat vendosin të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta.
20. Konstatohet se në rast ndryshimi të kontrollit, kërkohet pëlqimi paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
21. Konstatohet se zbatimi i kontratës koncensionare do të monitorohet dhe mbikëqyret nga Njësia e Zbatimit të Projektit, bazuar në monitorime që vetë kjo njësi kryen si dhe në raportet e depozituara nga koncensionari.
22. Nisur nga fakti se ndërmarrja “Noa Control” SHPK , bëhet tashmë ndërmarrje me të drejta të veçanta, lind detyrimi i zbatimit të nenit 9 të ligjit 9121/2003 nga ana e ndërmarrjes “Noa Control” SHPK.
23. Konstatohet nga vlerësimi ligjor i kësaj draft kontrate që pika 3 e nenit 14 për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja “Noa Control” SHPK kufizon konkurrencën.
24. Parashikimi i përcaktuar për 5% të totalit të instrumentave do të sjellë kufizime të konkurrencës pasi përllogaritja e tij është e paargumentuar dhe pa një metodologji të përcaktuar.
25. Periudha tranzitore e papërcaktuar lë shkak për abuzim me pozitën dominuese që fiton ndërmarrja.
26. Rritja e frakuencës së verifikimit të instrumenteve matës nuk duhet të bëhet për të gjithë subjektet e detyruar ose ose për zona ose për subjekte të detyruar për shkak se për veprime tregtare të njëjta me palët nuk mund t’i vendosë ata në gjendje të pafavorshme konkurrence.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja (d) (f), nenin 26 dhe nenin 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. T’i kërkojë nga shoqëria “Noa Control” SHPK, si një ndërmarrje e cila fiton të drejta të veçanta nëpërmjet Draf Kontratës së koncesionit “*Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm*” që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

II. T'i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për sa më poshtë:

1. Në nenin 14 të Draft Kontratës “*Tarifa e Shërbimit, tarifa koncesionare dhe mënyra e pagesës*” në rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit:
 - a. Të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet depozitimit të dokumentacioneve shoqërues, për të cilat kërkohet ndryshimi i tarifave, për faktin se e drejta e dhënë në ofrimin e këtij shërbimi krijon një të drejtë ekskluzive.
 - b. Ndryshimi i tarifave të shërbimit për çdo verifikim të çdo aparati/instrumenti matës të njoftohet paraprakisht për vlerësi pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 - c. Ndryshimet e tarifave të shërbimit duhet të jenë të argumentuara, të bazuara në një metodologji të përlllogaritjes së tyre, dhe të jenë tarifa të orientuara drejt kostos.
 - d. Detyrimin që si autoritet kontraktor të hartojë një metodologji për vendosjen e përqindjes për instrumentat matës të verifikuara që rezultojnë me probleme si dhe të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës për shkak të së drejtës ekskluzive që fitohet nga ndërmarrja “Noa Control” SHPK.
2. Pika 3 e nenit 14 të draft kontratës së koncesionit, të rishikohet, të rishikohet, për sa më poshtë:
 - a. Përqindja e përcaktuar e totalit të instrumenteve matës të verifikuar që rezultojnë me probleme, duhet të përcaktohet në bazë të një metodologjie të miratuar nga autoriteti kontraktor;
 - b. Periudha tranzitore duhet të jetë e përcaktuar në terma konkretë, duke ju referuar një afati kohor të përcaktuar: muaj, vit apo vite;
 - c. Rritja e frekuencës së verifikimit të instrumenteve matës duhet të adresohet vetëm për ato “subjekte të detyruara” tek të cilat rezultojnë problematika dhe jo për të gjithë subjektet e detyruar;
 - d. Të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 647, Datë 09.08.2019

“Për miratim paraprak me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të transferimit të kontratës së koncesionit të shoqërisë DiaVita SHPK “Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.08.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Njoftimin e përqendrimit të shoqërisë DiaVita SHPK dhe shoqëria Diaverum International AB.

Baza ligjore: Nenet 10-12, neni 24, germa d, neni 26 dhe nenet 53-64 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Ligji nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB,

VËREN SE:

Transaksioni dhe përqendrimi

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të shoqërisë DiaVita SHPK nga shoqëria Diaverum International AB.

Blerësi: Diaverum International AB, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar sipas legjislacionit të Suedisë, më datë 28.06.2011, me aktivitet pronësinë dhe administrimin e aksioneve dhe letrave me vlerë dhe aktivitete të tjera të ngjashme me to, sipas formularit të plotë njoftimit.

Sipas dokumentacionit të depozituar, nuk rezultojnë të ardhura të realizuara gjatë viteve 2013-2017 nga Shoqëria Diaverum International AB. Kjo shoqëri nuk e ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri.

Shitësit:

Evita SHPK, është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë me NIPT L31714005J. Evita SHPK zotëron 85% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

American Hospital SHA, është një shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë me NIPT K61821002C. American Hospital SHA zotëron 15% të aksioneve të shoqërisë target Dia Vita SHPK.

Target: DiaVita SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Shqipërisë, e krijuar me datë 15.10.2015, me kapital 1.000.000,000. Objekt i aktivitetit të kësaj shoqërie është zbatimi i kontratës së koncesionit/PPP “Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan”. Kjo kontratë është nënshkruar më 10 shkurt 2016 ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë DiaVita SHPK dhe është bërë efektive në qershor të vitit 2016.

Më datë 25 qershor 2019, është nënshkruar “Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve”, midis palës blerëse Diaverum International AB dhe palës shitëse Evita SHPK e cila zotëron 85% të kapitalit si dhe “Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve”, midis palës blerëse Diaverum International AB dhe palës shitëse American Hospital e cila zotëron 15% të kapitalit.

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën Nr. 410/4, datë 30.07.2019 “Kërkohej informacion dhe dokumentacion”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u kërkua dokumentacioni mbi procedurat e ndjekura nga autoriteti kontraktor në lidhje me transaksionin e njoftuar, dhënien e pëlqimit paraprak si autoritet kontraktor në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, raportin e monitorimit të koncesionit me qëllim vlerësimin e aktivitetit të deritanishëm të kompanisë koncesionare si dhe planin e biznesit të shoqërisë blerëse me qëllim vlerësimin e aftësisë konkurruese të shoqërisë që pritet të hyj në tregun e shërbimit të hemodializës.

Në përgjigje të shkresës sonë, me shkresën nr. 3935/1 datë 31.07.2019 “Kthim përgjigje”, prot pranë AK me nr. 410/5 datë 31.07.2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoritet kontraktor, shprehet dakort për vazhdimin e procedurave të ndryshimit të strukturës së ortakërisë së shoqërisë koncesionare Dia Vita SHPK, por ajo (MSHMS) nuk depozitoi asnjë dokument sipas kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës.

Me shkresën nr. 3935/1 datë 31.07.2019 me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shprehet në lidhje me vazhdimësinë e procedurave të ndryshimit të strukturës së ortakërisë së shoqërisë koncesionare Dia Vita SHPK.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se shkresa nr. 3935/1 datë 31.07.2019 me lëndë “Kthim përgjigje”, nuk përmbush kriterin e nenit 32, pika 1 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 26, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ministria e Shëndetësisë, në zbatimin e nenit 32, pika 1 të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të shprehet me shkrim për miratimin paraprak të transferimit të kontratës së koncesionit “Për shërbimin e hemodializës pranë spitaleve rajonale në Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan” të shoqërisë DiaVita SHPK.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 651, Datë 10.10.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë SH.A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës Nr. 342 Prot., datë 09.09.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) Nr. 56 Prot., datë 20.07.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Berat- Kuçovë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
 - UK Berat-Kuçovë SHA duhet të aplikojë tarifën e miratuara nga ERRU sipas Vendimit Nr.13 datë 30.03.2017 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Berat-Kuçovë SHA dhe sipas Vendimit Nr.57 datë 29.12.2017, pra dy herë brenda vitit 2017. Sipas ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA, niveli i tarifave në fuqi është i diferencuar dhe për të mundësuar unifikimin e tyre ka aplikuar për ndryshimin e tyre.
3. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,* aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon tarifa të diferencuara për zonën urbane të Berat-Kuçovës (48 lek/m³) dhe për zonën rurale (50 lek/m³), të

cilat kanë qenë të miratuara me Vendimin Nr.13, datë 30.03.2017 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të UK Berat-Kuçovë SHA dhe sipas Vendimit Nr.57 datë 29.12.2017 për UK Berat-Kuçovë SHA.

4. Nëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA, propozon rritje të tarifave për të mundësuar unifikimin e tyre, për konsumatorin familjar në të gjitha zonat si urbane dhe ato rurale në vlerën 51 lek/m³, duke pësuar një rritje që varion nga 1 lek/m³ deri në 3lek/m³ për konsumatorët në zonat rurale dhe urbane, për konsumatorët privat dhe publik rritet me 20 lekë/m³ në Berat, Kucovë dhe 0 lekë/m³ për konsumatorët privat në zonën rurale, për të gjithë zonën pas riorganizimit, megjithëse tarifat kanë vetëm gjashtë muaj që janë miratuar nga ERRU pas riorganizimit. Propozohet ndryshim i tarifës fikse duke pësuar një rritje me 50lek/muaj/lidhje për konsumatorin familjar me një rritje 50% të tarifës aktuale, tarifa fikse për konsumatorin publik dhe privat mbetet e pandryshueshme. Tarifa volumetrike për largimin e ujërave të ndotura, për të tre konsumatorët nuk është një tarifë e re pasi ajo është miratuar në vitin 2017, për këtë tarifë kërkohet rritje me 1 lekë/m³ për konsumator familjarë, 2 lekë/m³ për konsumator publik dhe konsumator privat. Në këtë aplikim nuk është kërkuar unifikimi i saj si pjesë e këtij projekt vendim të ERRU-së. Aplikimi nuk është unifikues për të gjithë zonën e shërbimit, sepse tarifa e Njësise Administrative Roshnik mbetet e pandryshuar.
5. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 dhe vitin 2020 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, rritjen e mundësisë për shlyerjen e investimeve të deritanishme.
6. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA pas riorganizimit arrin të mbulojë kostot e operim mirëmbajtjes pasi ajo parashikohet të jetë në masën 104 % gjatë 2019, por mbulimi i kostove totale të operimit dhe mirëmbajtjes ishte 68% për vitin 2018 dhe parashikohet 96.8% për vitin 2019.
7. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA për vitin 2019 duhet të rritë kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes totale me 9% për vitin 2019 krahasaura me vitin 2018 dhe të rritë 28.8% kostot totale të operimit në vitin 2020, krahasuar kjo me vitin 2019, për të gjithë zonën e shërbimit.
8. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke anagzhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasi të ujë që nuk maten, mbi sasi të autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë plan biznesin 5 vjeçar sipas riorganizimit në kuadër të VKM Nr.63, me qëllim argumentimin për nevojën e investimeve në lidhje me përmirësimin e shërbimit si edhe qëndrueshmërinë financiare.
9. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Berat-Kuçovë SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
10. Duke qenë se niveli i kostove totale për vitin 2019 mbetet thuajse në nivele relativisht të ulëta krahasuar me ato të vitit 2018 me një rritje prej 9%, subvencionet që do të përfitojë kjo ndërmarrje për mbulimin e kostove, si dhe të gjitha investimet për përmirësimin e rrjetit të ujësjiellës, duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.

11. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Berat-Kuçovë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura.
12. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).
13. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, por nuk është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), gërma (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
 1. Tarifat e unifikuar që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Berat- Kuçovë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 2. ERRU të kërkoj nga Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruar duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëjë transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 659, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje miratimin e një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Ndryshimin në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OSHEE SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi një ndryshim në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OSHEE SHA,

VËREN SE:

1. Procedura e ndjekur

Me shkresën nr. 14321/3 prot., datë 17.09.2019 (protokolluar në Autoritetin e Konkurrencës me Nr. 436/4 prot., datë 23.09.2019) Enti Rregullator i Energjisë ka dërguar vendimin e bordit Nr. 123 dt. 29.07.2019 ka filluar procedurën për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” me kërkesë të OSHEE SHA.

Vendimi i ERE-s është bazuar në nenet 16, 19, 62, 69, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenin 19, 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar me anë të vendimit nr. 103 datë 23.06.2016 “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

OSHEE SHA në propozimin e saj kërkon ndryshimin e nenit 20 të rregullores që lidhet me pagesat dhe afatet e faturimit, duke propozuar që afatet e pagesave të jenë të negociushme midis palëve. Ky propozim është rrjedhojë e situatave financiare gjatë viteve të fundit, ku për shkaqe kryesisht të situatave ekstreme hidrike, OSHEE SHA është gjendur në vështirësi të theksuara likuiditeti. OSHEE SHA në muajt e parë të vitit 2019 është përballur me blerje të sasive të konsiderueshme të energjisë elektrike në treg të parregulluar.

Pasi u njohëm me vendimin e mësipërm për fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OSHEE SHA, në zbatim të nenit 69, të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, i ndryshuar, filloi puna për vlerësimin e aplikimit të OSHEE SHA, i cili gjendej i publikuar në faqen e ëeb-it të ERE-s.

ERE në mbështetje të nenit 27, 29 të” Rregullores së organizimit, funksionimit dhe dhe procedurave” për të kërkuar opinionin e grupeve të interesit dhe institucioneve organizoj një seancë dëgjimore bazuar në shkresës nr. 632 prot., datë 07.10.2019 me përfaqësues të palëve të interesit, për të diskutuar mbi miratimin e ndryshimit të kërkuar nga OSHEE SHA.

OSHEE SHA kërkon që pagesa e faturës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga blerësi brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit, dhe jo brenda 90 ditëve siç parashikohet në Rregulloren e shitblerjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.103/2016 për periudhë tranzitore deri në fund të vitit 2019.

OSHEE SHA me shkresën nr.14321 prot., datë 03.07.2019 drejtuar ERE argumenton se ka blerë sasi të mëdha energjie në treg të parregulluar për shkaqe kryesisht të lidhura me situatën ekstreme hidrike, gjë e cila ka cuar ndërrmarjen OSHEE SHA në vështirësi të theksuara likuiditeti.

Propozimin e saj OSHEE SHA e bazon në vendimin nr.139 datë 15.08.2016 të ERE lidhur me miratimin e “Rregullave të Përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”.

OSHEE SHA kërkon ndryshimin e nenit 20, gërma (a) të rregullores duke përcaktuar “Pagesa do të bëhet në përputhje me afatin e përcaktuar në ftesën për pjesëmarrje, afat i cili do të vendoset rast pas rasti në përputhje me mundësitë financiare likujduese të shoqërisë”.

2. Vlerësimi mbi ndryshimin në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik

ERE ka miratuar vendimin nr. 46 datë 19.03.2019, në përgjigje të kërkesës së OSHEE SHA me shkresën nr. 5477/1 Prot., datë 08.03.2019 nisur nga situata financiare në të cilën ndodhej, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për vendosjen e një periudhe tranzitore, e konkretisht për procedurat e blerjes së energjisë që do të zhvillohen nga OSHEE SHA deri në fund të vitit 2019, duke kërkuar që pagesa e faturës së blerjes së energjisë elektrike të bëhet nga blerësi brenda 180 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit, dhe jo brenda 90 ditëve siç parashikohet në Rregulloren e shitblerjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.103/2016,.

ERE ka miratuar vendimin nr. 46 datë 19.03.2019 duke vendosur :

- një periudhë tranzitore prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE SHA për tregtarët fitues të ankandëve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, mund të jetë jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike.
- Pagesa që OSHEE SHA do ti kryejë ndaj çdo tregtari me të cilin ka siguruar blerjen e energjisë të jetë proporcionale, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit për secilin tregëtar, por jo më vonë se 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë.

Duke vlerësuar se periudha tranzitore e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 46, dt.19.03.2019 lehtësoi situatën financiare të OSHEE duke parandaluar rrezikun e pamundësisë së aftësisë paguese dhe shmangur akumulimin e penalteteve për mos likudim në kohë të detyrimeve dhe nuk çënoi numrin e tregëtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike nga OSHEE SHA.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e Nenit 180 të Kodit të Procedurave administrative që sanksionon ndër të tjera se: Ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e çënon interesin publik.

OSHEEE SHA është ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik që lidhet me furnizimin e klientëve fundorë, prandaj stabiliteti, përformanca e lartë edhe qëndrueshmëria e shërbimit për klientët fundorë janë shumë të rëndësishme.

Duke vlerësuar se argumentat e sipërcituar legjitimojnë dhe arsyetojnë kërkesën e OSHEE SHA, por nuk mjaftojnë për të mbështetur në tërësi kërkesën e OSHEE SHA për shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr.46 datë 19.03.2019, për të gjithë periudhën e kërkuar, deri në 30.09.2019.

OSHEE SHA kërkesën e saj për ndryshimin e kërkuar e mbështet dhe e argumenton me rritjen e kostove të blerjes së energjisë elektrike të cilat ishin 5.7 miliardë Lek më të larta se ato të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar dhe 6.4 miliardë Lek më të larta se ato të planifikuara, rezultati financiar i 4 mujorit të parë 2019 ishte negativ për – 2.8 miliardë Lek megjithë uljen e ndjeshme të shpenzimeve në krahasim me ato të planifikuara dhe rritjen e të ardhurave prej 5.2%. Treguesit kryesorë të 4 mujorit të parë të vitit 2019 u paraqitën në mënyrë të detajuar tabelare. Kosto e lartë e blerjes së energjisë elektrike krijoi vështirësi të madhe likuiditeti në OSHEE SHA gjatë periudhës 4 mujore të cilat megjithëse u “zbutën” nga lidhja e kontratave me afat pagese 180 ditore, por nuk e kanë shmangur riskun e larë të likuiditetit me të cilën OSHEE SHA po përballlet. Parashikimet e motit akoma nuk sigurojnë ndryshime thelbësore në situatën hidrike dhe prodhimi i KESH pritet të jetë konsiderueshëm nën mesataren historike të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 me vetëm 2.6 TËh energji të parashikuar të prodhohet.

Duke vlerësuar se periudhën tranzitore të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 46, dt.19.03.2019 e cila lehtësoi situatën financiare të OSHEE SHA duke parandaluar rrezikun e pamundësisë së aftësisë paguese dhe shmangur akumulimin e penaliteteve për mos likudim në kohë të detyrimeve dhe nuk çënoi numrin e tregëtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike nga OSHEE SHA.

ERE ka miratuar me vendimin nr. 97, datë 21.06.2019 kërkesën e OSHEE SHA për shtyrjen e periudhës tranzitore të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 46, dt.19.03.2019, lidhur me afatin e kryerjes së pagesave që ndërmarrja OSHEE SHA duhet të kryente kundrejt furnitorëve fitues të ankandëve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjise elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë. OSHEE SHA ka kërkuar ndryshimin e kësaj periudhe tranzitore nga 90 ditë në zgjatjen e saj në 180 ditë. ERE ka miratuar ndryshimin e këtij afati me vendimin nr. 97, datë 21.06.2019.

Autoriteti i Konkurrencës referuar shkresës me nr. 580/1 datë 15.10.2019 të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) si edhe publikimit në faqen zyrtare të OSHEE SHA, për procedurat e blerjes së energjise në treg të parregulluar të zhvilluara deri në fund të vitit 2019, ka kërkuar dhe ka rënë dakord me vullnet të lirë të realizoj lëvrimin e pagesës kundrejt furnizuesve të energjisë elektrike, për një periudhë 180 ditësh, pra në një afat më të gjatë të periudhës tranzitore se ERE ka miratuar në vendimin nr. 97 datë 21.06.2019, për periudhë tranzitore deri në 30.09.2019.

Ndërmarrja OSHEE SHA në mënyrë të njëanëshme, përpara miratimit të vendimit nr. 97 datë 9.03.2019 të ERE, ka përcaktuar në nenin 6.1 të kontratës së prokurimit, për blerjen e energjisë afatin 180 ditë të pagesës, ndryshe nga sa ishte përcaktuar në vendimin nr. 97, datë 21.06.2019.

Autoriteti i Konkurrencës e vlerëson afatin 180 ditor të pa miratuar nga ERE në kundërshtim me rregulloren e miratuar me vendimin nr. 103 datë 23.06.2016 prej saj.

ERE për vendimin nr. 97 datë 21.06.2019 në të cilin është shtyrë periudha tranzitore e pagesës së faturës së blerjes së energjisë elektrike nga 90 ditë në 180 ditë, nuk ka kërkuar vlerësim ex-post nga Autoriteti i Konkurrencës.

Duke e konsideruar të një rëndësie të veçantë stabilitetin financiar të shoqërisë OSHEE SHA për sa i përket interesit publik, si i ngarkuari me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 “*Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*”. OSHEE SHA në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244/2016 ka detyrimin e blerjes së energjisë së prodhuar nga Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike.

OSHEE SHA ka pozitë dominuese në tregun përkatës, meqë ERE ka miratuar me vendimin nr. 46 datë 19.03.2019 kërkesën e OSHEE SHA për shtyrjen, për një periudhë tranzitore prej 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi gjatë së cilës afati i kryerjes së pagesave nga shoqëria OSHEE SHA për tregtarët fitues të ankandëve të shitblerjes së energjisë elektrike me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të klientëve fundorë, nuk mund të vazhdoj të përligjet për një afat 180 ditë nga dita e lëvrimit të energjisë elektrike, për prokurime të kësaj natyre përtej periudhës së miratuar 30.09.2019 nga ERE.

Rritja e afateve të lëvrimit të pagesës nga 90 ditë në 180 ditë, përtej afatit 30.09.2019 mund të shkaktoj kosto shtesë për furnizuesit dhe për pasojë do të ndikoj në rritjen e çmimit të shitjes së energjisë në një treg të parregulluar. Pra një rritje e tillë sikurse evidendohet dhe në shkresën me nr.15/1 datë 15.10.2019, protokolluar në tonën me nr. 580/1 prot., datë 15.10.2019 e AAES(Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike) mund të shkaktoj elementë të cilat lidhen me vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit.

Për sa më sipër referuar konkludojmë se :

- Gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikimit për ndryshimin e kërkuar të afatit të blerjes së energjisë elektrike, nuk janë respektuar afatet sipas parashikimeve të pikës 1, nenit 21 të “Rregullores për organizmin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”.
- Procedurat e kryera nga ana e OSHEE SHA për blerjen e energjisë duke vendosur në kontratat e prokurimit afatin e pagesës për blerje të energjisë dhe shlyrjen e tyre deri në një afat 180 ditë, përtej afatit 30.09.2019 të miratuar në vendimin nr.97, datë 21.06.2019 nuk kanë marrë miratimin e ERE-s.

Pra duke vlerësuar që:

- OSHEE SHA – Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike ka një rol kyç në tregun e energjisë elektrike, i cili ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në sigurinë e shpërndarjes me energji elektrike;
- Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike është operatori i vetëm në tregun e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, pra është monopol natyror dhe si i tillë tarifat e aplikuara prej tij duhet të pasqyrojnë drejt parashikimet ligjore lidhur me afatin e kontratave për çmimin e blerjes së energjisë, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe të miratuar nga ERE.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të një ndryshim në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë:

1. Shqyrtimin e procedurave të aplikimit për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, konform parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”.
2. Të kërkohet dhe të përcaktohet qartë periudha tranzitore për aplikimin e ndryshimit të kërkuar nga ana e OSHEE SHA në blerjen e energjisë në përputhje me parashikimet ligjore të lidhur me afatin e kontratave për cmimin e blerjes së energjisë, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe brenda afatit të periudhës tranzitore 30.09.2019 të miratuar nga ERE.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 660, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, në procedurat gjyqësore”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me procedurat e caktimit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime, ne procedurat gjyqësore.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) , neni 29/1 dhe nenin 69 dhe 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar ankesa me nr. 340 Prot., datë 28.05.2019, ku ankuesi është ekspert vlerësues dëmi në sigurime, i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe pjesë e listës që disponon gjykata për përzgjedhjen e ekspertëve.
2. Sipas ankuesit, në gjykatë janë rreth 40 ekspertë të pavarur që realizojnë ekspertime në lidhje me vlerësimet e dëmeve dhe nga gjykata thërriten vetëm pak prej këtyre ekspertëve dhe shumica e ekspertëve edhe pse paguajnë detyrime, taksa dhe tatime nuk thërriten si ekspertë nga gjykata. Sipas ankuesit në Gjykatën e Tiranës janë rreth 60 çështje në muaj dhe ankuesi pretendon se personalisht që nga Prilli 2016 e deri sot është caktuar vetëm në 2 prej tyre ndërkohë që duhet të ishte caktuar sipas tij në 24 çështje.
3. Në nenet 224 e në vijim të Kodit të Procedurave Civile parashikohet mënyra se si zgjidhet eksperti dhe përgjegjësitë e tij. Në nenin 225, pika 1 të K.Pr.C shprehimisht thuhet se caktimi i ekspertit bëhet nga Gjykata.
4. Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar se ekspertët përzgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë.
5. Në Udhëzimin nr. 1, datë 6.3.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.201 të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”, është parashikuar se përzgjedhja e ekspertëve bëhet mbështetur në të dhënat e Regjistratit Elektronik të Ekspertëve, regjistër që e vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë. Gjykata, bën përzgjedhjen e ekspertëve në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke konsideruar që çdo ekspert nuk mund të caktohet për të ofruar ekspertizën e tij më shumë se 30% të numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertizë brenda një viti kalendarik. Kjo për arsye që të

- sigurojë një nivel transparence të përshtatshme lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve nëpërmjet mjeteve elektronike.
6. Bazuar në nenin 226 të Ligjit nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, institucioni kompetent për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurimeve është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Vlerësuesit e dëmeve të licencuar, sipas pikës 4 të këtij neni, regjistrohen në regjistrin përkatës, i cili mbahet nga ky Autoritet.
 7. Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar me shkresën nr. 340/1 Prot., datë 08.07.2019 “Kërkim informacioni”, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, duke kërkuar informacion lidhur me numrin total të procedurave gjyqësore për të cilat është kërkuar ekspert për vlerësimin e dëmeve në sigurime, ekspertët e caktuar nga gjykata dhe listën e ekspertëve që përdor gjykata.
 8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. 340/5 Prot të AK, datë 19.07.2019 “Kthim përgjigje shkresës nr.340/1, datë 08.07.2019” na bën me dije se përsa i përket mënyrë së përzgjedhjes së ekspertëve është kompetencë e trupës gjyqësore dhe nuk ka një referim të caktuar ligjor.
 9. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr 340/4, datë 18.07.2019 “Kthim përgjigje” na bën me dije se përgjatë vitit 2018 dhe deri në ditët e sotme 2019 nuk është gjykuar asnjë çështje gjyqësore për vlerësimin e dëmeve në sigurime nga kjo gjykatë.
 10. Ministria e Drejtësisë është përgjigjur me shkresën nr. 340/3 Prot., datë 17.07.2019 “Kthim përgjigje shkresës suaj me nr. 340/2 Prot., datë 08.07.2019”, se Ministria e Drejtësisë bazuar në nenin 224/d të Kodit të Procedurës Civile dhe Udhëzimit të Ministrisë nr.10619, datë 19.10.2018 “Për krijimin, Administrimin dhe Vënien në Dispozicion për Publikun të Regjistrin Elektronik për Ekspertët”, është institucioni që krijon, administron dhe vë në dispozicion për publikun një Regjistër Elektronik për Ekspertët. Ky regjistër ndahen në seksione të ndryshme, duke grupuar ekspertët sipas fushave të tyre të ekspertizës dhe vendit ku punojnë. Në përfundim të këtij procesi regjistri elektronik i ekspertëve do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
 11. Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr.340/9 Prot., datë 01.10.2019 “Kërkim informacioni”, i është drejtuar Gjykatave të Rretheve Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, duke kërkuar informacion lidhur me numrin total të procedurave gjyqësore për të cilat është kërkuar ekspert për vlerësimin e dëmeve në sigurime, listën e ekspertëve mbi të cilën bazohet gjykata në caktimin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve në sigurime si dhe informacion statistikor lidhur me numrin e çështjeve për çdo ekspert në këtë fushë.
 12. Nga sa më lart konstatohet se Gjykatat theksojnë faktin se caktimi i ekspertit është në diskrecionin e gjykatësit, i cili e zgjedh ekspertin bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.
 13. Vihet re se Gjykatat i referohen listës së ekspertëve të miratuar nga AMF dhe se ka një shpërndarje të rasteve të shqyrtimit lidhur me dëmet në sigurime, duke pasur parasysh edhe numrin e kufizuar të rasteve nëpër rrethe.
 14. Evidentohet fakti se është Ministria e Drejtësisë, e cila krijon regjistrin elektronik të ekspertëve. Me Udhëzimin Nr. 10619, datë 19.10.2018 “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistrin Elektronik për Ekspertët”, Ministria e Drejtësisë krijon, administron dhe publikon Regjistrin Elektronik për Ekspertët, i cili mbahet në format elektronik dhe ndahet në seksione, duke i grupuar ekspertët sipas fushës së tyre të ekspertizës dhe vendit ku ata punojnë, referuar juridiksionit territorial të rretheve gjyqësore.

15. Në pikën 33 të këtij Udhëzimi është përcaktuar një afat 4 mujor brenda të cilit Grupi i Punës së bashku me sekretariatit teknik ndjekin procedurat e nevojshme të përcaktuara në udhëzim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 24, shkronja (d) (f), nenin 29/1, nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë krijimin, administrimin dhe publikimin e Regjistrimit Elektronik për Ekspertët vlerësues të dëmeve në sigurime, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Me krijimin e Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve, Ministria e Drejtësisë njofton edhe Autoritetin e Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 661, Datë 21.11.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.

Baza ligjore: Neni 24, gërma (d), neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin Nr. 10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”.
2. Këshilli Drejtues i AKEP-it me vendimin Nr. 11, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare”.
3. Autoriteti Konkurrencës pas shqyrtimit të dokumentit për këshillim publik të AKEP “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*” me Vendimin Nr. 634, datë 04.07.2019 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”.
4. Autoriteti Konkurrencës pas shqyrtimit të dokumentit për këshillim publik të AKEP “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare*” me Vendimin Nr. 635, datë 04.07.2019 vendosi “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare”.
5. Vodafone Albania me shkresën Nr. 540 Prot., datë 23.09.2019, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës komunikimin e qëndrimit në lidhje me rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës për

Analizën e Tregut të AKEP dhe tregun e shërbimeve celulare në përgjithësi.

6. AK ka realizuar dy takime konsultative me Vodafone Albania në datat 11.10.2019 si dhe më 01.11.2019 ku janë diskutuar qëndrimet e Vodafone Albania lidhur me analizat e AKEP në tregun e shërbimeve celulare.
7. Sipas Vodafone Albania procesi normal për të analizuar tregun është së pari të identifikojmë situatën nga pikëpamja e tregut me pakicë, nëse ka probleme të konkurrencës dhe nëse është kështu të zbatojmë testin e tre kritereve, sipas udhëzimeve të Komisionit Evropian. Dhe nëse testi rezulton pozitiv për secilin nga kriteret, të mundohemi të gjejmë nëse ka vërtet në treg një operator me fuqi të ndjeshme.
8. Hapi i parë i procesit është që të shikojmë nëse duhet të zbatohet ndërhyrja ex-ante dhe AKEP e ka ndërmarrë testin e tre kritereve dhe në gjykimin dhe provat e Vodafone Albania, vlerëson së ky test nuk është përmbushur në asnjë nga kriteret.
9. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian dhe BEREC.
10. AKEP-i përcakton tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke pasur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sektor dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.
11. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.
12. Direktivat dhe rekomandimet e KE, veçanërisht dokumentet shoqërues të rekomandimeve për tregjet përkatës, e bëjnë të qartë se që një treg të jetë i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, duhet të realizohen të tre kushtet. Nëse edhe njëri prej tyre nuk realizohet atëherë tregu nuk mund të konsiderohet si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante.
13. KE në 7 Maj 2018 ka miratuar udhëzimin e ri për analizën e tregut dhe FNT “Udhëzimi i Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik”, që zëvendëson Udhëzimin e vitit 2002.
14. Sipas pikës 26 të Udhëzimit të KE (2018/C 159/01), pika fillestare e çdo analize duhet të jetë një vlerësim i tregjeve me pakicë duke marrë parasysh zëvendësueshmërinë nga ana e kërkesës dhe ofertës nga perspektiva e përdoruesve fundorë mbi periudhën e ardhshme të rishikimit bazuar në kushtet ekzistuese të tregut dhe gjasat e zhvillimit të tyre.
15. Si dhe sipas pikës 15, pika fillestare për identifikimin e tregjeve me shumicë të justifikueshme për ndërhyrjen ex-ante duhet të jetë gjithmonë analiza e tregut me pakicë.
16. Komisioni Evropian ka theksuar dhe në vendimet e mëparshme se kushtet e tregut me pakicë mund të informojnë një Autoritetit Rregullator për strukturën e tregut me shumicë, por nuk janë në vetvete përfundimtare për sa i përket gjetjes së një operatori me FNT në tregun me shumicë.
17. Siç përcaktohet në disa vendime të Komisionit në bazë të nenit 7 të Direktivës 2002/21/EC, nuk ka nevojë të provohet nëse një/disë sipërmarrës ka/kanë fuqi të ndjeshme në tregun me pakicë, në mënyrë që të

përcaktohet që një/disa sipërmarrës ka/kanë fuqi të ndjeshme dhe në tregun me shumicë.

18. Direktivat dhe rekomandimet e KE, veçanërisht dokumentet shoqërues të rekomandimeve për tregjet përkatës, e bëjnë të qartë se që një treg të jetë i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, duhet të realizohen të tre kushtet. Nëse edhe njëri prej tyre nuk realizohet atëherë tregu nuk mund të konsiderohet si treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante.
19. Për sa më sipër duke qenë se AK për arsye të interesit të përgjithshëm vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ si dhe bën rekomandime përkatëse, Komisioni Konkurrencën vlerëson se AKEP duhet të marrë në konsideratë komentet e Vodafone Albania lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
1. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për dokumentin për këshillim publik "Analizë e tregut të shërbimeve celulare - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare", të vlerësojë:
 - Komentet e Vodafone Albania, depozituar në AKEP datë 18.06.2019 lidhur me Analizën e Tregut të shërbimeve celulare në përgjithësi.
 - Të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit European për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2018/C 159/01) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 666, Datë 23.12.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vorë” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Vorë” SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për Ujësjetllës Kanalizime Vorë SH. A,

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 430 prot., datë 22.11.2019, informon Autoritetin e Konkurrencës se me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr.05 prot., datë 01.02.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Vorë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetllësit, në të gjithë zonën e shërbimit pas riorganizimit.
2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Vorë SHA”, rezultoi se:
 - Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale.
3. ERRU thekson që shoqëria “UK Vorë” SHA aplikon tarifa të miratuara nga ERRU të unifikuara për të gjithë zonën e shërbimit, por kërkon ndryshimin e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit, sepse kërkon të kryej investime afatgjatë, përmirësimin e gjendjes financiare të ndërmarrjes si edhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve për të gjithë zonën pas riorganizimit bazuar në:
 - Vendimi nr. 47 datë 07.11.2017 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për ndërmarrjen UK Tiranë SHA”.
4. *Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm*, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja ka aplikuar tarifën 65 lek/m³, për konsumatorin publik ka aplikuar tarifën 140lek/m³ dhe për konsumatorin privat ka aplikuar tarifën 155lek/m³. Tarifa e propozuar për zonën e riorganizuar nga UK Vorë SHA është:

- 80 lek/ m³ për konsumatorët familjar duke pësuar një rritje prej 15 lekë/m³ ose 23% më shumë se tarifa aktuale,
 - për konsumatorin publik është propozuar tarifa 150 lek/m³ duke pësuar një rritje prej 10 lekë/m³ ose 7% më shumë se tarifa aktuale
 - për konsumatorin privat është propozuar tarifa 190 lek/m³ duke pësuar një rritje prej 35 lekë/m³ ose 18% më shumë se tarifa aktuale.
5. Rritje e tarifës volumetrike për furnizimin me ujë për të tre kategoritë, familjare, publike dhe private nuk është miratuar nga ERRU. Kjo vlerë është propozuar nga ERRU të mbetet e pandryshuar 65 lek/ m³ për të gjithë zonën e shërbimit të furnizimit me ujë për klientët familjar, 140 lekë/ m³ për klientët privat dhe 155 lekë/ m³ për klientët privat.
6. Njëpërmjet aplikimit, ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Vorë SHA, propozon rritje të tarifave volumetrike për largimin e ujërave të ndotura për të tre kategoritë. Propozohet ndryshimi i tarifës si më poshtë:
- 18 lekë/m³ për konsumatorët familjar duke pësuar një rritje prej 7 lekë/m³ ose 36% më shumë se tarifa aktuale
 - 50 lekë/m³ për konsumatorin publik duke pësuar një rritje prej 20 lekë/m³ ose 40% më shumë se tarifa aktuale
 - 50 lekë/m³ për konsumatorin privat duke pësuar një rritje prej 15 lekë/m³ ose 30% më shumë se tarifa aktuale
7. ERRU nuk e gjen të justifikuar ndryshimin për të gjitha tarifatat e propozuara nga Ndërmarrja, pasi nuk janë të bazuara në shqyrtimin e Bilancit të Ujit, Modelit të Aplikimit si edhe Pasqyrat Financiare të vitit 2017-2018 prandaj ka vendosur mos ndryshimin e tarifave të ujit për të tre konsumatorët, por ndryshimin e tarifave fikse dhe tarifës volumetrike të KUN vetëm për konsumatorin familjar. Tarifa e rishikuar nga ERRU për konsumatorin familjar e propozuar për t'u miratuar është 15 lekë/m³ ose 27%.
8. Nga analiza e kryer, bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2019 dhe vitin 2020 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, duke reduktuar kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar uljen e humbjeve teknike dhe administrative si edhe synimin kryesor për rritjen e qëndrueshmërisë financiare, trasnparencën në përfitimin e investimeve, rritjen e efikasitetit në faturime dhe menaxhimin e humbjeve teknike.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Vorë SHA nuk arrin të mbulojë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes dhe në këtë aplikim synon përmirësimin e tij me 3% krahasuar me vitin 2018. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M nga 88% në vitin 2018, parashikohet në 84.4% në vitin 2019, ndërsa sipas nivelit të objektivit nga ERRU në vitin 2020 mbulimi i kostove të O&M parashikohet të jetë në nivelin 91.3%. UK Vorë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që tentojnë të mbulojnë nivelin 100% kostot e operim & mirëmbajtjes.
10. ERRU-ja gjykon se ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Vorë SHA për vitin 2019 do të përmirësojë nivelin e lartë të humbjeve njëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza për reduktimin e humbjeve të cilat ndikojnë në përmirësimin e performancës financiare. Ndërmarrja UK Vorë SHA duhet të mbajë në kontabilitet të ndara sipas llojit të shërbimit të ofruar kostot përkatëse, me qëllim që edhe tarifatat të orientohen drejt kostove.
11. ERRU gjykon se ndërmarrja Ujësjetës Kanalizime Vorë SHA duhet të punojë për reduktimin e nivelit të humbjeve teknike dhe administrative, duke angazhuar stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo

komponenti që bilanci të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasi të ujit që nuk maten, mbi sasi të autorizuara të pa faturuara, etj, si edhe të hartojë Bilancin e Ujit sa më real, në të gjithë zërat e tij. Gjithashtu, të gjitha pikat e prodhimit edhe pikat kryesore të rrjetit duhet të pajisen me matësa të mëdhenj me qëllim zbatimin e një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë dhe çdo muaj.

12. Tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, duke shmangur fitimin e ndërmarrjes UK Vorë SHA e cila ka pozitë dominuese dhe rregullatori duhet të stimulojë uljen e këtyre kostove, arritjen e fitimeve të arsyeshme, si dhe vendosjen e tarifave në nivele minimale, duke siguruar që konsumatorët të paguajnë çmimin e duhur për produktin dhe shërbimin që u ofrohet.
13. Duke qenë se ndërmarrja nuk ka instaluar matësa në prodhim, në pikat kryesore të rrjetit, niveli i humbjeve administrative dhe real është shumë i lartë, rekomandohet të analizojë historikun e debisë nga mos pagimi i faturave të shërbimeve UK, si edhe të hartojë një plan të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura. Gjithashtu, duhet të menaxhojë saktë dhe të shlyejë në kohë detyrimet ndaj furnitorëve me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatë vonesat duke përfituar edhe nga subvencionet e alokuara nga Qeveria. Të gjitha investimet duhet të jenë sa më transparente, të përshtatshme, efikase dhe të nxitin reduktimin e kostove nga niveli aktual si dhe përdorimin në mënyrë efektive të burimeve ujore.
14. Nga vlerësimi i Konkurrencës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Vorë SHA” rezulton se: Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Vorë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, ka detyrimin e orientimit të çmimeve drejt kostos. Në aplikimin për rritje të tarifës, UK Vorë SHA nuk ka realizuar ndarjen veç e veç dhe sipas zonave, të kostove të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga shërbimi i largimit të ujërave të ndotura gjithashtu dhe kostot për shërbimin e ofruar me ngritje mekanike apo me rënie të lirë.
15. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot totale së bashku për të dy shërbimet e ofruara, duke mos zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).
16. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masë 91.3% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 8.7% nga rritja e nivelit të faturimit.
17. Konstatohet se vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, gjithashtu është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit.

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Vorë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.

2. ERRU të kërkoj nga Ujësjellës Kanalizime Vorë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
3. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 668, Datë 24.12.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja (d), (f) dhe nenin 69 dhe 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 574, datë 26.11.2018 “Për hapjen e Procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira” vendosi Hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira (shërbimin e noterisë, avokatisë dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme).
2. Arsytet e hapjes së hetimit është fakti se Tregu i Profesioneve të Lira, si treg i rregulluar, mund të paraqesë kufizime në hyrjen dhe sjelljen profesionale.
3. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një studim në tregun e profesioneve të lira. Studimi u mbështet mbi praktikat më të mira të vlerësimit të tregut të shërbimeve të noterisë & avokatisë të OECD.
4. Në Janar 2019 janë përgatitur shkresat drejtuar institucioneve të ndryshme si: Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Institutit të Statistikave; Dhomës Kombëtare të Avokatisë (DHKA); Dhomës Kombëtare të Noterëve (DHKN); Shoqërisë së Vlerësuesve të Pasurive të paluajtshme (SVP).
5. Janë zhvilluar takime respektive për të kuptuar problematikat e sektorit me DHKN si dhe me SVP.
6. Në 18 korrik 2019, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur për organizimin e seancave dëgjimore me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe me Shoqatën e Vlerësuesve. Për mospjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të tre organet, seancat dëgjimore nuk u zhvilluan.
7. Shërbimet e Profesioneve të Lira kane një rol të rëndësishëm në përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë në përgjithësi dhe ofrimin e shërbimeve publike për konsumatorët në veçanti. Sipas Raportit të Komisionit Evropian, shërbimet profesionale janë motori kryesor i rritjes në BE, duke përbërë 54% të GDP dhe për 67% të punësuarve. Sipas statistikave të INSTAT numri i kontribuesve në profesionet e lira është rritur në vitin 2017, 10% krahasuar me vitin 2016. Numri i kontribuesve në profesionet e avokatit,

noterit dhe vlerësuesit që janë në procedurë hetimore, përfaqësojnë rreth 36% të numrit total të kontribuesve të profesioneve të lira.

8. Arsyeja e parë pse nevojitet rregullimi i shërbimeve profesionale bazohet në konceptin e “asimetrisë së informacionit” ndërmjet klientëve dhe ofruesve të shërbimeve. Një tipar përcaktues i shërbimeve profesionale është se ato kërkojnë që ofruesit të shfaqin një nivel të lartë të njohurive teknike. Konsumatorët mund të mos i zotërojnë këto njohuri teknike dhe prandaj e kanë të vështirë të gjykojnë në lidhje me cilësinë e shërbimeve që marrin. Ka një ekzistencë të informacionit asimetrik midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve. Ofruesit duhet të kenë një nivel të lartë të ekspertizës teknike që konsumatorët nuk kanë domosdoshmërisht, kështu që ata mund të kenë vështirësi në vlerësimin e cilësisë së shërbimeve që ata blejnë.
9. Arsyeja e dytë pse nevojitet rregullimi i shërbimeve profesionale bazohet në konceptin e “eksternaliteteve”. Në tregje të caktuara, ofrimi i një shërbimi mund të ketë ndikim mbi palë të treta dhe jo vetëm mbi klientin që blen shërbimin apo marrësin e shërbimit.
10. Arsyeja e tretë pse nevojitet rregullimi i shërbimeve profesionale bazohet në konceptin e të “mirave publike”. Shërbime të caktuara profesionale konsiderohen se prodhojnë të mira publike që janë me vlerë për shoqërinë në përgjithësi.
11. Shërbimet e profesioneve të lira rregullohen nga akte ligjore dhe nënligjore të miratuara, duke pasur mbikëqyrjen si të institucioneve shtetërore por edhe të organizmave të tyre, që vetë ata kanë krijuar, duke nxjerrë edhe akte rregulluese të brendshme të miratuara nga organet e tyre drejtuese, të detyrueshme për zbatim, duke sjellë kështu një vetë rregullim të ofrimit të këtyre shërbimeve.

PROFESIONI I AVOKATIT

12. Profesionin e Avokatit rregullohet, organizohet dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 55, datë 23.7.2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore.
13. Konstatohet se në këtë profesion tregu është i liberalizuar, nuk ka barriera në hyrje, kufizime territoriale në ofrimin e këtij shërbimi, kufizime të reklamës apo strukturës së biznesit. Avokati i licencuar mund ta ushtrojë veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
14. Konstatohet se tarifat përcaktohen me marrëveshje midis palëve. Pritet të miratohen akt ligjore ku të përcaktohen tarifat referuese të shpërblimit të avokatit, të cilat zbatohen në rastin kur në marrëveshjen me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit, nuk është parashikuar mënyrë shpërblimi.
15. Vërehet se akoma nuk është plotësuar akoma kuadri i plotë nënligjor në fushën e avokatisë bazuar në ligjin e ri të 2018.
16. Pritet të miratohet një Udhëzim i Përbashkët lidhur me tarifat në rastet e mbrojtjes së detyrueshme bazuar në Kodin e Procedurës Penale.
17. Ndërkohë, vijon të jetë në fuqi Urdhri i Ministrit të Drejtësisë Nr. 1284/3, datë 16.03.2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënie të ndihmës juridike”, i cili ka përcaktuar tarifat e shpërblimit për shërbimet e ofruara nga avokatët, jo vetëm për mbrojtjen e detyrueshme por edhe tarifa të tjera. Këto tarifa zbatohen në rastet kur midis avokatit dhe klientit nuk ka marrëveshje paraprake për shpërblimin. Pavarësisht urdhrin të mësipërm, nuk kufizohet e drejta e një marrëveshje të mëvonshme midis avokatit dhe klientit në lidhje me çmimin.
18. Konsumatori duhet të ketë të qartë pagesën e tarifës që do paguajë. Transparenca e çmimeve dhe dhënia e një informacioni të plotë, është element i rëndësishëm dhe në zyrën e çdo avokati duhet të jetë e publikuar lista përkatëse e çmimeve.

19. Në Shqipëri numri i avokatëve është relativisht i lartë dhe i mjaftueshëm për të përballuar kërkesat në rritje nga ana e konsumatorëve. Numri i avokatëve në RSH është në total 2651 nga të cilët 1775 ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë kurse të tjerët nëpër rrethe.
20. Konstatohet se në lidhje me reklamën dhe publicitetin e veprimtarisë së avokatit, në Ligjin 55/2018 nuk vërehet ndonjë dispozitë, e cila të parashikojë një gjë të tillë. Studiot e avokatisë në faqet e tyre të web kanë të pasqyruar kryesisht llojet e shërbimeve, historikun e veprimtarisë së tyre, duke dhënë një panoramë të shërbimeve që ofrojnë. Nga konstatimet nëpër tabelat përkatëse ku evidentohet fakti se në një vend të caktuar ofrohet shërbimi i avokatisë, nuk vërehen publicitet rreth veprimtarisë, përveçse orientim lidhur me faktin se aty ofrohet shërbimi i avokatisë duke dhënë edhe kontaktet e avokatit përkatës. Gjithashtu, nuk janë konstatuar reklama apo publicitet i kryer nga studiot ligjore në media apo televizione, ku të reklamohet veprimtaria e studiove të avokatisë.
21. Cilësia e shërbimit është diçka që duhet vlerësuar dhe analizuar rast pas rasti në varësi të nevojave të konsumatorëve për ekspertizë dhe përfaqësim në fusha të ndryshme.
22. Konstatohet se bazuar në nenin 52 të Ligjit, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, është autoriteti i vetëm i cili përgjigjet për hartimin dhe zhvillimin e strategjisë së edukimit profesional të avokatëve. Programi i trajnimit, përveç trajnimit fillestar që ofrohet për kandidatët për avokatë, parashikon edhe trajnimin vazhdues, që organizohet për avokatët që ushtrojnë profesionin.
23. Vijueshmëria e ofrimit të kualifikimeve dhe trajnimeve vijuese është shumë e rëndësishme për ofrimin e shërbimit të avokatisë. Në nenin 54 të ligjit janë parashikuar dispozita konkrete të cilat duhet të zbatohen deri në marrjen e vërtetimeve përkatëse për ndjekjen e tyre nga Dhoma e Avokatisë, sipas fushave specifike të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
24. Në Statutin e DHKA, nuk janë bërë ndryshimet e duhura për përfshirjen e shumë elementëve të cilat janë shtuar në Ligjin Nr. 55/2018 “Për Avokatinë” dhe duhet të gjejnë pasqyrim në dispozitat e Statutit.
25. Konstatohet se bazuar në nenin 57 të Ligjit organet e caktuara nga ligji ngarkohen me detyrimin e hartimit dhe miratimit të akteve të nevojshme nënligjore.

PROFESIONI I NOTERIT:

26. Profesionin e noterit në Shqipëri rregullohet, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit 110/2018 “Për Noterinë”
27. Konstatohet fakti se pas miratimit të ligjit të ri për noterinë, nuk është plotësuar akoma baza ligjore me aktet e nevojshme nënligjore të cilat plotësojnë kuadrin ligjor në fushën e noterisë. Konstatohet se bazuar në dispozitat e ligjit 110/2018 pritet që të hartohen dhe miratohen rreth 33 akte nënligjore, të cilat do të rregullojnë fushën e veprimtarisë së noterit në RSH.
28. Sipas Legjislacionit Shqiptar, profesioni i Noterit është profesion i lirë dhe i nënshtrohet vetëm ligjit, ai licencohet nga Ministri i Drejtësisë. Leja për ushtrimin e profesionit të noterit, së bashku me të dhënat përkatëse, regjistrohen në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe në Dhomën Kombëtare të Noterisë.
29. DHKN mbledh dhe organizon të gjithë noterët në RSH. Çdo noter është detyrimisht anëtar i DHKN. Dhoma e Noterisë në nivel vendor përbëhet nga të gjithë noterët që janë caktuar të ushtrojnë veprimtarinë materiale në juridiksionin e saj.
30. Konstatohet se numri i noterëve që ushtrojnë noterinë në Shqipëri është më i madh se sa 1 në 15 000 siç e përcakton ligji. Numri i përgjithshëm i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jetë në përpjesëtim të arsyeshëm me numrin e përgjithshëm të popullsisë. Aktualisht

në Shqipëri bazuar në nenin 142 të ligjit është pezulluar dhënia e licencave të reja për noter derisa të arrihet raporti midis numrit të përgjithshëm të noterëve dhe popullsisë siç përcaktohet në nenin 10 (1 noter për 15 000 banor rezidentë).

31. Tarifat e shërbimit për këtë profesion miratohen nga Ministria e Drejtësisë në mbështetje të urdhrit Nr. 279, datë 14.6.2012 “Për miratimin e tarifave të Shërbimeve Noteriale”. Bazuar edhe në dispozitat e ligjit të ri konstatohet fakti se do të hartohet dhe miratohet një akt nënligjor i cili të përcaktojë tarifat e shërbimeve noteriale. Kjo bazuar në eksperiencën e deritanishme dhe në kulturën shqiptare.
32. Konstatohet se për tu licencuar si noter duhet të kryhen kualifikimet e nevojshme, të ndiqen kurset e duhura dhe të kryhen provimet përkatëse.
33. Pas përfundimit të fakultetit, për tu licencuar si noter, duhet të kryhen provime pranimit dhe kualifikime, stazh pune dhe kërkohet një eksperiencë e caktuar para emërimit definitivisht si noter. DHKN kryen analizën mbi nevojën e zhvillimit të provimit të pranimit në formimin fillestar. Pas kalimit me sukses të provimit dhe pranimit në formimin e vazhduar, ky formim fillestar i vazhduar është i detyrueshëm për tu ndjekur për një periudhë 1 vjeçare. Pas përfundimit të këtij programi të detyrueshëm, aplikanti i nënshtrohet një provimi përfundimtar, që mbulon gjithë lëndët e zhvilluara. Kandidati për noter, pas përfundimit me sukses të trajnimit praktik 2 vjeçar si i tillë pranë një zyre noteriale, ka të drejtë të hyjë në provimin e kualifikimit për noter dhe kur kalojnë me sukses provimin vendosen në një listë pritjeje për hapjen e pozicioneve si zëvendës noterë. Noter bëhen ata zv/Noter kur krijohet një vend vakant, të cilët janë të parët në listën përkatëse ku janë shënuar të gjithë zv/noterët dhe detyrimisht ai zv/noter i cili i bie të jetë më i vjetri (me më shumë eksperiencë).
34. Konstatohet se Dhoma e Noterisë duhet të ofrojë kualifikim dhe trajnime të vazhdueshme, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë për noterët. Ky është një detyrim i cili është përcaktuar edhe në pikën ç) të nenit 81 të Ligjit për noterinë, ku dhoma ka kompetenca të sigurojë formimin fillestar të kandidatëve për noterë dhe formimin e vazhdueshëm për noterët si dhe rrit kualifikimin profesional të kandidatëve për noterë, zëvendës noterë dhe noterë.
35. Dhoma duhet të themelojë dhe të organizojë Qendrën Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, e cila funksionon si strukturë e dhomës por ka pavarësi akademike. Gjithashtu është e rëndësishme hartimi i akteve nënligjore përkatëse në lidhje me programin e detyrueshëm të formimit fillestar dhe formimit të vazhdueshëm për noterët.
36. Konstatohet se shërbimi i noterisë bazuar në ligjin e ri duhet të dixhitalizohet, dhe çdo veprim noterial do të regjistrohet automatikisht duke sjellë transparencë, kontroll me të detajuar dhe mungesë të informalitetit. Ky sistem gjithashtu do të lehtësojë komunikimin midis noterëve në Shqipëri por edhe më gjerë, dhe do të shmangë problemet e deritanishme në konkurrencën e pandershme midis noterëve, ku evidentoheshin raste të praktikave noteriale të cilat nuk regjistroheshin fare, kryheshin poshtë niveleve të fiksuara të tarifave të përcaktuara duke sjellë si konkluzion edhe mungesën e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së këtyre veprimeve.
37. Konstatohet fakti se nuk lejohet reklamimi i profesionit të noterit përtej asaj çka përcakton Urdhri i MD Nr. 8046, datë 02.12.2004 “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, lidhur me elementë të caktuar të reklamimit të aktivitetit të tilla si: tabelë e përmasave 0.6*1 në të cilën të shënohet fjalët “Noter”, emri e mbiemri sipas dëshirës, adresën e zyrës dhe numrin e telefonit, Jo më shumë se një tabelë, e cila është unike për të gjitha zyrat dhe kjo tabelë nuk mund të vendoset përveçse në fasadën e zyrës etj. Nga sa më lart, në vendin tonë shërbimi i noterisë nuk e lejon përdorimin e reklamës. Tabela e noterit e vendosur pranë zyrës së noterit jep vetëm

informacion për klientin, që ofrohet shërbim noterial, si edhe është përcaktuar forma dhe përmasat e tabelës.

38. Është e vërtetë që ka një informacion asimetric midis ofruesve të shërbimit që janë noterët dhe marrësve të shërbimit, konsumatorët, të cilët duhet të jenë më tepër të informuar lidhur me të drejtat e tyre. Duhet të ketë një transparencë dhe informim në lidhje me shërbimet e ofruara pasi behet fjalë për shërbime të cilat kërkojnë një nivel të caktuar ekspertize, për të cilat konsumatorët nuk kanë nivelet e duhura të njohurive. Në çdo rast, duke qenë se behet fjalë për shërbime dhe të mira të besueshme, krijohet një marrëdhënie mirëbesimi midis ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorëve, ku secili ka nivelin e vet të përgjegjësisë.

PROFESIONI I VLERËSUESIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

39. Profesionit i vlerësuesit të pasurive të paluajtshme rregullohet nga VKM Nr. 712 datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme” dhe akte të tjera nënligjore në fuqi.
40. Konstatohet se mund të ketë nevojë për një rregullim më të mirë të kuadrit ligjor, përmirësimin e legjislacionit ekzistues, duke hartuar rregullore që do të nxisin konkurrencën dhe do të çojnë në shërbime më cilësore dhe më shumë zgjedhje për konsumatorët dhe përdoruesit.
41. Konstatohet se nuk ka tarifa të përcaktuara për ofrimin e shërbimit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, tarifa fikse apo të rekomanduara. Tarifat i përcakton vetë ofruesi me marrësin e shërbimit nëpërmjet negociatave apo dakortësisë midis tyre.
42. Konstatohet se nuk ka kufizime lidhur me ushtrimin e profesionit të VPP, shërbim i cili, mund të ofrohet, në të gjithë territorin e RSH-së.
43. Konstatohet se bazuar në VKM Nr. 712/2016 janë përcaktuar kriteret dhe kushtet për licencimin, shkalla e dytë pastaj shkalla e parë, duke vështirësuar disi marrjen e licencës së shkallës së parë nga ana e vlerësuesve të shkallës së dytë. Kufizimet e tepërta të licencimit, numri i kufizuar i të licencuarve të shkallës së parë, në kushtet kur nuk ka tarifa të përcaktuara por ato janë objekt diskutimi dhe negociimi midis ofruesit dhe marrësit të shërbimit, mund të çojnë në çmime më të larta pa siguruar cilësi më të lartë.
44. Konstatohet se bazuar në VKM Nr. 712/2016 nuk parashikohet formë tjetër zëvendësuese apo mënyrë alternative e dorëzimit të dokumentacionit për licencim përveç asaj elektronike.
45. Konstatohet se Vlerësuesit e Pasurive të paluajtshme mund të jenë anëtarë të Shoqërisë së Vlerësuesve të Pasurive mbi baza vullnetare. Anëtarësimi nuk është i detyrueshëm.
46. Konstatohet se Shoqata e Vlerësimit të pasurive nuk është shumë e përfshirë në proceset e ndryshme rregulluese të këtij profesioni. Kjo shoqatë ka vetëm një përfaqësues në Komisionin e Posaçëm të Licencimit. Në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore nuk konstatohet përfshirja e SVP.
47. Konstatohet se përdoren Standardet Evropiane të Vlerësimit dhe nuk ka standarde shqiptare për kryerjen e vlerësimit të pasurive të paluajtshme.
48. Konstatohet se institucione të tilla si INSTAT apo MIE, nuk kanë të dhëna të detajuara lidhur me profesionet e lira të cilat ushtrojnë aktivitetin në vlerësimin e pasurive të paluajtshme lidhur me xhiron që realizojnë dhe numrin e të punësuarve. Si pasojë nuk ka një vlerë reale të këtij tregu në përgjithësi si dhe tregjeve përkatëse pjesë të tij.
49. Konstatohet se nuk ofrohen kurse të trajnimit të vazhduar për vlerësuesit e pasurive të paluajtshme. Pas marrjes së licencës, nuk ka specializime apo trajnime për tu kualifikuar apo përditësuar me informacione

të reja në këtë fushë. SVP ka aplikuar për një Projekt të Bashkimit Evropian dhe një nga pikat e draft projektit është pikërisht ofrimi i kurseve dhe trajnimeve të mëtejshme në këtë fushë.

50. Konstatohet se procesi i përzgjedhjes së vlerësuesve nga ana e Bankave apo Përmbarrimit (pranë Bankave) për vlerësuesit e licencuar, nuk është shumë transparente. Ka disa banka që e vlerësojnë transparencën, procesin e përzgjedhjes dhe më pas shpërndarjen e vlerësimeve që do të kryhen tek të gjithë të përzgjedhurit. Ka banka që nuk respektojnë këtë parim duke “favorizuar” një numër të caktuar vlerësuesish.
51. Konstatohet se aktualisht Regjistri Elektronik i Ekspertëve ndodhet në proces përditësimi bazuar në vlerësimin e kërkesave të administruara, ku më përfundimin e kësaj procedurë ky regjistër do të jetë i aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr.10619, datë 19.10.2018 ‘Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrimit elektronik për ekspertët’, është duke kryer shqyrtimin dhe verifikimin e plotësimin të kriterëve ligjore të aplikimeve të paraqitura.
52. Nuk konstatohen të përdoren gjerësisht reklama apo publiciteti në ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Në websitet e disa ofruesve të shërbimit janë të evidentuara eksperiencat, fushat e veprimtarisë pa elementë të tjerë kufizues.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në neni 24, shkronja (d) (f), nenin 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë që lidhur me profesionin e avokatit:
 - 1.1. Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e avokatisë bazuar në dispozitat e ligjit 55/ 2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;
 - 1.2. Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa, ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përlllogaritjes së tarifave, me qëllim vlerësimin e tyre konform ligjit 9121/2003.
 - 1.3. Respektimin e dispozitave ligjore duke ofruar transparencë lidhur me shërbimet dhe çmimet që ofron profesioni i avokatit. Mundësi aksesimi nga të gjithë konsumatorët i informacionit të nevojshëm.
 - 1.4. Kryerja e amendimeve të nevojshme në Statutin e Dhomës së Avokatisë dhe Kodin e Etikës;
 - 1.5. Faqja zyrtare e web e DHKA të pasqyrojë gjithë informacionin e nevojshëm përfshirë edhe informacionet lidhur me trajnimet që duhet të ofrojë dhoma.
2. T’i rekomandojë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterëve që lidhur me profesionin e noterit:
 - 2.1. Plotësimin e kuadrit nënligjor përkatës në fushën e noterisë bazuar në dispozitat e ligjit të 110/ 2018 “Për Noterinë”.
 - 2.2. Dërgimin për mendim dhe vlerësim të draft-akteve nënligjore të hartuara nga organet përkatëse pranë Autoritetit të Konkurrencës, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe në rastet e hartimit të akteve nënligjore që përcaktojnë tarifa, ky draft akt të jetë i shoqëruar edhe me metodologji të përlllogaritjes së tarifave, me qëllim vlerësimin e tyre konform ligjit 9121/2003.

- 2.3.DHKN duhet të ofrojë asistencën e duhur noterëve lidhur me trajnime të vazhdueshme dhe kualifikime;
- 2.4.Kur të draftohet urdhri i ri “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, të merret në konsideratë mundësia lidhur me unifikimin e përmasave të tabelave, llojit të shkrimit, vetë ngjyrës së tabelës duke ofruar të njëjtin perceptim për konsumatorët dhe pa manipuluar zgjedhjen konsumatore.
- 2.5.Përfshirja e AK për evidentimin e problematikave të ndryshme që mund të ekzistojnë dhe prekin fushën e konkurrencës. Organizimi dhe pjesëmarrja në seminare/konferenca lidhur me konkurrencën në tregun e ofrimit të shërbimeve të profesioneve të lira.
3. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjinë dhe Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive:
- 3.1.Rishikimin e kuadri ligjor ekzistues duke parashikuar dispozita ligjore për organizimin dhe funksionimin e SVP.
- 3.2.Në rast rishikimi të Udhëzimit Nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve të ekspertëve në gjykatë”, të merret mendimi i Autoritetit të Konkurrencës para miratimit të ndryshimeve. Përcaktimi i pagesave dhe tarifave të ekspertëve në çdo rast duhet të jenë të orientuara drejt kostove të ofrimit të shërbimit, të shoqëruara me metodologji të përllogaritjes së tyre dhe relacione shpjeguese.
- 3.3.Dërgimi për mendim pranë AK të çdo projekt akti i cili synon të përcaktojë tarifa, të vendosë barriera për hyrjen në treg, të shoqëruara me relacionet dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.
- 3.4.Kurset dhe provimet e kursit të formimit të vazhduar të jenë cilësore për të prodhuar diploma/certifikata cilësore me standard.
- 3.5.Të hartohen standarde shqiptare të vlerësimit si edhe të ngrihet një organizëm i pavaruar me anëtar profesionistë të licencuar për kontrollin dhe monitorimin e standardeve dhe Etikës së ekspertëve.
- 3.6.Në rast rishikimi të VKM Nr. 712 datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, të shikohet mundësia e heqjes së kufizimeve që pengojnë hyrjen në treg, lehtësimin e kushteve dhe kriterëve për të marrë licencën e VPP duke lehtësuar hyrjen në treg të profesionistëve të rinj.
- 3.7.Të forcohet roli i shoqatës së vlerësuesve, si kusht për rritjen e cilësisë së shërbimeve të vlerësimit, vendosjen e kontakteve me organizata e shoqata të së njëjtës natyrë dhe shkëmbimi i përvojës me ta; hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë ngritjen profesionale.
4. T’i rekomandojë bankave të nivelit të dytë:
- Shpërndarja e vlerësimeve duhet të kryhet tek të gjithë vlerësuesit e përzgjedhur. Procesi i përzgjedhjes së vlerësuesve duhet të jetë transparent dhe të zbatohen deri diku parimet e prokurimit publik ku vlerësuesit të konkurrojnë midis tyre nëpërmjet parimeve të mirënjohura mbi të cilat funksionon dhe rregullohet ky profesion.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 670, Datë 24.12.2019

“Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me shqyrtimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OST SHA.

Baza ligjore: Neni 24, germa d) dhe f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit mbi shqyrtimin e procedurave për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OST SHA,

VËREN SE:

1. Procedura e ndjekur

Me shkresën nr. 330/2 prot., datë 31.07.2019 (protokolluar pranë AK me Nr. 474 prot., datë 01.08.2019) Enti Rregullator i Energjisë ka dërguar vendimin e bordit Nr. 118 dt. 29.07.2019 ka filluar procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” me kërkesë të OST SHA.

“OST” SHA nëpërmjet shkresës me nr.3053 prot., datë 07.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 330 prot., datë 09.05.2019, ka përcjell për miratim draft “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, i cili është hartuar nga shoqëria “OST” SHA me asistencën teknike të financuar nga “IFC”.

OST SHA me qëllim përgatitjen e këtyre rregullave në mënyrë sa më të plotë, ka përcjell për mendim draft-rregullat e tregut shqiptar të balancimit dhe ka zhvilluar takime me palët e interesuara në zbatim të nenit 98, pika 1 e ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

ERE me anë të shkresës nr.630/5 prot., datë 14.11.2019 (protokolluar pranë AK me Nr. 474/2 prot., datë 15.11.2019) kërkon opinionin dhe qëndrimin e AK-së, pas shkresës nr.6727/2 prot., datë 31.10.2019 të OST SHA, lidhur me shqyrtimin e procedurës së “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

Vendimi nr.118 datë 22.07.2019 është bazuar në nenin 16, 19, 62, 98, 99 dhe nenin 100 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neni 19, 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurat e ERE-s.

Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin nr. 118, datë 22.07.2019 ERE, vendosi të filloj procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” sipas draftit të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) SHA me asistencën teknike të “IFC”-së.

Enti Rregullator i Energjisë në bazë të nenit 98 të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është organi kompetent për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë për qëllim të:

- a. themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, që operohet nga OST;
- b. përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në tregun e balancimit;
- c. mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut;
- d. përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit,
- e. krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruar nga OST, si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit; dhe
- f. çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues.

Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike kanë si objektiv krijimin e një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jo diskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin, si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.

Drafti i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, i paraqitur nga OST SHA për miratim, është i strukturuar në njëmbëdhjet (11) kapituj dhe tre anekse (3);

AK pasi u njohëm me vendimin e mësipërm për shqyrtimin e procedurës për “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” sipas draftit të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) SHA me asistencën teknike të “IFC”-së, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, nga OST SHA, në zbatim të nenit 69, të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, i ndryshuar, filloi puna për vlerësimin e vendimit nr.118 të ERE, i cili gjendej i publikuar në faqen e web-it të ERE-s.

ERE në mbështetje të nenit 27, 29 të” Rregullores së organizimit, funksionimit dhe dhe procedurave” për të kërkuar opinionin e grupeve të interesit dhe institucioneve organizoj një seancë dëgjimore bazuar në shkresës nr. 630/5 prot., datë 10.10.2019 me përfaqësues të palëve të interesit, për të diskutuar mbi miratimin e ndryshimit të kërkuar nga OST SHA.

OST SHA në shkresën e saj drejtuar ERE-s përpara miratimit të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, kërkon si tw arsyeshme dhe transparente të përfshihen në rregullat e tregut sa mw poshtw vijon:

a) përcaktimin e afatit kohor të zbatimit Dry-run në implementimin pa efekte financiare, pasi ky afat nuk është pjesë e përmbajtjes së rregullave të propozuara nga OST SHA.

b) në pikë 3.2 “Hyrja në fuqi e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit” përcaktohet se: “*ERE duhet të lëshojë një vendim për shfuqizimin e “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike” në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit(TSHB)” të hiqet nga draft rregullat, por të parashikohet një pikë e veçantë në raportin përfundimtar të miratuar nga ERE, sipas të cilës, të gjitha aktet e mëparshme rregullatorë, që rregullojnë balancimin në sektorin elektroenergjitë shqiptar, të shfuqizohen.*

c) në pikën 3.3.3, “procesi fillestar i shqyrtimit të zbatimit të rregullave të TSHB”, fillon në varësi të paraqitjes nga OST në ERE të një raporti përmbledhës mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave, por në këtë pikë nuk shprehet nëse paraqitja e këtij raporti është detyruese.

d) në kapitullin 4 pika 4.1.1.7 është lënë bosh pjesa për sa ditë do të pezullohet marrëveshja me Ofruesit e Shërbimit të Balancimit(OshB-në), ndërkohë që në marrëveshje në aneks është parashikuar afati 30 ditë.

e) pika 5.6.1 e rregullores si pjesë e “Çmimit të disbalancave” shprehet se: “Kostot e prokurimit të kapacitetit rezervë mbarten në tarifë. Çdo rezultat neto për OST SHA nga Pala Përgjegjëse e Balancimit (PPB) dhe shlyerja e Ofruesit të Shërbimit të Balancimit (OShB) do të përlllogariten në tarifën e vitit të ardhshëm. Të gjitha kostot e tjera të alokuara për OST për të zhvilluar, operuar dhe mirëmbajtur proceset operative që lidhen me regjistrimin e PPB, ndryshimet, dispozitat e PPB të mundësisë së fundit, shlyerjen e disbalancave, si dhe kosto e ngjashme mbulohen nga tarifa”.

f) në pikën 5.9.1.1 për Palën Përgjegjëse për Balancimin(PPB) të mundësisë së fundit, nuk parashikohen kriteret e përcaktimit të saj dhe as cili është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e PPB-së. Analogjia me FMF (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e FMF mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.

i) në pikën 5.9.3.2 përfshihet opinioni i konsulentit dhe nuk përbën një dispozitë të saktë të rregullave. Gjithashtu analogjia me FMF është e paqartë për përcaktimin e PPB së mundësisë së fundit.

j) në pikën 5.9.1.5, gërma “b” ndër të tjera thuhet se për koston e PPB të mundësisë së fundit, kostot e këtij roli të përkohshëm të PPB-së, duhet të mbarten në tarifë pa përcaktuar mënyrën e llogaritjes së këtyre kostove në kushtet e PPB së mundësisë së fundit.

k) nuk është parashikuar në këto rregulla mënyra e shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST SHA gjatë operimit të këtij tregu tek klientët.

2. Vlerësimi mbi shqyrtimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” sipas draftit të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) SHA, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.

ERE ka miratuar me vendimin nr. 118 datë 22.07.2019, fillimin e procedurave të “**Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike**” në përgjigje të kërkesës së OST SHA fillimin e procedurës së miratimit të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” sipas draftit të hartuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) SHA, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.

ERE ka miratuar vendimin nr. 118 datë 22.07.2019 duke vendosur:

- Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” bashkë me anekset përkatëse, të propozuara nga OST SHA me qëllim zbatimin e periudhës së implementimit të tyre (Dry Run) pa efekte financiare për një periudhë kohe 6 mujore.

Gjatë procedurës për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, si dhe propozimet e OST SHA, konkludojmë se janë të rëndësishme për më shumë transparencë, argumentim të kostove për të gjithë procesin, dhënien e rekomandimeve si më poshtë vijon:

- a. Përcaktimin e afatit kohor të zbatimit Dry-run për një afat të arsyeshëm, si pjesë përbërëse e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- b. Shfuqizimin e të gjitha akteve të mëparshme rregullatorë që rregullojnë balancimin në sektorin elektroenergjitik shqiptar, pas miratimit të Rregullave të TSHB.

- c. Raporti përmbledhës mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave nga OST SHA të jetë i detyruar dhe pjesë e rregullave të tregut.
- d. Unifikimin me 30 ditë i marrëveshjes për OShB-në si në draft rregullat e tregut ashtu dhe në aneksin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- e. Përcaktimi i qartë i kostos së tarifës për PPB-në nga OST dhe palët e interesit, kosto të cilat duhet të jenë të justifikuar dhe argumentuara, bazuar në përcaktimet e “Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.
- f. Përcaktimin e kriterëve si për Palën Përgjegjëse të Balancimit(PPB) të mundësisë së fundit, ashtu edhe të Autoritetit Përgjegjës të PPB-së. Analogjia me FMF (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e FMF mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.
- g. Përcaktimin e mënyrës së llogaritjes së kostove në kushtet e PPB së mundësisë së fundit në këto rregulla.
- h. Parashikimi i qartë i shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST SHA gjatë operimit të këtij tregu tek klientët si pjesë e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.

Pra duke vlerësuar që:

- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike ka një rol kyç në tregun e energjisë elektrike, i cili ndikon në mënyrë të drejtpërdrejte në sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
- Operatori i transmetimit të energjisë elektrike është operatori i vetëm në tregun e i transmetimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, pra është monopol natyror dhe si i tillë tarifat e aplikuar prej tij kundrejt PPB-ve duhet të pasqyrojnë drejt parashikimet ligjore lidhur me rregullat, përcaktimet ligjore, metodologjinë e përcaktimit të tarifës - kostove, bazuar në një kthim të arsyeshëm, një kohëzgjatje të arsyeshme të përcaktuar dhe të miratuar nga ERE.
- Gjithashtu, shërbimi i transmetimit të energjisë elektrike është i pazëvendësueshëm për pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, si rrjedhim edhe tarifat që do të aplikohen nga OST SHA do të ndikojnë në funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në transaksionet e pjesëmarrësve të tregut dhe kostot përkatëse dhe do të reflektohen në kostot e klientëve tarifore apo konsumatorët familjarë;

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet: 24, germa d) e f); 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë ERE-s që gjatë procedurës së miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, të marrë në konsideratë:
 - 1. Përcaktimi i qartë i afatit kohor të zbatimit Dry-run si pjesë përbërëse e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
 - 2. Shfuqizimin e të gjitha akteve të mëparshme rregullatorë që rregullojnë balancimin në sektorin elektroenergjitik shqiptar, pas miratimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
 - 3. Raporti përmbledhës mbi eksperiencën e fituar nga zbatimi i rregullave nga OST SHA duhet të jetë i detyruar.

4. Unifikimin e afatit të marrëveshjes për Ofruesit të Shërbimit të Balancimit si në draft rregullat ashtu dhe në aneksin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
5. Përcaktimi i qartë i kostos së tarifës për Palës Përgjegjëse Balancuese nga OST dhe palët e interesit, kosto të cilat duhet të jenë të justifikuara dhe argumentuara, bazuar në përcaktimet e “Metodologjisë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017.
6. Përcaktimin e qartë të kriterëve për Palën Përgjegjëse të Balancimit(PPB) të mundësisë së fundit, se edhe të Autoritetit Përgjegjës për përcaktimin e PPB-së. Analogjia me Furnizuesin e Mundësisë së Fundit (OSHEE aktualisht) nuk gjen mbështetje në ligj, pasi ligji nuk parashikon PPB të mundësisë së fundit, për më tepër që rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mund ta kryejë çdo furnizues që përcaktohet si i tillë dhe jo vetëm OSHEE.
7. Mënyra e llogaritjes së kostove në kushtet e Palës Përgjegjëse Balancuese (PPB-së), të mundësisë së fundit të jetë e përcaktuar si pjesë përbërëse e këtyre rregullave.
8. Të përcaktohet qartë mënyra e shpërndarjes së përfitimeve financiare të mundshme të OST SHA gjatë operimit të këtij tregu tek klientët si pjesë e këtyre rregullave.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE - 2019

VENDIM

Nr. 633, Datë 26.06.2019

“Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.06.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh) dhe neni 65 të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Udhëzuesi është përshtatur duke përfaruar Direktivën 2014/104/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 nëntor 2014 “Mbi disa rregulla që rregullojnë veprimet për dëmet e ligjit kombëtar për shkelje të dispozitave të ligjit të konkurrencës të Shteteve Anëtare dhe të Bashkimit Evropian” (32014L0104/ OJ L 349,5.12.2014) - (Directive 2014/104/EU of the European Parliament and of the Council of 26 November 2014 “On certain rules governing actions for damages under national law for infringements of the competition law provisions of the Member States and of the European Union”).
2. Udhëzuesi përcakton rregullat që nxisin konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe heqjen e pengesave për funksionimin e duhur të saj, duke parashikuar dispozita lidhur me procedurat që zbatohen për të siguruar mbrojtje për të gjithë ata që kanë pësuar një dëm nga shkelja e rregullave të konkurrencës.
3. Çdo person fizik ose juridik që ka pësuar dëmin e shaktuar nga një shkelje e dispozitave të ligjit të konkurrencës ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kompensimin për atë dëm.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) dhe 65 të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË ICN (RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS)

VENDIM

Nr. 636, Datë 04.07.2019

“Mbi miratimin e “Kornizës së Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (*Competition Agency Procedures - CAP*) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.07.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e “Kornizës ligjore të procedurave hetimore të Autoriteteve të Konkurrencës – Anëtare të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja dh) e Ligjit 9121/2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, i ndryshuar si dhe të pikës 4, neni 3 e Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Korniza e Procedurave të Autoriteteve të Konkurrencës (*Competition Agency Procedures - CAP*) – në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), përbën një set rregullash ligjore në lidhje me ndjekjen e procedurave të drejta në procesin e hetimeve dhe zbatimit të ligjit të konkurrencës, nga të gjitha Autoritetet e Konkurrencës anëtare të ICN, pjesë e të cilës është edhe Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës.
2. Korniza “Për Procedurat e Agjensisë së Konkurrencës” (CAP) në përbërje të saj përcakton kryesisht parimet që rrjeti i ICN ndjek në përputhje me punën në grupe ndërmjet Autoriteteve të Konkurrencës pjesë e rrjetit si dhe në fushën e politikës së konkurrencës, duke reflektuar gjithnjë konsensusin e gjerë brenda komunitetit global të konkurrencës. Kjo kornizë ligjore lejon rritjen e mëtejshme të ndërveprimit dhe dialogut ndërmjet Autoriteteve të Konkurrencës duke nxitur kështu konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe duke thjeshtësuar funksionimin e duhur të saj.
3. Pas analizës së bërë të Kornizës së “Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (CAP) – në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), anëtare e së cilës është edhe Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, konstatohet se asnjë prej parimeve apo rregullave të përcaktuara në të, nuk përbëjnë shkelje apo kufizim ligjor në kuptim të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar si dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) si dhe të pikës 4, neni 3 e Rregullores “Për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit Korniza e “Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” (*Competition Agency Procedures - CAP*) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

AKTE TË TJERA TË MIRATUARA NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”, I NDRYSHUAR

VENDIM

Nr. 584, Datë 17.01.2019

“Mbi miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja b) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Procedurat e kontrollit të përqendrimeve të paraqitura për shqyrtim, vlerësim dhe marrje autorizimi është rritur ndjeshëm kohët e fundit;
2. Tregjet në të cilat ndodhin transaksionet dhe rastet e paraqitura kanë prekur tregje sensitivë, me ndikim në ekonominë shqiptare;
3. Shkalla e vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit në varësi edhe të sektorëve dhe tregjeve sensitivë ka ardhur në rritje dhe vërehen transaksione në raste dhe tregjet të ndryshme dhe si rrjedhojë analiza e kryer ka qenë e veçantë rast pas rasti,
4. Qëllimi është edhe reflektimi i eksperiencave të Autoriteteve homologe të vendeve evropiane por edhe të agjencive të konkurrencës në rajon:

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja b) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, miratuar me Vendimin nr.10, datë 29.06.2004 i ndryshuar të Komisionit të Konkurrencës , shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 665, Datë 16.12.2019

“Mbi miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.12.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja dh) të Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenin 46 të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”, bazohet në nenin 46 të ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
2. Rregullorja përcakton rregullat, mjetet, mënyrat, procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në rastet e konfliktit të interesave.
3. Qëllimi i rregullores është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë në ushtrimin e funksioneve në Autoritetin e Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës”
2. Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin

Buletini Zyrtar i Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës

e Konkurrencës”, e miratuar me Vendimin nr.83, datë 02.07.2008 “Për miratimin e Rregullores së brendshme “Për parandalimin e konfliktit të interesave ne ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Konkurrencës””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

